



REPUBLIKA E BHQIPËRIË

UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"

**RREGULLORE E**

**BULETINIT SHKENCOR**

**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"**

(Miratuar me vendimin nr. 148, datë 18. 03/2022,  
të Senatit Akademik, Universiteti "Fan S. Noli")

KRYETARI I SENATIT

REKTORI

Prof. dr. Dhimitri Bello



## **Neni 1** **Periodiku shkencor: Buletini Shkencor**

1. Buletini Shkencor është periodik shkencor i njohur nga institucioni përgjegjës për certifikimin e periodikëve shkencorë të Republikës së Shqipërisë. Si vit i fillimit të botimit të tij njihet vit 1996.
2. Buletini Shkencor është botim periodik i regjistruar me numër serë ISSN 2078-7111.
3. Buletini Shkencor është botim i vetë Universitetit "Fan S. Noli". Ai ka si funksion kryesor ndihjen, zhvillimin, promovimin dhe vlerësimin e veprimtarisë kërkimore, shkencore dhe botuese të universitetit, si institucion i arsimit të lartë.
4. Parimi themelor i Buletini Shkencor është cilësia akademike, profesionalizmi dhe etika në kërkim. A boton punime origjinale të shkencara në gjuhën shqipe ose angleze dhe synon përfaqësimin e njohurive të reja të kërkimit shkencor të aplikuar.
5. Buletini Shkencor botohet të paktën dy herë në vit, në formë të printuar dhe elektronike, sipas kategorizimit të mëposhtëm:
  - 5.1 Seria e shkencave shoqërore.
  - 5.2 Seria e shkencave natyrore.
6. Procesi i botimit të Buletini Shkencor realizohet nga Bordi Shkencor dhe Komisioni i Botimeve.

## **Neni 2** **Bordi Shkencor:** **Funksionimi dhe detyrat**

1. Bordi Shkencor është organi shkencor që drejton procesin e realizimit të Buletini Shkencor, si dhe të botimeve të tjera që publikohen në nivel institucional, në nivele më të larta kryesore dhe pjesë baze.
2. Anëtarët e Bordit Shkencor vetëkandidohen dhe zgjidhen me shumicë të thjeshtë votash nga Senati Akademik, për një mandat 2-vjeçar, me të drejtë rrygjedhjeje. Ata përzgjidhen nga punonjësit akademikë me kalë të plotë të Universitetit "Fan S. Noli", nga stafi i fuar nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë, me t tuj shkencore. Anëtarët e Bordit Shkencor përfaqësojnë fusha të ndryshme studimi, brenda koadrit të fushave të studimit të përmendura në Neni 1, pika 5.
3. Bordi Shkencor kryesohet nga Rektori i Universitetit "Fan S. Noli".
4. Bordi Shkencor mbledhet në mënyrë periodike të paktën dy herë në vit.

5. Me propozim të Komisionit të Botimeve dhe sipas përcaktimeve në këtë rregullorë, Bordi Shkencor miratim formatin e thirrjeve periodike për botim, kriteret për hollim procedurën dhe dokumentacionin e pranimit të artikujve për botim.
6. Kryeredaktori i Komisionit të Botimeve është njëkohësisht Sekretar i Bordit Shkencor të Buletinit Shkencor.
7. Mandati i Bordit Shkencor është 2-vjeçar, me të drejtë përsëritjeje. Mandati fillon prej mbledhjes së tij të parë. Bordi Shkencor zhvillon mbledhjen e tij të fundit brenda muajit të fundit të mandatit.
8. Sekretarimi i anëtarit të Bordit Shkencor bëhet nga Senata Akadematike kur çënohet rëndë imazhi i Buletinit Shkencor nga veprimi ose mosveprimi i tij/saj.
9. Mënyrë e shpërndimit të anëtarëve të Bordit Shkencor përcaktohet me vendim të Bordit të Administrimit.

### **Neni 3**

#### **Komisioni i Botimeve: Funksioni dhe detyrat**

1. Komisioni i Botimeve përbëhet nga kryeredaktori, redaktorët dhe specialistë pranë Sektorit të Bashkëpunimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë.
2. Zv/Rektori për Shkencën dhe Marrëdhëniet me Jashtë është njëkohësisht kryeredaktor i Komisionit të Botimeve. Kryeredaktori udhëheq veprimtarinë e Komisionit të Botimeve dhe harton dhe paraqet për diskutim procedurat, kriteret për publikim, shpalljet e thirrjeve për botim, mbledhjen, koordinimin për redaktim dhe paraqitjen për miratim të artikujve të propozuar për botim.
3. Çdo njësi, bazë e fakulteteve ka redaktorët e saj përfaqësues.
  - 3.1 Redaktorët mbarë tituj ose grada shkencore,
  - 3.2 Ata vlerëkohësisht, përzgjidhen nga SA dhe kanë mandat 2-vjeçar;
  - 3.3 Redaktorët kujdesen për shpërndarjen e thirrjes së botimit në institucionet si dhe institucione partnere;
  - 3.4 Ata kryejnë koordinimin e listës së ekspertëve vlerësues të artikujve sipas fushave në çdo thirrje, të bashkëpunim me sekretarin e Komisionit të Botimeve;
  - 3.5 Redaktorët propozojnë titullin dhe formatin e brendshëm të paraqitjes së buletinit.
4. Specialisti pranë Sektorit të Bashkëpunimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë, është sekretar i Komisionit të Botimeve.
  - 4.1 Ai merret pjesë në të gjitha mbledhjet e Komisionit të Botimeve dhe mbulon procesin e protokollimit.
  - 4.2 Ai merret dorëzime dureshkrimeve nga autorët dhe i kontrollon për zbatimin e kriterëve për botim.
  - 4.3 Ai sigurohet që autori/autorët ka/kanë firmosur *Deklaratën e autorit*.

- 4.4 Ai përgatit një raport shpërndarës për secilin artikull dhe e paraqet në mbledhjet e Komisionit të Botimeve.
- 4.5 Sekretari koordinon listën e ekspertëve të vlerësimit dhe udhëqet procedurat e vlerësimit të detyrueshme të artikullit, në bashkëpunim me redaktorët përkatës, sipas fushave të botimit.
- 4.6 Ai rishikon procesin e botimit përfundimtar të buletinit në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës.
- 4.7 Ai ben redaktimin gjithësesor të artikujve që përzgjedhen për botim.

5. Mënyra e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Botues përcaktohet me vendim të Bordit të Administrimit.

#### **Neni 4**

#### **Thirrja dhe afatet e botimit**

- 1. Thirrja për Buletin Shkencor publikohet çdo herë në vit:
  - 1.1 Thirrja për serinë e shkencave shoqërore del në muajt mars të çdo viti kalendarik;
  - 1.2 Thirrja për serinë e shkencave natyrore del në muajt maj të çdo viti kalendarik.
- 2. Afat i dorëzimit të artikujve për secilën thirrje nuk tejkalon më tepër se dy muaj.
- 3. Pas mbledhjes së artikujve, procedurat e shqyrtimit, vlerësimit dhe miratimit paraprir nga ana e ekspertëve rryllën brenda muajt pasardhës.
- 4. Artikujt e miratuar nga ekspertët i paraqiten për miratim Bordit Shkencor të paktën një muaj para mbledhjes së tij të radhës.
- 5. Pas miratimit nga Bordi Shkencor, artikujt paraqiten pranë Sektorit të Prokurimeve të universitetit, i cili kryen procedurat administrative të botimit të serisë së radhës.
- 6. Pas botimit, sektori i Botimeve dorëzon 5 (pesë) kopje në Bibliotekën perkatese të Universitetit "Fan S. Noli" dhe 5 (pesë) kopje në Bibliotekën Shkencore Universitare, si dhe sigurohet që secili autor të marrë kopjen e tij të buletinit.
- 7. Botimi elektronik i buletinit publikohet në faqen zyrtare elektronike të Universitetit "Fan S. Noli", në hapësirën E-botime, në format PDF.
- 8. Tarifa e botimit të artikujve për autorë përcaktohet me vendim të Bordit të Administrimit.

#### **Neni 5**

#### **Mbledhjet e Komisionit të Botimeve**

- 1. Komisioni thirret për mbledhje nga kryeredaktori. Ai njofton anëtarët për mbledhjen e radhës të paktën një javë me parë. Kryeredaktori, njofton sekretarin dhe redaktorët përgjegjës që të dërgojë nëpërmjet e-mail-it të gjithë dokumentacionin (shpërndarje thirrjeje, përcaktime afatesh, artikuj për t'u diskutuar, ndaje ekspertizash, vlerësimi, përgjigje ekspertizash, etj.).
- 2. Komisioni diskuton gjithashtu vendimet për të pranuar apo për ta refuzuar për botim një artikull, bazuar në kriteret teknike, apo vendimet e ekspertizës, çështje të së drejtës së autorit dhe përzgjedhjet e radhës së artikujve të botim.

## Neni 6

### Rregullat e vendimmarrjes në mbledhjet e Bordit Shkencor

1. Bordi Shkencor merr në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga Komisioni i Botimeve dhe raportin shoqëruar për çdo thirrje dhe merr vendimin për botim. Vendimmarrja bëhet me shumicë votash.
2. Mbledhja e Bordit për miratim të artikujve për botim mbahet kur janë të pranishëm të paktën 50% e anëtarëve plus 1.
3. Përveç pjesëmarrjes fizike, anëtarët e Bordit Shkencor mund të marrin pjesë edhe virtualisht në mbledhjet e këtij të fundit. Diskutimet gjithashtu mund të shtohen edhe nëpërmjet e-mail-ëve, në të cilat përfshihen të gjithë anëtarët e Bordit Shkencor. Diskutimi zgjat jo më pak se një javë dhe përgjigjet e anëtarëve protokollohen nga Sekretari i Bordit Shkencor.

## Neni 7

### Caktimi i ekspertëve për artikujt

1. Vlerësimi shkencor i artikujve bëhet nga ekspertët e fushave përkatëse. Ata caktohen nga Komisioni i Botimeve.
2. Eksperti duhet të jetë profesionist i fushës dhe njohës i mirë i problemit që trajton artikulli. Ai nuk mund të jetë pjesëtar i Komisionit të Botimeve, bashkautor i artikullit të paraqitur apo bashkautor me artikullshkrimsit në një apo disa artikuj të mëparshëm, që trajtojnë një temë të përafërt apo janë përzierës të temës që trajton artikulli i dorëzuar.
3. Për çdo artikull caktohen dy ekspertë, të cilët bëjnë vlerësimin e tij në mënyrë të pavarur.
4. Eksperti e trajton artikullin brenda kohës së përcaktuar në kontratë dhe përcakton *Formularin e revidencës*, i cili është dokument standard.
5. Emri i ekspertit mbahet i fshehtë për autorin e artikullit dhe emri i autorit të artikullit mbahet i fshehtë për ekspertin për të shmangur mundësinë e ndikimit në vlerësim.

## Neni 8

### Marrëdhëniet me autorët e artikullit, mënyra e dorëzimit dhe pranimi i artikujve, kthimi i përgjigjeve

1. Çdo autor që kërkon të botojë në faqet e Buletinit Shkencor, duhet të respektojë çdo kërkesë standarde, të nevojshme për të siguruar cilësinë shkencore dhe vizivë të botimit, barazimë, të drejtën e shprehjes, etikën e kërkimit dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit.

2. Artikulli mund të ketë një ose më shumë autorë. Në rastin kur artikulli ka shumautorësi, renditja e autorëve duhet të jetë dakordësuar nga autorët dhe nuk mund të ndryshohet ndërkohë që dorëshkrimi është dorëzuar. Autori i parë caktohet përgjegjës për korrespondencën me Komisionin e Botimeve.
3. Autorët plotësojnë *Deklaratën e autorit*, për përgjegjësinë mbi të drejtat e autorit, në momentin e dorëzimit të artikullit.
4. Autorët e paraqesin artikullin e tyre në një kopje të printuar dhe një kopje elektronike. Kopja elektronike do të jetë në format *.pdf* dhe në format *.doc* ose *.docx*.
5. Në momentin e paraqitjes personi përgjegjës që merret në dorëzim artikullin, e kontrofon atë për përputhjen me kërkesat e formatimit.
6. Çdo shkelje e këtyre parametrave raportohet nga Sekretari i Bordit dhe artikulli i kthehet autorit për riptimin, për ta përputhur atë me kërkesat e formatimit.
7. Nëse artikulli i respekton kërkesat, ai kalon në mbledhjen e radhës në Komisionin e Botimeve për diskutim dhe për pezazimin e eksperteve.
8. Nëse eksperti e vlerësonë artikullin të përshtrishëm për botim, ai parashtrohet në mbledhjen e Bordit Shkencor, i cili jep vendimin përfundimtar për botimin e tij.

## Neni 9

### Kërkesat ndaj autorëve

1. Dorëshkrimi i dorëzuar duhet të jetë origjinal dhe i papublikuar më parë.
2. Dorëshkrimi dorëzohet në shqipërisht dhe, pas vendimit paraprak të Komisionit të Botimeve për botim, autori e përkthehet atë në anglishten korrekte.
3. Materialet dorëzohet në formë elektronike dhe të printuar tek personi përgjegjës i Komisionit të Botimeve.
4. Artikulli i plotë, duhet të përfshijë në një total prej 10 faqesh tekstin, materialet grafike dhe tabelat së bashku me ditë, numër përkatës, si dhe listën e referencave.
5. Në faqet e Botimit Shkencor ka vend për një rubrikë diskutimesh, apo artikujsh "Case Study", të cilët trajtojnë në formë të hollësimit një problem me rëndësi kombëtare në konceptin shkencor.

## Neni 10

### Standardet e dorëshkrimit

1. Teksti i dorëshkrimit paraqitet në madhësinë e faqes A4 (përmasa 21x29.7cm), hapësira mes rreshtave "*Line spacing*" – *single*, 9 çka nënkupton një sasi të përafërt prej 800 fjalësh për faqe.
2. Përmasat e shkronjave "*font size*", do të jenë 12pt (Times New Roman) dhe hapësira në anët e fletës "*margins*" do të jetë 3 cm në anën e majtë (Left margin) dhe 2.5 cm në tri anët e tjera (kart-top; djathtas-right; poshtë-bottom). Faqet duhet të jenë renditur sipas numrit të tyre (page number), duke nisur nga njësi.

## Neni 11 Skema e ndërtimit të artikullit

1. Artikulli do të ndërtohet duke respektuar skemën e mëposhtme:
  - a) Titulli (**bold 12 pt.**): Sa më i shkurtër dhe përmbledhës të jetë e mundur.
  - b) Autorësia (*italic 10 pt*): Emër/Mbiemër shoqëror me indeksë sipër mbiemrit (1), (2) etj., të cilat shoqërohen me referencën e plotë të emërimit dhe adresës së institucionit nga vlen autori që i përkon indeksit. Indeksët me adresat zëmbeten menjëherë poshtë autorëve, secila në një rresht duke nisur nga adresa e autorit të parë, e cila shoqërohet dhe me një kontakt e-mail nëpërmjet të cilit Komisioni i Botimeve mban lidhjet me të.
  - c) Abstrakti (*italic 12 pt*: në 250 fjalë (përfshijësi 15 meshta) duhet të bëhet një përmbledhje e shkurtër e qëllimit të punimit, përfundimeve dhe rezultateve kryesore. Abstrakti nuk duhet të përmbajë referenca dhe shkurtime.
  - d) Fjalët Kyçe: (*italic 10 pt*): një sasi prej maksimumi 6 fjalësh kyç.
  - e) Teksti kryesor (*Times New Roman 12 pt*).
    - Ndërtohet i ndarë në seksione sipas radhës: **HYRJA, QËLLIMI, METODOLOGJIA E PËRDORUR, REZULTATET, DISKUTIMI I REZULTATEVE dhe PËRFUNDIME.** Titujt e seksioneve janë **Bold, UPPERCASE** (krijt me shkronja kapitale) dhe mund të ndahen deri në dy nënseksione, titujt e të cilëve dallohen në formatim në këtë mënyrë:
      - Seksion: niveli i parë 1: **TITULLI I SEKSIONIT** (bold & shkronja kapitale),
      - Nënseksioni i nivelit të parë 2: **Titulli i Nënseksionit 1** (bold, shkronja e parë e çdo fjale kapitale, të tjerat të vogla),
      - Nënseksioni i nivelit të dytë: *Titulli i Nënseksionit 2* (italic, shkronja e parë e çdo fjale kapitale, të tjerat të vogla).
  - f) Përdorimi i shkurtimeve: në artikull mund të përdoren shkurtime, kuptimi i të cilave duhet të jetë sqaruar në përshkrimin e parë.
  - g) Njësitë: në buletin njësitë e përdorura do t'i përputhen Sistemit Ndërkombëtar të Njësiteve
  - h) Dëshiturat e figurave: duhen paraqitur nën çdo figurë në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, bashkë me referimet përkatëse.
  - i) Referencat: duhen paraqitur në tekst. Në tekst referenca paraqitet (Mbiemri 1. viti) ku E nënkupton inicialin e emrit. Për referencë me dy autorë (Mbiemri 1 E.1, Mbiemri 2 E2, Viti) për referencë me më shumë se dy autorë (Mbiemri 1 E. 1., etj. al. viti).
    - Referencat në listën e referencave rënditen sipas rendit alfabetik, ku i pari në radhë është artikulli më i vjetër nga pikëpamja kronologjike. Nëse një autor apo një grup i njëjti

autorësh kanë botuar në të njëjtin vit, dy apo më shumë artikuj që referohen në artikull, atëherë ato dallohen nga indekset: A, B ... etj., të cilat vendosen përpara vitit dhe citohen në tekst. P.sh. (Mbiemri E., 1999A), (Mbiemri I., 1999B), e po kështu me rastet për dy apo më shumë se dy autorë.

- Nëse në një paragraf citohen më shumë se një referencë ato futen të gjitha në një kllapë rumbullake dhe ndahen me pikëpresje (.). P.sh (Mbiemri E., Viti; Mbiemri I Et. Mbiemri2 E2. Viti).
- Në listën e bibliografisë duhet dalluar nëse referenca i përket një libri të plotë, një kapitulli të veçantë nga një libër, një teze ose mikroteze PhD, një raport apo një artikulli në një periodik shkencor.
- Në bibliografi duhet paraqitur saktë titulli, viti, vendi i botimit dhe viti i botimit, kodet ISSN për revistat shkencore dhe ISBN për librat, si dhe sasia apo totali i faqeve të materialit të referuar

Radhitja e të dhënave të një reference në listën e referencave është:

- Emri "1" Mbiemri "1", Emri "2" Mbiemri "2", ..... , Emri "n" Mbiemri "n" (viti i botimit). Titulli, *Lloji i materialit të cituar* Titulli i botimit nëse është revistë. *Te dhënat e botimit*. *Vendi i botimit*, *numri i faqeve*, *kodi ISSN apo ISBN*

## Neni 12

Kjo Rregullore e shtën veprimtarinë duke filluar nga viti akademik 2021-2022,



ISSN: 2078-7111



UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"  
KORÇË

**BULETINI SHKENCOR**

**SCIENCE BULLETIN**

(seria e shkencave shoqërore dhe  
seria e shkencave të zbatuara)

VITI XXVII I BOTIMIT, Nr. 33, 2022

BULETINI I UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI”

(seria e shkencave shoqërore dhe seria e shkencave  
të zbatuara)

Nr. 33, 2022

THE SCIENTIFIC BULLETIN

(Series in Social Science and Series in Applied  
Science)

Nr. 33, 2022

2022



## **KËSHILLI SHKENCOR**

**Kryetar: Prof. dr. Dhimitri Bello**

**Anëtarë: Prof. dr. Gjergji Pendavinji**

**Prof. dr. Ali Jashari**

**Prof. dr. Robert Damo**

**Prof. dr. Irena Nikaj**

**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

**Prof. as. dr. Ledina Alolli**

**Prof. as. dr. Sonela Stillo**

**Prof. as. dr. Jonela Spaho**

**Prof. as. dr. Gjergji Mero**

**Prof. Ionel Roventa,**  
Universiteti i Craiovës,  
Rumani

**Assoc. Prof. Mihaela Alexandrina Popescu,**  
Universiteti i Craiovës,  
Rumani

**Prof. Elena Griva,** University  
of Western Macedonia

**Ass. Prof. Anastasia Yannakopoulou,** University of  
Western Macedonia

**Assoc. Prof. Gergana Padareva** – Faculty of  
philology, “Neofit Rilski”,  
Blagoevgrad

**Assoc. Prof. Bilyana**

**Todorova** – Faculty of  
philology, “Neofit Rilski”,  
Blagoevgrad

**Assoc. Prof. Nikolay Atanasov**– Technical faculty,  
“Neofit Rilski”, Blagoevgrad

**Assoc. Prof. Daniela Tomova**  
– Faculty of pedagogy, “Neofit  
Rilski”, Blagoevgrad

**Assoc. Prof. Bilyana Yordanova** – Faculty of  
philosophy, “Neofit Rilski”,  
Blagoevgrad

**Assoc. Prof. Emil Gachev** -  
Faculty of Mathematics and  
Natural Sciences, “Neofit  
Rilski”, Blagoevgrad

**Prof. dr. Vaska Stancheva-  
Popkostadinova** - Faculty of  
Public health, health care and  
sport, “Neofit Rilski”,  
Blagoevgrad

**Assoc. prof. Miglena Simonska-Tsatsova** - Faculty  
of Public health, health care  
and sport, “Neofit Rilski”,  
Blagoevgrad

**Prof. Georgios Floudas,** Dean  
of the Sciences School,  
University of Ioannina

**Prof. Evangelia Karagianni-**

*Karagiannopoulou, Dean of Social Sciences School, University of Ioannina*

**Prof. Katerina Plakitsi**, Head of the Department of Early Childhood Education of the University of Ioannina.

**Akis Tsonos, PhD** of the University of Ioannina, Archaeologist, Secretary of the I.T.C.C. and Associate Lecturer at the Demokritus University of Thrace, Komotini, Greece.

**Aris Papayiannis, MA** of the University of Crete, Treasurer of the I.T.C.C. and Archaeologist of the Ephorate of Antiquities of Magnesia (Thessaly).

**Maja Gori, PhD**, Researcher at Istituto di Scienze del Patrimonio Culturale del Consiglio Nazionale delle Ricerche (ISPC – CNR), Italy, and Associate Lecturer at the Institute of Prehistoric Archaeology of the Freie Universität, Berlin, Germany.

**Stavros Oikonomidis, PhD** Adjunct Professor of Greek Archaeology Arcadia University, Glenside, USA The Greek – Albanian Archaeological Expedition at the Tri – National zone of the Prespes

**Silvia Kirova, Assoc.**

**Professor, PhD Deputy Head, International Economic Relations and Business Department University of National and World Economy, International Economic Relations and Business Dept. Sofia**

**Elisabeth Yoneva, Associate Professor, Vice-Dean in Scientific and Research Activity – Faculty of International Economics and Politics, Department of International Relations, University of National and World Economy, Sofia.**

**Prof. dr. Gentian Kostandini**, University of Georgia, USA

**Prof. dr. Elton Mykerezzi**, University of Minnesota, USA

**PhD. Roy Alden Adwood**, Honorary President & Member of the President’s Advisory Board, Evangelia University, Anaheim, CA, USA

## **KËSHILLI BOTUES**

**Kryeredaktor:** Dr. Benita Stavre

**Redaktorë:** Phd. Jordan Jorgji

Dr. Rafail Prodani

Dr. Ermiona Braholli

Dr. Eneida Çifligu

Dr. Klaudeta Merollari

Dr. Zhinzela Qyli

**Redaktor gjuhësor:**

Msc. Eftiona Bylykbashi

**TABELA E PËRMBAJTJES**  
***I-LINGUISTICS, LITERATURE, EDUCATION SCIENCES,***  
***FOREIGN LANGUAGE***

**JONELA SPAHO**

NJË VËSHTRIM MBI KRIJIMTARINË LETRARE TË  
ILO MITKË QAFËZËZIT ..... 8

**ILIR SHYTA**

PUSHKINI DHE KONCEPTI I TIJ PËR FEMRËN E DASHURINË,  
KËNDVËSHTRUAR PËRMES DITARIT SEKRET .....20

**LONORA HYSOLLI**

RRETH KOMPOZITAVE DHE TIPAREVE TË TYRE, QËMTUAR NË  
MATERIALIN FOLKLORISTIK TË “BËLETËS SHQYPTARE” TË  
THIMI MITKOS..... 28

**JULIANA ÇYFEKU**

A VIEW OF CROSS-LINGUISTIC DIFFERENCES IN ENGLISH  
LANGUAGE CORPORA; AN INTER-LANGUAGE ANALYSIS TO THE  
TARGET LEARNER.....40

**ANXHELA LILO**

STRUKTURA E NJËSIVE FRAZELOGJIKE NË ROMANIN “LUMI I  
VDEKUR” TË JAKOV XOXËS.....57

**ANISA MUÇO**

**BENITA STAVRE**

READING STRATEGIES FOR ELEMENTARY DYSLEXIC LEARNERS  
OF ENGLISH AS A FOREIGN LANGUAGE.....68

**EDMOND CANE**

**WANG CAIXIAO**

MËSIMI I GJUHËS SË HUAJ MBI BAZA JO-STRUKTURALISTE..... 83

**RRIOLLZA AGOLLI**

**LAURA AGOLLI**

**BRIXHILDA LILKA**

EDUKIMI PËRMES ARTIT DHE RËNDËSIA E TIJ NË ZHVILLIMIN  
SOCIAL - EMOCIONAL TË NXËNËSVE NË ARSIMIN FILLOR .....100

***II- SOCIAL SCIENCE, LAW, PHILOSOPHY, POLITICAL SCIENCE,  
HISTORY***

**DENISA TITILI**

MIGRIMI RURAL- URBAN: INTEGRIMI SOCIO- KUTUROR I  
BANORËVE TË ARDHUR NGA FSHATI NË QYTET.....125

**ERISELD KALEMAJ**

PROGRESI HISTORIK I SHOQËRIVE DHE ARRITJA E  
SOVRANITETIT KOZMOPOLIT SIPAS I. KANT.....141

**DHIMITËR ZGURO**

VËSHTRIM KRITIK MBI ZHVILLIMIN HISTORIK TË SË DREJTËS  
PENALE SHQIPTARE MBI KRIMET SEKSUALE.....151

**JORDAN JORGJI**

ROLI I PERCEPTIMEVE NË POLITIKËN E JASHTME: RASTI I  
MARRËDHËNIEVE SHQIPËRI-KINË  
NË PERIUdhËN E LUFTËS SË FTOHTË.....168

**MARSELA SAKO**

NDËRMJETËSIMI I KONFLIKTEVE NDËRKOMBËTARE DHE ROLI I  
SHTETEVE SI PALË TË TRETË.....184

**BENITA STAVRE**

MENDIME TË AUTORËVE BRITANIKË DHE AMERIKANË  
RRETH QEVERISJES SË MBRETIT ZOG.....198

<b>ROMEO TEROLLI</b> <b>ILIRIAN KOROVESHI</b> PËRSIATJE HISTORIKE E KULTURORE E POLENËS.....	<b>210</b>
--	------------

***III- ECONOMY, AGRICULTURE***

<b>MAJLINDA BELLO</b> VARFËRIA DHE MATJA E SAJ. VARFËRIA NË SHQIPËRI.....	<b>225</b>
--	------------

<b>ILIR NIÇKO</b> <b>ARBEN GJATA</b> <b>TEODOR GJATA</b> <b>KOSTIKA STOJA</b> MATJA SASIORE E DINAMIKËS SË NDRYSHIMIT TË DISA PARAMETRAVE KIMIKË TEK DISA KULTIVARË MOLLE GJATË RUAJTJES NË ZONËN E KORÇËS.....	<b>238</b>
---	------------

<b>THOMA NASTO</b> <b>GJERGJI MERO</b> <b>YLLI SHAHINLLI</b> <b>NEVRUS ZEKA</b> VLERËSIMI I NDIKIMIT TË SKEMËS SË MBJELLJES SË SPECIT AUTOKTON CV “GOGOZHARE” NË TREGUESIT BIOMETRIKË DHE TË PRODHIMIT.....	<b>251</b>
---	------------

## NJË VËSHTRIM MBI KRIJIMTARINË LETRARE TË ILO MITKË QAFËZEZIT

**PROF. AS. DR. JONELA SPAHO**  
Fakulteteti i Edukimit dhe Filologjisë  
Universiteti, “Fan S. Noli” Korçë  
[jspaho@gmail.com](mailto:jspaho@gmail.com)

**Abstrakt:** *Ilo Mitkë Qafëzezi është një personalitet i çmuar i kulturës shqiptare, i cili ka dhënë kontributin e tij të vyer në disa fusha të rëndësishme të kësaj kulture, sidomos ato që kanë të bëjnë me identitetin kombëtar. Vepra e tij e botuar, por edhe dorëshkrimet që presin dritën e studimit dhe botimit të tyre, janë të një rëndësie të dorës së parë për historianët, gjuhëtarët, shkrimtarët, por edhe më gjerë dhe paraqet interes për të hedhur dritë mbi aspekte ende të pastudiuara sa duhet të historisë dhe kulturës kombëtare.*

*Ky punim hedh një vështrim të përmbledhur mbi krijimtarinë e Ilo Mitkë Qafëzezit si komedian, mbledhës, por edhe krijues i anekdotave popullore e shkrimtar për fëmijë. Kjo krijimtari ka rolin dhe meritën e vet në kuadrin e zhvillimeve të letërsisë shqipe, sidomos të kohës kur i përkasin, pasi rezultojnë si ndër të parat vepra të zhanrit në të cilin janë shkruar. Megjithëse e pakët kjo krijimtari, si dhe pjesa tjetër që mbetet në dorëshkrim, duhet të studiohet e analizohet, për të përcaktuar drejt rolin e autorit në proceset e zhvillimit të letërsisë shqipe si dhe për ta pasuruar këtë letërsi me vepra që luajtën rolin e tyre të rëndësishëm dhe emancipues në kohën kur u shkruan*

**Fjalë kyçe:** *kulturë, identitet, komedian, folklorist, shkrimtar, studiues*

### A VIEW ON THE LITERARY CREATIVITY OF ILO MITKË QAFËZEZI

**Abstract:** *Ilo Mitkë Qafëzezi is an important personality of Albanian culture, who has given his important contribution in several important areas of this culture, especially those related to national identity. His published work, but also the manuscripts that look forward to the day of their study and publication, are of paramount importance to historians, linguists, writers, and beyond, and it is of interest to shed light on still unstudied aspects of national history and culture.*

*This work gives a brief overview of the creativity of Ilo Mitkë Qafëzezi as a comedian, collector, but also creator of popular anecdotes, as well as a writer for children. This creativity has its role and merit in the context of the developments of Albanian literature, especially of the time when they belong,*



*as they result as among the first works of the genre in which they are written. Although few, this creativity, as well as the rest that remains in the manuscript, should be studied and analyzed, to correctly define the role of the author in the development processes of Albanian literature and to enrich this literature with works that played their role. important and emancipatory at the time it was written.*

**Keywords:** *culture, identity, comedian, folklorist, writer, studies*

Ilo Mitkë Qafëzezi është një personalitet i çmuar i kulturës shqiptare, i cili ka dhënë kontributin e tij të vyer në disa fusha të rëndësishme të kësaj kulture, sidomos ato që kanë të bëjnë me identitetin kombëtar. Vepra e tij e botuar, por edhe dorëshkrimet që presin ditën e studimit dhe botimit të tyre, janë të një rëndësie të dorës së parë për historianët, gjuhëtarët, shkrimtarët, por edhe më gjerë dhe paraqet interes për të hedhur dritë mbi aspekte ende të pastudiuara sa duhet të historisë dhe kulturës kombëtare.

Lindi në Korçë, në vitin 1889, por prejardhja e familjes së tij ishte nga Qafëzezi i Kolonjës. Kur ishte 13 vjeç, shkoi në Rumani dhe më pas emigroi në Amerikë ku qëndroi deri në vitin 1924. Në Amerikë, ku krahas punës vazhdonte edhe shkollën, ra në kontakt për herë të parë me shkrime të ndryshme që flisnin për figura të njohura e luftëtarë trimë të Shqipërisë. I tërhequr nga personaliteti kompleks i disa figurave historike, ai zgjodhi të përkthente në shqip “Historia e Ali Pashë Tepelenës” të Arvantinoit. Përkthimin e pasuroi dhe e ilustroi edhe me këngë popullore që këndoheshin për pashain famëmadh.

Vazhdimisht lexonte, grumbullonte material, përkthente në shqip dhe botonte. Në një kohë shumë të shkurtër botoi “Historia e Napoleon Bonapartit”, “Qysh u gjend Amerika”, “Kurani shqip”, “Këndime” etj. Më pas, u kthye përfundimisht në Korçë dhe punoi si mësues e drejtor shkolle. Edhe puna e tij krijuese, tashmë, mori një drejtim tjetër, kryesisht, si punë e mirëfilltë gjurmuese e studimore për fakte e të dhëna me karakter historik e gjuhësor, sidomos për Korçën, Voskopojën, Vithkuqin, Beratit etj, që ishin qendra të zhvilluara në shekullin XVIII; si dhe për njerëzit e figurat e shquara të asaj kohe. Tani ai ishte i pajisur me një kulturë të gjerë, si njohës i disa gjuhë të huaja të Ballkanit dhe të Evropës dhe kishte përgatitjen e duhur për të vlerësuar dhe interpretuar veprat historike e gjuhësore të figurave të njohura të këtyre qendrave. I ndikuar, siç pohon edhe vetë, nga mësuesi

i tij i parë Nuçi Naçi, më pas nga rrethet patriotike të kolonive shqiptare të emigracionit që i mëkuan atdashedashurinë, si dhe i fymëzuar nga poeti ynë i madh Asdreni, ai iu përkushtua gjithë jetën studimeve të dokumenteve që evidentonin kulturën dhe identitetin shqiptar. Këto ndikime do të bëheshin faktorë të fuqishëm që ai t'ia dedikonte jetën leximit dhe mësimin duke shfletuar gazeta, revista e libra të ndryshëm, në mënyrë autodidakte si dhe të mblidhte e të grumbullonte gjithçka që i binte në dorë për Shqipërinë dhe për historinë e popullit shqiptar. Gjithashtu, ai kishte një pasion të jashtëzakonshëm për mbledhjen e krijimtarisë artistike popullore, këngët, tregimet, përrallat e legendat dhe sidomos humori që shpalosej në to.

Me një punë këmbëngulëse e sistematike, ai zbuloi në manastirin e Shën Pjetrit, në Vithkuq dhe në kishat e Voskopojës, një dorëshkrim të Theodhor Kavaliotit dhe një dorëshkrim shqip të Dhaskal Kostë Vithkuqarit. Po kështu, zbuloi edhe një kopje të botimit të parë të fjalorit katërgjuhësh të Dhanilit, botuar në Venedik, në vitin 1794. Në këto kisha ai zbuloi edhe abetaren e Naum Veqilharxhit të vitit 1844. Por puna e tij nuk u mjaftua me kaq. Këto zbulime e fakte të reja, shumica e tyre të panjohura deri atëherë, i bëri të ditura duke i botuar në organe të ndryshme të shtypit që dilnin në atë periudhë, si në Korçë, ashtu dhe në qytete të tjera. Ilo Mitkë Qafëzezi pati bashkëpunim të përhershëm me “Gazetën e Korçës”, “Hylli i dritës”, revistat “Leka”, “Minerva” etj. Ai botoi një sërë shkrimesh dhe qe i pari që solli fakte e botoi dokumente me shumë interes për zhvillimin ekonomik, politik e kulturor të trevës së Voskopojës, Korçës, Vithkuqit, Beratit etj, si dhe shkaqet që çuan në prishjen e shkatërrimin e tyre. Ilo Mitkë Qafëzezin në punën e tij e kanë tërhequr tepër edhe traditat, zakonet e vjetra, bile edhe lodrat e fëmijëve të vegjël. Studimi i tij “Zhvillimi i lodrave të kalamanit shqiptar” u përdor nga profesori rumun Theodhor Kapidani në veprën e tij “Lodrat me ashikë tek fëmijët e Ballkanit”.

Ilo Mitkë Qafëzezi, si njohës i thellë i historisë së Voskopojës dhe i jetës e veprave të Theodhor Kavaliotit, ishte i pari që shkroi një monografi me vlerë për të. Kjo monografi që titullohet “Protopapa Theodhor Nastas Kavalioti Voskopojari, Shkollarku i Akademisë së Re të Voskopojës”, është një sintezë e 15 artikujve dhe studimeve speciale botuar nga autori gjatë periudhës 1934-1943, në revistat kulturore “Jeta”, “Minerva” etj. Po kështu, dorëshkrim i pabotuar ka mbetur edhe

një monografi e gjatë për Korçën.(Bitraku A, I.M.Qafëzezi një thesar ende i pazbuluar i kultures, 2011)

Siç shihet, Ilo Mitkë Qafëzezi, megjithëse autodidakt, ka bërë një punë të madhe e voluminoze, duke sjellë një kontribut të shquar në mjaft fusha të veprimtarisë letrare e shkencore. Ai ishte i pajisur me një kulturë të gjerë dhe biblioteka e tij ishte shumë e pasur. Më 1946, ai humbi krejtësisht dritën e syve nga një sëmundje e gjatë dhe e rëndë. Megjithatë, vullneti e këmbëngulja e tij ishin për t'u admiruar. Ilo Mitkë Qafëzezi vdiq në Korçë, në vitin 1964, duke lënë pas emrin e mirë dhe shumë botime në fushën e letërsisë dhe kulturës sonë kombëtare.

Në kompleksitetin e personalitetit kulturor të I.M.Qafëzezit, nuk mund të anashkalohet një aspekt i rëndësishëm siç është krijimtaria letrare artistike, që na servir vepra e tij. Parë dhe studiuar në këtë aspekt, krijimi artistik i tij rrok tri aspekte: atë të komediografit, të folkloristit dhe të shkrimtarit për fëmijë.

Vështruar përmes këtyre aspekteve, I.M.Qafëzezi meriton vëmendjen e studimeve letrare në këto lloje, aq pak të lëvruara në kohën kur ai i shkroi. Nisur nga konteksti kohor i tanishëm, kjo krijimtari nuk ofron sasi dhe ka pika të diskutueshme. Nisur nga klima kulturore dhe letrare e kohës kur u shkruan dhe u botuan, ato sjellin një ndihmesë jo pak të konsiderueshme. Pa pretendimin e një studimi të thelluar kritikoletrar, ky shkrim rreket të krijojë imazhin e profilit letrar të I.M.Qafëzezit dhe rëndësinë e pozicionit që zë vepra e tij, sipas zhanrit të lëvruar në historinë e letërsisë shqipe. Kështu, nëse i referohemi krijimtarisë letrare të tij, padyshim që së pari do të ndalemi te komediografi, më pas te folkloristi dhe së fundi te shkrimtari për fëmijë. E cilësojmë së pari si komediograf duke iu referuar veprës më të rëndësishme letrare, jo vetëm për materialin që sjell, por dhe për lëvrimin e një prej gjinive aq të rralla, por shumë të mirëpritura dhe të dëshiruara nga publiku i kohës dhe skenat e teatrove amatore “Dhaskal Gjoka, apo shkolla korçare e qëmoçme”, botuar në Korçë, në vitin 1936, me një kushtim tepër prekës në ballinë të saj: *“I kushtohet hijes së adhuruar të mësonjësit t’em të ndjermë, që më frymëzoi shumë dashuri për shqipe dhe për Shqipëri”* (Qafëzezi, I., Dhaskal Gjoka, Korçë, 1936). Kjo komedi, në kontekstin kohor dhe letrar, i përket gjysmës së dytë të shekullit XX dhe fazës së dytë të zhvillimit të komedisë tek ne. Komedia, si një lloj relativisht i vështirë i gjinisë dramatike në letërsinë tonë të traditës, ka

njohur një zhvillim të vonët dhe të pakët në sasi. Nëse i referohemi zhvillimit të komedisë në letërsinë tonë, fillesat e saj i gjejmë në periudhën e fundit të Rilindjes. Zhvillimi i dramaturgjisë gjatë kësaj periudhe dha frytet e veta dhe në llojin komik. Prof. Kudret Velça, në studimin e tij për historinë e teatrit shqiptar të viteve 1912-1939, vë në dukje mbizotërimin e komedisë. (Velça, K., Historia e teatrit shqiptar I, Tiranë, 1984, f. 118.110). Ky fakt do të shpjegohej me disa përparësi që ka ky lloj i gjinisë dramatike. Në fakt, komedia është cilësuar si kompensim filozofik, po aq sa dhe psikologjik. Sa herë që ne bëhemi të ndërgjegjshëm, se kjo nuk është bota më e mirë e mundshme, na duhet ndihma e komedianeve për të përballuar “defektet” e pakapërcyeshme të realitetit. Vizioni i lartë komik i jetës është humori, një arritje kjo e njeriut si qenie njerëzore, Meredith këtë kishte parasysh kur thoshte se komedia është civilizuesi ynë përfundimtar. (Meredith, G., An essay on comedy, Nju-Jork, 1956, f. 47.)

Fillimet e saj i gjejmë në fazën e fundit të letërsisë së Rilindjes me dy komedi të mirënjohura të Çajupit dhe një komedi të Gramenos, të cilat u krijuan në kohën kur në jetën e trazuar shqiptare, krahas problemeve politike u bënë evidente dhe problemet shoqërore. Këto komedi krijuan një traditë, e cila u zhvillua më pas në periudhën e viteve 1912-1939, përmes dy fazave.

Faza e dytë e zhvillimit të komedisë në këtë periudhë, në të cilën përfshihet dhe vepra në fjalë, u prir më tepër, pohojnë studiuesit, drejt efektit argëtues të zhanrit, më shumë sesa u mundua të ngrinte probleme. Por, është i vërtetë fakti, që krahas ndonjë komedie zbavitëse, siç ishin ato të Aleko Vançit apo Dhori Kotit, pati dhe komedi që prekën probleme të rëndësishme. “Dhaskal Gjoka” është pikërisht një komedi e tillë, e cila përpos elementëve ekspresivë të humorit dhe të së qeshurës, ka dhe karakter të theksuar pedagogjikodidaktik, që shtron një problem të rëndësishëm siç është ai i përdorimit të metodave të vjetra pedagogjike në shkollën fillore. Kjo komedi, përmes humorit që varion nga një ironi e hollë në satirë dhe sarkazmë, duke arritur dhe në grotesk, trajton dhe probleme të tjera që kanë të bëjnë me domosdoshmërinë e mësimin të gjuhës shqipe, përveç asaj greke, me afirmimin e idealeve atdhetare e deri në problemet që kanë të bëjnë më çështjet e etikës dhe moralit. Gama informative e komedisë, në këtë aspekt meriton vëmendje.

Autori e pohon këtë në parathënien e veprës: *“Mundem të them se këto pjesëra sjellin ca më tepër dobi se librat edhe sesa konferencat. Pjesa teatrore dramatike, veçanërisht komedia është hem e këndëshme, hem instruktive, si për ata me gramë si për ata që nuk kanë dituri.”*, (Qafëzezi I. , Dhaskal Gjoka, Korçë,1936), pohim ky që dëshmon qëllimin e një vepre të shkruar për të gjithë dhe të receiptueshme gjerësisht. Për të realizuar një komedi të tillë, autori është përpjekur të fokusohet tek karakteri komik, i cili është ndërtuar përmes kontradiktave dhe situatave komike, gjatë të cilave veprimet dhe arsyetimet e dhaskalit spikasin thelbin grotesk të tij. Lëvrimi i komedisë, si lloj i gjinisë dramatike, është shprehje e zhvillimit dhe emancipimit shoqëror, e forcimit të vetëdijes kritike të një shoqërie që synon të integrohet në proceset moderne të jetës së saj. Dihet se zhvillimi i komedisë, sidomos karakteri kritik i saj, fshikullues ndaj dukurive negative të shoqërisë, mund të bëhet kur ekziston një farë lirie e mendimit kritik. Aristoteli te vepra e tij *“Poetika”*, shkruan se komedia është imitimi i çdo gjëje më të keqe nga ç’është në realitet dhe imiton ato vese që janë qesharake. Sipas tij, nëse tragjedia synon të pasqyrojë njerëzit më të mirë se ç’janë në të vërtetë, komedia i pasqyron njerëzit jo në tërë format, por vetëm në formën e tyre qesharake. (Aristoteli, *Poetika*, Tiranë, 2004, f. 20).

Dukuritë komike lindin prej shkaqeve të ndryshme. Disa dukuri të vjetëruara që përpigën të paraqiten si bashkëkohore janë, shpesh, shkak primar i komikes. Por, komikja lind dhe kur përfaqësues të shtresave të caktuara shoqërore mendojnë se luajnë një rol të rëndësishëm shoqëror, ndërkohë që roli i tyre është regresiv dhe qesharak. Këta individë që ndjekin automatikisht fatin e tyre, pa menduar për lidhjet me të tjerët janë shpesh burimi i komizmit. I tillë është dhe dhaskal Gjoka, i cili mendon se e drejta e tij për të dhënë mësim është e pazëvendësueshme dhe roli i tij është i pamohueshëm, ndërkohë që misioni i tij, në fakt, ka marrë fund dhe metodave të tij u ka kaluar koha. I ndërtuar përmes kësaj kontradikte, midis metodave të tij të vjetëruara pedagogjike dhe fanatizmit me të cilin i mbron, ky karakter është i realizuar plotësisht brenda kuadrit komik, nëpërmjet kombinimit të së qeshurës, por dhe keqardhjes për fatin e dhaskal Gjokës.

Aristofani thotë se heroi tragjik nuk mund të jetë dhe i korruptuar, ose dhe thjesht një viktimë e fatit të keq, ndërsa komedia kënaqet të ketë të bëjë me ata që janë viktima të fatit të keq, së bashku me ata që janë të

korruptuar e plot vese dhe i paraqet ata me anë të satirës dhe groteskut. Dhaskal Gjoka është tipi i mësuesit pedant e i dhunshëm, i cili në mënyrë strikte aplikon metoda të vjetëruara e kthehet në një bunker përballë sugjerimeve për të ndryshuar. Ai vetëdemaskohet duke gjeneruar komizëm, nëpërmjet të menduarit dhe të vepruarit në situata të veçanta, siç janë ato të etiketimit vulgar të nxënësve për fjalët e shqiptuara gabim, ndëshkimet viktoriane të fëmijve, mënyrat sesi kërkon të përfitojë materialisht prej prindërve që dërgojnë fëmijët në shkollë, mënyrës qesharake se si reagon ndaj thashethemeve që qarkullojnë rreth tij, etj.

Karakterin komik autori e realizon gjithashtu nëpërmjet alogjizmit. Gjatë gjithë zhvillimit të komedisë vërehet aktivizimi i alogjizmit, si një mjet i fuqishëm stilistik për të thelluar kontradiktën komike, duke zbuluar nëpërmjet tij shterpësinë mendore të personazhit, çka vë në lëvizje mekanizmin komik të situatave. Kështu, dhaskal Gjoka është alogjik në gjithë konceptimin e sistemit të tij pedagogjik, të cilin e mbështet në parimin se “druri është derë e paradhisit” dhe se nëpërmjet tij mund të “shërojë veset”. Alogjizmi me të cilin ai mbështet teorinë e tij të vlerave, e kthen atë në një karikaturë groteske e të zvetënuar, që nuk merr fare parasysh dëshirat dhe shpalosjen e lirë të lirisë së fëmijës, çka Rusoi e kishte propoganduar me forcë një shekull më parë. Kulmin alogjizmi i tij e arrin kur kërkon të disiplinojë në mënyrë strikte dhe nevojat fiziologjike të fëmijëve. Sistemi i tij pedagogjik del si një farsë qesharake kur protoskollli i tij 13- vjeçar i thotë: *“Nga të gjitha këto që këndoj as fare nuk marr vesh. Mua më k’ënda të rrynj brenda në këto fjalë të perëndisë. Të këndosh dhe gjë të mos kuptosh, gramë i thonë kësaj? Katran me bojë.”* (Qafëzezi I., Dhaskal Gjoka, Korçë, 1936), Ndërsa përgjigjja alogjike dhe qesharake e dhaskalit, tipizon përfundimisht karakterin komik të tij: *“Dale morre Nuçi biro. Ti dashke të rrynj brenda e të dish dhe ato që nuk i dinë dot vetë priftërinjtë!”* (Qafëzezi, I., Dhaskal Gjoka, Korçë, 1936), Ja pra, ky është kulmi grotesk i dhaskal Gjokës, i cili nuk ka ideale etike dhe pedagogjike dhe mbron me forcë të drejtat e tij.

Në këtë mënyrë, realizimi i unitetit mes karakterit dhe veprimit na çon natyrshëm drej thelbit të tij. Nisur nga sa theksuam, subjekti i komedisë nuk karakterizohet nga një veprim i gjatë dhe ndeshje personazhesh, por për ta bërë veprën interesante autori rrit komizmin gradualisht, komizëm i cili arrin kulmin në fund të komedisë, kur interesat e

dhaskalit vihen në diskutim. Autori di ta vërë situatën në funksion të realizimit të karakterit komik, në mënyrë të natyrshme dhe spontane, sepse kjo është dhe natyra e komedisë, e cila ndryshe nga tragjedia s'ka nevojë ta ruajë veten me anë të ndonjë logjike të pashmangshme, apo me anë të rregullave akademikë. Ajo i bën artistike të gjitha rastet që propabiliteti tragjik mundohet t'i mënjanojë. Kjo na lejon të shpjegojmë dhe justifikojmë shumë aspekte të kësaj komedie, e cila po t'u referoheshim kërkesave specifike të zhanrit, do të linte shumë për të dëshiruar.

Duke qenë se subjektet e veprave komike mund të jenë të ngjashme me materialin që nxjerr jeta, dalim në përfundimin se autori është përpjekur të zgjedhë një subjekt, që edhe pse për kohën kur u shkrua nuk ishte shumë aktual, prapë sjellë skena jetësore që janë të lidhura drejtpërdrejt me mentalitetet e jetesës, sidomos në qytetin e Korçës. Ajo paraqet skena të këndshme që të bëjnë të shkrihesh gazit, por të vënë dhe në mendime, sepse reminishenca të dhaskal Gjokës mund t'i gjesh në çdo kohë, sepse në komedi ne qeshim me vesin, por dhe frikësohemi me dyshimet tona për gjëra që ndoshta s'do të ndodhin kurrë. Në këtë mënyrë komedia si shenjë e zhvillimit dhe emancipimit shoqëror realizon atë "katharsis" aq të rëndësishëm, që e bën atë të receptueshme dhe të pëlqyeshme, ashtu siç u bë dhe komedia në fjalë. Interes paraqesin në komedi dhe personazhet e tjerë, dy prej të cilëve janë dhe personazhe historike: Naum Veqilharxhi dhe Kostë Mitkua. Ata, përpos rolit që luajnë në zhvillimin e subjektit dhe organizimin e dialogëve, janë dhe zëdhënës të ideve të autorit në lidhje me shtjellimin e pikëpamjeve të tij pedagogjike dhe patriotike.

Për sa i përket mënyrës së ndërtimit, ashtu si dhe komeditë e tjera të periudhës dhe tek kjo vepër vërehet ndikimi i komedisë klasiciste, me respektimin e njësisë së kohës, vendit dhe veprimit, trajtimit të problemeve etike, madje ndikimi vërehet dhe në mënyrën e ndërtimit të ndonjë personazhi. Të bën përshtypje, veçanërisht, përshtypje të saktë i veshjes dhe ambientit, çka thekson dëshirën dhe qëllimin e autorit për receptimin e saj nëpërmjet skenës.

Pa lënë mënjëanë këtë kontribut të autorit në fushën e komedisë dhe duke iu referuar përsëri sferës së satirës dhe humorit, nuk mund të mos vlerësojmë dhe përmbledhjen me tregime në vargje "Rrësku arbëror: (Hazna Shqipëtare): tregonjësja popullore satirike për të mëkur së qeshuri ndër vjersha", i cili u shkrua me alfabetin e Stambollit dhe u

botua për herë të parë në Selanik në vitin 1910 dhe më pas u botua përsëri në Korçë, në vitin 1924. Ishte vetëm 16 vjeç kur botoi në Rumani “Anekdota shqiptare”, që nuk kaluan pa rënë në sy të mjaft lexuesve e studiuesve. Edhe kur ishte në Amerikë, megjithëse punëtor fabrike, nuk reshti së mbledhuri material folklorik nga goja e popullit, e shqiptarëve që punonin e jetonin atje.

Në këtë vëllim, autori me një humor të hollë, përpunoi në vargje rrëfenjëzat e bukura të mbledhura me kujdes nga goja e popullit. Aty ironizohen, vihen në lojë e fshikullohen kadilerët, pashallarët, bejlerët, hoxhallarët e priftërinjtë që gënjenin e mashtronin popullin. Gaetano Pettrota thekson se kjo figuron si e vetmja vepër anekdotash satirike shqip në historinë e letërsisë sonë. (Pettrota, G., Popolo lingua e letteratura albanese, Palermo, 1931.)

Në historinë e folkloristikës shqiptare shpesh është përmendur puna kolosale e Mitkos, Jubanit, Dines etj., në mbledhjen e folklorit, por tepër rrallë është përmendur emri i I.M. Qafëzezi, i cili jo vetëm mblodhi dhe grumbulloi, por dhe përshtati në vargje rreth 73 anekdota satirike, të mbledhura nga goja e “llauzit shqiptar”. E veçanta e kësaj përmbledhjeje qëndron në faktin se I. M. Qafëzezi ishte vetëm 15 vjeç kur i mblodhi e i përpunoi dhe 19 vjeç kur i botoi. Siç e thamë, janë rreth 73 anekdota satirike në vargje të metrave e gjatësive të ndryshme, gjithmonë të rimuara sipas skemës AA BB ose ABAB, ndërsa vargjet variojnë që nga 8-rrrokëshi i poezisë popullore e deri te 16-rrrokëshi. Anekdotat shquhen për larmi tematike dhe siç i klasifikon vetë autori, në një shkrim polemizues në “Gazetën e Korçës”, gjysma e tyre merren me veset dhe gabimet e njerëzve të pasur, në hirearkinë e të cilëve përfshihen mbretër, vezirë, pashallarë, gjykatës, priftërinj dhe hoxhallarë, madje dhe ndonjë figurë historike si ajo e Ali Pashë Tepelenës, ndërsa pjesa tjetër e tyre i përkasin Hoxhë Nastradinit “të madhit ironist filozof”. Por, në këtë përmbledhje, përveç materialit të mbledhur në popull e të mësuara prej babait të tij zdrukthëtar, një pjesë e anekdotave janë krijime origjinale të autorit, madje dhe kur e braktisi këtë lloj krijimtari ai vazhdonte të kishte rreth 100 copëza të tilla ende të papërpunuara. Autori pretendon në autenticitetin e këtyre anekdotave, duke theksuar se ato janë pasuri popullore dhe vetëm përpunimi artistik është meritë e tij. Ato janë bërthama anekdotash që bëjnë pjesë në folklorin e pashtershëm shqiptar: “*Janë thërrime anekdotash llauzishte të treguara në Toskëri*” (Qafëzezi, I., Rrësku



arbëror, Korçë,1924).Vlera e tyre spikat dhe qëllimin e autorit, i cili nga njëra anë, përmes satirës dhe humorit, rreket të përqeshë dhe thumbojë veset, dobësitë dhe anët negative të jetës njerëzore, me një vello të imët filozofie tipike popullore, në mënyrë që njerëzit nëpërmjet tyre të shohin më qartë vetveten, duke qeshur dhe zbavitur, dhe nga ana tjetër “ato të ndihmojnë të ndreqësh ndonjë kusur që ndofta do të bëhet huq, që të mos katandisesh të qeshin të tjerët me ty si me ata të shakasë”.(Qafëzezi,I., Rrësku arbëror, Korçë,1924).

Përmes tyrë shpaloset një galeri e tërë tipash qesharakë, të cilët bien pre ose e padijes, ose e lakmisë dhe egoizmit të tyre. Ndër më të bukurat, ku morali gjen vend për t’u ndërthurur natyrshëm me filozofinë janë: “Ali pashë Tepalena dhe prifti i Hormovës”, ”Prifti dhe kusarët”, “Jam turk për zotnë Krisht”, “Mjekra e kadiut”, “Prej asaj bote”, “Vleftë e rrobes së rë”, ”Nastradini në gosti”, “I verbëri”etj.

Në përgjithësi, autori nuk e bën moralin qëllim në vetvete por, përmes rrëfimit të ngjarjes i jep mundësi lexuesit të nxjerrë përfundimin. Duke qenë anektoda të mbledhura në popull, autori zbulon në to thesare mençurie e filozofie të “...shqipos së varfër malësor dhe fusharak, i cili me gjithë mbijetesën e gjatë të paditurisë si njeri i ngurtë dhe i shtypur ndë zgjedhën turke e nën influencë polesh e kulturash të huaja, ka mundur të na e ruajë të pacënuar këngën popullore, përrallën dhe shakanë. Ndë mest të frazave të shakave të vatrës kemi për të zbuluar me qindra e mijra fjalë shqipe të paregjistruara ndë ndonjë fjalor shqip nga ato që kemi gjer më sot. Anektodat përbëjnë një pjesë të krijimtarisë gojore poulllore dhe të kulturës sonë të cilat nuk duhen nënvleftësuar”.(Qafëzezi I., Rrësku arbëror, Korçë,1924).

Parë në këto aspekte, I.M. Qafëzezi është ndër të parët folkloristë që janë marrë më mbledhjen dhe përpunimin e anekdotave satirike. Megjithëse në ndonjë shkrim, në shtypin e kohës kur jetoi autori, janë shprehur mendime nënvleftësuese për këto pjesë, përsëri ato kanë vlerë dhe rëndësi, së pari si fond i trashëgimisë kulturore dhe së dyti për mesazhet universale që ato mbartin, pavrësisht formës së thjeshtë e pa pretendime të dukshme letrare që ka arritur t’u japë autori.

Së fundi dhe shkurtazi nuk mund të mos përmendim krijimtarinë e tij në fushën e letërsisë për fëmijë, gjë e cila merr rëndësi duke e pozicionuar në kontekstin kohor të viteve 30’, kur kjo letërsi kishte nevojë që të krijohet si degë më vete e letërsisë në përgjithësi. Shkrimet e tij për fëmijë ai i botoi kryesisht te revista “Vatra e Rinisë” e Vangjel

Xhaçkës dhe të “Gazeta e Korçës”, në një hark kohor që përfshin vitet 1933-1936, vite në të cilat ai kishte arritur pjekurinë letrare, siç ka ndodhur shpesh me të gjithë autorët që kanë shkruar për fëmijë, pasi kanë arritur kulmin letrar, sepse kjo lloj letërsie paraqet vështirësi relative që lidhen me të kuptuarit e botës dhe psikologjisë feminare.

Një ndër autorët që u shquan te revista “Vatra e rinisë” për krijimtari origjinale për fëmijë qe Ilo Mitkë Qafëzezi. Përmendim sidomos dy tregime dhe e dy përralla interesante të botuara aty. Në tregimin “Është kafshë shtëpiake”, jepet ideja e respektit ndaj punës në sfondin e jetës së shkollës, kurse te “Dhori Nazetori” vihen në lojë tekat e fëmijëve.

Përrallat janë: “Tre kurridalë të këqij”, “Kokodaku, kocomiu dhe ndrikulla Pambuke”. Në to dënohet tradhëtia e pabesia, himnizohet fuqia e njerëzve të thjeshtë të popullit. Te shkrimet e këtij autori vlen të përmendet veçanërisht prirja e tij humoristike që është një karakteristikë e domosdoshme për ata që ja kushtojnë veten letërsisë për fëmijë. (Bishqemi A, Historia e letërsisë shpise për fëmijë, Elbasan, 2000).

Ndër këto shkrime pra kemi dy lloj zhanresh të lëvruara prej tij, tregimet: “Dhori nazetari”, “Është kafshë shtëpiake”, “Ortaku i panginjur“, etj. dhe zhanrrin e përrallës : “Tre kurrisdalë të këqinj”, “Pse s’ka Baliku shtëpi”, “I shkreti lepur”, “Çafkëlorja dhe shtërgu “etj.. Për sa iu përket përrallave, ato paraqesin interes nëpërmjet elementëve që mbartin, duke marrë shpesh dhe trajtën e gojdhënave siç ndodh te “Çafkëlorja dhe shtërgu”, ku nëpërmjet një gjuhe të këndëshme dhe humorit, ai iu tregon fëmijëve se pse çafkëlorja ka mbetur “pa qafëzë”.

I. M. Qafëzezi është cilësuar si një ndër shkrimtarët që bën pjesë në letërsinë moderne shqiptare për fëmijë të viteve 30’, së bashku me M.S.Gurrën, V. Xhaçkën, Migjenin, T. Gjylin dhe Q. Guranjakun, madje është cilësuar së bashku me tre të fundit si një ndër shkrimtarët që njihen mirë botën e brendshme dhe dëshirat e fëmijëve. Këto lloj krijimtarie, padyshim, e ka favorizuar dhe profesioni i tij si mësues. Për këtë arsye ai përdor me kaq mjeshtëri një armë të tillë si humori kaq të suksesshme në letërsinë për fëmijë dhe siç e theksuam e aktivizon në gjithë veprën e tij. I. M. Qafëzezi është një autor që priret nga humori dhe sarira dhe duket se ka ditur ta shfrytëzojë atë më mjeshtëri. Për më tepër iu mbetet detyrë studiuesve dhe historianëve të letërsisë të ndërmarin studime më të thelluara lidhur me krijimtarinë letrare të I.

M. Qafëzezi, duke i dhënë vendin që i takon në kulturën dhe letërsinë shqiptare.

## **BIBLIOGRAFIA**

- Aristoteli, Poetika, Tiranë, 2004.
- Bergson H., Lawghter, New York, 1956.
- Bitraku A, I. M. Qafëzezi një thesar ende i pazbuluar i kulturës, 2011.
- Bishqemi A, Historia e letërsisë shpise për fëmijë, Elbasan, 2000.
- Elsie R., Historia e letërsisë shqiptare, Tiran-Pejë, 1997.
- Mato J., Paradokset e satirës dhe humorit, Tiranë, 2000.
- Mato J., Poetika e komikes, Nëntori, nr.7, Tiranë, 1988.
- Meredith G., An essay on comedy, New-York 1956.
- Petrota G., Popolo lingua e letteratura albaneze, Palermo,1931.
- Spaho J., Zhvillimi i komedisë shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit të XX, Buletini Shkencor, Universiteti “F.S. Noli”, Korçë, 2004, nr.8.
- Spaho J., Prurje dhe risi në teatrin korçar të periudhës 1912-39, Buletini shkencor, Universiteti “F. S. Noli”, Korçë, 2010, Nr. 15.
- Qafëzezi,I., Dhaskal Gjoka, Korçë, 1936.
- Uçi A., Estetika e groteskut I, Tiranë, 2001.
- Uçi A., Grotesku në letërsinë shqipe, Tiranë, 2001.
- Velça K. & Zheji Gj., Historia e teatrit shqiptar I, Tiranë, 1984.
- “Historia e letërsisë shqiptare “,Tiranë, 1993.
- “Histori e Shqipërisë”, Tiranë, 1965, f. 282
- “Shkrimtarë shqiptarë” I, II, Tiranë, 1941.

## **PUSHKINI DHE KONCEPTI I TIJ PËR FEMRËN E DASHURINË, KËNDVËSHTRUAR PËRMES DITARIT SEKRET**

**Dr. ILIR SHYTA**

Pedagog

Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë

Universiteti “Fan S. Noli”

Korçë

[ilirshyta@yahoo.com](mailto:ilirshyta@yahoo.com)

**Abstrakt:** Objekt i kësaj kumtese është poetika e Pushkinit përmes një qasje sqaruese, e cila buron nga ditari sekret i tij, mbajtur në vitet 1836-1837, duke thyer tabu në koherencë.

Marrëdhëniet që shkrimtari vendos me gjuhën e bëjnë veprën letrare, gjithnjë sipas Proust-it, vendin e “të shpikurit” më shumë në “të shprehurit” e vetvetes.

Në një lexim tjetër, të ndryshëm nga ai i deritanishmi, në paralelizëm, hidhet dritë mbi gjenium shkrimtar dhe elementë të jetës private. Njerëzit i shprehin afeksionet e tyre përmes letërsisë, në sintoni me gjuhën e trupit... Dashuria poetike pushkiniane mbetet e jetësuar në vargje, ndërsa përmes saj hidhet dritë edhe mbi anë të panjohura, intime, të jetës së autorit. Duhet thënë, se deri më tani nuk ka pasur një interpretim ndryshe të poezive për shkak të mendësisë së kritikës socrealiste, që nuk guxonte të bënte një interpretim të tillë, pikëvështruar përmes ditarit sekret të Aleksandër Pushkinit. Poezia na adreson, se duke u nisur prej saj në receptim, disa krijimeve poetike të Pushkinit, mund t’ju bësh një qasje tjetër kuptimore. Këtë e tregon vetë interesimi që ngjall ditari sekret ndër lexues, duke rritur më shumë kërshërinë e tyre, rreth veprës së poetit.

Ky receptim i ndryshëm, sjell konotacion të pafundëm për lexuesin dhe artin pushkinian. Për qasja në kohë na përforcon idenë, se një poezi mund të lexohet shumë herë dhe në mënyra të ndryshme interpretuese.

**Fjalë-kyçe:** Ditar, shkrimtar, letërsi, tabu, vlera.

### **PUSHKIN’S VIEW ON WOMAN AND LOVE, SEEN THROUGH THE SECRET DIARY**

**Abstract:** The object of this article is Pushkin’s poetics through an explanatory approach, which originates from his secret diary, kept in the years 1836-1837, breaking the taboo on coherence.

*The relations that the writer establishes with language make the literary work, always according to Proust, the place of “inventing” more in the “expression” of oneself.*

*In another reading, different from the one so far, in parallel, light is shed on the writing genius and elements of private life. People express their affections through literature, in tune with body language... Pushkin's poetic love remains alive in verses, while through it light is shed on unknown, intimate aspects of the author's life. It must be said that until now there has not been a different interpretation of the poems due to the mindset of the Socialist Realism critic, who did not dare to make such an interpretation, viewed through the secret diary of Alexander Pushkin. The poem addresses us, that starting from it in the reception, some of Pushkin's poetic creations, you can make a different approach to meaning. This is shown by the interest that the secret diary arouses among readers, increasing their curiosity about the poet's work.*

*This different reception brings endless connotations for the reader and Pushkin's art. The time approach reinforces the idea that a poem can be read many times and in different interpretive ways.*

**Keywords:** *Diary, writer, literature, taboo, value.*

Disa poezi të Pushkinit hapin polemikë, me receptimin e tyre ndër lexues. Të tilla poezi si A. P. Kernës; *Kujtoj me mall një çast gëzimi; Koketës; Letra e djegur apo Të huajës* marrin konotacion personal pushkinian. Agron Tufa vëren se “*Pushkini kishte dozën e vet të fortë prej donzhuanit. Në poezitë e tij janë të kamufluara një shumësi e madhe femrash të epokës. Ndër të cilat ka qenë p.sh. A. P. Kerna (Ana). Ana Kerna është e identifikuar, ka qenë personazh real historik. Ekzistojnë madje dhe portrete të saj. Por vini re:*

*Kujtoj me mall atë çast takimi/ Kur para meje u shfaqe ti,/ Si vezullim i një vegimi,/ Si engjëll plot me bukuri.*

*Vazhdon poezia në 6-7 strofa, një perlë e lirikës së Pushkinit dhe ky engjëll që duket sikur nuk i prekin flatrat në tokë, që është gjithmonë një frymëzim i diafragmës së lartë, paraqitet në shënimet e ditarit të tij krejt ndryshe...” (Tufa 2015:2)*

Këto shënime së pari u botuan në SHBA më 1986 nga shtëpia botuese M.I.P. Comany, në Minneapolis me një tirazh që shkonte në 100 mijë kopje, duke u kthyer në bestseller. Ditari është përkthyer në Japoni, Francë, Gjermani, Itali, Greqi etj. Botimi i parë i librit në USA është

bërë në gjuhën ruse. Pikërisht, aty, në këtë ditar sekret Pushkini shkruan:

*“Me Kernin, për shkak të mendjelehtësisë së saj, kam folur vetëm për gjëra pa rëndësi. Te ajo më habiste vetëm trupi i saj i shkëlqyer. Dhe nuk është faji im që shuma e femrave më josh e më habit vetëm me trupin.*

*Ka edhe raste kur takoj gra të zgjuara dhe mendjeholla. Me to është kënaqësi të bisedosh, sidomos për një marrëdhënie të zjarhtë. Këto femra të rralla nuk ankohen kurrë se veç trupit ato nuk paskan vlerë tjetër, sepse, së pari, e dinë mirë se nuk është kështu, dhe, së dyti, ato janë aq të zgjuara sa ta kuptojnë se po të shprehen në këtë mënyrë, bëhen qesharake.(Pushkin 2000:119) Ose ...pasi të jetë ngopur me të, ai të jetë në gjendje të vlerësojë mendien, talentin, mirësinë dhe gjithçka të bukur që mund të ketë ajo.”(Pushkin 2000:120)*

Në ditarin sekret Pushkini shkruan për veten. Madje saktëson Tufa, “...këtu zë fill një dukuri: përdorimi i niveleve të ndryshme të gjuhës. Një nivel gjuhe përdoret për artin dhe një nivel tjetër në ditar. Pra është i njëjti subjekt femëror, i cili shfaqet në dy trajta. Në rastin e parë, siç është poezia, pra engjëll, ndërsa në shënimet e ditarit ai është krejt në anën e kundërt kur thotë, p. sh.: Atë ditë, kur me ndihmën e Zotit, iu shtiva në dorë ... Dhe hyn në hollësi fiziologjike.”(Tufa 2015:3)

Ditari sekret i Pushkinin na fton për një lexim ndryshë të titujve poezive të tij, të përmendura më sipër, duke mundësuar dy receptime në të njëjtën kohë. Poezitë kështu duken edhe më interesante në interpretimin e tyre. “Duke e flakur “të folmen e përditshme”, “shprehjet gjysmë të gatshme”, gjithë sa “na vijnë nga të tjerët” dhe nga të tjerë më të këqinj se ne, “na japin për realitet vetëm një njohje konvencionale”, ku shkrimtari vërtet synon të zbresë në atë “qetësi të thellë ku mendimi për zgjedh fjalët në të cilat do të mishërohet. Duke u larguar nga gjuha e zakonshme, të shkruarit lejon të rrokësh atë që deri dje nuk qe rrokur ende prej të menduarit. Edhe për këtë arsye vepra nuk është as “produkti” as “pasqyrimi” i një realiteti paraekzistues, por është një “zanafillë”, “një ndodhi e re. [...] Kritika tradicionale, madje edhe degë të reja, si psikokritika apo sociologjia e letërsisë, për interpretimin e veprës të degdisin te një “gjetiu”, te një gjësend jashtë saj (veprës): te jeta e shkrimtarit apo historia dhe shoqëria e kohës, ndërkohë që ky konceptim i ri i letërsisë, përkundrazi, të shtyn kah një “kritikë e brendshme”. Për atë që di të lexojë,

*marrëdhëniet e shkrimtarit me botën e me njerëz të tjerë, si dhe me vetveten, gjenden në plotësinë e tyre aty, në vepër. Aty është sheshi, tek shkrimtari e zbulon veten, madje e shpik. Do të ishte e kotë ta kërkoje një shkrimtar në dokumente arkivore. Të shkruarit përfytyrohet si një “fshetje”, një “strukje”, një “bishtnim” prej realitetit ekzistues për t’u ngujuar në hapësirën e gjuhës dhe të letërsisë”. (Echo 1968:173)*

E pashprehshmja nuk shfaqet në thurrimën e veprës e analizuar, por vepra e analizuar afrohet ndaj nesh si një mekanizëm që përfiton të pashprehshmen. Përkufizimi i këtij mekanizmi do të ishte *përkufizimi i emocionit estetik*. (Lanson 1991:18) Një libër i cili do që të të mbajë, të vazhdojë, është një libër që duhet të na japë mundësi ta lexojmë në shumë mënyra, d.m.th. *“mundësi për lexime të ndryshme, të ndryshueshme, të ndërrueshme”*. (Echo 1968:173) Echo thotë se një vepër arti, edhe kur ajo është formë e kryer dhe e “mbyllur” në përkryerjen e vet si organizëm përpikshmërisht i kalibruar, është “e hapur” së paku për aq sa mund të interpretohet në mënyra të ndryshme pa iu tjetërsuar veçanësisht e saj e pacënueshme. (Echo 1962:84)

Veprat e mëdha të shkrimtarëve të mëdhenj, jetojnë nëpër kohë. Ato nuk vdesin, por përjetësohen. *“Meraku për seks është më i fuqishmi nga meraqet njerëzore. Kur nxiten nga ky merak, njerëzit zhvillojnë mprehtësi të imagjinatës, fuqi të vullnetit, këmbëngulje dhe aftësi krijuese të panjohur për ta në kohë të tjera. Kaq i fuqishëm dhe nxitës është meraku për kontakt seksual, sa që njerëzit rrezikojnë lirisht jetën dhe reputacionin për ta kënaqur atë. Kur shfrytëzohet dhe rodrejtohet nëpër vija të tjera, kjo forcë motivuese i mirëmban të gjitha atributet e veta të mprehtësisë së imagjinatës, të guximit etj., që mund të përdoren si forca të fuqishme krijuese në letërsi, në art apo në çfarëdo profesioni a zanati tjetër, duke përfshirë, natyrisht edhe grumbullimin e begatë”*. (Hill 2018: 206) Ndërkaq, Hill sërish vijon të argumentojë tezën e tij. *“Burrat që kanë grumbulluar pasuri të mëdha dhe kanë arritur famë të jashtëzakonshme në letërsai, në art, në industri, në arkitekturë dhe në profesione, ishin të motivuar nga ndikimi i një gruaje”* (Hill 2018: 207)

Në këtë këndvështrim, organizimi i domethënësit në tekstin letrar sjell një mugullim të vijueshëm marrëdhëniesh të brendshme, që i mbeten çdo lexuesi t’i zbulojë gjatë leximit të tij. Shpjegimi tradicional i tekstit, që brengoset vetëm për “letrarësinë”, nuk i pranon “kuptimet e figurëshme”. Ndërkohë, metodat e reja kritike priren t’i shumëfishojnë

këto kuptime; vetë sprovat e bëra gjatë një aventure japin shembuj të këtyre ndryshimeve në mënyrën e të lexuarit. Edhe estetika e receptimit e ka pranuar “papërcaktueshmërinë” e tekstit letrar, “ambiguitetin” që qëndron në thelbin e tij. (Plasari 1996:102)

Jauss-i është i mendimit se interpretimet e reja të një vepre të së shkuarës mbrohen ndaj tepërive arbitrare nëpërmjet caqeve dhe kushteve të horizontit historik dhe shoqëror. Për të kuptuar çështjet që një vepër parashtron, duhet ta lidhim atë me “horizontin e pritjes” së “lexuesve të parë”. Nga ana tjetër, vargu i njëpasnjëshëm i kuptimeve që tashmë i janë dhënë të njejtit tekst përgjatë historisë, ka logjikën e vet. Ai krijon një traditë interpretimi, ndaj së cilës, një interpretim i ri duhet të vendosë një qëndrim të ri, si në rastin e poezive të veçanta nga të tjerat. Një poezi është krijuar për t’u marrë e rimarrë, për t’u lexuar e rilexuar në pafundësi herësh dhe kuptimesh. *“Pushkini ishte tjetër, ishte një lule ekzotike: ezmer, i fortë, me kaçurrela. Mes dëborës ruse dhe një race të bardhë, Pushkini ishte tërheqës, kishte atë shkëndijën magjike tërheqëse jo vetëm si ligjërues, bashkëbisedues, ishin një tok cilësish të përbashkëta të karakterit që e bënë të ishte lider. Pushkini kishte prejardhje etiopiane. Ishte shtatshkurtër, afër mesatares, por mprehtësia e tij, zotërimi elegant i gjuhëve, mënyra për të sintetizuar çdo kontekst ose replikë, e bënë të ishte i kërkuar gjithkund...”*(Tufta 2015:3) Madje ai arrin deri aty sa shkruan edhe për bashkëshorten e vet, Natalia Gonçarovën, duke supozuar se çfarë mund t’i ketë bërë Cari asaj. Pushkini xhelozohej për të. *“Kur shikoj se si Cari i hedh gruas sime vështrime të zjarrta, i kundërpërgjigjem duke e vështruar dhe unë perandoreshën në mënyrë aq të pacipë, sa ta shikoj mirë dhe ai. Me këtë dua ta bëj të mendojë se pasioni i tij për gruan e tjetrit shpaguhet me pasionin tim për gruan e tij”.*(Pushkin 2000:169) Ajo në ditar një herë del me emrin Natalia, një herë me inicialin N. dhe një herë me emrin përkëdhelës Nina.

*“Por gjëja më e tmerrshme që ne nuk mund ta marrim vesh lehtë është nëse gruaja është apo jo besnike. Unë nuk e di asnjherë se çbën në fakt N., kur nuk e shikoj. Besnikëria ruhet vetëm me anë të besimit. Ajo vetëm mund të besohet. Kur besimi im dobësohet, do të thotë se te unë vjen djalli i xhelozisë dhe asnjë provë besnikërie nuk mund të më ndihmojë, sepse në çdo provë aryeja gjen një papërsosmëri. Vetëm rikthimi i besimit në zemër largon xhelozinë. Por ç’e do, vetëm për një farë kohe.”*(Pushkin 2000:50) Ose *“Besnikëria është luftë me joshjen*



*për të mos qenë besnik. Dhe mua nuk më mjaftuan forcat në këtë luftë. Kur e pashë se kjo dobësi do më sillte fatkeqësi, fillova t'ia mbushja mendien N. Të jetonim në fshat. E dija se nuk do t'i bëja ballë joshjes, kurse vetmia do të mbante lidhur pas tryezës së punës” (Pushkin 2000:51) Ose sërish: “Arrita t’i mbush mendjen Ninës se dantesi kishte sifilizin dhe infekton çdo grua që shkon me të... Ajo më besonte deri Katja i tregoi se kjo ishte fund e krye një gënjeshtër. (Pushkin 2000:63) Përsëri Pushkini vijon në ditarin e tij sekret: “Nuk kam forca t’i qëndroj besnik sime shoqeje. Unë e çmoj vërtet atë te gratë e tjera dhe e kërkoj medoemos nga e imja. Madje modelin e saj e kam paraqitur te Tatjana. Edhe N. mundohet shumë. S’e lënë të qetë edhe njerëzit që e përflasin sikur nuk e pëlqeka poezinë time”. (Pushkin 2000:146)*

Tatjana është personazhi femëror të cilën autori e pikturon me ngjyrat e fjalëve të tij. Ajo ka të gjitha cilësitë e një femre mahnitëse për ne, lexuesit. Të gjitha virtytet njerëzore autori i skaliti në këtë personazh femëror, e cila bëhet model për kohën, por jo vetëm për kohën kur është shkruar, një personazh i tillë mbetet i dashur edhe në kohën tonë. “Autori në romanin “Eugjen Onjegini” ngriti lart figurën e femrës, gjë që ishte e pazakonshme për kohën dhe sistemin shoqëror-politikë, sepse në atë kohë fare pak autorë mund ta ngritnin figurën e femrës në pedestalin në të cilin e ngriti Pushkini. Ai bëri hapin e parë dhe kështu krijoi një figurë femër madhështore, e cila u bë model për autorë tjerë të mëvonshëm vendas dhe botërorë”. (Tufa 2015:4)

*“Një mikut mund t’i behesha mike/ Dhe shoqe e jetës e besnike/ Dhe zonjë e ndershme për shtëpi./ Një tjetër... jo askujt në jetë/ Nuk do t’i falnja dashuri!/ E ka vendosur Qielli vetë, jam e jotja në perjetësi;/ Gjithë jeta ime më pat qenë/ Një peng se ty do të takoj/ Se Zoti jetën ma ka dhënë/ Që gjer në varr të adhuroj...” ose: “Mendja fillon të më lëshojë/ Në heshtje duhet të humbas./ Të pres ti eja siç ma k’ënda/ Dhe shpresat ngjallm’ i përsëri,/ A ma prish ëndrrën që tashi/ Me të qortuara të rënda!” (Pushkin 2000:89)*

Theksojmë se: “Forma e romaneve si **Onegini** është krijuar nga Bajroni; të paktën mënyra e tregimit përzjerja e prozës dhe e poezisë në realitetin e paraqitur, apostrofat, thirrjet e poetit drejtuar vetvetes dhe sidomos prania e ndjeshme e personit të poetit në veprën e krijuar nga ai, gjithë kjo është puna e Bajronit. Sigurisht, të përvetësosh, formën e re të huaj për subketin tënd, nuk është njësoj si ta krijosh vetë atë; me gjithë atë kur krahason Oneginin e Pushkinin me **Don Zhuanin**,

*Çaild Haroldin dhe Bepon e Bajronit, nuk mund të gjesh asgjë të përbashkët, përveç formës dhe mënyrës të veçantë të të shkruarit personal.”(Bjelinski 1960:52)*

Ndër poezitë e tjera që futen në këtë grupim, janë edhe poezitë “Sa ju kam dashur!”, “Letra e djegur”, “Kujtoj me mall një çast gëzimi”, “Koketës”...(Pushkin 2009:18;25;60;82)

*-Ndofta dashuria/ Nuk është shuar krejt në shpirtin tim!/ Po s’dua që prej dhembjeve të mia/ Të ngryseni sërish në dëshpërim.*

*“-Oh, lamtumirë, o letër! Ajo me porositi.../ Sa po më dridhet dora tani prej dhembshurisë!/ Si mund t’i djeg gëzimet që më kish patur shpirti?!/ Po mjaft, erdhi ora, digju, o letër e dashurisë!*

*-Dhe rreh me gaz kjo zemra ime/ Sepse ju kthyen perseri/ Dhe perendi, dhe frymezime/ Dhe lote, e jete, e dashuri.*

*-S’më prek betimi qesharak/ Dhe djallëzitë m’u mërzitën/ Por edhe juve jo më pak/ Besoj ju lodhën tradhtitë/ Të ftoht’u bëmë dhe të matur/ Dhe s’presim të na thot’ njeri,/ Se e përjetshmja dashuri*

*-Ndofta dashuria/ Nuk është shuar krejt në shpirtin tim!/ Po s’dua që prej dhembjeve të mia/ Të ngryseni sërish në dëshpërim.*

*-Oh, lamtumirë, o letër! Ajo më porositi.../ Sa po më dridhet dora tani prej dhembshurisë!/ Si mund t’i djeg gëzimet që më kish patur shpirti?!/ Po mjaft, erdhi ora, digju, o letër e dashurisë!*

*-S’më prek betimi qesharak/ Dhe djallëzitë m’u mërzitën;/ Por edhe juve jo më pak*

*Besoj ju lodhën tradhtitë;/ Të ftoht’u bëmë dhe të matur/ Dhe s’presim të na thot’ njeri,/ Se e përjetshmja dashuri/ Tri javë e shumta mund të zgjatet.”*

Duhet thënë se për këto poezi ka pikëtakime të tjera me femra inicialet e të cilave gjenden në ditarin sekret të Pushkinit (1836-1837). Përmendim A., Z, K., N. N., etj. Pushkini ishte një nga zëdhënësit virtuozë jo vetëm të shpirtit poetiko-lirik të rusëve, por edhe i filozofisë së përgjegjësisë së tyre në dashuri. Poeti i romantizmit rus, kurrsesi nuk mund të linte jashtë kësaj ndjesie poetikën e tij, e cila bëhet edhe më e bukur në këndvështrimin receptues. Nën tisin e kësaj qasjeje analizuese, lexuesi mbetet më i drejtpërdrejtë me një realitet që nuk është vështirë ta riprodhosh, si dikur edhe në ditët tona.

## **BIBLIOGRAFIA**

1. A. S. Pushkin. *Ditari sekret 1836-1837*, Shtëpia botuese Fan Noli, Tiranë, 2000
2. A. S. Pushkin. *Poezi, poemë, drama në vargje*, Shtëpia botuese Argeta LMG, Tiranë, 2009
3. A. Pushkini. *Eugjen Onjegini*, Shtëpia botuese Argeta LMG, Tiranë, 2000
4. A. Plasari, *Fishta i dashuruari*, Shtëpia botuese “Marlin Barleti”, Tiranë 1996
5. Napoleon Hill. *Mendo dhe pasurohu*, Shtëpia botuese Pema, 2018
6. V. G. Bjelinski. *Artikuj kritikë*, Shtëpia botuese Naim Frashëri, Tiranë, 1960
7. <http://www.infoelbasani.al/tatjana-i-shkruan-onjeginit-letra-e-famshme-per-vajzat-e-mira-qe-te-ben-ti-duash-fort/>

**RRETH KOMPOZITAVE DHE TIPAREVE TË TYRE,  
QËMTUAR NË MATERIALIN FOLKLORISTIK TË “BËLETËS  
SHQYPTARE” TË THIMI MITKOS**

**LONORA HYSOLLI**

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë  
Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë  
Universiteti “ Fan S. Noli”

[lhysolli@yahoo.com](mailto:lhysolli@yahoo.com) & [lhysolli@unkorce.edu.al](mailto:lhysolli@unkorce.edu.al)

**Abstrakt:** “Babai i folklorit shqiptar”, Thimi Mitko, me veprën e vet “Bëleta Shqyptare” u bëri një dhuratë të vyer gjithë brezave të studiuesve që priren të vënë në dukje vlerën e vërtetë të këtij burimi të pashtershëm shumëplanësh. Në pjesën e parë të kësaj vepre (vështruar tek “Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar 1635-1912, II”, Instituti i Folklorit, Tiranë, 1961), autori ka renditur gjithë çka munda të vjelë nga goja e popullit e të sistemojë me logjikën dhe dorën e vet: Fjalë të moçime; Fjalë t’errëta Të përshëndoshura; Emëra vetiakë; Këngë të vjetëra (alegorike dhe për të qeshur); Këngë që këndohen në disa ditë të caktuara; Kënga shqype dasëmore, Kënka shqype jaranishte; Gegërishte; Kënka shqype trimërishte; Këngë trimërie gegërishte; Përralla shqype.

Tek gjithë kjo lëndë, janë hulumtuar e marrë në shqyrtim një sërë kompozitash, të cilat, ashtu si gjithë fjalët jo të parme, kanë karakteristikat, tiparet dhe veçoritë e tyre. Gjithë inventari i kompozitave të qëmtuara është parë si vlerë e shtuar e krijimit popullor, si mënyrë prodhimtare fjalëformimi, në këndvështrimin e lashtë dialektor burimor etj. Punimi rreket të sjellë mendim të argumentuar, që lidhet me vjetërsinë e kompozitave dhe rëndësinë që ato kanë për të vërtetuar se kjo mënyrë prodhimi fjalësh është po aq e vlerë dhe e lashtë për shqipen, sa dhe mënyrat e tjera dhe zhvillohet krahas tyre, sipas nevojave të leksikut të gjuhës. Materiali i vjelë prej veprës së Mitkos ka shumë rëndësi për të argumentuar idenë në fjalë, e “paragjykuar” disi nga disa studiues të huaj të shqipes.

**Fjalë kyçe:** fjalëformim, kompozita, kulturë kombëtare, personalitet, tipare, personalitet, veçori dialektore

## ABOUT THE COMPOSITES AND THEIR FEATURES, FOUND IN THE FOLKLORIC MATERIAL IN "BËLETA SHQYPTARE" OF THIMI MITKO

**Abstract:** *“The father of albanian folklore”, Thimi Mitko, with his work “Bëleta Shqyptare” gave a precious gift to all generations of researchers who tend to notice the true value of this multiplan inexhaustible source. In the first part of this work, (looked at “Prime collectors of albanian folk 1635-1912, II”, The Institution of Folklor, Tirana, 1961), the author has listed everything he could collect from local people tells, depending on his own logic and handwriting:*

*Ancient words; dark words; greeting words; proper noun; old songs (allegorical and funny); songs that are sang in special occasions; The albanian weddings song; The albanian love song; North; The albanian bravery song; The albanian northern bravery song; Northern bravery song; The albanian fairytale*

*In this whole subject, some compositions were searched up on, which like all non simple words, have characteristics and their own features. The entire inventory of composite nouns found and collected, is seen as an added value of albanian nation creation, efficient way of word formation, in the ancient point of dialect source etc.*

*The work tends to bring a argumentative opinion, which is related to the oldness of the composites and their importance to prove that this work creation way is as worth and acient for the albanian language as the other ways and develops alongside them, according to the needs of the language vocabulary. The acquired material taken from Mitko’s work, has much importance to argue the idea in question, “judged”, a bit by some foreign albanian researchers.*

**Keywords:** *word formation, composition, international culture, personality, features, dialectical features.*

### **Hyrje**

Është universaliteti dhe kompleksiteti i figurës intelektuale për ta vazhduar traditën përkujtimore në nder dhe respekt të mendimit e shpirtit të tij të mbujtur me dashuri e krenari. Gjithmonë, ka diçka për të shtuar për të, pasi ai ka qenë, është edhe do të jetë... **Thimi Mitko.** Përkujtohet si folklorist, patriot, atdhetar, veprimtar i çështjes kombëtare, publicist, etj. Pra, përbën një personalitet të shquar të kulturës sonë kombëtare.

-**Si folklorist**, kreu një punë të sistemuar, mbështetur në kritere shkencore, për mbledhjen, ruajtjen dhe klasifikimin e materialit folklorik, duke u bërë kështu themeluesi i kërkimeve folkloristike. Ai qëmtoi me dashuri mes bashkatdhetarëve të tij në mërgim: këngët e bukura, lodrat zbavitëse, përrallat, gjuhën e kulluar të proverbave.

- **Si patriot e atdhetar**, evidenton rolin historik të krijimtarisë popullore për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare tek populli. Nxjerr në pah rëndësinë dhe rolin e madh që ka folklori tek gjuha dhe letërsia e një populli. Sipas tij, atdheu është i pari, është mbi të gjitha. Ai nuk e donte përçarjen fetare dhe copëtimin e Shqipërisë.

Testamenti dhe amaneti i tij “Bëleta Shqiptare”, duke qenë i qëllimshëm, si dëshmi e gjallë, zbulon më së miri ekzistencën e popullit shqiptar, jo thjesht si një shprehje gjeografike, por si një gjeni e madhe krijuese, me botë shpirtërore aq shumë të pasur, që përcillet në breza përmes këngëve, përrallave, gjëzave, proverbave etj... Për të, çështja e gjuhës amtare është po ashtu jetike, identitare, pasi është ushqim i parë e i përbashkët që i jep gjallëri popullit... Përhapja e mësimi të gjuhës shqipe, prezantimi dinjitoz përballë botës së qytetëruar me traditat luftarake, me virtytet dhe aftësitë mendore të popullit shqiptar, e bëjnë Mitkon një rilindas të vërtetë.

## **Qëllimi**

E kjo trajtesë gjuhësore le të jetë një pjesëz që e merr në konsideratë kontributin e tij gjuhësor, në sjelljen e fjalëve të përbëra të formuara në mënyrë origjinale si nevojë përditshmërie nga populli ynë, që në zanafillë. Babai i folklorit shqiptar, me veprën e vet “Bëleta Shqiptare” i bëri një dhuratë të vyer, thesar të paçmuar, vendit të lindjes, atdheut të tij dhe gjithë brezave të studiuesve që priren të vënë në dukje vlerën e vërtetë të këtij burimi të pashtershëm. Viti 1878 mbetet i shënuar në historinë shqiptare, sepse u botua ky testament, në përgjigje të kërkesave të kohës.

Nga Parathënia e Mitkos, mund të dallohet lehtë:

***Qëllimi i “Bëletës Shqypëtare”, d.m.th i këtyre studimeve albanologjike, është përgjithësisht: shpëtimi dhe dhënia brezave që vinë i fjalëvet dhe tekstevet shqipe, të cilat para disa vjetësh i mbledha me shumë mundim e shpenzime, dhe besoj se do të kenë një vlef të, sepse në këto duket origjina, karakteri, zakonet e racës shqiptare; veçanërisht, dua që t’u ipet një shkak e një nxitje bashkatdhetarëve***

*shqiptarë për kulturën edhe për të studjuar gjuhën e tyre amtare, që me këtë mënyrë t'u sjell dobi që të mundin edhe këta të përparojnë edhe të kenë njësoj vleftë me vëllezërit e tjerë të tyre ellenofonë. Uroj që të tjerë, me të zotët se mua në këtë punë ta pasurojnë këtë mbledhje edhe ta zbukurojnë, që të përdoret për dobinë morale të kombit.*

### **Metodologjia e përdorur**

Në pjesën e parë të “ Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar 1635-1912, II” , Instituti i Folklorit, Tiranë, 1961, Thimi Mitko ka renditur çka mundi të vjelë nga goja e popullit dhe të sistemojë me logjikën dhe dorën e vet:

*a. Fjalë të moçime ; b. Fjalë t'errëta ; c. Të përshëndoshura ; ç. Emëra vetiakë; d. Këngë të vjetëra (alegorike dhe për të qeshur); dh. Këngë që këndohen në disa ditë të caktuara; e. Kënga shqype dasëmorie; ë. Kënka shqype jaranishte; f. Gegërishte; g. Kënka shqype trimërishte; gj. Këngë trimërie gegërishte; h. Përralla shqype.*

Këtu janë qëmtuar e marrë në shqyrtim një sërë kompozitash të cilat, ashtu si gjithë fjalët jo të parme, kanë karakteristikat, tiparet dhe veçoritë e tyre. Gjithë inventari i kompozitave të qëmtuara, të cilat po i sjellim në punim sipas renditjes, është parë si vlerë e shtuar e krijimit popullor, si mënyrë e lashtë ,prodhimtare fjalëformimi.

### **Rezultatet**

#### **a. Fjalë të moçime (f. 17-27)**

Gjymës' e mijës *pesëqind*. I madh, *gjëmëmadhi*. Me njerin e vet ha e pi, pa *dhënëmarreje* mos ki. Puna është *faqebardhë* . Puno, o *fat-zi!* Hai o *bark-stihi!* Shpata e trimit edhe sofrë e *zëmërbardhit* nuku pritët kurrë. Vetëm një gomar *buzëbardhë?*

#### **b. Fjalë t'errëta (f. 27-30)**

*Bythëkuqi* rref *bythëzinë* . Dy shigjeta *pendëzeza*, tekdo i lëshon, atie venë.

#### **c. Të përshëndoshura (f. 30-32) Faqebardhë**

#### **d. Këngë të vjetëra (35 këngë, f. 36-49)**

*shalë-dema* , *krye-kaleshi*, *nuse-miri* , *derë-bardhi*

**dh. Këngë që këndohen në disa ditë të caktuara (17 këngë, f. 50-55)**  
*monobirrë, mirë-dita, kamë-bardhë, thumba-thumbuari, gozhdë-gozhduari*

**e. Kënka shqype dasëmore (58 këngë, f. 55-70)**  
*këmbëkuqe, dhëndër-trimit, dhëndër-trimi, bash-hodë, faqe-zezënë, sy-zezë, faqe-qelqe, zëmbërë-ftohëtë, krahërgjëntë*

**ë. Kënga shqype jaranishte (73 këngë, f. 70-92)**  
*lumëmadhëja, sy-larmenë/sy-larme, grykëzënë, sy-zezë, (përsëritur disa herë) vetullë-hollë, faqe-kuqesë, faqe-tolopuçeja, faqe-nkuqura,lesh-gjatë, lesh-kurore, mustaqe-zi, sy-zezat, dor'-argjënda, faqe-rrumbulla, mes-këputura, shami-kuqe, sy-rrushe, buzë-qengjërushëja, buzë-karafilëja, mes-langore, buzë-burbuqe, krahëruar-bardha, cullufe-zezë, (përsëritur disa herë), sy-konxhë, ballë-xhufetë, faqe-rrogosi, jelek-kuqeja*

**f. Gegërishte (5 këngë, f. 93-94)** *mes-hollatë, vetull-qemere*

**g. Kënka shqype trimërishte (93 këngë, f. 94-154)**

- **Kënga e Gjikhë Thanasit nga Borshi i Haonisë**  
*murtajëmadhi, mustaqe ziu, derëzi, gunë-gjetë, binish-gjatë, papadhemoni, kordhë-shpata, qafë-gjati, fat-zinë, (përsëritur disa herë) faqe-bardhë, derë-ziu, mustaqezi, gunë-dhirë, pisqollë-artë, fustane-holli, vetullëhollë, fustane-bardhë, mustaqe-verdhë, bashnizamit, gjemenxhetë, pisqolle-larë, gushëbardhë, mëngëçarë, merhabanë, mustaqerruari, gunëbardhë, brigje -brigje, qafëzetas, Qafëzezi.*
- **Kënga e kryengritjes së Gjon Lekës më 1847**  
*xhephanetë, mustaqeziu, shallvare-gjërë, kokë-mollë, kurris-dalë, kriso-gaitanë, kordhëshpata, myshaverenë, vetullëthanë, këmbë-pula, besë-qeni, vetullë-hollë, fat-keqe, mustaqe-dhiamë, dyfek-karafilë, besa e besë, mustaqverdhë.*

**gj. Këngë trimërie gegërishte (f. 155-165)**

*faqebardhë, krye-lopa, karadyzenë, mezil-dorinë, perçe-sërmalijetë, divanhane, kasaphane*



## **h.Përralla shqype: Tinglimaimun**

### **Te titujt e këngëve:**

*Mirë-dita* për këllana; Lumeja ti mori *sy-zezë*; Moj unaza rreth flori;  
Tanana, moj *faqe-qelqe*;  
*Lumëmadheja* ku je; *Syzezë, vetullë-hollë*; Vetë e bardhë *shami-kuqe*;  
Tatushan moj *mes-langore*;  
Ngjelino *buzë-burbuqe*; Moj *sy-zezë* moj *sy-konxhë*; Kardhiqotë *gunë-dhirë*; Bilbil o *pisqollë-larë*; O xhandar o *mëngëçarë*; More Nule *kurrisdalë*; *Pesëdhietë* kolonjarë duallë; *Pesëqind* dhen me pesë këmborë;

**Çështja e fjalëve të përbëra të gjuhës shqipe** është studiuar nga gjuhëtarë të mëdhenj të huaj, por dhe nga gjuhëtarë shqiptarë, të cilët, të tërhequr fort nga ndërtimi i fjalëve të kësaj gjuhe, **“të bekuar nga Perëndia”**, siç thotë Naimi, vendosën të japin ndihmesën e tyre në këtë drejtim. Studiuesi shqiptar i gjuhës Kostaq Cipo i ka përkufizuar kompozitat si *shprehje lakonike të rastit, miklime e lulëzime të gjuhës, që marrin nga një emër sipas punës që bëjnë në gjë të periodës*.

Një tjetër studiues shqiptar që i ka kushtuar vëmendje kompozitave është edhe Androkli Kostallari. Sipas tij, *fjalë e përbërë ose kompozitë e mirëfilltë në gjuhën shqipe është ajo fjalë dygjymtyrëshe që formohet nga bashkimi i dy ose më shumë temave në një fjalë të vetme, në një njësi të vetme leksiko-morfologjike, ka kategoritë e veta potenciale fjalëformuese, zhvillohet semantikisht dhe kryen funksionet e veta sintetike gjithnjë si një tërësi-fjalë, pavarësisht nga veçoritë fonetike dhe leksiko-gramatikore të saj*.

Fjalët e përbëra dokumentohen që në monumentet më të lashta të gjuhës sonë të shkruar. Në veprat e Buzikut, Budit, Bardhit, Bogdanit, Varibobës e të tjerë takohen disa nga tipat më të vjetër e produktivë të kompozitave të shqipes. Në onomastikë dhe sidomos në toponomastikë gjejmë një dokumentim edhe më të lashtë të kompozitave në gjuhën e shkruar. Por, me gjithë këtë dokumentim të hershëm, pasqyrimi i kompozitave në gramatikat e shqipes është relativisht i vonë. Në studimin e tij kryesor mbi shqipen *Franc Boppi* nuk i trajton fare kompozitat e shqipes. Trajtimi i tyre, padyshim, do të ndihmonte shumë për të treguar edhe më qartë afërsinë e shqipes me gjuhët e tjera indoeuropiane në lëmin e formimit të fjalëve dhe do ta bënte njëkohësisht më të plotë trajtimin e strukturës së fjalës në shqipen. Ky

qëndrim ndaj kompozitave të shqipes me sa duket, ushtroi një influencë të madhe mbi shumë studiues të mëvonshëm të shqipes, si p.sh. tek *Kamarda, Dozoni, Weigandi*, etj.

*J.G.Hahn*, punimet e të cilit janë në një kohë me ato të *F.Boppit*, edhe atëherë kur sjell si shembull mbiemrat e përbërë *derë bardhë, derë zi, kokë-lesh*, shpreh pikëpamjen se ky tip kompozitash është i rrallë në gjuhën shqipe . Fill pas *J. G. Hahnit* edhe *D. Kamarda* në shqyrtimin e kompozitave të shqipes niset gjithashtu edhe nga mendimi i gabuar se shqipja nuk është e pasur me kompozita të mirëfillta. Ai thotë shprehimisht se një gjë të tillë e ka vënë re edhe *Boppi*. *Kamarda* jep të dhëna të krahasueshme mbi formimin e fjalëve me anë të parashtesave, prapashtesave dhe kompozimit.

Gramatika , ku formimi i fjalëve në shqipe pasqyrohet më hollësisht se në çdo gramatikë tjetër të shekullit XIX, është ajo e *A. Dozonit*. Në këtë gramatikë kompozitat ndriçohen më pak se çdo mënyrë tjetër fjalëformuese. Sipas tij formimi i fjalëve në gjuhën shqipe, “*kryhet në radhë të parë me anë të derivacionit, ndërsa kompozimi është një fakt më i rrallë*”.

Ashtu si *A. Dozoni, G.Weigand* e konsideron kompozimin e fjalëve në shqipe si një shfaqje “shumë të rrallë”. Pastaj ai jep një pasqyrë mjaft të varfër të kompozitave të shqipes. Si kompozim të mirëfilltë dhe më të rëndësishëm në shqipen ai quan togfjalëshat tipit *emër në emërorë + emër në rrjedhore* si p.sh. *gur-mullini, breg-deti, vakt-dreke* etj.

Emrat më të dëgjuar shqiptarë në studimin e kompozitave janë ata të *Aleksandër Xhuvanit, Kostaq Cipos, Shaban Demirajt, Latif Mulakut, Androkli Kostallarit, gjuhëtarë të cilët kanë bërë studime më të gjera e përgjithësuese për këtë tip fjalësh. Përmes këtyre studimeve është hedhur poshtë mendimi i mëparshëm, si një “paragjykim” i disa prej studiuesve kryesisht të huaj, si *Hahn, Dozon, Weigand* etj, sipas të cilëve gjuha shqipe nuk ka kompozita të mirëfillta dhe formimi i fjalëve të tilla nuk është karakteristike për të.*

### **Në përgjithësi formantet kompozitëformuese të shqipes kanë këto veçori:**

Rendi i përcaktuar i gjymtyrëve të kompozitës (sepse ndërrimi i rendit sjell prishjen e fjalës); Qënia e një theksi të vetëm kryesor për gjithë fjalën; Prania e zanores lidhëse (për një numër rastesh) e cila në këtë

rast luan rolin e një ndajshese fjalëformuese,por shpesh edhe i vijës lidhëse, me të njëjtin efekt.

### **Si tipare të tyre veçojmë:**

Duke patur të paktën dy tema motivuese, kompozitat kanë zakonisht një *ngarkesë semantike më të madhe se fjalët e prejardhura*. Temat përbërëse të kompozitave janë tema fjalësh emërtuese, që kanë një kuptim leksikor të qartë, të përcaktuar si : emra, mbiemra, folje, ndajfolje, por edhe numërorë apo përemra. Bazuar pikërisht tek raporti midis kuptimeve të gjymtyrëve dhe kuptimit të fjalës kompozitë, ne mund të përcaktojmë lidhjen sintaksore midis gjymtyrëve përbërëse (**bashkërenditëse/këpujore** apo **nënrenditëse / përcaktore**).

*Kompozitat këpujore* janë fjalë që përbëhen nga dy ose më shumë gjymtyrë me lidhje bashkërenditëse mes tyre: *kuqezi, shitblerje* etj. Ato plotësojnë në mënyrë të ndërsjelltë njëra-tjetrën. *Kompozitat përcaktore* janë fjalë të formuara prej dy gjymtyrësh që kanë lidhje nënrenditëse midis tyre, ku njëra përcakton tjetrën. (e para të dytën ose anasjelltas)

### **Diskutimi i rezultateve**

**Tek “ Bëleta”** vihen re se kompozitat janë shumë e gjithfarësh:

**1. Kompozita përcaktore:** Vihet re se mbizotëron kompozimi me marrëdhënie nënrenditëse përcaktore mes gjymtyrëve të kompozitave: *Gjëmëmadhi, dhënëmmarrëje, faqebardhë, pendëzeza, krye-kaleshi, nuse-miri, këmbëkuqe, faqe-qelqe, zëmbërë-pula, zëmbërë-ftohëtë, krahërgjëntë, krye-lopa, sy-rrushe, mëngëçarë, besë-qeni, këmbë-pula, mustaqeverdhë, kurrisdalë* etj.

**2. Kompozita këpujore:** *Pesëqind, thumba-thumbuesi, gozhdë-gozhduari, pesëdhjetë, besa e besë, brigje- brigje.*

### **3. Nuk vihen re shkurtesa**

Nga këndvështrimi burimor i krejt kompozitës apo elementeve të saj përbërëse, gjejmë këtu një grup kompozitash orientale, të cilat vijnë nga fusha të ndryshme semantike:

*berberhane, divanhane, merhaba, sulltanevrüz, xhephane, kahreman, kasaphane, mejhane, perçe-sërmalijë, bashnizamit, karadyzenë*

Ndër fjalët e përbëra, me *marrëdhënie përcaktore* midis njërës gjymtyrë me burim nga turqishtja dhe tjetrës me burim nga shqipja kemi:

*binish-gjatë, palla-gjerë, shallvare-gjanë, sy-konxhë, vetull-qemere, dyfek-karafilë, pisqollëlarë, etj.*

**Kompozitat përcaktore me burim nga shqipja të të dyja gjymtyrëve, janë mbizotëruese:**

*Faqebardhë, buzë-bardhë, zemërbardhë, nuse-mirë, pendë-zeza, faqe-qelqe, krahargjentë, zëmbrë-ftohëtë, buzë-qengjëruseja, kokë-mollë, kurris-dalë, rreth-flori, vetullë-hollë etj.*

Sipas Juliana Kumes (në *Çështje leksikore të gjuhës shqipe në fjalorin trigjuhësh të Thimi Mitkos, 2015: 119*), për formimin me anë të kompozimit:

*Të shumtë në numër janë emrat e kompozuar në krahasim me mbiemrat e kompozuar. Shumë prej këtyre emrave të kompozuar i krijon vetë autori, ose mund të jenë të asaj kohe të formuara nga rilindës të tjerë. Fjalët e përbëra që i hasim tek Mitkoja, sipas formimit të tyre janë bashkim i dy temave emërore ose emër + mbiemër. Nga dy tema emërore kemi strukturën morfematike **emër + emër + prapashtesa (sufiks)***

*p.sh.: ujëdhësë-a (ujë/dhe/së-a), udhëkryq/e-ja (udhë/kryq/e-ja), uji-argjendi (uji/argjend/i), gur-argjendi (gur/argjend/i), shami-qafe-ja, këmishë-gjumi, rrobe-shtëpie, rrathëduarshet, cipë-gjarpëri, këmbë-pule-ja, shtëpizë-fushe, etj.*

**Emër + folje ose pjesore foljesh + prapashtesë (sufiks):** *verëqitësi (verë/ qit/ ës/ i), lule-shtrydhëje (lule/ shtrydhë/ je), zemër-dashurë, bukë-shkelës-i (bukë/shkelës/i), lëkurë-rregjës-i, dorëshkrume-ja, gjellë-bërës, derë-hapuri-a, njeridashurë-i, zemër-dashur, gojë-lëshuarë etj.*

**Emër + mbiemër + mbaresë:** *lëvdatëmadh-i, lëvdatëkot-i; Zëmadh-i; sumadhe-ja; dritëshkurtërë-i; dhëmbëçalë-I; mëndie-hollë-i; shtat-mirë-i; gënjeshtërmadh;-i zemërmirë-i, sy-vëngër-i etj.*

Sa i takon çështjes së drejtshkrimit të kompozitave është mëse e pranueshme që të ketë shmangie, sa kohë që gjuha letrare shqipe ishte në fillimet e saj në prirjen drejt unifikimit e normëzimit. Në mënyrën e të shkruarit: Kompozitat e gjetura tek këngët e mbledhura të Mitkos, vijnë përgjithësisht të shkruara bashkë: *lumëmadhja, grykëzënë,*

*murtajemadhi, gushëbardhë, mëngëçarë, kordhëshpata, vetullëhanë, kurrisdalë* etj.

Por kemi dhe shkrimin me vizë në mes, që zënë vendin më të madh apo janë më të shumta në inventar si: *sy-larme, sy-zezë, lesh-gjatë, mes-langore, faqe-nkuqura, kordhë-shpata, gunëdhirë, besë-qeni, mustaqe-dhiamë, fat-keqe, shallvare-gjerë*, etj.

Edhe të shkruara ndaras, kemi kompozita si : *mustaqe ziu, brigje brigje, besa e besë, rreth flori (unaza)*

Në shumicën e përdorimeve, Thimi Mitkoja e ka regjistruar materialin duke u mbështetur kryesisht mbi të folmen e Korçës, Kolonjës, Përmetit, madje edhe të çamërishtes, ndoshta për shkak të përkatësisë së bashkatdhetarëve të tij në vendbanimin ku ai jetoi e punoi.

Si tipare të theksuara të toskërishtes vihen re:

Përdorimi i zanores **ë**- fundore: *sy-larmenë, grykëzënë, vetullë-hollë, faqe-kuqesë, mëngëçarë, vetullëthanë, faqezezënë* etj.

Përdorimi i zanores **ë**, në vend të zanores **e** të theksuar para bashkëtingëlloreve hundore m, n, nj: *dor'-argjenda, krahërgjëntë, zëmërbardhi*

Përdorimi i grupit **mb**: *zëmbrë-ftohëtë*,

Përdorimi i grupit **nt**, për **nd**: *krahërgjëntë*,

Ruajtja e zanores **e** tek trajta e shquar e emërores, për emrat e gjinisë femërore: *lumëmadheja, buzë-qengjëruseja, buzë-karafilëja, jelek-kuqeja*

Përdorimi i **-s** fundore në vend të bashkëtingëllores **-z**: *kurris-dalë, faqe-rrogosi*

Ruajtja e grupit zanor **ua**: *krahëruar-bardha*

Përdorimi I bashkëtingëllores nistore **k** të shurdhët në vend të **g**-së së zëshme: *sy-konxhë* etj.

## **Përfundime**

“Bletën” e tij, Mitkoja e botoi më 1879 me alfabetin e Kamardës me një qëllim shumë të lartë, siç shprehet ai: “*për të bashkuar muhamedanët e të krishterët shqiptarë edhe për të ndërtuar gjuhën tonë*”. Edhe këto fakte janë të mjafta për të arritur në përfundimin se Thimi Mitkoja vuri një gur të rëndë në ngritjen e ndërtesës së alfabetit të shqipes dhe njësimi të saj. Tek “Bleta”, janë qëmtuar e marrë në shqyrtim një sërë kompozitash, të cilat ashtu si gjithë fjalët jo të parme, kanë karakteristikat, tiparet dhe veçoritë e tyre. Gjithë

inventari i kompozitave të qëmtuara është parë si vlerë e shtuar e krijimit popullor, si mënyrë prodhimtare fjalëformimi, krahas mënyrave të tjera, të lashta sa vetë gjuha e popullit që e ka në folklorin e vet e që e trashëgon ndër breza.

Nuk mund të jetë rastësore që kompozitat me rrënjët (ose temat) e shqipes janë më të shumta. Madje, edhe kur huazon detyrimshëm nga ndikimi i gjuhëve në kontakt, rrënjën themelore e ka të vetën. Nëse jo, qëllimi justifikohet nga mjeti.

Fjalët e përbëra mbeten një nga çështjet më të diskutuara nga gjuhëtarët në rrjedhën e kohës, madje, siç thotë Aleksandër Xhuvani, kompozitat janë një nga çështjet e shumta të paharruara të gjuhës sonë. Me gjithë dokumentimin e hershëm kompozitat në gramatikat e gjuhës shqipe janë pasqyruar relativisht vonë. Midis trajtimit të kompozitave dhe brumit të gjallë leksikor të shqipes ekziston një lidhje mjaft e dobët. Kjo lidhje e dobët është shkaku kryesor i krijimit të një tradite gramatikore skeptike kundrejt kompozitave të gjuhës shqipe, traditë që në shfaqjet e saj ekstreme arrin deri në mohimin e plotë të ekzistencës së kompozitave të mirëfillta të shqipes. Shpesh në gramatikat e shekullit XX nuk është i qartë as vetë koncepti i fjalës së përbërë në gjuhën e sotme shqipe, por kompozitat janë një tip shumë i pasur dhe prodhimtar fjalësh edhe në gjuhën shqipe. Ato dëshmohen që me shkrimet e para të shqipes. Më herët ato dalin si emra vendesh, p.sh. *Gruemirë* apo mbiemra njerëzish p.sh. *Buzëglani* (*Buzëgjeri*). Krahas krijimit kolektiv për nevoja të bashkësisë folëse të shqiptarëve, fjalët e përbëra janë krijuar edhe nga dijetarë, shkrimtarë, intelektualë shqiptarë, në rrjedhë të kohërave. Kompozimi është *mënyra më prodhimtare fjalëformuese në gjuhën shqipe pas ndajshtesimit*.

Përpyekjet për krijimin e neologjizmave me kompozita me vetë brumin e gjuhës shqipe, qysh nga shkrimtarët e parë shqiptarë e duke vazhduar me shkrimtarët e Rilindjes, të kryesuar nga Naimi dhe Samiu e duke vijuar edhe në ditët e sotme, e ka mbështetur dhe Mitkoja me krijimet (fjalëformimet) e tij, duke parë si një nga rrugët më të rëndësishme të pasurimit të gjuhës me njësi, shprehje dhe ndërtime të reja, ashtu sikurse e shihte të lidhur ngushtë me detyrën e pastrimit të gjuhës nga njësitë leksikore, apo neologjizmat e panevojshme. Disa prej neologjizmave të krijuara me brumin e gjuhës shqipe nga autori ose që mund t'i kenë përkthir asaj kohe, janë p.sh.: *dorëshkrume-ja*,

*dheshkres, rrathduarshet, rrathë-duarset, rrobe-shtëpie, shami-qafeja, cipë-gjarpëri, erë-shtiellësa.*

## **BIBLIOGRAFIA**

- Baliu. B., *Thimi Mitko dhe fillimet e shkencës së Albanologjisë*, Korçë, 2015
- Demiraj. M.-Bushaj. M., *Rreth përdorimit të orientalizmave në veprën “Bleta Shqiptare” të Thimi Mitkos*, Korçë, 2015
- Haxhihasani. Q., *Thimi Mitko, Vepra*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti I Kulturës Popullore, Tiranë, 1981.
- Latifi. L., *Turqizmat dhe semantika e tyre në fjalorët e shqipes*, Tiranë, 2012
- Metani. I., *Identifikimi I krijimtarisë popullore sipas leksikut vendor në veprën e Thimi Mitkos*, Korçë, 2015
- “Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar 1635- 1912, II”, Botim i Institutit të Folklorit, Tiranë, 1961
- Mitko. Th., *Vepra*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 1981.
- Shegani. K., *Vështrime leksikore në veprën e Thimi Mitkos*, Korçë, 2015
- Xhanari. L., *Korpusi i turqizmave në përmbledhjen folklorike “Bleta Shqiptare” të Thimi Mitkos dhe rëndësia e tij në përcaktimin e kronologjisë së hyrjes së turqizmave në gjuhën shqipe*, Korçë, 2015

# NJË QASJE E DALLIMEVE NDËRGJUHËSORE NË KORPUSET E GJUHËS ANGLEZE: NJË ANALIZË NDËRGJUHËSORE PËR STUDIUESIT E GJUHËS

**DR. JULIANA ÇYFEKU**

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë

Departamenti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti "Fan S. Noli"

[juliana.cyfeku@gmail.com](mailto:juliana.cyfeku@gmail.com)

**Abstrakt:** Bazuar në faktin se folësit amtarë të gjuhës angleze ndryshojnë shumë nga anglishtfolësit e huaj për sa i përket aspekteve komunikuese, ky studim ofron vëzhgime thelbësore të përpunuara nga studiuesi që e shikon përvetësimin e gjuhës angleze nga një këndvështrim komunikues. Metodologjikisht, ai përpiqet të ndërlihdë sfidat komunikuese duke iu referuar këtu "dukurive të keqkomunikimit" që studentët e universitetit hasin në procesin e mësimin të gjuhës angleze. Studimi zhvillohet me një fokus në përvetësimin e komunikimit në mësimin profesional të gjuhës angleze nëpërmjet përdorimit të korporave.

Korpuset gjuhësore shfaqin dhe pajisin studentët e universitetit me perspektiva të ndryshme komunikuese dhe i udhëzojnë ata drejt një sërë kërkimesh të bazuara në të dhëna për qëllime të caktuara gjuhësore. Në të vërtetë, fluksi i vërtetësisë i gjuhës angleze që rezulton nga shfrytëzimi i korporave nxjerr në pah dallimet ndërgjuhësore, si edhe vështirësitë që studentët hasin për të kuptuar gjuhën autentike në procesin e komunikimit. Korpuset e gjuhës angleze ofrojnë një sërë mjetesh metodologjike që u mundësojnë këtyre të fundit të kryejnë çdo analizë ndërgjuhësore për të fituar njohuri komunikuese në kontekstet e jetës reale. Gjatë gjithë zbatimit të analizave të bazuara në korpus, studentët mund të hetojnë dhe të bëjnë krahasime në mënyrë të pavarur mbi pothuajse çdo model gjuhësor për sa i përket dukurive leksikore, strukturore ose leksiko-gramatikore. Kjo u lejon atyre të bëjnë dallimin midis atyre ndryshimeve gjuhësore në gjuhën amtare që ata vërejnë në gamën e gjuhës së korporave. Rezultatet përfundimtare padyshim do të rezultojnë në krijimin e kompetencës komunikative të synuar, duke ofruar "në mes të vargjeve të korporave", të dhëna për vetë-korrigjimin e çdo parregullsie të mundshme të krijimit individual.



*Fjalë kyçe: komunikim, dukuri, dallim ndër-gjuhësor, korpora, analizë ndër-gjuhësore*

## **A VIEW OF CROSS-LINGUISTIC DIFFERENCES IN ENGLISH LANGUAGE CORPORA; AN INTER-LANGUAGE ANALYSIS TO THE TARGET LEARNER**

Qasja teorike gjenerativiste ka dominuar shkencat gjuhësore në 6 dekadat e fundit. Por tashmë është formësuar një pol tjetër teorik, po aq i fuqishëm dhe i pranishëm në gjuhësi të paktën në 20-30 vitet e fundit. Këto rryma marrin përsipër të ndërtojnë modele si është strukturuar dhe si funksionon gjuha, duke përmbushur të tre nivelet e saktësisë dhe plotësisë, por e bëjnë jo duke vënë strukturën në themel të modelit të tyre gjuhësor, por përdorimin gjuhësor, materialin konkret që përdorin folësit, prej nga ngrihen shkallë të ndryshme abstragimi dhe skema strukturore. Këto rryma me bazë përdorimin, propozojnë se strukturat e gjuhës formësohen mbi bazë të përdorimit të gjuhës dhe gjatë përdorimit të gjuhës. Ndër rrymat kryesore janë Gramatika Konstruktive (GK) dhe Gjuhësia Konjitive (GjK)<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> Gramatika Konstruktive (GK) i ka fillimet te Charles Fillmore (1967, 1977). Kjo teori u bë më e njohur veçanërisht pas viteve 1980. Në 1995, Goldberg përcaktoi një kornizë më të plotë teorike (Goldberg 1995), që referohet nga të gjithë si gur themeli i GK. Autorë të tjerë të rëndësishëm janë Willliam Croft, Richard Hudson, Hans Boas, Ronald Langacker, Martin Hilpert, Thomas Hoffmann, Stefan Gries, Holger Diesel, etj.

Gjuhësia Konjitive është gjithashtu një fushë e gjerë rrymash, ndoshta shkolla më e plotë përballë Gramatikës Gjenerativiste. Ndër autorët e mëdhenj janë Ronald Langacker, George Lakoff, Gilles Fauconnier, Marc Turner, Laura Janda.

Përveç dallimit thelbësor mes tyre, nëse e ndërtojnë modelin e funksionimit të gjuhës me bazë strukturën apo me bazë përdorimin, këto dy shkolla të kundërta kanë një kuadër të tërë dallimesh që rrjedhin nga bazat e tyre konceptuale të ndryshme. Në këtë artikull, do të vijoje trajtimi sipas shkollës teorike me bazë përdorimin. Shkollat teorike në njërin drejtim apo tjetrin, kanë pasur variantet e tyre aplikative - zbatimin e tyre shkencor (shkenca e zbatuar), përfshi edhe në qasjet teorike dhe praktike për mësimin e gjuhës.

### ***1.2 Konceptimi për gjuhën sipas shkollës (ose shkollave) teorike me bazë përdorimin.***

Përgjithësisht, shkollat teorike kanë disa koncepte bazë, të cilat janë në themel të trajtimeve në sferat e caktuara të strukturimit dhe funksionimit të gjuhës. Teoritë me bazë përdorimin nuk janë një shkollë e vetme. Brenda tyre ka zhvillime, modele dhe teza të ndryshme. Por në përgjithësi ato ndajnë mes tyre një sërë tezash themelore.

Në lidhje me formësimin e gjuhës, qasja strukturaliste e nis shpjegimin nga struktura, e cila vetë-zhvillohet mbi bazë të 'informacionit strukturor' që përmban, dhe kështu zhvillohet sipas këtij programimi, pavarësisht kushteve dhe mjedisit ky ndodh kjo rritje dhe ky zhvillim. Prandaj drejtimet që ndjekin shkollën strukturaliste në lidhje me mësimin e gjuhës së huaj përpriqen të ndjekin të njëjtën rrjedhë, pra duke nisur me strukturën pasi gjithë informacioni i nevojshëm që duhet të ketë folësi për të mësuar gjuhën është brenda strukturës

Në qasjet e drejtimit tjetër, me bazë përdorimin, strukturat e gjuhës ngrihen nga përdorimi, formësohen dhe zhvillohen gjatë rrjedhës së përdorimit. Pra baza e nisjes nuk është struktura, por përdorimi, rastet praktike gjuhësore dhe strukturat janë derivat, apo produkt i një procesi të gjatë që ndodh në mendjen e folësve. (Langacker 1987, Goldberg 1995, Hopper & Bybee 2001, Bybee 2006, Croft 2001). Sipas GK dhe GjK, fëmijët që mësojnë gjuhën e mëmës, ndodhen në një mjedis gjuhësor, prej nga ata thithin, akumulojnë përpunojnë zhvillojnë, dhe akumulojnë në vijimësi, raste të plota gjuhësore: sintagma të plota, pjesë fjalish, fjali, kontekste gjuhësore më të gjera, që depozitohen dhe

---

Gramatika Konstruktive dhe Gjuhësia Konjitive shihen si dy shkolla që kanë një masë të madhe mbivendosje, dmth, të përbashkët.

ruhen pjesërisht. Ky është bagazhi që shërben si bazë për të ushqyer në mënyrë graduale dhe të vijuar ngritjen e strukturave gjuhësore. Prandaj dhe strukturat e para gjuhësore ndër fëmijët nuk janë të plota, dhe janë kopje të zbehta të rasteve që fëmijët kanë vërejtur dhe ruajtur në kujtesën e tyre (Tomasello 2003, Bybee 2006, etj.)

### *1.2.1 Projekzioni dhe 'transferimi' i këtij dualiteti në metodologjitë e kundërta në mësimin e gjuhës së huaj*

a) *Qasjet tradicionale* kryesisht e nisin ndërtimin e gjuhës te studentët bazuar në strukturat, duke shpjeguar dhe ndërtuar strukturat, dhe kanë pritshmërinë që studentët të ndërtojnë raste gjuhësore konkrete bazuar në strukturat si abstragim skematik me potencial të madh gjenerues.

b) *Qasjet me bazë përdorimin* hasen në mënyrë empirike në shumë praktika më të hershme, për shkak se mësuesit, me intuitën dhe eksperiencën mësimore kishin kuptuar pamjaftueshmërinë e strukturave dhe kështu krijonin praktika konkrete, ilustrime, trajtime të gjalla, spontane, natyrale. Ato nuk kanë lindur në truall të zbrazët dhe janë në linja të ngjashme me intuitën dhe ekspertizën empirike të mësuesve. Orientimi më i organizuar teorik në dekadat e fundit e bën më të qartë strategjinë mësimore, më efektive. Këto zbatime nuk janë aplikuar në masë të gjerë në mësimin e gjuhëve të huaja por është domethënës fakti që formatimi i provimeve të njohura ndërkombëtare përkohet nga kjo filozofi: TOEFL, IELTS, provimet e Cambridge Esol (FCE, CAE, PCE). Duke filluar nga 2001, kjo është edhe korniza formale e referencave për gjuhët që njih dhe aplikon Këshilli i Europës, dhe shumë shpejt u bë Korniza e Përbashkët edhe për kontinentet e tjera: Amerikë, Azi, Australi e Afrikë<sup>2</sup>. Është zhvilluar një paketë e plotë eksperte që është bërë kuadri i formimit dhe vlerësimit të mësuesve të gjuhëve, provimeve të gjuhës dhe vlerësimit të studentëve<sup>3</sup>

---

<sup>2</sup> Korniza njihet si *Common Framework of References for Languages* – shih Shih <https://www.coe.int/en/web/common-european-framework-reference-languages>; <https://www.coe.int/en/web/common-european-framework-reference-languages/level-descriptors#:~:text=The%20CEFR%20organises%20language%20proficiency,'can%2Ddo'%20descriptors>.

<sup>3</sup> Shih <https://www.coe.int/en/web/common-european-framework-reference-languages/the-cefr-descriptors>. Institucioni profesional që zhvillon dhe monitoron

Disa koncepte të tjera teorike që njihen si pjesë e bërthamës teorike të GK dhe GJK do të trajtohen më poshtë në seksionin 2.

## **2. Zhvillimi aplikativ i qasjeve me bazë përdorimin: teza, modele, praktika**

Ndërtimi i një mjedisi përdorimi. Bazuar në qasjet teorike, funksioni i mësuesit është të organizojë dhe zhvillojë një situatë ligjërimi, ku të lëvrohet masa e gjuhës, e cila organizohet nga mësuesi në mënyrë që të depozitohet në mënyrë të qëndrueshme të studentët. Është kjo masë përdorimi, (kontekste, situata, argumente), që ruhet në kujtesë të studentëve. Strukturat dalin prej kësaj mase konkrete, paragrafësh konkretë.

Që të jetë e tillë, kjo situatë përdorimi kërkon disa parakushte.

- Duhet të jetë konkrete, natyrale, funksionale. Problemi i madh që kanë qasjet tradicionale është organizimi i mësimeve fragmentare që nuk kanë ‘prekje’ apo lidhje personale te studentët, me personazhe të sajuar. Sigurisht, këto artifica, apo edhe fjalitë formale në ushtrimet gramatikore nuk mund të depozitohen në kujtesë.

- Ajo që përcjell mësuesi duhet të jetë ngarkesë konjitive e përballeshme, të mos ketë mbingarkesë.

- Duhet të jetë racionale në ngarkesën strukturore – të përmbajë vetëm ato struktura apo set strukturash që janë objekt i mësimit

- Argumenti dhe rastet, rrëfimi, faktet në fjali apo njësi fjalish duhet të jenë lehtësisht dhe favorshëm lidhur me njëra tjetrën. Një seri rrëfimi e lidhur në vetvete ka mundësi të ruhet në kujtesë ndërsa fjali dhe pjesë fragmentare kërkojnë punë të madhe nga studentët për t’u ruajtur.

Modele në përputhje me sa më sipër mund të jenë me shumicë dhe nuk duhen dhënë vetëm receta të kufizuara. Disa raste tipike që kemi aplikuar në BISU (Beijing International Study University) në fazat e fillimit të mësimit të gjuhës (shqipe) janë më poshtë

Situata personale e studentit (studentët meshkuj aplikojnë variantin mashkullor, dhe studentet variantin femëror – secili të vetën, situatën reale, gjë që nuk ka për ta harruar)

---

kornizën dhe standardet e gjithëpranuara është ALTE – *Association of Language Testers in Europe* – shih <https://www.alte.org/>.



*Unë jam XX. Jam nga ..... Jam 18 vjeç. Familja ime është në ..... Mamaja ime është \_\_\_ vjeç. Ajo është \_\_\_\_\_. Babai im është \_\_\_ vjeç. Ai është \_\_\_\_\_. Kam një motër. Motra ime është \_\_\_ vjeç. Ajo është në shkollë. Vëllai im është \_\_\_ vjeç. Ai është në shkollë.*

*Përshkrimi i shtëpisë – që sjell një seri strukturash: folja kam në rastet pa kryefjalë, emra shoqëruar me numra si dhe shprehje vendore. Shtëpia ime është në G D, në rrugën XX. Shtëpia është larg nga qendra, 1 orë me tren.*

*Është një apartament, në një pallat, në katin e 9-të. Apartamenti ka 2 dhoma gjumi, 1 kuzhinë, 2 banja, një dhomë ndenje dhe një ballkon. Unë kam një dhomë. Dhoma ime ka 2 dritare, 1 derë, 1 krevat, 1 kondicioner, 1 TV, 1 kompjuter, 1 raft librash, 1 dollap rrobash, 1 karrike dhe 1 tryezë.*

Në këtë situatë ka edhe një numër modest shprehjesh vendore. Shpesh ndiqet një strategji e tillë: në fillim jepet një dozë e lehtë me një numër rastesh që kanë në thelb një strukturë të synuar, dhe më pas vjen një rrëfim tjetër që bart një numër të madh me këtë strukturë dhe në forma më komplekse.

Një rast interesant është përshkrimi i rutinës që javën e parë ose të dytë të studentëve fillestare. Foljet janë direkt të kuptueshme dhe të qëndrueshme. Veta, numri janë pothuaj të parëndësishme pasi është monolog për veten, dhe do ishte një kosto e panevojshme të mbingarkohet studenti me informacion strukturor (që nuk hezitojnë ta bëjnë mësuesit tradicionalë). Një shembull jepet më poshtë  
*Rutina ime. Zgjohem nga gjumi në 06.30. Lahem, vishem, dhe dal nga shtëpia në 07.00. Shkoj në mensë dhe ha mëngjes. Në orën 8 pa 10 arrij në shkollë.*

*Mësimi fillon në orën 09.00. Kam 3 orë. Mësimi mbaron në orën 12.15. Shkoj në mensë dhe ha drekë. Shkoj në shkollë. Mësimi fillon përsëri në orën 13.10. Mësimi mbaron në orën 05.30 pasdite. Dal nga shkolla në 05.30 pasdite dhe kthehem në dhomë. Ndërrohem, lahem dhe pushoj.*

*Më pas, bëj detyrat, studjoj. Përfundoj detyrat në 8. Ha darkë në 8 dhe më pas shoh televizor ose dal shëtitje. Fle gjumë në 11.*

Kjo situatë ndërthen strukturën e argumentit që vjen dhe rivjen në formë të thjeshtë, një numër foljesh bazë të thjeshta, si dhe rikthim te numrat, duke i vendosur në një kontekst natyral

Përshkrimi i Tiranës: ku futen në masë shprehjet parafjalore vendore

*Te sheshi është Universiteti i Tiranës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës. Afër Universitetit është Akademia. Afër Akademisë është Presidenca. Përballë Presidencës është Pallati i Kongreseve. Afër Pallatit është Muzeu Arkeologjik. Afër Muzeut është Universiteti.*

Përshkrimi i ditëlindjes, që ka si fokus jo thjesht foljet, por strukturën bazë të argumentit: [kryefjalë–folje–kundrinë]

*XXB ka ditëlindjen. Ajo bëhet 19 vjeç. Shoqet dhe shokët i përgatisin një festë. Në orën ... mblidhen në restorant, afer universitetit. Kanë disa dhurata. Kanë edhe një tortë me çokollatë.*

*Shoqet dhe shokët këndojnë: Shumë urime për ty/shummë urime për ty/shumë urime XXB/ Shumë urime për ty. Pastaj urojnë: Gëzuar Ditëlindjen.*

*XXB pret tortën. Në kokë ka një kurorë të bukur. A luan në piano. C luan në pipa. B luan në kitarë. D kërcen. F as nuk kërcen, as nuk këndon. Ai shikon. Disa djem dhe vajza hanë tortë dhe pinë koka kola. Më pas, ata luajnë: një djalë pikturon një fytyrë dhe vajzat gjejnë kush është. Ose, një vajzë pikturon një fytyrë dhe djemtë gjejnë kush është.*

Struktura e argumentit është bërthama e fjalisë. Jo vetëm që është pjesa që ndodh në mënyrë të thjeshtë ose komplekse në të gjitha fjalitë, dhe kryesisht në një format që mund të dallohet lehtë, struktura e argumentit është edhe baza që sqaron dhe qartëson gjymtyrët e tjera.

Shqipja paraqet edhe një problem të konsiderueshëm, pasi shpesh kryefjala nuk është e shprehur me mjetet tipike (emër, përemër etj.), por megjithatë është e pranishme nëpërmjet mbaresës së foljes (veta), dhe kjo sendërton kryefjalën në strukturën e argumentit. Kjo është gramatika natyrale që duhet prezantuar, dhe mund të bëhet me shumë eficiencë në prezantimet situacionale – në situata shumë të qarta ku studentët të kapin sa më shpejt dhe qartë strukturën bazë [kryefjalë–folje–kundrinë]

Për këtë arsye, rekomandohet që pas fazës së parë ku studentët ndërtojnë bazën minimale me një sasi përdorimi të konsiderueshme dhe një set modest strukturash, është mirë të vijohet më rrëfime që janë të favorshme për kujtesë të gjatë, të qëndrueshme, dhe që kanë një linjë që mban vetveten. Një shembull që ka disa tipare të tilla është seria për historinë e Skënderbeut, që për studentët e vitit të parë u prezantua pas

2-3 muajve të parë. Avantazhi është se ky rrëfim mund të ndërtohet me një fjalor modest që shpjegon vetveten. Gjithashtu, struktura bazë e argumentit mbetet përgjithësisht e qëndrueshme ose që mund të kuptohet menjëherë, pasi personazhet, veprimet, rrethanat e veprimit mund të merren lehtë me mend dhe ndjekin një rrjedhë të njohur. Një rast i tillë siguron një shpjegim të lehtë dhe ka garanci për kujtesë të gjatë që mund të rifreskohet, ristrukturohet dhe zgjerohet lehtësisht.

Një tjetër rast ideal janë poezitë apo këngët. Situata që sjellin është reale, konkrete dhe me ngarkesë të madhe konjitive dhe emocionale – është një argument që, pasi studentët e kanë mësuar, e kanë të lehtë ta mbajnë në kujtesë.

Këngët kanë një avantazh më tepër, pasi kanë një melodi që i ngjiz frazat në një linjë të vijueshme dhe kjo është garanci për kujtesë të qëndrueshme. Këngët janë përdorur për disa struktura specifike. Më poshtë vijnë disa ilustrime

Përdorimi i klitikëve që për shqipen është tipik dhe për studentët e huaj që nuk janë familjarizuar me këtë format, është diçka abstrakte, që pasi e kapin në një mësim, e harrojnë dhe kjo ndodh në një seri përpjekjesh. Edhe kur studentët në mësimin tradicional kanë punuar fort dhe i kanë kuptuar, janë gjendur disi më të dobët tek rastet e tjera të larmishme, ose kanë paqartësi. Ndërsa, situata konkrete, reale që nuk të shqitet nga mendja, e fikson në një lidhje specifike një strukturë të caktuar dhe vetëm atë.

Tek kënga “*Mirëmëngjes*” e A. Skënderajt për shembull, është rreshti:

1. *t’i them mirëmëngjes*

2. *Si t’ia them*

Në këtë kontekst, pasi është shpjeguar njëherë në mënyrë shteruese situata mes djalit dhe vajzës, nuk është e nevojshme t’ia rishpjegosh studentëve, pasi, kënga, linja e rrëfimit, video shoqëruese, zëri i Albanit janë përforcues dhe kontekst i pagabueshëm. Edhe nëse dobësohet njëri sinjal, janë të pranishëm sinjalet apo treguesit e tjerë dhe rrëfimi mbetet i plotë për një kohë të gjatë në kujtesë.

Një avantazh është se struktura e argumentit në të dy segmentet më sipër mbetet e njëjtë

[*djali – thotë – vajzës – mirëmëngjes*]

Pavarësisht se kryefjala (autori) mungon, bëhet automatikisht lidhje kryefjalë-folje dhe identifikohet markuesi vector i foljes si

shprehje e kryefjalës (Unë – djali në monolog). Qasja tradicionale strukturaliste është e orientuar të perceptojë strukturën formale:

*Unë --- veta e parë njëjës*

*Them --- folje, veta I, njëjës*

Ky format është një diskurs strukturor teorik dhe sigurisht nuk zë vend në mendjen e studentëve. Ndërsa për qasjen me bazë përdorimi, mësuesi duhet të japë rastet konkrete pa shpjegime teorike, në numër të bollshëm dhe studentët prej tyre abstragojnë gradualisht strukturat specifike sipas rastit. Për shembull, te seria e rrëfimeve për Skënderbeun, studentët marrin një masë të bollshme situatash:

*Skënderbeu doli*

*Ai rrethoi kështjellën*

*Ai sulmoi*

*Turqit rrethuan kështjellën*

*Turqit sulmuan ...*

Pra krijohet një seri që replikohet mjaftueshëm dhe krijon rregullsinë e nevojshme në mendjen e nxënësve. Strukturat dalin gradualisht prej rregullsisë së depozituar në kujtesë. Nëse në të kundërt, nuk tregohet kujdes dhe kujtesa bjeret, strukturat krijohen me vështirësi, krijohen struktura të mangëta, ose nuk krijohen.

### ***2.1 Zhvillimi i shprehive të të folurit, skema konjitive që dalin nga praktika ligjëruese***

Teza qendrore që strukturat dalin prej përdorimit ofron një perceptim të ndryshëm nga qasjet strukturaliste në mënyrë si lidh performancën dhe kompetencën, të cilat Chomsky i ndan në mënyrë absolute. Duke risjellë performancën si bazë ku ngrihet kompetenca, qasjet me bazë përdorimin risjellin rëndësinë që ka praktika – dhe kjo ka rëndësi të madhe në metodologjinë e të mësuarit dhe strategjitë didaktike. Kapaciteti për të folur krijohet dhe zhvillohet nga të gjitha përvojat dhe ndërveprimet ku është përfshirë folësi. Disa rrjedhoja indirekte nga kjo tezë vijojnë më poshtë.

- Nëse folësi përfshihet në praktika të varfëra – këto eksperiencia krijojnë tek folësi skema të varfëra
- Nëse këto praktika janë fragmentare, të sajuara – do të humbin si ‘sheqeri në ujë’ dhe nuk depozitohen në kujtesë. Kjo është arsyeja që shumë përpjekje mësimore rezultojnë pa efekt dhe harrohen, dhe kështu progresi është tepër i ngadaltë dhe i mangët.

- Kur studentët në klasë ndodhen dhe përfshihen në praktika të mbushura me gabime dhe korrigjime, apo dështime – pikërisht këto janë skemat që zhvillohen në kujtesën dhe mendjen e studentëve

Sipas koncepteve të GK dhe GjK, skemat dalin nga eksperiencia ku këto trajta ndodhin dhe rindodhin rregullisht. Dabrowska (2014) thekson se sipas qasjes me bazë përdorimin, skemat apo konstruktet rrenjosen nëpërmjet përdorimit të përsëritur, në ligjërime apo në dëgjim. Përdorimi i njëjësive dhe lidhjeve të caktuara e përforcon sinjalin dhe kjo rrit gjasat që ky folës ta mbajë mend dhe ta përdorë këtë skemë në të ardhmen. Konteksti tipik për lindjen e skemave abstrakte është kjo linjë rregullsie, për të cilat sistemi konjitiv njerëzor është i përgatitur t'i kapë dhe t'i formësojë në skema apo konstruktet. Prandaj rregullsia është është në qendër të vëmendjes në organizimin e mësimin të gjuhës

*Jam nga Pekini*

*Jam nga Tirana*

*ose*

*Ajo është mësuese*

*Ai është biznesmen*

*Ai është student*

*Ajo është profesore*

Sa më sipër krijojnë rregullsitë ashtu si ndodhin në formën e tyre natyrale, që përfshin:

- i) Një masë të madhe të përbashkët, e cila ndodh dhe rindodh në këtë seri praktikash – kjo krijon rregullsinë skematike
- ii) Variacione tipike që e bëjnë këtë një situatë natyrale. Por, variacionet duhet të jenë në një masë modeste, përndryshe dëmtojnë fokusin dhe pengojnë perceptimin e masës dhe rregullsisë së përbashkët

Pjesë e rregullsisë është edhe konfigurimi me variacione brenda një skeme që përsëritet.

*Babai im është 56 vjeç. Ai është inxhinier*

*Babai im është 62 vjeç. Ai është profesor*

*Mamaja ime është 54 vjeç. Ajo është biznesmene*

*Mamaja ime është 46 vjeç. Ajo punon në zyrë*

*Babai im është 61 vjeç. Ai punon në zyrë*

*Mamaja ime është 52 vjeç. Ajo punon në supermarket*

Praktika më sipër sugjeron që rregullsitë mund të jenë të kombinuara: në strukturë dhe në funksion. Në këtë mënyrë koordinohen bashkë

*Ajo është mësuese*

*Ajo punon në supermarket*

Pasi funksionalisht, ato i përgjigjen të njëjtës pyetje dhe i përkasin të njëjtit kontekst.

Pra siç shihet, teoritë me bazë përdorimi kanë një orientim të fortë funksional dhe koordinojnë ngushtë strukturat dhe funksionin.

## **2.2 Koncepte të tjera që rrjedhin nga sa më sipër**

Përdorimi siguron një kontekst të gjerë që përmban informacion gjuhësor dhe jogjuhësor, dhe ky informacion kontribuon në formatimin e strukturave gjuhësore (Diessel 2019), që është në përputhje edhe me konceptet e përgjithshme konjitiviste që strukturat gjuhësore rrjedhin prej përdorimit ose zbatimit të proceseve në sferën e përgjithshme konjitive (Bybee 2010: 1). Janë me dhjetëra detaje, efekte, raste në kontekstin ky ndodh një strukturë gjuhësore, që shpjegimi formalist strukturalist i injoron, dhe kështu studentët marrin një informacion tepër të varfër. Këto kontekste shoqëruese ruhen në kujtesë dhe janë pjesë e një strukture – prandaj folësit e një gjuhe janë aq të natyrshëm të pasur, spontanë. Kohët e fundit është theksuar shumë edhe fakti që informacioni dhe detajet asociative janë të një natyre multi-modale: efekte audio, vizuale të fytyrës, gjesteve, efekte emotive që shpesh janë më të forta se shprehjet ekspresive. Na ndodh shpesh që për një situatë të kaluar, kujtesa jonë mund të mos ketë regjistrimin e artikulimit ekspresiv (tekstual), por nuk fshihet lehtë se si jemi ndjerë në lidhje me këtë situatë. Këto janë ndjesitë që japin situatat natyrale si një poezi për shembull (në kurrikulën e BISU-t kemi përdorur poezi nga Mimoza Ahmeti, Xhevahir Spahiu, Naim Frashëri, Çajupi, Migjeni, Noli, etj.) dhe këto ndjesi emotive janë baza kryesore për kujtesën dhe prej nga formësohen strukturat e gjuhës në këto poezi).

Në literaturën e gjuhësisë konjitive një tezë qendrore është fakti që *kuptimi leksikor dhe gramatikor është enciklopedik*. Ky është një aspekt ku teoritë strukturaliste kanë qenë të pasukseshme, pasi në vend të kësaj pasurie në përmbajtje, japin një shprehje të thatë formalistike. Praktika ka treguar rëndësinë e një konteksti të pasur, të plotë si parakusht për suksesin e rrënjësor së strukturave.

Në formësimin e strukturave ka një rol të veçantë edhe informacioni sasior. Kjo shpesh bën dallimin e studentëve të huaj që mësojnë një gjuhë dhe folësve vendas, që e kanë gjuhën e mëmës, mësuar në habitatin natyral. Informacioni sasior për një strukturë apo për një tjetër bën dallimin dhe diferencon në përdorim cila strukturë është e përshtatshme në një situatë apo në një zhanër të caktuar. Asnjë lloj mësimi nuk do të arrinte të demonstronte aspektet sasiore të përdorimit të strukturave gjuhësore përveç praktikës natyrale të përdorimit të gjuhës mënyrë masive, natyrale siç është në përdorim normal, jo didaktik që aplikon metodologjia tradicionale.

### *2.2.1 Teza konstruktiviste: Gjuha është organizuar në konstrukte.*

Këto janë njësitë themelore të gjuhës. Gjuha nuk është veçse një tërësi konstruktesh dhe gjithë informacioni fonologjik, leksikor e gramatikor është brenda konstrukteve si njësi bazë (Goldberg 1995, 2006, Langacker 1987, etj.). Kjo tezë shkon në drejtim të kundërt me tezat strukturaliste që e organizojnë gjuhën në module qartësisht të ndara: shtresa fonologjike, shtresa leksikore dhe shtresa gramatikore që organizon fjalët në ligjërim gjuhësor. Kuptohet qartë që ky konceptim i ndryshëm krijon dy metodologji krejt të ndryshme. Prova e vërtetësisë është sa të suksesshme janë në praktikën dhe eksperiencat mësimore.

Në mënyrë më konkrete, kjo nënkupton që gjuha nuk konceptohet si një set rregullat gramatikore që organizojnë fjalët dhe këto kanë më pas një veshje fonologjike. Sipas Gramatikës Konstruktive, nuk është e saktë të konceptojmë fjalë si njësi leksikore, pasi, në vend të kësaj, konstruktet konkrete kanë pjesën leksikore, gramatikore lidhur me këtë njësi konkrete dhe aspektin fonologjik të shkrirë në këtë njësi specifike. Në këtë mënyrë, Gramatika Konstruktive eliminon edhe një dallim tjetër të rëndësishëm strukturalist – nuk ka dallime thelbësore leksik – gramatikë, por ka konstrukte gramatikore dhe konstrukte leksikore që kanë një format të ngjashëm. Të dy llojet e konstrukteve janë ngjizje, çiftëzim i drejtpërdrejtë dhe i pandashëm i formës dhe përmbajtjes (Goldberg 1995, Croft 2001, Diessel 2019).

Në lidhje me sa më sipër, defekti kryesor i praktikave me bazë strukturalizmin është që në klasë prezantohet pjesa formale e strukturës dhe nuk ka vëmendje në lidhje konkrete specifike të strukturës formale me përmbajtjen funksionale. Në vend të paraqitjes modulare (ku semantika, gramatika etj., janë module më vete) në qasjet strukturaliste, Gjuhësia Konjitive propozon një prezantim të natyrshëm siç ndodh me

gjuhën e mëmës, ku nuk ndodh ndarja artificiale e konstruktit. Përkundrazi, mësuesi i sjell konstruktet në klasë të pandashme dhe synon ta konsolidojë këtë pandashmëri. Në rast se mësuesi e fillon prezantimin e njësive të reja gjuhësore në mënyrë të ndarë, është tepër e vështirë t'i ribashkojë dhe kjo është sfida më e madhe që bllokton ndërtimin e strukturave dhe kompetencës gjuhësore tek studentët.

Sipas Goldberg, gjuha është e gjitha konstrakte, nga fillimi deri në fund<sup>4</sup>. Për metodologjinë e mësimit të gjuhës, kjo nënkupton që gjithë informacioni që folësit, domethënë studentët, duhet të zhvillojnë për gjuhën, duhet të formatohet dhe konceptohet mbi bazë të konstrakteve specifike, leksikore apo gramatikore, dhe jo në fashën e leksikut nga njëra anë, që organizohet nëpërmjet fashës së rregullave sintaksore/gramatikore – që është qasja më bazë strukturën.

*2.2.2 Teza: gjuha bën pjesë në kuadrin më të përgjithshëm të njohjes*

Gjuhësia Konjitive e konsideron gjuhën si pjesë e kornizës më të përgjithshme të njohjes ndryshe nga Chomsky që e sheh si një sferë konjitive specifike, me tipare dhe ligje specifike funksionimi e strukturimi. Në vijim, edhe për gjuhën, janë mekanizmat e përgjithshme të njohjes dhe jo mekanizma specifike gjuhësore, që kushtëzojnë dhe përcaktojnë zhvillimin e gjuhës (në ndryshim të plotë me qasjen gjenerativiste). Në përputhje me këtë, organizimi i procesit mësimor përgjatë linjës strukturore është joefikas dhe i papërshtatshëm. Folësit mund t'a bëjnë të tyren materialin gjuhësor që shkëmbehet dhe strukturat e integruara brenda saj, nëse vendosen në një kontekst real, natyral dhe jo të sajuar – siç kanë zakonisht tekstet e gjuhës shqipe, që flasin për personazhe joreale (Mira, Beni, Tani) përfshirë në aktivitete që nuk arrijnë të ngacmojnë vëmendjen natyrale të studentëve. Një instruktor i gjuhës Python (gjuhë programimi) u shpreh se ai nuk prezanton gjuhën Python në përgjithësi. Kjo gjuhë është për të zgjidhur probleme. Fillimisht ju keni nevojë të keni një problem, dhe pastaj të përdorni këtë gjuhë për ta zgjidhur. Shumë materiale në tekstet tradicionale ose ato bazuar mbi strukturën nuk e kanë këtë metodologji dhe efektet ndjehen direkt te studentët. Kjo është e dukshme për shembull te numrat. Ky është një seksion interesant dhe ka metodologji të ndryshme për t'i trajtuar me studentët.

---

<sup>4</sup> Goldberg 2006: 18 - "It's constructions all the way down!"



Nisur nga tezat dhe konceptet kryesore të qasjeve me bazë përdorimin, në eksperiencën në BISU kemi përgatitur kontaktet e nevojshme dhe mjediset reale ku gjenden numrat dhe ku folësit përdorin numrat. Fokusi ka qenë tek ato numra që kanë pasur lidhje me studentët: numrat e tyre të telefonit, që janë 18 vjeç, data e lindjes, etj. Një tjetër aspekt interesant është njohuria e ndërtuar mbi numrat, si veprimet aritmetike bazë, ose kombinime mbi rregullsi të caktuara, si për shembull numrat tek (1, 3, 5, 7, 9, 11, 13) ose seria e numrave çift (2, 4, 6, 8, 10, 12, 14, etj.), numrat që plotpjesëtohen me 3 (3, 6, 9, 12, 15, 18, etj.) plotpjesëtohen me 5 (5, 10, 15, 20, 25), rregullsi të tjera: (23, 33, 43, 53, 63, ose 27, 37, 47, 57, etj.), numërimi prapa (10, 9, 8, 7, 6, 5, 4, 3, 2, 1), veprime aritmetike ( $2+2=4$ ,  $3+3=6$ ,  $4+4=8$ ; etj.;  $11=6+5$  /  $7+4$  /  $8+3$  /  $9+2$ ;  $9+7=..$ ;  $9+5=..$  etj.).

Sa më sipër konkretizojmë edhe një parim të rëndësishëm konjitivist që kuptimi i njësive gjuhësore dhe lidhjeve të tyre ndërtohet mbi një informacion shumë të zgjeruar. Konkretisht, numrat nuk janë thjesht ajo shfaqje e sipërfaqshme [9 -> nëntë] por nënkuptojnë një dije të gjerë, informacion për ato kontekste ku përfshihen. Ky informacion është faktik, specifik dhe deri individual – që ka kuptim për një folës të caktuar. Ky ka qenë një dallim mjaft i madh mes dijes që kanë pasur folësit e gjuhës mëmë dhe dijes që merrnin studentët në klasa tradicionale.

Një dizavantazh tepër i madh është kur mësuesi e lidh skemën numërore me gjuhën e mëmës të studentëve. Në këtë mënyrë, skemat solide të gjuhës mëmë bllokojnë formimin e skemave të gjuhës së re, ose, edhe kur formohen, mbeten gjithmonë dytësore nën lidhjet e forta të numrave në formatin e gjuhës primare.

Po kështu edhe shpjegimet e mësuesit janë një tjetër pengesë që bllokoi formimin e skemave konjitive të studentët. Përkundër këtyre prirjeve tradicionale ose me bazë strukturat, rekomandohet që mësuesi të ofrojë kontekste përdorimi, të shumta në raste dhe në tipologji. Do të jenë studentët ata që gradualisht do të formësojnë konstruktet dhe skemat e abstraguara, mbi bazë të të cilave do të kenë një performancë aktive gjuhësore në lidhje me numrat<sup>5</sup>.

---

<sup>5</sup> Për një trajtim më të plotë në lidhje me numrat si dhe me testimet e konceptuara mbi këtë qasje mund shihni Cane 2020

### 3. Përmbyllje

Ky artikull nuk mund të jetë një trajtim shterues i një informacioni aq të gjerë që trajtohet sot në qasjet e rëndësishme gjuhësore. Faktikisht, jo të gjitha aspektet teorike në rrymat gjuhësore kanë një rëndësi të konsiderueshme në mësimin e gjuhës së huaj. Përveçse duhet filtruar ai informacion që sjell një vlerë të shtuar te mësuesit, është e nevojshme të ketë një ndërveprim aktiv mes dy grupeve (mësuesve dhe gjuhëtarëve), që të përzgjedhin por edhe të shqyrtojnë dhe të diskutojnë çfarë bën të mundur një proces sa më efektiv dhe sa më të informuar nga dijet e sotme shkencore. Në një rast të tillë, nuk do ishte e papritur që të ketë edhe role të zgjeruara të palëve: domethënë, mësues që përfshihen në trajtime teorike gjuhësore thelbësore (jo vetëm në studime të zbatuara), si dhe gjuhëtarë që shikojnë më me vëmendje procesin e mësimin të gjuhës dhe msimdhënies, duke i përdorur si sfera për të kuptuar aspekte teorike ose për të vërtetuar apo zbatuar qasje të caktuara

### BIBLIOGRAFIA

- Bybee, J. L. (2006). From usage to grammar: The mind's response to repetition., *Language*, 82(4), 711-733.
- Bybee, J. (2010). *Language, usage and cognition*. Cambridge University Press.
- Cane, E. (2020). Numeral schemas within cognitive framework: Their usage-based establishment and degrees of entrenchment. *Konińskie Studia Językowe*, 8(4), 409-433.
- Chomsky, N. (1965). *Aspects of the theory of syntax Special technical report no. 11* (No. NASA-CR-79495).
- Croft, W. (2001). *Radical construction grammar: Syntactic theory in typological perspective*. Oxford University Press on Demand.
- Dąbrowska, E. (2014). Recycling utterances: A speaker's guide to sentence processing. *Cognitive Linguistics*, 25(4), 617-653.
- Diessel, H. (2019). *The grammar network*. Cambridge University Press
- Fillmore, C. J. (1967). The case for case.
- Fillmore, C. J. (1977). The case for case reopened. In *Grammatical relations* (pp. 59-81). Brill.
- Fauconnier, G. & Turner, M. (2003). *The Way We Think*. New York: Basic Books.
- Goldberg, A. (1995). *Constructions: A Construction Grammar approach to argument structure*. . Chicago and London: Chicago University Press.

- Goldberg, A. E. (2006). *Constructions at work: The nature of generalization in language*. Oxford University Press
- Hopper, P. J., & Bybee, J. L. (2001). Frequency and the emergence of linguistic structure. *Frequency and the Emergence of Linguistic Structure*, 1-502.
- Lakoff, G. & Johnson, M. (1980). *Metaphors we live by*. Chicago: Chicago University Press.
- Langacker, R. W. (1987 ). *Foundations of cognitive grammar: Theoretical prerequisites*, Stanford University Press.
- Pierrehumbert, J. (2001). Exemplar dynamics: Word frequency, lenition, and contrast. . In ed. by Joan Bybee and Paul Hopper, *Frequency and the emergence of linguistic structure* 137-157.
- Tomasello, M. (2003). *Constructing a Language: A Usage-Based Theory of Language Acquisition*, Harvard: Harvard University Press.

**EDUKIMI PËRMES ARTIT DHE RËNDËSIA E TIJ NË  
ZHVILLIMIN SOCIAL - EMOCIONAL TË NXËNËSVE NË  
ARSIMIN FILLOR**

***RRIOLLZA AGOLLI***

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë  
Departamenti i edukimit  
Universiteti “Fan S. Noli”  
[ragolli@unkorce.edu.al](mailto:ragolli@unkorce.edu.al)

***LAURA AGOLLI***

Ankara Haci Bayram Veli Universitesi, Ankara, Turkey  
[agolli.laura@hbv.edu.tr](mailto:agolli.laura@hbv.edu.tr)

***BRIXHILDA LILKA***

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë  
Departamenti i edukimit  
Universiteti “Fan S. Noli”  
[blilka@unkorce.edu.al](mailto:blilka@unkorce.edu.al)

**Abstrakt:** Gjatë dekadës së kaluar, artet janë vendosur në qendër të ideve të reja që kanë të bëjnë me ristrukturimin e kurrikulës shkollore (Chappell, 2005; Krug & Cohen-Evron, 2000; Gude, 2004, Walker, 2001). Kjo vendosje ka treguar se ato promovojnë pjesëmarrjen aktive të nxënësve (Goldberg, M. 2005), ndihmojnë në mësimdhënien efektive drejt stileve të ndryshme të të mësuarit (Rabkin, N. & Redmond, R. 2004), nxisin krijimtarinë dhe vetëshprehjen (Boyd, W. L. 1980).

Në këtë punim, vihet theksi në sfidën e mësimdhënësve me një orientim të ri kah vlerave të përbashkëta që sjell integrimi ndërlëndor me fokus qendror artet, si një mundësi e përmirësimit në vazhdim të rezultateve të të nxënësve të nxënësve.

Nga shqyrtimi i temave të sjella dhe organizimit të orëve mësimore të vëzhguara në klasa, të cilat në punimin tonë vijnë nëpërmjet projekteve përfundimtare të realizuara nga nxënësit, nëpërmjet analizës cilësore, vihet theksi në atë që mësimi nëpërmjet artit gjeneron disa faktorë themelorë, nga të cilët dallojmë: nxënie aktive, kurrikul e përshtatshme që përcakton interesat dhe entuziazmin e nxënësve, respekt dhe angazhim në punën me kulturën, si dhe mësues të motivuar.

**Fjalë kyçe:** edukim, arsim fillor, art, kornizë kurrikulare, zhvillim social-emocional

## **EDUCATION THROUGH ART AND ITS IMPORTANCE IN THE SOCIAL-EMOTIONAL DEVELOPMENT OF CHILDREN IN PRIMARY EDUCATION**

**Abstract:** *During the past decade, the discipline of arts has been aligned in the center of new ideas related to reengineering the school curriculum (Chappell, 2005; Krug & Cohen-Evron, 2000; Gude, 2004, Walker, 2001). This setting has promoted active student participation (Goldberg, M. 2005), assist in effective teaching towards different learning styles (Rabkin, N. & Redmond, R. 2004), and encourage creativity and self-expression (Boyd, W. L. 1980).*

*This research puts its emphasis on the challenge of teachers with a new orientation towards common values that brings interdisciplinary integration with a focus on the arts, as an opportunity for continuous improvement of students' learning results.*

*As a result of the research, it can be concluded that learning through art generates some fundamental factors such as active learning, appropriate curriculum that determines students' interests and enthusiasm, respect and engagement in working with culture, as well as motivated teachers.*

**Key Words:** *education, primary education, art, curriculum framework, social-emotional development*

### **RISHIKIM I LITERATURËS**

Emocionet dhe aftësitë shoqërore ndikojnë në aftësinë e fëmijëve për të qëndruar në aktivitete të orientuara drejt një qëllimi, për të kërkuar ndihmë kur është e nevojshme dhe për të përfituar nga marrëdhëniet. Zhvillimi social-emocional, midis të tjerash përfshin mënyrën e menaxhimit të emocioneve të një fëmijë, si dhe aftësitë për të krijuar lidhje pozitive me bashkëmoshatarët (NSCDU, 2004).

Bashkëveprimi i fëmijëve ndikon në zhvillimin e sjelljeve shoqërore, kontribuon në zhvillimin e besimit në vetvete e ndaj të tjerëve, në krijimin e shoqërisë dhe miqësisë, në formimin e cilësive pozitive etj. (Gjini, F. 2001). Zbatimi i një kurrikule arti që promovon zhvillim të shëndetshëm shoqëror-emocional mund të nxisë, arritje mjaft të mira në shkollë.

Floweri shpjegon se të mësuarit e bazuar në art i jep nxënësve një ndjenjë kenaqësie, duke kuptuar potencialin e tyre personal (Flower, C. 1996). Kështu ai: ● ndihmon individët të kuptojnë historinë, vendin, besimet e tyre dhe t'i shprehin ato ● rrit

ndërgjegjësimin e shqisave të tilla si shikimi, dëgjimi dhe shija • u mëson individëve një sërë vlerash morale • u mëson që të respektojnë lirinë e mendimit etj. (Mercin, L. Alakus, AO. 2007).

Puna me artin në klasë ka qenë një praktikë e zakonshme gjatë gjithë historisë arsimore (Stankiewicz, M; Amburgy, P. & Bolin, P. 2004) duke vijuar me ritme më të shpejta në ditët e sotme.

Supozimi se arti ndihmon në stimulimin e krijimtarisë padyshim varet nga mënyra se si mësohet arti. Në këtë rast qëndrimi i mësuesit të artit kundrejt tij është shumë i rëndësishëm. Cilësia e arsimit do të jetë e dobët, nëse mësuesit që përcjellin njohuritë e artit nuk janë entuziastë, nuk punojnë me përpikmëri dhe nuk kënaqen me rezultatet.

Gjatë dekadës së kaluar, artet janë vendosur në qendër të ideve të reja që kanë të bëjnë me ristrukturimin e kurrikulës shkollore (Chappell, 2005; Krug & Cohen-Evron, 2000; Gude, 2004, Walker, 2001). Artet kanë treguar se promovojnë pjesëmarrjen aktive (Goldberg, M. 2005), ndihmojnë në mësimdhënien efektive drejt stileve të ndryshme të të mësuarit (Rabkin, N. & Redmond, R. 2004), nxisin krijimtarinë dhe vetëshprehjen (Boyd, W. L. 1980).

Integrimi i arteve përkufizohet si një qasje e përqendruar në art për mësimdhënien dhe të mësuarit (Lufting, R. 2000). Ai është një proces dinamik i bashkimit të artit me disiplina të tjera në një përpjekje për të hapur një hapësirë gjithëpërfshirëse në mësimdhënie, mësim dhe përvojë. Gjithashtu, integrimi i arteve në lëndë dhe fusha të tjera të zhvillimit, synon të mbështesë kurrikulën dhe të nxëniet e nxënësve. Ai nuk i shërben qëllimit të plotësimit të kohës boshe gjatë ditës në shkollë, por përbëhet nga orë të planifikuara me kujdes që përfshijnë komponentët e planifikimit të mësimin (Burnaford, G. 2001).

Për më tepër ky integrim aplikohet në klasat fillore, pasi mësuesit tradicionalisht janë më fleksibël për ta përfshirë në shkallë të ndryshme në klasat e tyre. Integrimi i arteve në shkollat fillore mund të sigurojë një përvojë cilësore të mësimdhënies, të të nxëniet (Muir, M. 2005; Yokley, S. 2002).

Harmani dhe Smagorinsky vunë re se në kohën kur nxëniet e tyre merrnin pjesë në një projekt teatrore që përfshinte improvizimin, shkrimin, tregimin dhe vizatimin, dukeshin të motivuar sepse kishin zgjedhur temat, kishin zgjedhur si të arrinin audiencën e tyre dhe kishin

marrë udhëzime se si të zhvillojnë dhe t'u jepnin jetë teksteve informuese (Harman, R. & Smagorinsky, R. 2014).

Në procesin mësimor-edukativ përdorimi i metodave çon në realizimin e detyrave dhe qëllimeve edukative dhe arsimore. Janë të shumta kriteret që ndihmojnë në përzgjedhjen e metodave mësimore (ASCAP. 2021).

Përdorimi i këtyre metodave është rëndësishëm, sidomos, në rubrikën “Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare” të planifikimit ditor të mësuesit. Në këtë rubrikë përdorimi i këtyre metodave siguron rritjen e vlerësimit dhe të vetëvlerësimit të nxënësve, motivim që siguron progresin e gjithësecilit nxënës, duke i bërë bashkëpunues me njëri-tjetrin (po aty).

## **PËRSHKRIMI I STUDIMIT**

Ky punim synoi t'u përgjigjet pyetjeve kërkimore të mëposhtme.

1. A është edukimi artistik i rëndësishëm në procesin e zhvillimit social-emocional të nxënësve?

2. Cila është rëndësia e integritit ndërlëndor në arsimin fillor me fokus artet?

Për të arritur këtë synim u përdor metoda e vëzhgimit të nxënësve dhe mësuesve në klasë, hulumtime në literaturë, kërkime mbi përfshirjen e artit në fusha të tjera, praktika gjatë orës mësimore, që lidhen me integrimin e arteve dhe zhvillimin social-emocional të nxënësve. Në këtë punim, vihet theksi në sfidën e mësimdhënësve me një orientim të ri kah vlerave të përbashkëta që sjell integrimi ndërlëndor me fokus qëndror artet, si një mundësi e përmirësimit në vazhdim të rezultateve të të nxënësve.

## **BURIMET E REFERIMIT**

Për këtë studim kanë shërbyer këto burime referimi:

1. Literatura bashkëkohore shqiptare dhe e huaj, ku janë trajtuar:
  - Çështje të zhvillimit të individit në fëmijëri;
  - Çështje të rëndësisë së edukimit nëpërmjet artit në shkollë;
  - Çështje të rëndësisë së integritit ndërlëndor në shkollë.
2. Gjetjet në shkollën e arsimit 9-vjeçar, Polenë, nëpërmjet vëzhgimit në klasat e arsimit fillor.

3. Hulimtimi i disa temave në lëndët: Gjuhë Shqipe, Matematikë, Dituri Natyre, Histori, Edukatë për Shoqërinë.

### **METODAT E KËRKIMIT**

Metoda që kemi përdorur për mbledhjen e të dhënave në këtë punim është vëzhgimi, i cili ka hetuar fakte dhe ka sjellë argumente të rëndësishme në kuadër të trajtimit të temës së këtij studimi, duke ndërtuar një “mozaik” mbi rëndësinë e artit në zhvillimin social-emocional të nxënësve në arsimin fillor. Vrojtimi apo vëzhgimi u siguroi me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të hulumtueses në mënyrë aktive. Vëzhgimi është me pjesëmarrje të plotë, pasi hulumtuesja, në të njëjtën kohë, vrojton, si dhe merr pjesë në orë të zhvilluara në klasë. Në procesin e vëzhgimit janë përdorur dhe situatat e kombinuara, pra dhe rastet kur procesi formalizohet krahasimisht me lloje të mëherëshme, duke parë se si ngjarjet, sjelljet, marrëdhëniet etj. evoluojnë me kalimin e kohës, kapin dinamikën e konteksteve, burimeve, roleve dhe në këtë mënyrë bëhet e mundur sjellja e një pamjeje më dinamike dhe lehtësimi i gjenerimit të gjetjeve. Vëzhgimi realizohet përmes shënimeve të shpejta, ditareve dhe përvojave në terren, përshkrimit të ngjarjeve, sjelljeve, aktiviteteve, shenja grafike të konteksteve të ndryshme, shënime të paracaktuara, grafikë të strukturuar të vëzhgimit, të dhëna nga diskutimet me mësuesit etj. Gjatë shqyrtimit të të dhënave është përdorur analiza e përmbajtjes, nëpërmjet metodës cilësore.

### **GJETJE DHE VLERËSIME**

Në arsimin fillor zhvillohen 13 lëndë mësimore, të përmbledhura në 7 fusha të nxëni. Secila fushë ka kompetencat e saj. Përmbushja e rezultateve të tyre realizohet nëpërmjet përmbajtjes, e cila në disa lëndë jepet brenda kompetencave të fushës dhe në disa lëndë jepet sipas tematikave. Programet mësimore të arsimit fillor kanë të njëjtën strukturë dhe rubrika për çdo lëndë. Në mënyrë të përmbledhur, në vijim jepen kompetencat, tematikat dhe numri i orëve për secilën klasë sipas lëndëve përkatëse. Numri i orëve për çdo lëndë mund të lëvizë nga njëri mësues tjetri, sepse ka fleksibilitet që 10% e orëve nga njëra tematikë të kalojë në tematikën tjetër (MASR, 2021). Kompetenca përcaktohet si një integrim i njohurive, shkathtësive, qëndrimeve që një nxënës duhet t’i fitojë gjatë provës të nxënies. Kur



nxënësi realizon kompetencat lëndore atëherë ai ka realizuar dhe kompetencat kyç. Ndërtimi dhe zhvillimi i kompetencave kyç nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyç me kompetencat e lëndës, duke realizuar në këtë mënyrë integrimin ndër-lëndor, si dhe duke bërë që nxënësi të arrijë në rezultate mjaft të kënaqshme të nxëni, të përcaktuara në planin vjetor të mësuesit.

Tabelat më poshtë listojnë tematikat e fushës “Artet”.

Tabela 1: Tematikat në lëndën: Arti pamor

Kompetencat	Tematikat	I	II	III	IV	V
›Krijimi artistik	• Gjuha dhe komunikimi artistik	10	10	10	10	10
›Performimi artistik	• Teknika dhe procese artistike	20	20	19	19	19
›Vlerësimi artistik	• Historia, arti dhe shoqëria	5	5	6	6	6

Tabela 2: Tematikat në lëndën: Muzikë

Kompetencat	Tematikat	I	II	III	IV	V
›Krijimi muzikor	• Gjuha dhe komunikimi muzikor	6	8	8	8	8
›Performimi/ interpretimi muzikor	• Teknika dhe procese muzikore	24	22	22	22	22
›Vlerësimi i veprave muzikore	• Historia, muzika dhe shoqëria	5	5	5	5	5

Tabela 3: Tematikat në lëndën: Kërcim

Kompetencat	Tematikat	I	II	III	IV	V
›Krijimi nëpërmjet lëvizjeve	• Gjuha dhe komunikimi i kërcimit	-	5	7	-	-
	• Teknika dhe procese të kërcimit	-	10	23	-	-
	• Historia, kërcimi dhe shoqëria	-	3	5	-	-
›Performimi/interpretimi i lëvizjeve dhe i kërcimit						
›Vlerësimi i lëvizjeve dhe i kërcimeve						

Tabela 4: Tematikat në lëndën: Teatër

Kompetencat	Tematikat	I	II	III	IV	V
›Krijimi i veprave teatrore	• Gjuha dhe komunikimi teatror	-	-	-	-	6
	• Teknikat dhe proceset teatrore	-	-	-	-	8
›Interpretimi i veprave teatrore	• Historia, teatri dhe shoqëria	-	-	-	-	4
›Vlerësimi i veprave teatrore						

Ne vëzhguam nga afër vlerësimin e artit në shkollë, ndërthurjen me lëndët e tjera dhe vlerësimin e punës së nxënësve. Në mjedisin e klasës ku është kryer vëzhgimi ishin ekspozuar punime arti, të vetë fëmijëve, të krijuara gjatë orëve mësimore në lëndë të ndryshme. (Figura 1)



**Figura 1.** Këndi i punëve të nxënësve

Më poshtë po sjellim disa forma të organizimit të punës në klasë, me fokus integrimin e arteve me lëndë të tjera.

**Lënda: Gjuha Shqipe 3 (Botime “Pegi”, 2020)**

Qëllimi i mësimit të gjuhës shqipe në klasën e tretë është përvetësimi dhe zhvillimi i shkathtësive për të komunikuar në situata të ndryshme, krijimi i pavarësisë individuale dhe formimi kulturor, përvetësimi i standardit gjuhësor, përgatitja e nxënësit për të njohur jetën, zhvillimi i ndjenjës për të dëgjuar, komentuar dhe argumentuar për tema të ndryshme me karakter edukativ dhe arsimor, nxitja dhe motivimi i

nxënësve për të nxënë nëpërmjet hulumtimit (Shuteriqi, L; Buçpapaj, 2019).

**Tema:** Si të bëjmë muzikë

**Forma e artit:** Muzikë

**Figura 2.** Tema mësimore në lëndën “Gjuha shqipe 3”

Gjatë orës mësimore, në lëndën “Gjuha Shqipe 3”, me temë “Si të bëjmë muzikë”, fëmijët e klasave të treta modeluan vegla muzikore dhe më pas me to krijuan nota muzikore.



**Figura 3.** Vegla muzikore të ndërtuara nga nxënësit

Veglat muzikore janë ndërtuar me materiale tingëlluese, si përshembull: enë kuzhine, enë plastike, lapsa, materiale druri etj. Kjo orë mësimore ndihmon nxënësit të kuptojnë më shumë mbi artin (kryesisht muzikën), të dëgjojnë tingujt që dalin nga veglat, të krijojnë vetë një melodi etj, duke zotëruar në këtë mënyrë aftësi themelore që janë mjaft të rëndësishme për të zhvilluar më pas ndjenjën e vetëbesimit. Nxënësit fillojnë të përmirësojnë aftësitë e tyre, të bëhen të aftë dhe të kryejnë detyra dhe veprime të caktuara.

**Tema:** Dhelpra dhe lejteku

**Forma e artit:** Teatri

Në kapitullin “Pjesë teatrore” nxënësit arrijnë të mësojnë se çfarë është teatri, cilët janë pjesët përbërëse të saj (aktorët, autori, kompozitori, skenografi, kostumieri), mësojnë të luajnë një pjesë teatrore, të bashkëpunojnë, të inerpertojnë në një skenë etj. Kjo tregon se integrimi i artit me lëndët e tjera shkollore ka një rëndësi të madhe dhe i jep një larmishmëri idesh dhe pasurim të imagjinatës së fëmijëve. Gjithashtu,

rrit dhe përforcon vetëvlerësimin e nxënësve dhe fëmijët kanë prijen që të punojnë më mirë, nëse kanë besim në aftësitë e tyre.



Figura 4. Tema mësimore në lëndën “Gjuha Shqipe 3”

Në temën “Dhelpra dhe Lejleku” nxënësit e klasave të treta krijuan kostumet e tyre për secilin aktor që interpreton rolin e caktuar.



**Figura 5.** Kostumet e përgatitura nga nxënësit në funksion të temës “Dhelpra dhe Lejleku”

Pas dizajnit të kostumeve e rëndësishme ishte mësimi i skenarit dhe sinkronizimi ose bashkëpunimi me njeri-tjetrin. Mjedisi ku do të zhvillohej vënia në skenë e pjesës ishte klasa, e cila u modelua me skenografinë e përshtatshme sipas ngjarjes që do të luhej nga nxënësit. Nxënësi arrin të bëjë lidhjen e ngjarjeve nga jeta me ato të rrëfyera në një tekst; shpreh emocionet dhe mendime lidhur me ngjarjen; përdor tonin dhe mimikën e duhur; kupton rëndësinë e tolerancës dhe dialogut;

#### **Matematika 5 (Botimet “Ideart”, 2020)**

Matematika është shkenca, gjuha universale e së cilës, ndihmon nxënësin të kuptojë dhe veprojë në realitetin që jeton. Kjo e bën atë të japë një kontribut të rëndësishëm për zhvillimin intelektual të nxënësit dhe formimin e identitetit të tij. Zotërimi i saj është vlerë e madhe për integrimin në shoqëri duke mundësuar zhvillimin e personalitetit të nxënësit, zhvillimin e aftësive të tij për të menduar në mënyrë kritike dhe për të punuar i pavarur e sistematikisht (MASR, 2021).



**Figura 6.** Punime të nxënësve në lëndën “Matematika 5”  
**Tema:** “Drejtëza e simetrisë. Figura simetrike”  
**Forma e artit:** Art pamor



**Figura 7.** Tema “Drejtëza e simetrisë. Figura simetrike”

Gjatë orës së matematikës, në temën mësimore mbi drejtëzën e simetrisë, nxënësit e klasave të pesta kuptuan çfarë është drejtëza e simetrisë, dalluan figurat që kanë drejtëzë simetrie dhe e vizatuan atë në mënyrë të tillë që të dyja anët e saj të puthiten. Në figurën e paraqitur më poshtë nxënësit nëpërmjet vizatimit, prerjes, ngjitjes ndërtojnë figura simetrike dhe i paraqesin ato në një poster.

Kjo ndihmon ata që nëpërmjet artit të kuptojnë termat matematikore, si dhe i ndihmon në përvetësimin e informacionit, ku zakonisht nxënësit hasin vështirësi. Nëpërmjet integritimit ndërlëndor nxënësit zhvilluan kuriozitetin matematikor, duke përdorur arsyetimin induktiv dhe deduktiv, krijuan besim në lëndën e matematikës për të analizuar situata në shkollë dhe në jetën reale, si dhe zhvilluan mendimin abstrakt, logjik dhe kritik duke reflektuar mbi punën e tyre dhe të bashkëmoshatarëve të tjerë në klasë.





**Figura 8:** Figura simetrike të realizuara në temën “Drejtëza e simetrisë. Figura simetrike”

**Lënda:** “Dituri Natyre 4” (Botimet “Pegi”, 2018)

Fëmijët që në moshën e hershme të tyre i nxit kërkshëria që të mësojnë për botën që i rrethon. Është e natyrshme që kjo kërkshëri së pari të lidhet me mjedisin, me një shtrirje të gjerë si në drejtim të natyrës, ashtu dhe të shoqërisë, të dyja mjaft të rëndësishme për edukimin e fëmijës. “Dituria e natyrës” plotëson kuadrin e njohurive në elementët e sipërpërmendur, në kornizën kurrikulare në arsimin fillor, duke e pajisur nxënësin me kompetencat e duhura për jetën, me shprehje dhe dije afatgjata.

**Tema:** Si ndikojmë në mjedis

**Forma e artit:** Arti pamor



**Figura 9.** Tema mësimore në lëndën “Dituri natyre”



**Figura 10.** Punim i realizuar nga nxënësit e klasës së katërt në orën e lëndës “Dituri natyre”, në kuadrin e detyrës për temën mësimore “Si ndikojmë në mjedis”

Rezultatet e të nxënit për temën “Si ndikojmë në mjedis” u konkretizuan nga nxënësit në punimin e paraqitur në fig.10, (është sjellë për ekonomi përshkrimi vetëm një punim) në të cilën përmes njohurive të marra gjatë integritimit ndër-lëndor, nëpërmjet artit pamor treguan si si duhet të mbrojmë mjedisin. Kjo u realizua nëpërmjet

pikturave, posterave që nxënësit i punuan gjithësecili. Në këtë mënyrë fëmijët mësojnë që të vegjël rëndësinë e natyrës dhe mbrojtjes së saj nga ndotja, duke qenë sensibilizues për të gjithë ata që ndjekin punën e tyre në klasë, por dhe jashtë saj (familjarë dhe të afërm të tjerë në komunitet). Puna në grupe në lëndën e “Diturisë së Natyrës” i lejon fëmijët të mësojnë konceptin shoqëror, të ndajnë materialet dhe të ndihmojnë njëri-tjetrin, të japin opinionet e tyre pozitive ose negative etj. Pra, njohuritë janë mjet për të arritur përvojë. Në këtë mjedis krijohet forca e motivimit që natyrisht çon në rezultatet e dëshiruara të të nxënës. Mësuesi përdor interesat natyrore të fëmijëve për të ndihmuar nxënësit të marrin shprehite që do të ndihmojnë në plotësimin e nevojave dhe të dëshirave të tyre. Kjo, gjithashtu, i ndihmon për të krijuar kujtesën njohëse të informacionit të nevojshëm në shoqëri.

**Lënda: “Histori 5” (Botimet “Ideart”, 2019)**

Historia, si një shkencë humane, është thelbësore në zhvillimin e qytetarëve, të cilët i kuptojnë çështjet aktuale me zgjuarsi, nëpërmjet kuptimit, analizës dhe përfundimeve të nxjerra nga përvojat e së shkuarës. Detyra e programit të historisë është të drejtojë nxënësit për t’u bërë pjesëtarë të përgjegjshëm të shoqërisë, të cilët dinë se si të trajtojnë në mënyrë kritike një fenomen të epokës së tyre dhe të së shkuarës. Këto cilësi mbështesin nxënësit në zhvillimin e qëllimeve, kompetencave kyçe dhe rezultateve të dëshiruara të arsimit fillor në mënyrë që ata të jenë individë të përgatitur, të aftë për të kontribuar ndaj kombit dhe të aftë për t’u përgjigjur zhvillimeve globale (MASR, 2021).

**Tema 1.** Kultura dhe besimi në parahistori

**Tema 2.** Kultura dhe jetesa e ilirëve

**Forma e artit:** Arti pamor

## 2.10 Kultura dhe besimi në parahistori

**Udhëzime**

- lexoni
- shprehni mendimet tuaja
- diskutoni
- shkruani

**Udhëzime**

Në parahistori besimi dhe u shfaqën elementet e para të kulturës shqiptare. Që janë ngjashme me ato të kulturës moderne. Lëmia e kulturës shqiptare ka qenë pothuajse e njëjtë me kulturën moderne dhe po shprehë një zhvillim të përparimtë.

**Udhëzime**

Më kaloni a keni menduar për besimin në të gjatë? Nëpërmjet nga kaloni nga fillimi të menduarit. Duke shprehur besimin në gjatë gjatë me besim e me për të gjatë, gjatë kaloni mendimi të besimit e të përparimtë nëpërmjet të cilës që kaloni të besimit me besim e përparimtë. Nëpërmjet nga menduarit vesh dhe besimit me besim e përparimtë. Nëpërmjet nga menduarit vesh dhe besimit me besim e përparimtë.

**Udhëzime**

Nëpërmjet nga menduarit vesh dhe besimit me besim e përparimtë. Nëpërmjet nga menduarit vesh dhe besimit me besim e përparimtë.




**Udhëzime**

Nëpërmjet nga menduarit vesh dhe besimit me besim e përparimtë. Nëpërmjet nga menduarit vesh dhe besimit me besim e përparimtë.

## 3.7 Kultura dhe jetesa e Ilirëve

**Udhëzime**

- lexoni
- shprehni mendimet tuaja
- diskutoni
- shkruani

**Udhëzime**

Nëpërmjet nga menduarit vesh dhe besimit me besim e përparimtë. Nëpërmjet nga menduarit vesh dhe besimit me besim e përparimtë.

**Udhëzime**

Nëpërmjet nga menduarit vesh dhe besimit me besim e përparimtë. Nëpërmjet nga menduarit vesh dhe besimit me besim e përparimtë.

**Udhëzime**

Nëpërmjet nga menduarit vesh dhe besimit me besim e përparimtë. Nëpërmjet nga menduarit vesh dhe besimit me besim e përparimtë.




**Figura 11.** Tema mësimore në lëndën “Historia 5”

Gjatë orëve mësimore në të cilat u trajtuan temat e lartpërmendura, në lëndën “Historia 5”, mbi kulturën Ilire dhe të vendeve të tjera në botë, nxënësit paraqitën nëpërmjet pikturave veshjet popullore shqiptare dhe të vendeve të tjera anembanë globit. Nëpërmjet kësaj ore mësimore nxënësit kuptojnë më tepër mbi kulturën në

parahistori, i nxit të eksplorojnë dhe të ndërtojnë vegla parahistorike me mjete rrethore, ose dhe të vizitojnë një muze. Nxënësit gjithashtu, nëpërmjt kësaj teme kultivojnë identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore; përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare; zhvillojnë aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike; zhvillojnë përgjegjësi: ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit; aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore; aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës.





**Figura 12.** Punime nga nxënësit e klasave të pesta

**Lënda:** “Edukim Për Shoqërinë 2” (Shtëpia Botuese “Mediaprint”, 2016)

**Tema 1.** Lëvizim në rrugë të ndryshme

**Tema 2.** Të drejtat e mia dhe të të tjerëve

**Forma e artit:** Art pamor

## Edukimi për shoqërinë synon:

- T'u japë nxënësve mundësinë për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë intelektuale, të domosdoshme për të kuptuar, për të analizuar dhe për të ndikuar në politikat sociale dhe mënyrat e zbatimit të tyre.
- T'u japë nxënësve mundësinë për të zhvilluar aftësitë e pjesëmarrjes qytetare të nxënësve dhe përfshirjen e tyre të vetëdijshme dhe të kualifikuar në zgjidhjen e problemeve të komunitetit.
- T'u japë nxënësve mundësinë të zhvillojnë përkushtimin qytetar në respektimin e vlerave dhe parimeve demokratike të domosdoshme për bashkëjetesë në një shoqëri demokratike (Kolndreu, D. & Ramaj, E. 2016)



**Figura 13.** Tema mësimore në lëndën “Edukatë për Shoqërinë 2”

Në temat mësimore “Lëviz në rrugë të ndryshme” dhe “Të drejtat e mia dhe të të tjerëve” nxënësit realizojne punime dhe postera

(Figura 14) ku tregojnë informacionet e përvetësuara mbi sigurinë në rrugë. Gjithashtu, gradualisht fëmijët fillojnë dhe grumbullojnë informacion për detyrimet e miqësisë (si përshembull, të qenit i drejtë dhe i barabartë), respektin për autoritetet, rregullat e klasës dhe konceptin e drejtësisë dhe ligjeve. Nëpërmjet integritit ndërlëndor nxënësi mendon në mënyrë kritike kur shqyrton pasojat e veprimtarisë njerëzore në një mjedis të caktuar, kur vlerëson zgjidhjet e problemeve globale, kur krijon dhe mbron qëndrimin e tij. Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme shoqërore e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësi mëson të bashkëpunojë, duke u përballur me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe. Përdor gjuhën e të ligjit, të moralit, të ekonomisë për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij dhe për të organizuar përgjigjet.



**Figura 14.** Punime të realizuara nga nxënësit e klasës së dytë





## **VËSHIRËSITË DHE KUFIZIMET E STUDIMIT**

Në këtë punim jemi përpjekur të hulumtojmë rëndësinë që ka arti në zhvillimin emocional dhe social të nxënësve. Gjithashtu, pjesë e hulumtimit është dhe integrimi ndërlëndor i artit dhe lëndëve të tjera, me qëllim rritjen e produktivitetit të orës së mësimi. Ky studim nuk merr përsipër të studiojë të gjithë faktorët që ndihmojnë në rritje e produktivitetit të orës së mësimi.

Një nga vështirësitë e hasura, është pamundësia për të marrë në studim mendimin e mësuesve dhe nxënësve nëpërmjet pyetësorëve, në mënyrë që të përdornim dhe metodën sasiore të hulumtimit për një argumentim më të thelluar të temës, për shkak të kohështrirjes që do mbledhja e informacionit përgjatë vitit arsimor.

## **PËRFUNDIME**

Gjatë këtij punimi u konstatua se arti, për vetë natyrën e tij gjithëpërfshirëse, i jep mundësi mësuesit të jetë fleksibël në përcjelljen e njohurive në klasë, duke e parë nxënësin si një individ me nevoja specifike. Ajo që u munduam të theksojmë hap pas hapi është që edukimi cilësor mbështetet në tri parime themelore: edukim i cili është i përshtatshëm për nxënësit, por gjithashtu promovon vlera universale, edukim i cili është i barabartë në terma të aksesimit dhe të rezultateve dhe garanton përfshirje sociale në vend të përjashtimit dhe edukim i cili reflekton dhe ndihmon në plotësimin e të drejtave të individëve.

Nga shqyrtimi i temave të sjella dhe organizimit të orëve mësimore të vëzhguara, të cilat në punimin tonë vijnë nëpërmjet projekteve përfundimtare të realizuara nga nxënësit vihet theksi në atë që mësimi nëpërmjet artit gjeneron disa faktorë themelore, nga të cilët dallojmë: nxënie aktive; një kurrikul të përshtatshme, që përcakton interesat dhe entuziazmin e nxënësve; respekt dhe angazhim për komunitetet lokale dhe kulturën; dhe mësues të trajnuar dhe të motivuar.

Konstatuam, gjithashtu, nëpërmjet vlerësimit të produktit përfundimtar, por edhe nëpërmjet shqyrtimit të “Kornizës kurrikulare për arsimin fillor”, se arti ndikon në zhvillimin e nxënësit, në proceset vendimmarrëse, në gjithëpërfshirjen e tyre, në pajisjen me kompetencat më të kërkuara të shekullit të XXI dhe në rritjen e cilësisë në edukim.

Prezantimi i nxënësve me artin dhe integrimi i tij në lëndë të tjera të kornizës kurrikulare, tregoi se kultivon në çdo individ një ndjenjë kreativiteti dhe iniciative, një imagjinatë të pasur, inteligjencë emocionale dhe një moral të lartë, një kapacitet për reflektime kritike, një ndjenjë pavarësie dhe liri mendimi dhe veprimi. Lidhja e artit me lëndët e tjera në kurrikul bëri që nxënësit të hapin një dritare me botën për të zbuluar karakteristikat e veçanta të saj dhe të kuptojnë më mirë kulturën e tyre.

Ajo që duam të theksojmë është se edukimi nëpërmjet artit, inkurajon zhvillimin emocional dhe sjell një balancë më të mirë ndërmjet tij dhe zhvillimit konjitiv, duke kontribuar në mbështetjen e një kulture të duhur.

Në orën e mësimit nxënësit u përfshinë “duke bërë”, mënyrë që sipas qasjes socio-konstruktiviste përbën thelbin e të mësuarit me kompetenca. Krijimtaria në art kontribuoi në formimin e një identiteti personal e të vetëbesimit dhe i ndihmoi nxënësit në krijimin e vetëdijes kulturore dhe ndjeshmërisë artistike.

## **REKOMANDIME**

Punimi ynë theksoi rëndësinë e artit në zhvillimin social-emocional të nxënësve në arsimin fillor. Rekomandimet e këtij punimi u drejtohen studiuesve të tjerë, hartuesve të politikave arsimore, universiteteve.

- Në përfundim të tij mendojmë se është e rëndësishme të studiohet ndikimi pozitiv i artit në zhvillimin social-emocional të nxënësit në një kampion studimi, duke përfshirë nxënës dhe mësues nga disa shkolla të arsimit fillor.
- Nisur nga përfundimet e punimit rekomandohet se është mirë që të hartohen module trajnimi për mësuesit në detyrë, të tilla që të përmbajnë njohuri që promovojnë artet dhe integrimin e tyre me lëndë të tjera në kurrikulën e arsimit fillor (Pantic, N. & Wubbels, T. 2010).
- Mësuesit mund të kenë qëllime të mira kur përpiqen të përfshijnë artet në klasë, por mund të dalin probleme kur trajtohen me më pak seriozitet se lëndët e tjera. Prandaj, rekomandohet që integrimi i arteve nuk duhet të trajtohet si “të bësh”, por një mënyrë për të menduar, me fokus procesin dhe jo produktin përfundimtar.

- Për të arritur integrimin ndërlëndor duhet që mësuesit të krijojnë situata ideale për një të mësuar fleksibël. Arti në vetvete siguron rritjen e kujtesës.
- Ministria e Arsimit duhet kërkojë nga institucionet përkatëse lokale që mbështesin arsimin, të pajisin shkollat me mjete dhe materiale arti, duke krijuar brenda secilës, si fillim një klasë që të shërbejë për orët e artit të përcaktuara në kurrikul, dhe të rregulluara sipas grafikut të orarit mësimor që zbatohet në shkollë, duke synuar rritjen e zhvillimit social-emocional të nxënësit.
- Shkolla e shek. XXI, në mënyrë që të formojë kapacitete krijuese, si forca e vetme e shoqërisë, duhet të inkurajojë kreativitetin të nxënësit dhe këtë më së miri e kryen puna me artin.

## **BIBLIOGRAFIA**

Boyd, W. L. (1980). *The Arts And Education In The United States. Art Education*. 33(7). 24-27.

Burnaford, G., Aprill, A., & Weiss, C. (2001). *Renaissance In The Classroom: Arts Integration And Meaningful Learning*. Mahwah, NJ: Lawrence Erlbaum Associates, Publishers.

Chappell, J. (2005). *The Efficacy Of An Arts Integrated Approach To Teaching And Learning*. In M. Stokrocki (Ed.), *Interdisciplinary Art Education: Building Bridges To Connect Disciplines And Culture*. (Pp. 31-43). Reston, VA: National Art Education Association.

Fowler, *Strong Art, Strong Schools*, Oxford University Press, 1996.

Goldberg, M. (2005). *Arts And Learning: An Integrated Approach To Teaching And Learning In Multicultural And Multilingual Settings (3rd Ed.)*. New York, NY: Longman/Addison Wesley.

Gude, O. (2004). Postmodern Principles: *In Search Of A 21st Century Art Education. Art Education*, 56(1), 6-14.

Gjini, F. and A. Piluri. 2001. The Social World of the Child. Elbasan: Sejko

Harman, R. & Smagorinsky, P. (2014). *A Critical Performative Process: Supporting The Second-Language Literacies And Voices Of Emergent Bilingual Learners. Youth Theatre Journal*, 28 (2), 147–164.

Krug, D. H. & Cohen Evron, N. (2000). *Curriculum Integration Positions And Practices In Art Education, Studies In Art Education*, 41(3), 258-275.

Luftig, R. (2000). *An Investigation Of An Arts Infusion Program On Creative Thinking, Academic Achievement, Affective Functioning, And Arts*

- Appreciation At Three Grade Level*. Studies In Art Education, 41(3), 208-227.
- Mercin, L., & Alakuş, A. O. (2007). *Necessity Of Art Ed Ucation For Individu Al And Society*. Dicle University Ziya Gökalp Faculty Of Education Journal, 9, 14-20.
- Muir, M. (2005). *What Engages Underachieving Middle School Students In Learning?* In D. Kauchak, P. Eggen, & M. Burbank (Eds.), *Charting A Professional Course: Issues And Controversies In Education* (Pp. 159-165). Upper Saddle River, NJ: Pearson Education, Inc.
- National Scientific Council On The Developing Child. 2004. Children's Emotional Development Is Built. in to The Architecture Of Their Brain. [Http://Www.Developingchild.Net / Pubs / Wp / Childrens emotional development architecture Brains. Pdf](http://Www.Developingchild.Net / Pubs / Wp / Childrens_emotional_development_architecture_Brains.Pdf) (Accessed November 10, 2008).
- Rabkin, N. & Redmond, R. (Eds.). (2004). *Putting The Arts In The Picture: Reframing Education In The 21st Century*. Chicago, IL; Columbia College Chicago.
- Stankiewicz, M., Amburgy, P. & Bolin, P. (2004). *Questioning The Past: Contexts, Functions, And Stakeholders In The 19th-Century Art Education*. In E. Eisner, & M. Day (Eds.), *Handbook Of Research And Policy In Art Education* (Pp. 33-55). Mahwah, NJ: Lawrence Erlbaum Associates.
- Walker, S. (2001). *Teaching Meaning In Artmaking*. Worcester, MA: Davis Publications, Inc.
- Weinberger, N. M. (1998). *The Music Of Our Minds. Educational Leadership*.
- Yokley, S. (2002). *If An Artwork Could Speak, What Would It Say? Focusing on Issues for Elementary Art Education*. In Y. Gaudelius & P. Speirs (Eds.), *Contemporary Issues In Art Education* (Pp. 198-211). Upper Saddle River, NJ: Pearson Education, Inc.

## **MIGRIMI RURAL- URBAN: INTEGRIMI SOCIO- KUTUROR I BANORËVE TË ARDHUR NGA FSHATI NË QYTET**

**DR. DENISA TITILI**

Departamenti i Shkencave Sociale

Universiteti "Fan S. Noli"

[xhafkadenisa@yahoo.com](mailto:xhafkadenisa@yahoo.com)

**Abstrakt:** Ky punim synon të identifikojë dhe vlerësojë përmasat e integrimit sociokulturor të banorëve të zhvendosur nga zonat rurale në qytetin e Korçës dhe modelet e bashkëjetesës kulturore midis subkulturës urbane dhe subkulturës rurale. Të dhënat për këtë punim u siguruan përmes metodës sasiore të anketimit. 400 anketa u realizuan me banorë të zhvendosur nga zonat rurale në qytetin e Korçës. Për interpretimin e të dhënave u përdor analiza statistikore deskriptive dhe korrelative.

Studimi nxori në pah se modelet e integrimit nuk janë uniforme. Ndër faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në shkallën e integrimit social dhe kulturor të banorëve janë kohëzgjatja e qëndrimit në mjedisin e ri, ndërveprimi social me shoqërinë pritëse, rrjetet sociale, mjedisi social, modelet dhe dinamikat e migrimit, etj. Studimi gjithashtu tregoi se dinamikat dhe kompleksiteti i procesit të integrimit të migrantëve në shoqërinë pritëse varet, jo vetëm nga koha e qëndrimit dhe karakteristikat e lokalitetit nga ata vijnë dhe ku vendosen, por edhe prej burimeve dhe kapitalit social dhe kulturor të migrantëve.

**Fjalët kyçe:** migrim, intergrim ekonomik, social, kulturor, ndërveprim, mjedis social

## **RURAL -TO -URBAN MIGRATION: SOCIAL AND CULTURAL INTEGRATION OF MIGRANTS TO URBAN SOCIETY**

**Abstract:** This paper aims to identify and evaluate the level of social and cultural integration of migrants moved from rural areas to Korça city, as well as patterns of cultural coexistence between urban and rural subculture. Data for this study was provided through quantitative method (survey). There were conducted 400 surveys with people moved from rural areas to Korça city. Descriptive and correlative statistical analysis was used for data interpretation. The study revealed that integration patterns are not uniform. The most important factors impacting the level of social and cultural integration of rural- to- urban migrants are duration of stay to the city, the social interaction with the host society, social networks, social environment,

*migration patterns and dynamics, etc. The study also showed that the dynamics and complexity of integration of migrants in the host society depend not only from the duration of stay and the characteristics of the locality from where they come from and settle in, but also from social and cultural capital of migrants.*

**Key words:** *migration, economic integration, social and cultural integration, interaction, social network*

## **HYRJA**

Migrimi i brendshëm dhe ndërkombëtar përbën një nga dukuritë më karakterizuese dhe më dinamike të shoqërisë shqiptare të pas viteve 90'. Migrimi i brendshëm rural – urban, i kombinuar me lëvizjen e njerëzve jashtë Shqipërisë kanë sjellë ndryshime sociale dhe kulturore, që lidhen me bashkekzistencën e përbërësve të ndryshëm subkulturorë në një mjedis shoqëror tashmë të diversifikuar. Duke pasur parasysh këto ndryshime, në fokus të studimit është rajoni i Korçës, i cili përfaqëson një mjedis kulturor ku gërshetohen prirjet e ndryshimit kulturor për shkak të lëvizjeve të popullsisë nga zonat rurale në qytetin e Korçës, për shkak të procesit emigrator të fuqishëm, si edhe për shkak të bashkëjetesës së këtyre ndryshimeve brenda një hapësire urbane me prirje kulturore relativisht të qëndrueshme. Qëllimi i studimit është të vërë në dukje shkallën e ndërveprimit dhe integritimit socio- kulturor të banorëve të zhvendosur nga zonat rurale në qytetin e Korçës.

Gjatë periudhës së tranzicionit, në qarkun e Korçës, si në të gjithë Shqipërinë, popullsia ka migruar në masë të madhe brenda dhe jashtë vendit. Lëvizjet e tilla karakterizohen nga migrimi i popullatës nga fshatrat malore në ato fushore, nga zonat rurale në zonat urbane të qarkut dhe njëkohësisht prej emigrimit jashtë vendit.

Qyteti i Korçës përbën destinacionin e dytë, pas Tiranës, më të rëndësishëm për migrantët nga zonat rurale të pjesës juglindore të vendit (Vullnetari J, 2012: 119). Zhvendosja e banorëve nga fshati në qytet sjell pasojë të rëndësishme sociale dhe kulturore si për komunitetet pritëse ashtu edhe për ato dërguese dhe njëkohësisht sjell në fokus çështjen e intergimit të migrantëve në shoqërinë pritëse. Përmes dukurive migratore grupe me përkatësi të ndryshme kulturore vijnë në kontakt me njeri-tjetrin duke ndikuar ndërsjelltazi në sistemet kulturore përkatëse dhe duke sjellë si pasojë rimodelimin e sjelljeve, qëndrimeve, vlerave apo praktikave të tyre. Migrimi, si ai i brendshëm

rural-urban ashtu edhe emigrimi jashtë vendit, sjellin perspektiva të reja dhe pasurojnë diversitetin kulturor. Në këtë kuadër, duke u mbështetur në literaturën e gjerë në fushën e migrimit dhe integritit kulturor si edhe të dhënat empirike synohet të shqyrtohet përmes lenteve të sociologjisë ndikimi që kanë proceset migratore në ndryshimin dhe rimodelimin e mendësive dhe mënyrës së jetesës së individëve dhe familjeve të tyre.

## **METODOLOGJIA E STUDIMIT**

Ky punim është pjesë e një studimi më të gjerë në lidhje me integritin e migrimit të brendshëm dhe ndërkombëtar në qarkun e Korçës dhe impaktin socio- kulturor të tij. Të dhënat për këtë studim u siguruan përmes anketimit. Për anketimin e banorëve të ardhur nga fshati në qytet u përdorë kampionimi probabël sistematik. Për përcaktimin e madhësisë së kampionit është referuar Tabela 1 (Israel, 1992: 2), për madhësinë e kampionit për kufirin e gabimit 5%, ku niveli i konfidencës = .05 (95%) dhe  $P = .5$ . U anketuan 400 banorë të ardhur nga fshati në qytet. Anketa u pilotua fillimisht në 50 subjekte për të testuar nivelin e qartësisë, kuptueshmërisë dhe lehtësisë së plotësisimit nga ana e të anketuarve dhe njëkohësisht, u testua statistikisht për të parë vërtetësinë në analizimin dhe interpretimin e të dhënave dhe lidhjeve ndërmjet variablave. Të dhënat e siguruar përmes metodës sasiore (anketimit) u përpunuan statistikisht në programin SPSS, versioni 20. Gjatë analizimit dhe interpretimit të tyre është përdorur statistika deskriptive, testi hi- katror i Pearsonit për të testuar lidhjen ndërmjet variablave, analiza korrelacionale, krostabulimi i të dhënave, si edhe analiza deskriptive krahasuese për të krahasuar diferencën e raportit ndërmjet dy apo më shumë grupeve të subjekteve.

### **1. KORNIZË TEORIKE E MIGRIMIT RURAL-URBAN**

Në shkencat sociale njihen disa teori të cilat përpiqen të shpjegojnë aspekte të ndryshme të procesit të migracionit. Migracioni përbën një dukuri sociale tepër komplekse, e cila ka nevojë për një qasje ndërdisiplinare (Castels, S & Miller, M. J 1993, King, R 2012, Vieriu, M A 2013). Një ndër qasjet teorike mbi migracionin dhe modelet e migrimit që përbën edhe kornizën teorike për të kuptuar dukurinë e migrimit të brendshëm rural- urban në kontekstin e studimit tonë është qasja e Mabogunje (1970) mbi sistemin e migrimit.

Një nga çështjet më të rëndësishme për konceptualizimin e dukurisë së migrimit si një sistem është identifikimi i elementeve bazë ndërvepruese, attributeve dhe marrëdhënieve ndërmjet tyre. Qasja e A. L. Mabogunje (1970) mbi sistemin e migrimit rural-urban tregon elementet bazë të sistemit të migrimit rural-urban si edhe mjedisin brenda të cilit sistemi operon. Qasja ndaj sistemit të migrimit rural-urban është e lidhur jo vetëm me arsyen se pse njerëzit migrojnë, por edhe të gjitha pasojat e këtij procesi. Kjo qasje synon t'u japë përgjigje pyetjeve të tilla si:

Si dhe pse një individ nga zonat rurale bëhet një banor i përhershëm i qytetit?

Cila është struktura/modeli bazë i këtyre lëvizjeve dhe si përcaktohet ai?

Brenda këtij kuadri teorik është konceptualizuar dukuria e migrimit rural-urban në kontekstin shqiptar. Në shoqërinë shqiptare të paraviteve 90' hapësirat rurale konsideroheshin si të vetëmjaftueshme dhe politikat nuk lejonin lëvizjen e banorëve nga zonat rurale drejt atyre urbane. Ndryshimet politike, ekonomike e shoqërore që karakterizuan vendin në vitet 1990-1991 dhe më pas, u shoqëruan me zhvendosjen masive të popullsisë nga hapësirat rurale drejt atyre urbane e suburbane. Në këtë kuadër është e rëndësishme të pyesim:

*Cilat forca kanë ndikuar dhe vazhdojnë të ndikojnë në dobësimin e kushteve si vetëmjaftueshmëria në zonat rurale dhe dyndjen e banorëve në zonat urbane?*

Këto forca janë vënë në lëvizje kryesisht nga rritja e zhvillimit ekonomik. Në shoqërinë shqiptare pas viteve 90'-të, nga një ndalim i përgjithshëm i lëvizjes së lirë, ku çdo gjë kontrollohej nga shteti, u kalua në një shpërngulje të pakontrolluar të popullsisë, që jetonte në zonat rurale drejt qendrave të mëdha urbane. Zhvillimet demokratike në shoqërinë shqiptare e kanë ndryshuar rrënjësisht panoramën e fshatrave shqiptare. Hapja ndaj tregut botëror, shtimi i importve, konkurrenca jo e ndershme, etj kanë bërë që shumica e banorëve në fshat të braktisin veprimtarinë bujqësore dhe ta shndërrojnë mjedisin rural nga një hapërisë prodhuese në një hapësirë konsumuese.

Prishja e izolimit (hapja) i sjell zonat rurale në orbitën e një ose shumë qendrave urbane dhe zgjon vetëdijen dhe dëshirën e fshatarëve për një gamë gjithnjë e më të madhe produktesh apo shërbimesh që vetëm qendrat urbane mund t'i ofrojnë. Për këtë banorët e zonave rurale



ose duhet të prodhojnë mallra bujqësore dhe të hyjnë në marrëdhënie shkëmbimi me qytetet, ose të zhvendosen drejt zonave urbane për të “shitur” punën e tyre në këmbim të pagave më të mira me të cilat mund të blejnë mallra dhe shërbime. Ky është mjedisi brenda të cilit vepron sistemi i migrimit rural- urban. Për më tepër ai është një mjedis i cili është vazhdimisht në ndryshim dhe këto ndryshime ndikojnë në funksionimin e sistemit.

Në kuadrin e sistemit të migrimit rural- urban vëmendja fokusohet, jo vetëm tek migrantët, por edhe tek elementë të tillë, si: nënsistemet e kontrollit, marrëdhëniet sociale e ekonomike, mekanizma rregulluese etj, të cilat janë pjesë integrale e dukurisë së migrimit. Dy nënsisteme të rëndësishme janë nënsistemet rurale dhe nënsistemet urbane të kontrollit. Një nënsistem kontrolli është ai i cili mbikqyr funksionimin e përgjithshëm të sistemit dhe përcakton mënyrën **kur** dhe **si** rritet apo zvogëlohet sasia e prurjeve në sistem. Nëse ne pranojmë ekzistencën e nënsistemeve të kontrollit në këto lëvizje migratore, problem më tej është të identifikojmë se cilat institucione veprojnë në këtë mënyrë si në hapësirat rurale edhe në ato urbane.

Në zonat rurale një nënsistem kontrolli do të ishte familja, e zgjeruar ose nukleare. Familja është ajo që frenon migrantët potencialë derisa ata arrijnë moshën për të marrë vetë vendime. Edhe kur ata janë në moshë për të marrë vendimin për t’u zhvendosur, familja në shumë mënyra ende vepron si një nënsistem kontrolli. Në disa raste familja u mundëson anëtarëve të të dy gjinive të lëvizin lehtësisht, në disa raste të tjera vetëm anëtarët e njëjës gjini. Përveç familjes, edhe komuniteti fshatar mund të shërbejë si një nënsistem kontrolli. Roli i tij kontrollues nuk mund të jetë ndoshta i drejtpërdrejtë, por evidentohet në aktivitete të caktuara, që ai mund të inkurajojë. Psh, një komunitet rural i cili përpiket të përmirësojë kushtet ekonomike të fshatit mund të dekurajojë të paktën për një periudhë të shkurtër migrimin e përhershëm.

Nënsistemet urbane të kontrollit veprojnë në anën e kundërt për të inkurajuar apo frenuar zhvendosjen në mjedisin urban. Një faktor i rëndësishëm është sigurimi i punësimit.

Në zonat urbane mekanizmi i përshtatjes është në thelb përfshirja e migrantëve në një kornizë të re referimi, kryesisht të lidhura me nevojat e tij të reja në qytet. Qyteti është i përbërë nga një hirearki e

specializimeve. Qyteti është një hapësirë ku çdokush përpiqet të ofrojë aftësi të specializuara; sa më i madh specializimi, aq më e madhe kërkesa për të dhe aq më i madh çmimi. Sa më tepër ngjitet individi në hirearkinë sociale, aq më e madhe është përfshirja e tij në mënyrën urbane të të jetuarit dhe aq më e vogël është mundësia e kthimit në mjedisin rural.

Kjo qasje teorike lejon qw migrimi rural-urban tw konsiderohet jo si linear, por si rrethor, si një sistem të ndërvarur, progresiv, kompleks, në të cilin ndryshimi i një pjese çon në ndryshimin e gjithë sistemit. Kjo thekson natyrën dinamike të procesit të migrimit.

## **2. MIGRIMI I BRENDSHËM RURAL- URBAN**

Migrimi i brendshëm përbën një nga fenomenet më dinamike të dekadave të fundit në Shqipërinë paskomuniste dhe ka ndikuar në formimin e situatës socio-ekonomike dhe demografike të vendit (UNDP 2002, Çaro E, 2011). Pas viteve 90' shoqëria shqiptare u karakterizua nga një zhvendosje masive e banorëve brenda vendit. Numri i lëvizjeve të brendshme migratore në Shqipëri mbetet objekt debati. Shkalla e migrimit të brendshëm gjatë viteve 1989- 2001 varet nga masa e njësive gjeostatistike të përdorura për të regjistruar. Mendohet se ndërmjet tri rajoneve të mëdha (Veri, Qendër, Jug) numri i banorëve që kanë lëvizur është 182,600 banorë, ndërmjet 12 prefekturave 252,700 banorë dhe ndërmjet 36 rrethëve 355,000 banorë (King, Skeldon & Vullnetari, 2008: 28). Dukuria e migrimit të brendshëm reflekton zhvillimin demografik të rajoneve si edhe është një tregues i ndryshimeve sociale, si urbanizimi. Migrimi i brendshëm në kontekstin shqiptar është shprehur në popullimin masiv të disa zonave dhe shpopullimin e disa të tjerave. Për herë të parë në historinë e censuseve të kryera në Shqipëri popullsia e cila jeton në zonat urbane është më e madhe se ajo në zonat rurale. Kështu, 53.7% e popullsisë jeton në zonat urbane dhe 46.3% në zonat rurale (Censusi i popullsisë dhe i banesave 2011). Një fenomen i tillë lidhet me proceset e modernitetit. Dy periudhat e pikut të dukurisë së migrimit të brendshëm në shoqërinë shqiptare janë vitet 1990-1993 dhe 1996-1997, vite të cilat karakterizohen nga ndryshime dhe reformat të thella ekonomike. Faktorët shtytës që përcaktojnë migrimin e brendshëm lidhen me kushtet ekonomike, varfëria, të ardhurat e ulta, akses i ulët në shërbimet publike, papunësia, pavlefshmëria e tokës bujqësore, etj, ndërsa ndër

faktorët tërheqës përmendim mundësitë e punësimit, arsimimit, niveli i jetesës në vendet e destinacionit, etj.

Karakteristikë e migrimit rural-urban në Shqipëri është natyra kolektive e lëvizjeve, që ndryshon dukshëm prej emigracionit që ka karakter individual (Çaro E, 2011:81). Njerëzit largohen nga fshati dhe zhvendosen në hapësirën e qytetit familjarisht. Vlerat, normat kulturore, traditat e ndryshme të banorëve nga fshati përballen me ato të popullsisë urbane duke e bërë të vështirë procesin e përshatajes së tyre në mjedisin e ri shoqëror e kulturor. Migracioni i brendshëm në Shqipëri karakterizohet nga pjesëmarrja e të rinjve. Sipas të dhënave nga INSTAT (2004) 46% e migrantëve ndërmjet prefekturave në vitin 2001 nuk kanë arritur moshën 30 vjeç dhe 72 % e personave të migruar ishin në moshën ndërmjet 20 dhe 65 vjeç. Karakteristikë tjetër është përqindja e lartë e grave në migrimin e brendshëm, e lidhur kjo me dukurinë e migrimit të të gjithë familjes. Në vitin 2001 54% e migrantëve të brendshëm ishin gra (INSTAT 2004).

Migrimi i brendshëm, veçanërisht ai rural-urban, ka sjellë pasojat të mëdha ekonomike, sociale e kulturore për shoqërinë shqiptare të tilla, si: përqëndrim i lartë urban i popullsisë, urbanizim i shpejtë dhe i egër, ruralizim të hapësirës urbane, bashkëjetesa ndërmjet grupeve të ndryshme subkulturore apo edhe dukuri të veçimit/ përqëndrimit të banorëve të zhvendosur nga fshati në pjesë të caktuara të qytetit, kryesisht në hapësira informale etj.

Ky largim masiv i banorëve nga fshati drejt qytetit përbën një realitet të ri rural-urban. Kjo përzierje rurale-urbane që karakterizon shoqërinë shqiptare dallon prej koncepteve tradicionale “rurale” “urbane”, pasi shoqërohet me zhvillime tepër komplekse, të cilat çojnë drejt dilemës; *ruralizim i hapësirës urbane apo urbanizim i komunitetit të të ardhurve nga fshati?* (Çaro E, 2011:72).

## **2.1 Pasqyrë e lëvizjeve migratore në Qarkun e Korçës**

Qarku i Korçës karakterizohet nga lëvizje migratore si të brendshme ashtu edhe ndërkombëtare. Qyteti i Korçës është destinacioni i dytë më i rëndësishëm (krahas Tiranës) për migrantët nga zonat rurale të pjesës juglindore të vendit (Vullnetari, J. 2012: 119). Korça është poli rajonal më i rëndësishëm i juglindjes, i lokalizuar përgjatë njërës prej rrugëve më të rëndësishme tregëtare që lidhin Shqipërinë me Ballkanin dhe vendet e Evropës, përmes Maqedonisë

dhe Greqisë. Themeluar në shekullin XIII Korça ka qënë një qendër e rëndësishme historike dhe tregtare.

Duke qenë se fokusi i studimit është matja e shkallës së intergrimit të banorëve të zhvendosur nga fshati në qytetin e Korçës, po u referohemi disa treguesve të popullsisë të cilët tregojnë se në qytetin e Korçës numri i banorëve ka ardhur duke ndryshuar për shkak të dukurisë të migrimit. Kështu në vitin 1990 numri i banorëve në qytetin e Korçës llogaritej 65.000 banorë, në vitin 1995 numri i banorëve ishte 73.499 dhe në vitin 2000 numri ishte 80.772 banorë. Prej vitit 1991 deri në vitin 2000 numri i të ardhurve në qytetin e Korçës vlerësohet 16.646 të ardhur dhe 8124 të larguar (Projekt programi i zhvillimit rajonal të qytetit të Korçës, 2001). Po ashtu të dhënat nga Zyra e Statistikës në qarkun e Korçës tregojnë se në vitin 2005 në qytetin e Korçës numri i banorëve në fund të këtij viti ishte 85.590 banorë. Në vitin 2005 numri i të ardhurve në qytet vlerësohet 2.456 banorë dhe numri i të larguarve 1.163 banorë. Në vitin 2008 në qytetin e Korçës kishte 716 banorë të ardhur nga zonat rurale, prej të cilëve 524 femra dhe 192 meshkuj, ndërsa të larguarit nga qyteti i Korçës (kryesisht në Tiranë dhe emigrantë në Greqi) arrinin shifrën 614 prej të cilëve 178 meshkuj dhe 436 meshkuj (Buletini statistikor, Bashkia Korçë, 2008). Në vitin 2009 në qytetin e Korçës numri i banorëve në fund të vitit ishte 86.596, numri i të ardhurve 925 dhe numri i të larguarve 572 banorë.

Duke analizuar treguesit e popullsisë sipas viteve theksohet se numri i të ardhurve në qytet gjatë periudhës 1990-2000 është shumë i lartë krahasuar me numrin e të ardhurve prej vitit 2000 e në vazhdim. Periudha 1990-2000 përkon me ndryshimet e mëdha në strukturën politike, ekonomike e sociale të vendit, ndryshime të cilat përbëjnë edhe faktorët më të rëndësishëm shtytës të migrimit të popullsisë, ndërsa prej vitit 2000 konstatohet një stabilitet i përgjithshëm politiko-ekonomik në vend. Këto faza të rëndësishme të zhvillimit ekonomik, politik dhe social që karakterizojnë shoqërinë shqiptare reflektohen në mënyrë të dukshme edhe në dinamikën dhe përmasat e lëvizjeve migratore dhe emigruese në qarkun e Korçës.

### 3. GJETJE DHE DISKUTIME

#### 3.1 Përmasa të integrimit të banorëve të zhvendosur nga fshati në mjedisin urban të Korçës

Për të matur shkallën e integrimit të banorëve të zhvendosur nga fshati në mjedisin urban të Korçës i jemi referuar treguesve që lidhen me integrimin ekonomik, integrimin social dhe atë kulturor. Integrimi ekonomik lidhet me shkallën në të cilën të ardhurat e migrantëve barazohen me ato të grupit, ndërsa integrimi social-kulturor nënkupton masën në të cilën imigrantët ndajnë të njëjtat vlera dhe sjellje me pjesën tjetër të shoqërisë pritëse.

##### *Aspekte të integrimit ekonomik*

Punësimi i banorëve në qytet përbën një tregues të rëndësishëm të integrimit ekonomik, pasi punësimi lidhet jo vetëm me nivelin e të ardhurave, por edhe me përfshirjen e tyre në një sistem marrëdhëniesh sociale dhe kulturore me popullsinë urbane. Prej të dhënave të anketimit rezulton se 56.3 % e banorëve të ardhur nga fshati në qytet janë të përfshirë në marrëdhënie pune; pjesa tjetër përbëhet nga studentët 11.7% dhe pensionistët 12.5 % ndërsa ata që nuk janë të përfshirë në marrëdhënie punë përbëjnë 19.5 % të të anketuarve. Për të parë lidhjen ndërmjet punësimit dhe shkallës së integrimit të tyre në jetën urbane është përdorur testi Hi-katror i Pearson-it. Nga rezultatet e testit konstatohet se nga pikëpamja statistikore variabli *punësim* ndikon në variablin *integrimit*:  $X^2(66, N = 400) = 276.22, p = .000$ . Kjo tregon se punësimi i banorëve të ardhur nga fshati në qytetin e Korçës ndikon në shkallën e integrimit të tyre në jetën urbane.

Remitancat prej emigrantëve përbëjnë një faktor lehtësues në integrimin ekonomik të banorëve të ardhur nga fshati në qytet. Migracioni në kontekstin shqiptar karakterizohet nga një ndërlidhje e dukshme midis dy formave të migrimit (atij të brendshëm rural-urban dhe emigracionit jashtë vendit). Të dhënat e studimit tregojnë qartë lidhjen ndërmjet migrimit rural-urban dhe emigracionit; 70.0 % e të anketuarve pohojnë se kanë përvojë emigracioni personalisht apo ndonjë prej pjesëtarëve të familjes së tyre. Prej të dhënave rezulton se përvojat migratore janë të larmishme; në 41.5 % të rasteve emigracioni i ka paraprirë zhvendosjes nga fshati në qytet, në 11.5% të rasteve lëvizja nga fshati në qytet është pasuar prej përvojës migratore dhe në 17,0 % të rasteve emigrimi i ndonjë prej pjesëtarëve të familjes bashkëshoqëron përvojën migratore të pjesës tjetër të familjes në qytet.

Dërgesat në para të emigrantëve kontribuojnë në rritjen e të ardhurave për familjarët e emigrantëve, duke lehtësuar procesin e integritit ekonomik të banorëve të ardhur nga fshati në qytet, jo vetëm në fazën e parë të përvojës migratore, por edhe në vazhdimësi të qëndrimit dhe jetesës së tyre në qytet. Rezultatet e testit Hi- Katror mbi ndikimin që ka përvoja emigratore në shkallën e integritit të banorëve të ardhur nga fshati në mjedisin urban të qytetit tregojnë se variabli “përvojë emigratore” statistikisht ndikon në variablin “integritim”, pasi vlera e përftuar prej testit  $X^2(55, N = 400) = 83.39, p = .008$ .

Sigurimi i banesës përbën një tjetër tregues të rëndësishëm të integritit ekonomik të migrantëve në vendin pritës, krahas punësimit, nivelit të të ardhurave apo arritjeve në fushën e edukimit. Të dhënat e studimit vënë në dukje se ndërtimi apo blerja e një banese me të ardhurat e përfituara nga emigracioni (vetjak apo i ndonjë prej pjesëtarëve të familjes) është investimi tipik i banorëve të ardhur nga mjedisi rural në qytet. Vendosija në qytet dhe vazhdimësia e jetesës në mjedisin urban nuk mund të kuptohet pa sigurimin paraprak të banesës.

Ndërtimi apo blerja e një banese nuk vetëm një tregues i mirëqënies dhe integritit ekonomik në mjedisin e ri por shpreh edhe kërkesën për një status të ri social. Ait Hamza (1988) e cilëson investimin e tepruar në ndërtimin apo rregullimin e shtëpive si një përdorim irracional të parave për simbole statusi të panevojshme (vep. cit. De Haas, 2006: 15). Autori i referohet tendencës së banorëve nga fshati për të investuar paratë e siguruar nga puna në emigracion në ndërtimin/blerjen e banesave të mëdha dhe të kushtueshme në qytet.

Integritimi ekonomik ndikon në integritimin më të madh social dhe kulturor, por nga ana tjetër edhe ndërveprimi kulturor dhe social mund të jetë një faktor i rëndësishëm i integritit më të mirë ekonomik të migrantëve. Integritimi ekonomik dhe burimet materiale u mundësojnë migrantëve të sigurojnë një status dhe jetë më të mirë, duke përfituar një ndjenjë të përkatësisë dhe përshtatjes në komunitetin urban.

Dy faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në shkallën e integritit të banorëve të ardhur nga fshati në qytet është kohëzgjatja e qëndrimit në qytet dhe moshën. Të dhënat prej testit Hi- katror tregojnë se nga pikëpamja statistikore ndikimi mes variablave (kohëzgjatja e qëndrimit në qytet dhe shkallës së integritit në jetën urbane) është statistikisht i rëndësishëm:  $\chi^2(308, N = 400) = 373.25, p = .006 < .05$ . Kjo nënkupton

se sa më e gjatë koha e qëndrimit të banorëve në qytet aq më të mirëintegruar janë ata. Nga ana tjetër të dhënat prej korrelacionit ndërmjet moshës së të anketuarve dhe shkallës së integrimit të tyre në jetën urbane rezultojnë se ka një marrëdhënie negative ndërmjet këtyre dy variablave. Kjo nënkupton që sa më e madhe moshja e banorëve që vijnë nga fshati në qytet aq më e vogël shkalla e integrimit të tyre në jetën urbane. Vlera e koeficientit të korrelacionit tregon se lidhja ndërmjet variablave është e dobët, por statistikisht domethënëse:  $r(400) = -.232, p = .00 < .01$ . Kjo shpjegohet me faktin se integrimi i banorëve të ardhur nga fshati në qytet është një proces kompleks që varet nga një sërë faktorësh të tjerë të cilët bashkëndikojnë.

### *Përmasat sociale të integrimit në jetën urbane*

Duke u bazuar në modelin e Heckmann (2005) mbi llojet e integrimit në shoqërinë pritëse theksohet se dimensionet sociale të integrimit të migrantëve në një mjedis të ri social lidhet me atë që Heckmann e quan integrimi ndëraktiv, i cili përfshin marrëdhëniet sociale, miqësore, shkëmbimet martesore, anëtarësimi në organizata të ndryshme etj.

Mjedisi social përbën një faktor të rëndësishëm, që ndikon dukshëm në integrimin e migrantëve në mjedisin e ri shoqëror e kulturor, pasi lidhet me masën e ndërveprimit social të banorëve të ardhur nga fshati me shoqërinë pritëse. Konteksti lokal ku shfaqen ndërveprimet shoqërore mes migrantëve dhe shoqërisë pritëse janë të shumta dhe të ndryshme. Ata variojnë nga institucionet e shumta të shoqërisë pritëse (administrata dhe institucionet e shërbimeve publike, shkolla, kompani, spitale etj.), në hapësirat publike si sheshet, transporti publik, dyqane, komplekset e banimit. Ato, gjithashtu përfshijnë edhe sferën private (marrëdhëniet familjare, martesat, miqësitë) (Gsir, S. 2014:2). Studime të ngjashme tregojnë se të ardhurit nga fshati, të cilët në mjedisin social (të banimit, të punës, të shkollës etj.) rrethohen nga qytetarë kanë gjasa të integrohen më lehtësisht në jetën urbane krahasuar me ata banorë të cilët janë pjesë e një mjedisi shoqëror që karakterizohet nga dominimi i të ardhurve nga mjedisi rural krahasuar me pjesën qytetare. Edhe rezultatet e testit Hi-katror i Pearson-it për lidhjen ndërmjet variablit: *mjedisi social në zonën e banimit dhe variablit: shkalla e integrimit në jetën treguan se* ndërmjet variablave ka një lidhje domethënëse nga pikëpamja statistikore, pra  $\chi^2(30, N = 400) = 73.22, p = .000 < .05$ .

Rezultatet e testit Hi- katror të Pearson-it tregojnë se lidhja ndërmjet variablave “mjedisi social në vendin e punës apo shkollë” dhe “integrimi në jetën urbane” është statistikisht e rëndësishme:  $\chi^2 (24, N = 400) = 37.74, p = .037 < .05$ ;

#### *Përmasa kulturore të integrimit në jetën urbane*

Dimensioni kulturor i integrimit të migrantëve në shoqërinë dhe kulturën pritëse lidhet me ndryshimet sjellore, ndryshime të qëndrimeve, praktikave, vlerave, mënyrës së jetesës në përgjithësi. Bazuar në këta përbërës të sistemit kulturor është identifikuar shkalla e integrimit kulturor të banorëve të zhvendosur nga fshati në qytetin e Korçës, duke u mbështetur në përcaktimin e Algan et al (2012) për integrimin kulturor si masa në të cilën imigrantët ndajnë të njëjtat vlera apo modele sjellore me pjesën tjetër të shoqërisë pritëse. Integrimi kulturor i migrantëve rural- urbanë që reflektohet në ndryshimin e mënyrës së jetesës, qëndrimeve, sjelljeve, vlerave kulturore është një proces kompleks që ndodh me kalimin e kohës dhe në një kontekst hapësinor. Dimensioni hapësinor ka të bëjë me ndikimin që ushtron mjedisi social urban, densiteti dhe fluksi i ndërveprimit social me shoqërinë urbane në shkallën e ndryshimit të mënyrës së jetesës. Gjithashtu dendësia, apo madhësia e një grupi të caktuar në raport me popullsinë e përgjithshme në një zonë të caktuar, mund të jetë një faktor që ndikon në masën e ruajtjes apo modifikimit të tipareve kulturore vetjake. Për të vënë në dukje lidhjen ndërmjet mjedisit social urban dhe ndërveprimit social me qytetarët dhe masës së ndryshimit të mënyrës së jetesës është përdorur testi hi- katror i Pearson-it. Variabli: ndryshim i mënyrës së jetesës është matur përmes nënvariablave: ndryshim i mentalitetit, ndryshim i mënyrës së të folurit, të veshurit, ndryshime në tradita, rituale, marrëdhënie familjare. Rezultatet e testit tregojnë se lidhja ndërmjet variablave: fluksi i marrëdhënieve dhe ndërveprimit social me qytetarët dhe ndryshimit të mënyrës së jetesës së banorëve të ardhur nga fshati, është statistikisht e rëndësishme:  $\chi^2 (120, N = 400) = 164.59, p = .004 < .05$ . Rezultatet e testit tregojnë gjithashtu një lidhje statistikisht të rëndësishme mes variablit: miqësimi me korçarët dhe variablit: ndryshim i mënyrës së jetesës së banorëve të ardhur nga fshati,  $\chi^2 (60, N = 400) = 102.66, p = .001 < .05$ .

Procesi i integrimit së migrantëve në një mjedis të ri socio-kulturor përfaqëson një përvojë komplekse të të mësuarit dhe përshtatjes në një komunitet me kulturë të re dhe të ndryshme,



komunitetit dhe mjedisit si edhe një mjet për zhvillimin e mirëqenies. Pavarësisht ndryshimeve në mënyrën e jetesës dhe modifikimeve që kanë pësuar vlerat kulturore që migrantët bartin prej subkulturës rurale, si rezultat i jetesës në qytet dhe socializimit me subkulturën urban, shumica e banorëve që janë zhvendosur nga fshati në qytetin e Korçës ruajnë një ndjenjë të ruralitetit. Grupimi dhe përqëndrimi i tyre në pjesën periferike të qytetit krijon mundësinë që ata të ndajnë traditat dhe normat e fshatit. Kjo përputhet me supozimin e Tittle dhe Stafford (1992) se njerëzit që jetojnë në zonat periferike të qendrave urbane janë më homogjene, kanë kufij të forta sociale, tregojnë më pak anonimiteti dhe shfaqin më pak aspekte të urbanizmit (vep. cit. Çaro, 2011; 95). Këto karakteristika, së bashku me lidhjet e forta familjare, vazhdimësia e lidhjeve me shtëpinë, tokën, komunitetin rural të lënë pas pengon krijimin e një identiteti urban për këta banorë. Në kontekstin e studimit tonë evidentohet një përqëndrim i banorëve të ardhur nga zonat rurale në disa lagje të reja periferike të qytetit si lagjia 10, 18, etj ku ka një dominim të të ardhurve nga fshati. Në mjedise të tilla sociale, nën ndikimin edhe të lidhjeve sociale familjare banorët e fshatit në qytet manifestojnë disa modele sjellore, që janë katakteristikë e formimit psikokulturor të banorit të fshatit.

Për të vënë në dukje masën e ndikimit të vazhdimësisë së lidhjes me mjedisin rural në integrimin e banorëve të ardhur nga fshati në subkulturën urbane apo ruajtjen e elementëve të ruralitetit gjatë jetësë në hapësirën urbane i referohemi treguesve statistikorë mbi rezultatet e testit hi- katror. Rezultatet e testit tregojnë se ka një lidhje domethënëse nga pikëpamja statistikore mes vazhdimësisë së lidhjes me mjedisin e fshatit dhe ruajtjes së mënyrës rurale të të jetuait,  $\chi^2(70, N = 400) = 119.95, p = .00 < .05$ .

## **PËRFUNDIME**

Duke u bazar në të dhënat e studimit dhe interpretimin e tyre vlen të theksohet se integrimi ekonomik dhe burimet materiale kanë një rëndësi të veçantë për të ardhurit nga fshati në qytet, pasi u siguron atyre një status dhe një jetë më të mirë duke krijuar tek ata një ndjenjë të përkatësisë, që është thelbësore për përfshirjen dhe integrimin e mëtejshëm në jetën sociale dhe kulturore. Gjatë procesit të migrimit, emigrantët mund të humbasin, të fitojnë dhe të zëvendësojë burime të ndryshme për të kënaqur nevojat e tyre dhe për të plotësuar procesin e

integritit dhe përshtatjes së tyre me mënyrën urbane të të jetuarit. Rezultat e studimit treguan se të ardhurit nga fshati në qytetin e Korçës janë të mirëintegruar ekonomikisht në jetën urbane.

Migrantët në faza të ndryshme të procesit të migracionit dhe në varësi të karakteristikave të tyre personale kërkojnë burime të ndryshme për të kënaqur nevojat e tyre, qëllimet dhe kërkesat si edhe për tu integruar në shoqërinë pritëse. Për këtë arsye integrimi është proces kompleks që ndodh me kalimin e kohës dhe në një kontekst hapësinor. Rëndësi të veçantë në këtë proces merr kohëzgjatja e qëndrimit në destinacionin e ri. Kohëzgjatja e qëndrimit njihet si një element kyç në procesin e integritit, madje duke marrë parasysh ndryshimet e konsiderueshme në burimet midis migrantëve të hershëm dhe migrantëve të vonë. Dinamikat dhe kompleksiteti i procesit të integritit të migrantëve në shoqërinë pritëse varen, jo vetëm nga koha e qëndrimit dhe karakteristikat e lokalitetit nga ata vijnë dhe ku vendosen, por edhe prej burimeve dhe kapitalit social dhe kulturor të migrantëve.

Integrimi ekonomik dhe social i banorëve të ardhur nga fshati në qytet është i lidhur ngushtë me masën e integritit kulturor të tyre. Sa më të përfshirë dhe të integruar të jenë banorët në strukturën ekonomike dhe sociale të qytetit aq më tepër janë të integruar kulturalisht. Dimensionin kulturor i integritit lidhet me aspekte të ndryshme të mënyrës së jetesës.

Rezultatet e studimit treguan se bashkëjetesa me subkulturën urbane ka ndikuar ndjeshëm në ndryshimin e mënyrës së jetesës për pjesën dërmuese të përgjigjedhënësve. Gjatë bashkëjetesës me subkulturën urbane, migrantët fillojnë të përshtaten me mënyrën urbane të të jetuarit duke ndryshuar mënyrën e jetesës, vlerat, normat kulturore, traditat etj, duke u bërë gjithnjë e më të ngjashme me shoqërinë pritëse. Faktor i rëndësishëm i ndryshimit të mënyrës së jetesës së banorëve të ardhur nga fshati në qytet është mjedisi social urban.

Duke marrë në konsideratë lidhjen e ndërsjellë mes migrimit të brendshëm rural-urban dhe emigracionit në kontekstin e studimit tonë, përmasat e integritit në nivel subkulturor të banorëve dhe modelet e bashkëjetesës sociale dhe kulturore ndërmjet subkulturës rurale dhe subkulturës urbane arrihet në përfundimin se:

**Së pari**, nuk ka modele uniforme të 'integritit'.

**Së dyti**, karakteristikat dhe sfondi i popullsisë migrante janë shumë të ndryshme, dhe kjo reflektohet në shumëllojshmërinë e formave dhe përmasave të integritit në nivel individual apo familjar.

**Së treti**, modelet dhe dinamika e migrimit janë gjithashtu të rëndësishme dhe lidhen kryesisht me projektin migrator, strategjitë e integritit, mekanizma përjashtues apo integrues të kushtëzuara prej komunitetit pritës.

**Së katërti**, faktori kohë mbetet veçanërisht i rëndësishëm në këtë kontekst dhe është vënë vazhdimisht në dukje gjatë studimit.

## **BIBLIOGRAFIA**

Algan Y, Bisin A, Manning A & Verdier Th.,(2012), Cultural Integration of Immigrants in Europe, Oxford University Press

Buletini Statistikor, Bashkia Korçë, 2008, Botimi i USAID & CSD

Çaro E.,(2011), From Village to the City- Adjustment Process of Internal Migrants in Albania, Rozenberg Publishers, Amsterdam

Castles, S & Miller, M. J.,(1993), The Age of Migration. International Population

Movements in the Modern World, Book reviews, botuar në Progress in Human

Geography,1994, 18(3): 398-400, Sage publication

De Haas, H. (2012). The migration and development pendulum: a critical review on research

and policy, International Migration 50(3), 8-25.

De Haas, H.,(2010), The Internal Dynamics of Migration Processes: A Theoretical Inquiry,

Journal of Ethnic and Migration Studies Volume 36 (10), 1587-1617,DOI:10.1080/1369183X.2010.489361,

Routledge,<http://www.tandfonline.com/doi/pdf/10.1080/1369183X.2010.489361>

De Haas, H.,(2006), The social and cultural impacts of international migration on Moroccan sending communities: a review, paper to be published in Morocco and the

Netherlands: Society, Economy,Culture, Amsterdam 2006

Gëdeshi I & Jorgoni E.,(2012), Social impact of emigration and rural-urban migration in Central and Eastern Europe- Final country Albania,

[ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=8819&langId=en](http://ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=8819&langId=en)

Gsir, S.,(2014), Social Interactions between Immigrants and Host Country Populations: A Country-of-Origin Perspective, INTERACT RR 2014/02, Robert Schuman Centre for Advanced Studies, San Domenico di Fiesole (FI): European University Institut

INSTAT 2002, Popullsia e Shqipërisë në 2001- Rezultatet kryesore të rregjistrimit të popullsisë dhe banesave

INSTAT 2004, Migracioni në Shqipëri- Regjistrimi i popullsisë dhe i banesave 2001,

[www.instat.gov.al/media/169428/migracioni\\_ne\\_shqiperi.pdf](http://www.instat.gov.al/media/169428/migracioni_ne_shqiperi.pdf)

[INSTAT, Censusi i popullsisë dhe i banesave 2011](#)

Israel D. G.,(1992), Determining sample size, University of Florida, PEOD6, nxjerrë nga

<https://edis.ifas.ufl.edu/pdf/FILES/PD/PD00600.pdf>

King R.,(2012), Theories and Typologies of migration: An overview and a Primer, Willy

Brandt Series of Working Papers in International Migration and Ethnic Relations

3/12, MALMÖ University

King R, Skeldon, R.,(2010), Mind the gap! Integrating approaches to internal and international migration, Journal of Ethnic and Migration Studies, Vol. 36(10),

pp.1619- 1646, Routledge: King R, Skeldon, R & Vullnetari J., (2008), Internal and international migration: Bridging the theoretical divide, Working Paper No 52, University of Sussex,

[https://www.sussex.ac.uk/webteam/gateway/file.php?name=mwp52.p](https://www.sussex.ac.uk/webteam/gateway/file.php?name=mwp52.pdf&site=252)

df&site=252 Mabogunje J. A.,(1970), Systems Approach to a Theory of Rural-Urban Migration,

Geographical Analyses, Vol.2 (1), 1-18

Vullnetari J.,(2012), Albania on the Move- Links between Internal and International

Migration, Amsterdam University Press Vieriu M. A.,(2013), The process of migration and integration: A theoretical inquiry, Social

Research Reports, Vol. 24, pp. 7-15,

[http://www.researchreports.ro/images/researchreports/social/srr\\_2013\\_vol024\\_001.pdf](http://www.researchreports.ro/images/researchreports/social/srr_2013_vol024_001.pdf)

## **PROGRESI HISTORIK I SHOQËRIVE DHE ARRITJA E SOVRANITETIT KOZMOPOLIT SIPAS I. KANT**

**DR. ERISELD KALEMAJ**

Pedagog në Universitetin 'Fan S. Noli', Korçë  
Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane  
Departamenti i Shkencave Sociale  
[kalemaj.eriseld@yahoo.com](mailto:kalemaj.eriseld@yahoo.com)

**Abstrakt:** Në vëmendje të këtij punimi është nocioni i 'sovrانيتit'. Kuptimi themelor i sovranitetit është organizimi shoqëror, nën një pushtet të përbashkët. Çështja është se mbi ç'premissa arrihet ky homogjenizim i shoqërisë? Historia e filozofisë ka njohur dy shkolla: 'Shkolla e së drejtës natyrore', e cila e sheh njeriun në kushtet e mjedisit bio-fizik dhe 'Shkolla historike', duke e vështruar në kontekstin historik, moral dhe kulturor. Tek ky diskurs, në interesin tonë është pozicioni filozofik i I. Kantit.

Në thelb, marrëdhënia 'natyrë – histori' është marrëdhënia midis arsyes së kulluar dhe arsyes praktike. Natyra realizon qëllimin e saj përmes proceseve historike dhe po ashtu historia kuptohet si një plan natyror. Njeriu është në një lidhje të pandashme midis natyrës dhe historisë. Pikërisht këtu do të mund të kuptojmë njeriun midis ligjeve universale të natyrës dhe sjelljes antrope – kulturore. Kanti sheh homogjenizimin universal të shoqërisë tek kjo marrëdhënie. Midis natyrës dhe historisë, shoqëritë dallojnë nga njëra – tjetra, atëherë si mund të bashkohen të gjithë njerëzit, shoqëritë në një sovranitet kozmopolit?

**Fjalët kyçe:** natyrë, histori, shoqëri, sovranitet kozmopolit

## **THE HISTORICAL PROGRESS OF SOCIETIES AND THE ACHIEVEMENT OF COSMOPOLITAN SOVEREIGNTY CONCERNING TO I. KANT**

**Abstract:** In focus of this work is the notion of 'sovereignty'. The basic meaning of sovereignty relates with social organization, under a common authority. The issue which are the premises for the achievement of this homogenization of society? The history of philosophy recognized two schools of think, "the school of natural law", which finds man in terms of bio-physical environment and the "historical school", the last putting the man in historical, moral and cultural context. Our focus will relate with I. Kant's philosophical position in this discourse.

*In essence, the relation 'nature - history' consist the connection between pure and practical reason. The nature accomplishes its purpose through historical processes, and history is perceived as a natural plan. Human is at an inseparable connection between nature and history. Right here, between the universal laws of nature and the antropo-cultural behavior, we can understand the man. Kant sees the universal homogenization of society precisely in this relationship. Considering the fact that societies differ from each other regarding nature and history – as well as their connection, then how can all people and societies unite in a cosmopolitan sovereignty?*

**Key words:** nature, history, society, cosmopolitan sovereignty

## **HYRJE**

Njeriu dhe shoqëria karakterizohen nga kompleksiteti dhe papërcaktueshmëria. Vëzhguar në kontekstin politik, refleksioni sado skrupuloz të jetë, nuk mund të jetë përfundimtar. Në thelb, mbetet gjithmonë diçka e pashpjeguar, kontradiktore apo paradoksale. Ashtu si e kemi treguar deri më tani, historia e filozofisë, në çështjet politike njih një larmi teorish, pikëpamjesh, idesh etj. Mes tyre edhe shumë optika që shpjegojnë (justifikojnë) kuptimin e sovranitetit. Pas përmbajtjes fshihen rrymat filozofike. E shprehur kështu, nisur disa premisa, që nuk ishin gjë tjetër veçse mënyra se si e shikonin njeriun dhe shoqërinë, u abstragua për të krijuar një qenie statike dhe gjithëpërfshirëse, siç është Personi Sovran, qoftë person konkret, qoftë formë e organizimit institucional. Thjesht teorizimi, abstragimi i pushtetit Sovran mbi themelet e së drejtës natyrore, praktikisht është shtypës dhe filozofikisht jo e plotë në shpjegimin e konceptit.

Krijimi i një organizmi statik dhe kaq artificial nëpërmjet racionalitetit dhe logjikës së ftohtë, për shumë mendimtarë në fund shekullit të XVIII, injoroi një dimesion tepër të rëndësishëm të njeriut dhe shoqërisë, pikërisht karakterin historik e kulturor. Diskutimi u fokusua tek themelet historike dhe kulturore të shoqërisë, për të kuptuar sovranitetin. Unifikimi i shoqërisë nëpërmjet kulturës dhe historisë zëvendëson ‘të drejtën natyrore’ në përcaktimin e sovranitetit. Viko do të shihte identitetin kulturor si një ‘ligj i natyrës’, premisë nga duhet të diskutohet pushteti socio – politik dhe ai politik – juridik (Gadamer, 2004, f. 20). Në këtë diskurs shfaqen dy shkolla; shkolla e së drejtës natyrore, e cila e sheh njeriun në kushtet e mjedisit bio-fizik dhe shkolla

historike, duke e vështruar njeriun në kontekstin historik, moral dhe kulturor.

Izolimi i koncepteve që ngrehin teoritë mbi Sovranin; si natyrë njerëzore, gjendje sociale, kontratë shoqërore, pushtet politik, shtet, institucione etj. janë sofizma të sjella bukur në argument, por që nuk kanë asnjë referencë praktike – faktike. Theksi vihet tek premisa e gabuar që në dukje sjellë si të drejtë (të justifikuar... legjitimuar në terma juridik) pushtetin si fakt socio – politik. Ndërkohë që për disa syresh, organizmi politik i shoqërive është proces socio – historik. Kështu abstragimi i pushtetit Sovran, sado në perfeksion të jetë arsyetuar, kur mënjanon karakterin historik, ai është jashtë kontekstit praktik. Pra, kur njeriu i idesë apo *‘njeriu i kulluar’* (Schiller, 2004 f. 23) si e quan Shileri shtyp njeriun konkret, atë të kohës që ai jeton. Ideja i imponohet rendit kulturor (të veçantë), natyrshmërisë morale që është produkt i një procesi historik. Mospërshtatshmëria në këtë kuptim, është nënshtruese sepse nuk ka bindjen autentike të subjekteve. Provë për këtë është *‘Revolucioni Francez’* (1789 -1799), i cili i frymëzuar nga idetë e Rusoit, injoroi stadin shoqëror dhe nisi të krijonte një rend tërësisht nga fillimi. Mohimi total i traditës politike, diversitetit, kulturës nën justifikimi racionalist, të një shoqërie homogjene qytetarësh, në thelb, ishte e panatyrshme. Pasojat dihen; nga aspirata për liri u shndërua në regjim dhune dhe tiranie. Kritika ndaj *‘shkollës së të drejtës natyrore’* u fokusua tek fakti se, në pikëpamjen e tyre, ata anashkalonin karakterin historik (kulturor) të shoqërisë dhe politikës.

Idealizimi i një shoqërie me anëtarë racional, që bashkohen në një vullnet të përgjithshëm është reduktimi i njeriut në një barazi unike, ku njeriu konkret, ai personi moral humbet në abstraksionin e konstruktit social. Kështu, zbatimi i menjëhershëm, që synon të krijojë një rend nga gjeneza, duke mohuar vlerat e trashëguar është thyerje e natyrshmërisë evolutive të shoqërive. Imponimi teorik në absolutizmin e vetë nuk ka se çfarë rendi të krijojë veçse një rend tiranik.

Rusoi ishte i bindur në argumentat e teorisë së tij dhe qëllimisht kundërshtoi krijimin e pushtetit politik që gjen themelet e veta tek morali apo kultuara. Shoqëria është e keqe për nga natyra, trajta politike nuk duhet t’i ngjaj asaj, përkundrazi, politika duhet të ndërtojë një organizim të tillë, që ta përmirësojë kushtin social, të shkojë përtej saj. Mirëpo kjo braktis gjendjen dhe kushtin praktik (real) të një

shoqërie. Teorikisht ajo mund të qëndrojë dhe është tërësisht e justifikuar, por problemi është se, kërkesat praktike nuk mund të gjejnë vend në mënyrë abstrakte, sesi një shoqëri organizohet socio - politikisht. E menduar kështu, pushteti Sovran, jo vetëm nuk është produkt i individëve, që me vullnet ka pranuar t'i binden, por ai është hermetic dhe indiferent ndaj kushteve konkrete, për rrjedhojë është shtypës.

## **NATYRA, NJERIU DHE HISTORIA**

Bazat sociale dhe politike përcakohen fillimisht nga ligjësit e natyrës. Njeriu nuk është një qenie e përcaktuar, por aftësia intelektive bën që ai të progresojë në realitete të reja dhe gradualisht largohen nga kushtet fillesatare (egërsia dhe primitiviteti i gjendjes natyrore). Loku ka dhënë një shpjegim të tillë, por nuk u mbështet në argumentat historik. Ai mendonte se shoqëritë primitive, në naivitetin e tyre do të praninin një pushtet çfarëdo, pavarësisht mënyrës. Ai u mjaftua me kaq dhe më pas abstragoi teorinë e tij kontraktore të pushtetit dhe ndarjen institucionale, së tepërmi për t'ia përshtatur kohës, ku jetoi. Pra, Loku pa ngushtësisht evoluimin historik të ndryshimit të pushtetit politik, pa i'u referuar faktorit kulturor. Madje, jo rrallë herë, teorizimet filozofike i referohen historisë politike, duke e shmangur traditën. (Locke, 2005, f. 71). Synimi i jetës sociale tregon shprehjen e arsyes njerëzore dhe priren për të krijuar realitetin e vetë. Ç'është punë e njeriut nuk është e përkryer (ide e theksuar nga Monteskje dhe Rusoi). Ajo është vepër e njeriut të lirë dhe të gabueshëm, kështu që shoqëria nuk është idealja, sado e menduar mirë. “*Pra historia e natyrës fillon nga e mira, sepse ajo (natyra) është vepër e Zotit; historia e lirisë fillon nga e keqja, sepse ajo (liria) është vepër e njeriut*” (Kanti, 2004, f. 48). Njeriu është qëllimi i natyrës dhe arritja e këtij qëllimi do kohën e vetë (Kant, 2004, f. 7).

Fillimisht, mjedisi social lyp nevojën e një drejtuesi (Sinani, 2015, f. 33). I vetëdijshëm për egoizmin e tij në raport me të tjerët, ai i 'thërret' arsyes për të gjetur një Sovran, që do të thyej këtë ego të gjithësecilit në veçanti dhe të jetë garant i një rregulli të barabartë (homogjen) për të gjithë anëtarët e shoqërisë. I bindur për shtysën egoiste aq natyrale, njeriu kupton dhe kërkon një shtypje të këtij instikti me qëllim organizimin e lirisë së vetë. I tunduar nga pathosi personal, por me një arsye që kupton se; kjo nuk është rruga e duhur për të



përftuar natyrën e tij, njeriu shpreh nevojën (pse jo domosdoshmërinë) për prezencën e një fuqie (pushteti), që të shtypë këtë instikt anti-social, e cila pason me shkatërrimin e vetes. Pra, ka nevojë për një sovran, drejtues që të koordinojë sjelljet me të tjerët, duke qenë garant i rendit shoqëror. Drejtuesi (Sovrani) është një lloj ndërmjetësi, të kalimit të njeriut nga gjendja natyrore, në atë sociale (kulturore).

Problemi është se kush duhet të jetë ky person që shpreh idealin e drejtësisë, të së mirës publike dhe funksionimin e një rendi të caktuar shoqëror? Tek e fundi edhe ai është njeri dhe mund të shtyhet së tepërmi nga vullneti personal. Atëhere do i duhet një drejtues për vetë drejtuesin... e kështu deri në pafundësi. *“Prandaj kjo detyrë është më e vështira nga të gjitha; bile është e pamundur zgjedhja e saj e përsosur”*- shkruan Kanti (Kanti, 2004, f. 14). Merita apo e drejta për të qenë sovran nuk është asnjëherë e plotë. Teoritë janë orvatje për të legjitimuar një lloj sovran të caktuar, por jo se ai mbetet tërësisht i merituar si një pushtet politik dhe juridik. Në këtë kuptim, vetë koncepti ‘Sovran’ është një problem, një diskutim që asnjëherë nuk do të marrë një përkufizim apo zgjidhje përfundimtare. Ai është një zgjedhje e mundësisë më të mirë. Atëherë, si mund të dalim nga kjo situatë paradoksale? Kush duhet të jetë sovran? Është e vështirë përgjigja sepse nuk i jep dot përgjigje pyetjes si duhet të jetë sovrani?

Për Kantin, ky lloj utopizmi në filozofinë politike lidhet me tre komponentë tejet të rëndësishëm. E para është mungesa e nocioneve tepër të sakta në përcaktimin e një kushtetute ideale. E dyta, mungesa e përvojave botërore dhe padija (paaftësia) për të parashikuara, si pasojë e dinamizmit shoqëror. E fundit dhe më e rëndësishmja do na duhet një vullnet i mirë, i njohur më herët për ta pranuar këtë kushtetutë (Kant, 2004, f. 15). Prandaj, na duhet një standard i përsosur racionaliteti dhe emancipimi që ta përkufizojmë si duhet kushtetutën përfundimtare. Arritja e kësaj vjen si mësim i situatave të caktuara, përvojave konkrete, të cilat ndodhin gjatë një procesi historik. Kështu, tre komponentët sintetizohen në një, duke arritur sovranin ideal, global dhe qytetarin kozmopolit (Kant, 2004, f. 22).

## **PROGRESI HISTORIK I SHOQËRIVE DHE ARRITJA E ‘VULLNETIT TË PËRGJITHSHËM’ (QYTETARTIT KOZMOPOLIT)**

Si pasojë e sintetizimit të përvojave historike mund të përftojmë realisht ‘vullnetin e përgjithshëm’ të Rusoit. Pra, si një stad pjekurie të shoqërisë në procest e veta historike. Arritja e këtij konstrukti social e shkruar me termat e ‘vullnetit të përgjithshëm’ kuptohet, si shtysë e një reflektimi, bindje nga arsyeja. Vullneti i përgjithshëm kalon në filtrin e arsyes. Kanti tek vepra ‘Themelimi i zakoneve shoqërore’, nocionin e ‘vullnetit’ e sheh si arritje të arsyes dhe jo bindje për hir të autoritetit apo thjesht kapriço të vullnetit tërësisht të lirë (Kant, 2004, f. 66). Në këtë kuptim arsyeja është përcaktuese e vullnetit. Ndryshe, thjesht shprehja e vullnetit do të ishte një akt i pamoralshëm, pra, i motivuar nga subjektiviteti dhe egoja natyrore. Falë arsyes arrihet të shfaqet vullneti i mirë. Nga këtu, racionaliteti bëhet universalisht kompetent në gjykimin e çdo vullneti. Arsyeja është ligjvënsja e çdo akti konkret. Vetëm këtu, njeriu tregohet dinjitoz, ku bindja e tij është akt i gjykimit të vetë, kjo është liria e tij.

Nga ky argumentim, njeriu nga vullneti i lirë do të synojë një vullnet të përgjithshëm që do të jetë arritja e një kushtetute të përsosur shtetërore. Formalisht (teorikisht) kontrata sociale e Rusoit pranohet nga Kanti (Merriam, 2001, f. 21). Pra, në këtë pikë është arsyeja që kërkon t’i bashkohet apo kërkon të formojë trupin politik, falë një procesi emancipimi, nëpërmjet moralit dhe ligjit deri në krijimin e qytetarit. Shileri i influencuar nga filozofia e Kantit do të pranonte të shprehej se intelektin njerëzor ka aftësinë që kushtin fizik, gjendjen nevojshmërisë ta kthejë në një ligj moral, me dëshirën e madhe për t’ju larguar natyrës së egër që e karakterizon si njeri fizik. Kulturalisht ai vendoset midis nevojës dhe moralit, duke progresur në dije më të larta, që i fiton falë këtij dualiteti midis natyres, objektives dhe etikës (Schiller, 2004, f. 28). Me fjalë të tjera, nuk është vullneti në kontratë që krijon organizimin politik, por është arsyeja në kushtet e moralit që shkon drejt formimit të trupit politik. Kalimi i menjëhershëm nga nevoja, tek shteti është një kalim jo i plotë, sepse mënjonon njeriun në kuptimin e dinjitetit dhe moralit.

Racionaliteti dhe teknikiteti i politikës nuk është në shërbim të jetës së individit. Njeriu është më tepër se një ingranazh i natyrës. Më këtë nuk mohohet dimensionin fizik (natyror) i shtetit, por ai duhet të kalojë

edhe nën filtirin e moralit. Pushteti politik - juridik duhet të depërtojë midis këtyre dy shtysave (prirjeve). Për Shilerin kjo është ‘rruga e tretë’ (Schiller, 2004, f. 21). Shoqëria e kuptuar politikisht brenda rregullave abstrakte, apo koncepteve statike, e bën veprimin e pushtetit të distancuar nga konteksti jetësor. Pushteti, duhet të vendoset midis forcës fizike (shtysës fizike) dhe idealit të moralit. Nëse e para nuk justifikohet nga e dyta, atëherë ne nuk po flasim për pushtet të drejtë, por për një makineri që vepron vetëm për përmbushjen mirëqënies dhe sigurinë fizike të njeriut. Ndaj ‘vullneti i përgjithshëm’ i Rusoit duhet të jetë arsyeja e përgjithshme që ka arritur atë standard, fal progresionit empirik – etik (Merriam, 2001, f. 21).

Pakti shoqëror nuk ka ndodhur ndonjëherë në proceset historike, por është produkt ideal i arsyes. Konkretisht (empirikisht) ajo nuk ka ndodhur kurrë, madje është utopike. Pra, ai konstitucioni social është një arritje (ide) e arsyes, por kurrësesi një fakt historik (Merriam, 2001, f. 23). Kjo kontratë e supozuar (hipotetike) justifikon një element shumë të rëndësishëm praktik në mjedisin politik. Nëpërmjet saj legjitimohet pushteti dhe për rrjedhojë burimi i ligjit si akt i Sovranit (Kant, 2004, f. 75). Atëherë si është ky proces historik dhe si do të konkludohet me një homogjenitet racional të shoqërisë?

Pasoja e situatave jo parashikuese në shoqëri është shprehje e gjendjes antagoniste. Njeriu është një qenie sociale, ku realizon më së miri natyrën e tij dhe nga ana tjetër është një qenie individuale. Optika dhe sjellja e tij lidhet ngushtësisht me qëllimet dhe interesat personale. Tek ky konflikt shfaqet prirja për të ecur përpara, si një dialektikë midis forces dhe arsyes që gjeneron situata të reja. Konflikti si veti njerëzor është mënyra për të progresuar dhe për t’u zhvilluar intelektualisht. Në këtë kuptim, njeriu naiv kultivohet me përvoja të cilat e bëjnë më të mirë... ai kulturohet, duke i çuar më tej aftësitë apo dhunitë natyrore. Pra, ai vepron në një kontekst kulturor dhe krijon tërësinë morale të veprimeve me të tjerët (Kant, 2004, f. 10). Nga prakticiteti social, individi ngrihet në nivelin e racionalitetit, pra, kultura si shenjë e emancipimit, duke krijuar normat dhe vlerat morale. Kovencionimi i lirisë apo ‘*liria pozitive*’ si e quante I. Berlin (Berlin, 2003, f. 224) është shprehje e përfutimit të sigurisë, por pa e humbur për asnjë moment konfliktin shoqëri – individ. Arritja e kësaj lirie është produkt thelbësor i progresionit historik. Dinamika, diversiteti dhe konflikti, siç e thamë krijon rregulla ndërveprimi që vjen si rezultat i një intelektit të

përparuar. Emancipimi nëpërmjet progresit të arsyes është krijimi i qytetarit (civilizimi) që mbron veten dhe respekton integritetin e tjetrit. *“Ky ligj bazë, që mund të burojë vetëm nga vullneti i përgjithshëm i popullit quhet kontratë zanafillore”* (Kant, 2004, f. 72).

Ajo që duhet theksuar se ky proces historik nuk është një histori lineare. Pikëpamja teleologjike e Kantit për historinë kalon nga gjendja natyrore tek gjendja sociale. Veprimi mbi këtë plan është një përparim drejt një gjendje të racionalitet universal, i cili pa veprimin social nuk do bëhej e mundur (Kant, 2004, f. 6). Njeriu ka nevojë për shoqërinë (Tjetrin) dhe të përmirësojë jetën në të. Kështu, gjithë rastësia e jetës, spontaniteti i saj vendosen mbi këtë progresion të historisë së njerëzimit, që kulmon me krijimin e gjendjes tërësisht racionale derisa arrihet shoqëria kozmopolite, pra, qytetarin botëror, universal të diferencuar nga liria e egër. Ky qytetar mbart disa të drejta, që në thelb, na lënë të kuptojmë një liri të organizuar, racionale dhe këto mbeten të patjetësueshme.

Nga primitiviteti i lirisë gjatë një procesi evolutiv, njeriu arrin të konsolidojë raportet mes njëri - tjetrit. Pra, bashkohen për të mos e humbur asnjëherë atë. Në kushtet e lirisë, kupton (krijon bindjen) për ta rikonceptuar lirinë në raport me të tjerët. Racionalizmi i lirisë do të thotë se ajo jetohej brenda një konstrukti të caktuar social (moral). Për rrjedhojë, liria është njohja e kufijvë të saj. Liria e organizuar është hapësirë konflikti, ku njeriu rritet e kultivohet, duke marrë një formë (identitet) të caktuar. Ky është kriter parësor i çdo organizmi politik. Krijimi i kësaj gjendje mbështetet në tre principe kryesore; e para në lirinë e çdo anëtarit të shoqërisë si njeri, së dyti në barazinë si shtetas apo nënshetas dhe së fundi në pavarësinë e çdo anëtarit të një bashkësie, si qytetar (Kant, 2004, f. 65). Në këtë kuptim, liria qytetare është domosdoshmëri politike.

Konflikti nis nga një liri primitive, nga një raport dashakeqës për të shkuar tek një standard akoma e më i mirë i shoqërisë. Njeriu i ikën irracionaliteti natyror, duke u fokusuar tek dhuntitë e tij të mira, falë zhvillimit historik, ai i përsos ato duke arritur në kulturën e arsyes së shëndosh. Njeriu fillimisht e nis emancipimin nga gjendja praktike – empirike. Fillimisht, ai jeton kulturalisht, moralisht dhe gradualisht shkon drejt formimit (krijimit) të një shtetshpirtsh dhe racionale të ekzistencës së vetë. Arritja e këtij standardi shoqëror do të thotë shoqëri qytetare homogjene me kriter të qenit racionale. Nisja nga një kuptim

pesimist i gjendjes njerëzore dhe arritja e qëllimit është shprehje e optimizmit human. Në planin real kemi të bëjmë me shtetin konkret si produkt i kushteve historike, si një përballje e arsyes praktike me forcën. Sovraniteti, ashtu si e përshkruante Rusoi, do të gjente realizimin e tij falë një progresioni historik... si një marrëdhënie midis arsyes dhe forcës empirike (Merriam, 2001, f. 26). Ky është plani i fshehtë i natyrës. Për Kantin natyra karakterizohet nga kjo qëllimshmëri (pikëpamje teleologjike), ku merrë kuptim historia njerëzore. Arritja e kësaj shoqërie të mirë, këtij vullneti gjithëpërfshirës, stadi racional, konstrukti social qytetarësh homogjenë, nuk arrihet sot për sot. Kjo do kohën e vetë, pra, duhet një proces evolutiv historik.

### **SOVRANITETI KOZMOPOLIT DHE ARRITJA E PAQES SË PËRHERSHME**

Në gjithë larminë, ritmin dhe pakuptimësinë e jetës njerëzore, Kanti përtej shikon një qëllim. Arritja e këtij qëllimi është homogjenizimi universal i gjithë njerëzimit, si një unifikim i kulluar që vjen si pasojë e një procesi historik evolutiv. Për këtë do të na duhet një drejtues. Kështu, na duhet të rikthehemi tek argumenti i fillimit, se arritja e këtij standardi politik dhe shoqëror duhet të nis nga sovrani dhe jo nga populli. Në kuptimin kantian, Sovrani është prijësi që çon popullin e vetë drejt civilizimit si arritje e një kulture universale. Thënë me gjuhën e Shilerit; *“njeriu i kohës fisnikërohet te njeriu i idesë”* (Schiler, 2004, f. 23). Shprehur me këtë gjuhë, ‘Sovrani’ i Kantit nuk është një idhtar i pushtetit, por një ndihmës i kalimit të njeriut natyror në gjendjen e kulturës. Organizmi i brendshëm politik, duhet të evoluojë nëpërmjet reformave jo të shkëputura nga kushti praktik i shoqërive, ku kalimi nga një stad në tjetrin të mos jetë i dhunshëm, por krejt pa u ndjerë. Vetëm kështu ne mund të përshtasim të drejtën në politikëbërje, sepse e ansjellta do të ishte e rrezikshme (Kant, 2004, f. 144). Në këtë kontekst, pozita e Sovranit merr një rol parësor në përmbushjen e këtij qëllimi. Ndaj, plani natyror në zhvillimet e veta historike, udhëhiqet nga Sovrani, rregulli, institucioni dhe ligjet. Lëvizje që nis nga lart, poshtë.

Kanti nuk majftohet me një shpjegim partikularist të historisë. Ndaj plani natyror i saj synon një qëllim universal. Kushtetuta ideale nuk është e mundur vetëm brenda kufijëve politik të një shoqërie.

Normalisht nënkupton edhe marrëdhëniet midis shteteve apo kombeve. Historia ndër-kombëtare karakterizohet nga një raport konfliktuoz. Parë në nivel makro, marrëdhëniet ndërkombëtare karakterizohen nga irracionaliteti, lufta dhe dhuna. Ato janë në stad të egërisë natyrore. Shenja e barazisë midis shoqërisë qytetare me sovranitetin nuk mund të jetë e tillë nëse nuk arritet një paqe globale. Pra, të arrihet në një gjendje kozmopolite (qytetar global). Bota do të gjejë heshtje totale, duke përfunduar në një federatë të të gjithëve në një qëllim të vetëm; *‘paqen e përgjithshme’* (Kant, 2004, f. 94). Në këtë kuptim edhe shteti më i vogël do të gëzonte sigurinë, jo nga forca apo fuqia, por nga e drejta e patjetësueshme. Arritur falë standardit të emancipimit dhe racionalitetit, ku në thelb është arritja e vullnetit përgjithshëm botëor, të bashkuar dhe idealisht të unifikuar. Duke arritur tek civilizimimi i përsosur, kemi krijuar homogjenitetin ideal, qytetarin kozmopolit për të besuar tek një rregullsi universal dhe ligje të mirëpranuara nga të gjitha shtetet. Krijimi i marrëdhënieve sipas këtij rregulli universal konsolidon raportet mes shteteve. Tashmë nuk besohet më të brishtësia e ‘ekuilibrit të forcë’, siç ndodh në Evropë, trashëgura nga ‘Realpolitika’ që në kohën e Risheliesë. Për Kantin, kjo duket si foleja e zogut ‘Swift’, i cili është një arkitekt i përkryer në vendosjen e balances, kur ndërton folen e tij, por do të mjaftonte një harabel për ta shkatërruar gjithë këtë perfeksion ekuilibri (Kant, 2004, f. 97)

## BIBLIOGRAFIA

- Kant. I**, *“Themelimi i zakoneve shoqërore”*, Dritan, Tiranë 2004  
**Kant. I**, *“Ese në filozofinë historike dhe politike”*, Fan Noli, Tiranë 2004  
**Merriam. C. E**, *“History of the Theory of Sovereignty since Rousseau”*, Batoche Books, Kitchener (Ontario) 2001  
**Montesquieu**, *“Mbi frymën e ligjeve”*, Botimet “Luarasi” Tiranë 2000  
**Locke. J**, *“Traktati i dytë i qeverisjes”*, IPS&Dita 2000, Tiranë 2005  
**Ruso. Zh. Zh**, *“Kontrata sociale”*, Botimet “Luarasi”, Tiranë 2005  
**Schiller. F**, *“Mbi edukimin estetik të njeriut”*, Plejad, Tiranë 2004  
**Sinani. Gj**, *“Përmbledhje studimesh, Probleme të didaktikës në shkencat human”*, *“Metoda e përgatitjes së një komenti dhe hartimi i një komenti”*, f. 32 – 45, Flesh, Korçë 2015

# VËSHTRIM KRITIK MBI ZHVILLIMIN HISTORIK TË SË DREJTËS PENALE SHQIPTARE MBI KRIMET SEKSUALE

**DHIMITËR ZGURO**

Departamenti i së Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i  
Tiranës  
dhimiterzguro@gmail.com

**Abstrakti:** *Liria seksuale, si një pjesë e rëndësishme e lirisë individuale, është mbrojtur nga ligjvënësi shqiptar që nga koha e kodifikimit të parë të legjislacionit penal shqiptar. Megjithatë, jo gjithmonë kjo mbrojtje e ofruar nga ligjvënësi ka synuar mbrojtjen juridiko-penale të interesave të individit dhe paprekshmërisë seksuale të tij. Qëllimi i këtij punimi është të sjellë një qasje kritike mbi zhvillimin historik të së drejtës sonë penale mbi krimet seksuale. Gjithashtu, në punim trajtohet dhe nevoja për rishikimin e legjislacionit penal aktual mbi këto krime, me qëllim që ky i fundit t'i përgjigjet nevojave shoqërore dhe realitetit objektiv.*

**Fjalë kyçe:** *e drejta penale shqiptare, krimet seksuale, liria seksuale, legjislacion.*

## A CRITICAL APPROACH ON THE HISTORICAL DEVELOPMENT OF ALBANIAN CRIMINAL LAW ON SEXUAL OFFENCES

**Abstract:** *Sexual freedom, as an important part of individual freedom, has been protected by the Albanian legislation since the first codification of criminal law. However, this protection offered by the legislator has not always aimed at the legal-criminal protection of the interests of the individual and his sexual inviolability. The aim of this paper is to bring a critical approach to the historical development of Albanian criminal law on sexual offences. Also, the paper deals with the need to review the current criminal legislation on these offences, in order for the latter to respond to the social needs and objective reality.*

**Key words:** *Albanian criminal law, sexual offences, sexual freedom, legislation*

### **HYRJA**

E drejta penale në tërësinë e saj i përgjigjet nevojave të shoqërisë në një moment të caktuar dhe me ndryshimin e kushteve dhe nevojave shoqërore, ndryshon dhe mënyra sesi ligjvënësi penal rregullon

marrëdhënie të caktuara shoqërore. Ky tipar vërehet edhe në të drejtën penale shqiptare, e veçanërisht në të ato që sot njihen si krime seksuale, të cilat, në periudha të ndryshme kohore, megjithëse janë inkriminuar nga ligjvënësi, kanë mbrojtur të mira të ndryshme juridike.

Pashmangshmërisht në inkriminimin e sjelljeve të caktuara, ndikon edhe regjimi qeverisës i një shteti dhe orientimi i tij politik. E drejta penale shqiptare është shembulli më i mirë i kësaj veçorie, ku regjimi qeverisës ka pranuar ose ka refuzuar të inkriminojë veprime apo mosveprime të caktuara, duke u nisur nga fakti i vetëm nëse këto të fundit pranoheshin apo jo nga doktrina politike.

Mbi bazën e këtyre premisave, puna kërkimore u shtri në trajtimin e zhvillimit historik të traditës të së drejtës penale shqiptare përsa i takon krimeve seksuale, duke mbajtur një qasje kritike mbi zhvillimin e këtyre krimeve në legjislacionin tonë penal, përfshi dhe atë aktual. Prej një qasjeje të tillë, mund të nxirren përfundime të vlefshme me qëllim që legjislacioni aktual të ofrojë një mbrojtje më të mirë juridike për lirinë dhe paprekshmërinë seksuale të individit.

Si motiv i brendshëm për përgatitjen e këtij punimi ka shërbyer dëshira për të thelluar kërkimin në fushën e zhvillimit historik të së drejtës penale dhe vetë ndjeshmëria e temës së krimeve seksuale. Këto të fundit kur raportohen, për faktin se liria seksuale, si pjesë e lirisë individuale, është e shenjtë, shpesh ngjallin reagime emotive në shoqëri, të cilat shpesh çenojnë atë që kërkohet nga këto reagime: dhënien e drejtësisë.

Shpresoj që ky punim të shërbejë sado pak në njohjen e rregullimit që e drejta penale shqiptare, në historikun e zhvillimit të saj i ka bërë krimeve që çenojnë lirinë seksuale dhe pse jo, vlerësimet e këtij punimi të shërbejnë si një shtysë për nxitjen e debatit për një reformë ligjore të mirëfilltë në Kodin tonë Penal në lidhje me krimet seksuale.

## **1. KRIMET SEKSUALE SIPAS TË DREJTËS PENALE TË VITEVE 1928 – 1944**

E drejta penale shqiptare për herë të parë u kodifikua përmes miratimit të Kodit të parë Penal, të miratuar përmes dekretit të datës 3 qershor 1927 që hyri në fuqi më 1 janar 1928 (Republika e Shqipërisë, Ministria e P. të Mbrndshme, 1298), duke zëvendësuar kështu Kodin Penal otoman të vitit 1858 (viti 1274 sipas kalendarit otoman), si edhe



të gjitha shtojcat e mëvonshme dhe ligjet e posaçme të nxjerra nga shteti shqiptar (Elezi, I., Elezi, E., 2010).

Megjithëse është miratuar në vitin 1927, Kodi i parë Penal shqiptar merr në mbrojtje juridiko-penale nga krimet seksuale disa kategori shoqërore, gama e të cilave, siç do të shihet në vijim, është edhe më e gjerë se Kodet Penale të miratuara gjatë kohës së sundimit të së drejtës socialiste.

Ato që ligjvënësi sot i konsideron si krime seksuale, në Kodin Penal të Mbretërisë ishin të strukturuar nën titullin “delikte kundra zakonisht të mirë dhe rregullit familjar” (Mbretëria Shqiptare, Ministria e Drejtësisë, 1929). Këto delikte parashikohen në Titullin e VIII të Librit të Dytë të Kodit Penal të Mbretërisë dhe janë të strukturuar në 8 kapitula dhe përbëhen nga 39 norma juridiko-penale.

Nisur nga emërtimi që ligjvënësi i ka bërë këtij Titulli, është e qartë se objekti i mbrojtjes juridike do të ishte zakoni i mirë dhe rregullit familjar, duke e lënë në plan të dytë mbrojtjen e paprekshmërisë seksuale të individit.

Në Kapitullin I të Titullit VIII të Librit të Dytë, ligjvënësi nën emërtimin “turpshmëri me violencë, demoralizimi fizik i të vegjëlve, goditja e cipës publike (outrage à la pudeur)” ka parashikuar 13 vepra penale që lidhen me krimet seksuale (Mbretëria Shqiptare, Ministria e Drejtësisë, 1929). Megjithëse, ligjvënësi përdor termin turpshmëri përgjatë gjithë Titullit, nga interpretimi sistematik i këtij Titulli rezulton se ky term përdoret për t’u referuar marrëdhënieve seksuale. Të njëjtin qëndrim kanë mbajtur edhe studiuesit e së drejtës (Katro D., 2016).

Është për t’u vlerësuar fakti që ky Kod merr në mbrojtje subjektin pasiv, pavarësisht gjinisë së tij, duke iu ofruar një mbrojtje të njëjtë të gjithë subjekteve që çënohen nga veprimet e kundërligjshme. Kështu, referuar nenit 364 të këtij Kodi (Mbretëria Shqiptare, Ministria e Drejtësisë, 1929), kushdo që kryen marrëdhënie seksuale me një person femër ose mashkull, përmes shtrëngimit të dhunës ose frikësimit dënohet me burgim të rëndë nga tre deri në dhjetë vjet, në rast se nuk ekziston asnjë rrethanë tjetër cilësuese.

Në kuadër të risive që Kodi Penal solli në të drejtën shqiptare vlen të përmendet inkriminimi i veprave të luksurit (luxuria, lat.), të cilat ligjvënësi aktual shqiptar i ka titulluar si “vepra të turpshme”. Nga ana objektive vepra penale kryhej përmes veprimeve të luksurit, të cilat janë veprime që synojnë kënaqjen e epshit seksual duke demoralizuar

një person nën 16 vjeç (Mbretëria Shqiptare, Ministrija e Drejtësisë, 1929).

Një nga elementët që tregojnë sesa modern ka qenë në parashikimet e tij Kodi Penal në kohën e hartimit të tij është dhe inkriminimi i ngacmimit seksual për herë të parë në nenin 375 të këtij Kodi, sipas të cilit, në pikëpamje të anës objektive, kjo veprë penale kryhej përmes ngacmimit të femrave ose djemve përmes fjalëve ose veprave të ndryshme dhe dënohej me burgim deri në një muaj (Mbretëria Shqiptare, Ministrija e Drejtësisë, 1929).

Në kuadër të konsideratave përsa i takon parashikimit të krimeve seksuale në Kodin Penal të Mbretërisë, vlen të përmendet edhe fakti që, nisur nga rëndësia e madhe e të mirës juridike të mbrojtur në Titullin VIII të Librit të Dytë të Kodit Penal, ligjvënësi ka inkriminuar në një kaptinë të veçantë brenda këtij titulli edhe shtytjen në turpënim ose në luksur, ku për efekt të marrjes në përgjegjësi penale, në pikëpamje të anës subjektive, kërkohet qëllimi i posaçëm, i kënaqjes së epshtit seksual të një personi të tretë (Mbretëria Shqiptare, Ministrija e Drejtësisë, 1929).

Gjithashtu, Kodi Penal i Mbretërisë përmban ndër të tjera, edhe norma të cilat për botëkuptimin e sotëm duken arkaike apo norma të tilla që çënojnë parimin e barazisë para ligjit, parim ky i sanksionuar dhe në Statutin Themeltar të Mbretërisë.

Kështu, veprat penale të parashikuara në Kapitullin II të Titullit VIII nën emërtimin “turpnime të kundra natyrëshme” (Mbretëria Shqiptare, Ministrija e Drejtësisë, 1929) paraqesin problematikë në drejtimin e këtij parimi. Ligjvënësi i kohës me veprat penale të “turpnimit të kundra natyrëshme” i referohej marrëdhënieve seksuale mes personave me gjini të njëjtë, të cilat në ndryshim nga sot, ishin të inkriminuara në çdo rrethanë. Ajo që paraqet problematikë në këtë drejtim, lidhet me inkriminimin e subjektit pasiv të këtij delikti, të parashikuar në nenin 377 të këtij Kodi, sipas të cilit, dënohet edhe ai që turpënohet, pavarësisht faktit nëse ky i fundit kishte shprehur apo jo pëlqimin për kryerjen e aktit seksual.

Një tjetër aspekt ku vërehet mos respektimi i parimit të barazimit para ligjit lidhet edhe me mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale ndaj veprave penale të turpënit. Kështu, në referim të nenit 369 të këtij Kodi, në rast se subjekti pasiv është një femër, atëherë ndjekja penale bëhet vetëm mbi bazën e kërkesës së viktimës ose personit që ka të

drejtë të bëjë padi civile, ndërsa në rastin kur subjekti pasiv është një mashkull, ndjekja penale bëhej kryesisht.

Pavarësisht pushtimit të Shqipërisë, Kodi Penal i Mbretërisë u la formalisht në fuqi dhe krahas tij, me qëllim mbrojtjen e interesave të pushtuesve dhe bashkëpunëtorëve të tyre, u miratuan dhe ligje penale të posaçme, të cilat parashikon kryesisht vepra penale kundër autoritetit të pushtuesit (Elezi, I., Elezi, E., 2010), ndërsa veprat e tjera penale mbetën të pandryshuara.

## **2. KRIMET SEKSUALE SIPAS TË DREJTËS PENALE SOCIALISTE**

Me ardhjen në pushtet të komunistëve, këta të fundit, me qëllim rregullimin e problemit të fuqisë juridike të dispozitave të miratuara gjatë pushtimit do të miratonin Ligjin Nr. 61, datë 17 maj 1945, sipas të cilit abrogoheshin të gjitha dipsozitat e miratuara nga pushtuesit, ndërsa normat e miratuara para pushtimit do të ishin të vlefshme, vetëm kur nuk vinin në kundërshtim me frymën dhe vendimet e Këshillit Antifashit-Nacional-Çlirimtar (Nathanaili A., 1948).

Dispozitat penale e pjesës së posaçme të Kodit Penal të Mbretërisë, përfshi këtu edhe dispozitat mbi “deliktet kundër zakonit të mirë dhe rregullit familjar” do të shfuqizoheshin plotësisht me miratimin e Kodit Penal të vitit 1952, i cili udhëhiqej nga parimet e përgjithshme të së drejtës penale sovjetike (Klosi B., 1952) dhe do të bazohej në Kodin Penal të Bashkimit Sovjetik të vitit 1926 (Nathanaili A., 1952). Ndërsa pas prishjes së marrëdhënieve diplomatike me Bashkimin Sovjetik, e drejta penale shqiptare u bë autonome dhe fitoi origjinalitet (Myftiu M., 1977), origjinalitet që u materializua në Kodin Penal të vitit 1977.

Në ndryshim nga e drejta penale shqiptare e para luftës, e drejta penale socialiste i ka parashikuar krimet seksuale në Kapitullin e “Krimeve kundër personit” (Ministria e Drejtësisë e R.P.SH, 1952), duke i dhënë kështu përparësi mbrojtjes juridiko-penale të individit dhe veçanërisht, lirisë e paprekshmërisë seksuale të këtij të fundit.

Është për t’u vlerësuar fakti që Kodi Penal i vitit 1952 në të katërta dispozitat e parashikuara në seksionin e krimeve seksuale, merr në mbrojtje juridiko-penale si subjektin pasiv mashkull, ashtu edhe atë femër. Në këtë përfundim, arrihet nga interpretimi literal i dispozitave që flasin për viktimë të krimeve seksuale apo për persona që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale (Ministria e Drejtësisë e R.P.SH, 1952).

Krahas veprave penale që lidhen me marrëdhëniet seksuale të kryera me dhunë, me kanosje, duke përfitur nga pazotësia e viktimës për t'u mbrojtur apo mes personave që janë në gjini, Kodi Penal i vitit 1952 vazhdon të ruajë parashikimin si vepër penale të “veprave të turpshme”, duke përcaktuar se kjo vepër, në pikëpamje të anës objektive mund të kryhet vetëm përmes “korruptimit me anë të veprave të turpshme të personave që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale” (Ministria e Drejtësisë e R.P.SH, 1952).

Mangësi e këtij Kodi në drejtim të parashikimeve ligjore që lidhen me krimet seksuale, është fakti që ligjvënësi nuk ka përcaktuar një moshë minimale të personit, kur ky i fundit arrin pjekurinë seksuale dhe për rrjedhojë, të jetë i aftë të shprehë një pëlqim të vullnetshëm për kryerjen e aktit seksual. Kjo mangësi është plotësuar me hyrjen në fuqi të Kodit Penal të vitit 1977, ku sipas neneve nga 97 deri në 100, përcaktohet si moshë minimale për arritjen e pjekurisë seksuale moshë 14 vjeçare (Këshilli i Ministrave, 1982). Megjithëse përcaktoi moshën minimale, ligjvënësi e ka lënë në dorën e autoriteteve gjyqësore që të çmojnë faktin nëse viktima e ka arritur apo jo pjekurinë seksuale (Këshilli i Ministrave, 1982).

Megjithëse Kodi Penal i vitit 1977 është plotësuar në drejtim të përcaktimit të një moshe minimale, vërehet regres në drejtim të normimit të krimeve seksuale, i cili lidhet me karakterin regresiv në tërësi të Kodit Penal të këtij viti (Likmeta E., 2014).

Kështu, ky karakter regresiv vërehet veçanërisht në faktin se në mbrojtje juridiko-penale do të merreshin vetëm vajzat duke sanksionuar se nga pikëpamja e anës objektive, këto krime kryhen përmes kryerjes me dhunë të marrëdhënieve seksuale me dhunë, duke përfitur nga pazotësia për të mbrojtur e të dëmtuarës apo me vajza që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale (Këshilli i Ministrave, 1982).

Ideologjizimi dhe politizimi i tejkajshëm që i është bërë legjislacionit penal përgjatë kësaj kohe (Elezi I., Elezi E., 2010), solli cungimin e veprave penale që lidhen me mbrojtjen e integritetit dhe lirisë seksuale. Katro (Katro D., 2016) në disertacionin e saj, vë theksin mbi karakterin e cunguar të së drejtës penale socialiste në drejtim të parashikimit të krimeve seksuale duke nënvizuar faktin se, “shumë vepra penale në sferën seksuale nuk ishin të parashikuara pasi nuk ishin të pranuar si koncepte nga sistemi politik. Terminologjia

juridike ishte e varfër dhe në të njëtin nen gjenin parashikim situata të ndryshme juridike.”

Njësoj si Kodi Penal i Mbretërisë, edhe Kodet Penale të miratuara përgjatë regjimit diktatorial do të inkriminonin homoseksualizmin në dispozitën e emërtuar “pederastia” (Këshilli i Ministrave, 1982) dhe po njësoj si Kodi Penal i vitit 1928, objekt i kësaj vepre nuk ishte paprekshmëria seksuale e individit, por morali shoqëror.

Megjithëse në vitin 1988, Kodi Penal pësoi disa ndryshime me rëndësi (Elezi, I., Elezi, E., 2010), sërish kuptimi i ligjvënësit mbi krimet seksuale mbeti i pandryshuar dhe për rrjedhojë, një mbrojtje juridike efektive për viktimat e këtyre krimeve nuk u ofrua kurrë.

### **3. MBROJTJA JURIDIKO-PENALE E LIRISË SEKSUALE SIPAS KODIT PENAL TË VITIT 1995**

Miratimi i Ligjit Nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, i cili luajti rolin e një ligji kushtetues dhe do të shërbente si Kushtetutë deri në miratimin e kësaj të fundit përmes Ligjit Nr. 8417, datë 21.10.1998 dhe referendumit të mbajtur më datë 22.11.1998, kërkonte ndryshimin e bazës ligjore në fuqi që binte në kundërshtim me parimet e një shteti të së drejtës dhe demokratik.

Në kuadër të kësaj nevoje, u miratua edhe Ligji Nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i cili shfuqizoi Ligjin Nr. 5591, datë 15.6.1977 “Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar”.

Në pjesën e posaçme të këtij Kodi dhe më konkretisht në Seksionin VI të Kreut II të kësaj Pjese të titulluar “Veprat penale kundër personit” (Qendra e Publikimeve Zyrtare, 1995), ligjvënësi shqiptar ka parashikuar krimet seksuale, të cilat, doktrina bashkëkohore e të drejtës penale, i ka përkufizuar si veprime të kryera me dashje, që çenojnë lirinë seksuale dhe shëndetin e femrës a të mashkullit, dhe që mbrohen posaçërisht posaçërisht nga legjislatiioni penal nga veprimet kriminale (Elezi I., 2018).

Në mungesë të një norme shpjeguese në Kodin Penal mbi përkufizimin e lirisë seksuale, detyra për të dhënë një përkufizim të këtij nocioni i ka takuar doktrinës dhe jurisprudencës. Kjo e fundit, në qëndrimin e saj konstant, dhe në pamundësi për të cituar gjithë praktikën gjyqësore, më konkretisht në Vendimin Nr. 1178, datë 07.05.2019, të Gjykatës së

Rrethit Gjyqësor Tiranë ka përcaktuar se liria seksuale duhet kuptuar si: “e drejta ekskluzive e çdo personi për të disponuar lirinë e tij seksuale, për të pretenduar që ajo të respektohet nga të tretët si dhe si paprekshmëri e kësaj sfere kaq delikate”.

Në tërësi, Kodin e ri Penal janë vërejtur dy tendenca kryesore (Elezi I., Elezi E., 2010): ajo e inkriminimit të veprave të reja penale për të luftuar format e reja të kriminalitetit, të cilat nuk ishin pranuar nga e drejta penale socialiste, si edhe tendenca e dekriminalizimit të veprave penale politike apo atyre që nuk paraqesin rëndësi të tillë, që të mund të inkriminohen. Kjo tendencë ka prekur dhe seksionin e krimeve seksuale. Kështu, ligjvënësi në Kodin Penal të vitit 1995, ka zgjeruar sferën e mbrojtjes juridiko-penale ndaj lirisë dhe integritetit seksual duke parashikuar fillimisht 9 vepra penale (Qendra e Publikimeve Zyrtare, 1995).

Megjithëse dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, si edhe barazia para ligjit ishin baza e shtetit të ri demokratik, Kodi i ri Penal i vitit 1995 nuk do ta siguronte në mënyrë të plotë barazinë para ligjit midis shtetasve, e cila në vetvete, sikurse është shprehur dhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta (Vendimi Nr. 4, datë 12.2.2010, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë).

Kështu, në Seksionin VI të Kreut II të Pjesës së Posaçme të këtij Kodi, ligjvënësi do të trajtonte krimet seksuale dhe nga interpretimi i normave penale të gjendura në këtë Seksion del qartë se subjekt pasiv, pra viktimë e veprave penale që lidhen me cënimin e integritetit dhe lirisë seksuale mund të ishin vetëm femrat, duke lenë jashtë mbrojtjes juridiko-penale viktimën mashkull. Ky i fundit merrej në mbrojtje juridiko-penale vetëm nga neni 116 i Kodit Penal i titulluar “homoseksualizmi” (Qendra e Publikimeve Zyrtare, 1995), që përcakton se marrëdhëniet homoseksuale, kur kryhen me dhunë, me persona të mitur ose me persona të pazotë për t’u mbrojtur, janë të dënueshme. Nga interpretimi i kësaj dispozite, rezulton qartazi se viktima mashkull do të merrej në mbrojtje, vetëm atëhere kur autori i veprës penale do të ishte një person i gjinisë së njëjtë. Ndërkohë që kryerja e aktit seksual mes personave me gjini të njëjtë, me pëlqimin e lirë të tyre dhe kur të dy personat kishin arritur moshën e kërkuar nga ligji, u dekriminalizua me hyrjen në fuqi të këtij Kodi.

Megjithëse si në rastin e veprës penale “marrëdhënie seksuale me të mitura” parashikuar nga neni 100 i Kodit Penal të vitit 1995, ashtu dhe në rastin e veprës penale “homoseksualizmi” të parashikuar nga neni 116 i Kodit Penal të vitit 1995, viktima është një person i mitur, të cilit i është cënuar liria seksuale, marzhi i dënimit për autorin e këtyre veprave penale është i ndryshëm. Kështu, për veprën penale të “marrëdhënies seksuale me të mitura”, të parashikuar nga neni 100, dënimi është i përcaktuar në minimum me burgim prej pesë vitesh dhe në maksimum me burgim prej pesëmbëdhjetë vitesh (Qendra e Publikimeve Zyrtare, 1995), kurse për veprën penale të “homoseksualizmit”, të parashikuar nga neni 116, dënimi është i përcaktuar në maksimum me burgim gjer në pesë vjet (Qendra e Publikimeve Zyrtare, 1995).

Një tjetër aspekt ku vihet re mungesa e respektimit të parimit të barazisë para ligjit përsa i takon rregullimit të krimeve seksuale në Kodin Penal të vitit 1995 është dhe fakti që megjithëse në thelb, marrëdhëniet homoseksuale me të mitur çenojnë lirinë dhe integritetin seksual të të miturit, këto të fundit në këtë Kod janë parashikuar në Seksionin VIII të titulluar “vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit”, duke i dhënë përparësi mbrojtjes së moralit shoqëror dhe jo mbrojtjes së individit.

Me miratimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përmes Ligjit Nr. 8417, datë 21.10.1998 dhe referendimit të mbajtur më datë 22.11.1998, lindi nevoja për ndryshime të Kodit Penal duke reflektuar në këto të fundit frymën që mbizotëronte në Kushtetutë. Për rrjedhojë, me ndryshimet e herëpashershme të bëra në Kodin Penal, mbrojtja juridiko-penale e lirisë seksuale është zgjeruar edhe më tej, duke bërë që aktualisht në këtë sferë të parashikohen 12 vepra penale.

Reforma e parë ligjore në kuadër të parashikimit të veprave që çenojnë integritetin seksual është bërë përmes Ligjit Nr. 8733, datë 24.1.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”. Përmes këtij ligji u shtua një vepër tjetër penale në kuadër të krimeve seksuale, ndërsa 9 veprat e tjera penale u amenduan duke inkriminuar brenda këtyre figurave të veprave penale sjellje të tjera që paraqesin rrezikshmëri shoqërore (Qendra e Publikimeve Zyrtare, 2001).

Shfuqizimi i figurës së posaçme të veprës penale “homoseksualizmi” (Qendra e Publikimeve Zyrtare, 2001), bëri që brenda figurave të

përgjithshme të veprave penale të parashikuara në seksionin e krimeve seksuale të përfshiheshin shprehimisht dhe sjelljet e kundërligjshme të kryera me faj që deri asokohe parashikoheshin në nenin 116 të Kodit Penal.

Pra vepra penale “marrëdhënia seksuale me të mitura” e parashikuar nga neni 100 i Kodit Penal të vitit 1995, me reformën ligjore të vitit 2001 do të zgjerohej në pikëpamje të anës objektive, duke marrë në mbrojtje juridiko-penale edhe viktimën mashkull të mitur nga marrëdhëniet seksuale, qoftë ato kur subjekti aktiv është një person i gjinisë së njëjtë, qoftë kur është një person i gjinisë së kundërt. Të njëjtat ndryshime do të bëheshin pothuajse për të gjitha veprat e këtij seksioni të Kodit Penal, duke zgjeruar sferën e marrëdhënieve që do të merreshin në mbrojtje juridiko-penale, si edhe rrethin e subjekteve që do të përfitonin nga kjo mbrojtje.

Ndryshimet e rradhës që do të pësonte Kodi Penal në seksionin e krimeve seksuale do të kryheshin në vitin 2012, ku përmes Ligjit Nr. 23/2012 u rrit në minimum dhe në maksimum marzhi i dënimit për veprën penale të “marrëdhënieve homoseksuale me dhune me të rritur”, të parashikuar nga neni 102/a i Kodit Penal dhe për veprën penale “vepra të turpshme”, të parashikuar nga neni 108 i Kodit Penal (Qendra e Publikimeve Zyrtare, 2012).

Ndryshimet e bëra përmes Ligjit Nr. 144/2013 kishin për synim mbrojtjen më të mirë të disa kategorive sociale. Kështu, u kriminalizua kryerja e marrëdhënies seksuale me forcë mes bashkëshortëve ose bashkëjetuesve dhe u bë dallimi mes dhunës seksuale, marrëdhënieve seksuale, veprave të turpshme dhe ngacimit seksual (Hysi V., 2014).

Inkriminimi i marrëdhënieve seksuale mes bashkëshortëve ose bashkëjetuesve, kur kjo marrëdhënie kryhet pa pëlqimin e njërit prej tyre erdhi si një përgjigje ndaj kërkesave të Konventës Europiane “Për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr. 104/2012.

Me reformën ligjore të bërë në vitin 2013, Kodit Penal iu shtua dhe një vepër tjetër penale, ajo e “ngacimit seksual” e parashikuar nga neni 108/a i Kodit Penal aktual (Qendra e Botimeve Zyrtare, 2013), vepër e cila në historikun e kodifikimit të së drejtës penale shqiptare kishte ekzistuar vetëm në Kodin Penal të Mbretërisë Shqiptare.

Nga viti 2013 kur janë bërë ndryshimet e fundit përta i takon seksionit të krimeve seksuale, Kodi Penal është amenduar të paktën dhjetë here



deri më sot, dhe në asnjë rast ky seksion nuk ka pësuar më ndryshime, megjithëse ka patur mendime dhe sugjerime të shumta për të bërë ndryshime dhe amendime të tjera (Hysi V., 2014).

#### **4. NEVOJA E RISHIKIMIT TË LEGJISLACIONIT PENAL SHQIPTAR MBI KRIMET SEKSUALE**

Reformat ligjore të bëra deri më tani në seksionin e krimeve seksuale janë të pamjaftueshme për t'iu përgjigjur nevojave dinamike të shoqërisë shqiptare dhe veçanërisht, kur të paktën në pesë vitet e fundit janë regjistruar mesatarisht 123,6 procedime penale në vit për krime seksuale (INSTAT, 2021) dhe janë marrë mesatarisht 89,4 të pandehur për vit, nën akuzën e krimeve seksuale (INSTAT, 2021). Megjithatë besohet se këto shifra janë shumë herë më të larta (Picari M., 2021).

Një nga aspektet e Kodit Penal që nevojitet të rishikohet lidhet me faktin se nga ana e teknikës legjislative, termat e përdorura në ndërtimin e normave penale të ndodhura në seksionin e krimeve seksuale janë të vagët, duke lënë vend për interpretime subjektive të termave si: “dhuna seksuale”, “ngacmimi seksual” apo “veprime të turpshme”.

Problemit të kuptueshmërisë së shprehjeve dhe termave të përdorura në kapitullin e veprave penale kundër integritetit seksual, Kodi Penal i Kosovës i ka dhënë përmes parashikimit si dispozitë hyrëse të kapitullit një normë shpjeguese, e cila jep përkufizime mbi terma si: pëlqimi, akti seksual, prekja, pjesa intime etj. Arsyetimi i ligjvënësit kosovar mbi ekzistencën e një norme të tillë shpjeguese lidhet me nevojën për zbatimin e drejtë të normave juridiko-penale që mbrojnë integritetin seksual përmes kuptimit të drejtë të shprehjeve të përdorura në këto norma (Salihu I., et al., 2014). Një zgjidhje e tillë, në këndvështrimin tonë, është e nevojshme të aplikohet edhe në legjislacionin penal shqiptar, me qëllim eliminimin e mundësisë për zbatimin e gabuar të normave penale që mbrojnë lirinë seksuale.

Është e udhës që ligjvënësi shqiptar të zhbëjë edhe ndryshimet e bëra përmes Ligjit Nr. 8733. datë 24.1.2001, të cilat konsistojnë në emërtimin e veprave penale dhe figurat e veprave penale të parashikuara nga neni 100 deri në nenin 107 të Kodit Penal. Me reformën ligjore të Kodit Penal në vitin 2001, në emërtimin e veprave penale u shtua togfjalëshi “ose homoseksuale”, ndërsa në figurat konkrete të veprave penale, pas togfjalëshit “kryerja e marrëdhënieve

seksuale” u shtua togfjalëshi “ose homoseksuale”. Gjithashtu, kjo reformë ligjore parashikoi një dispozitë të veçantë, përmes të cilës synohej inkriminimi i marrëdhënieve homoseksuale me dhunë me të rritur.

Ndryshimet e bëra në emërtimin e veprave penale apo në figurat konkrete të veprave penale që parashikohen në krimet seksuale, aktualisht, kanë humbur kuptimin e tyre duke u bërë të panevojshme. Kështu, termi “marrëdhënie seksuale” është një term që nënkupton kryerjen e aktit seksual, i cili karakterizohet nga një kontakt fizik sado të vogël i një pjese të çfarëdoshme të trupit (Vendimi Nr. 1178, datë 07.05.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë) ose të një objekti për qëllime seksuale (Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës, 2019) të njërit prej partnerëve me një zonë gjenitale të partnerit tjetër, pavarësisht nëse kryhet midis dy personave të gjinisë së kundërt apo dy personave të gjinisë së njëjtë. Për rrjedhojë, duke mbajtur dhe në konsideratë se “homoseksualizmi” është një orientim seksual dhe duke mbajtur në konsideratë përkufizimin e këtij të fundit (Hyde J., et al., 2018) është e qartë se përdorimi i togfjalëshit “marrëdhënie homoseksuale” nga ana e ligjvënësit është jo vetëm i pakuptimtë, por edhe nuk i përgjigjet realitetit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 2014; 2017) në rekomandimet për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, e cilëson përdorimin e termit “marrëdhënie homoseksuale” në seksionin e krimeve seksuale si të papërshtatshëm dhe që mbart konotacion negativ dhe paragjykes. Në të tilla kushte, por edhe kur marrëdhënia juridike dhe vlerat shoqërore që kërkohen të mbrohen nga ligji penal nëpërmjet parashikimeve të bëra në seksionin e krimeve seksuale, siç është liria dhe paprekshmëria seksuale, arrin të garantohet më së miri edhe pa përdorur togfjalëshin “marrëdhënie homoseksuale”, ky i fundit nevojitet që të shfuqizohet.

Kodi Penal duhet njëherazi të zgjerohet edhe gamën e subjekteve që merren në mbrojtje nga veprimet e kundërligjshme që çenojnë lirinë seksuale, si edhe sferën e mbrojtjes-juridiko penale përmes inkriminimit të veprimeve të tjera që paraqesin rrezikshmëri shoqërore. Nga interpretimi i nenit 102 të Kodit Penal (Qendra e Botimeve Zyrtare, 2021), rezulton se kur marrëdhëniet seksuale kryhen mes

madhorëve dhe me dhunë, subjekti i vetëm pasiv që merret në mbrojtje nga kjo sjellje kriminale është femra. Sipas Vendimit Nr. 937, datë 04.11.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ligjvënësi në këtë dipozitë, “ka parashikuar mbrojtje të posaçme juridike të marrëdhënies të vendosura në bazë të ligjit për të siguruar mbrojtjen e lirisë seksuale të femrës”, duke përjashtuar në mënyrë diskriminuese nga mbrojtja juridiko-penale, lirinë seksuale të mashkullit madhor, kur subjekti aktiv është një femër. Çdo përfundim i kundërt që do të pranonte dhe mashkullin madhor si subjekt pasiv, kur kjo veprë penale kryhet nga një subjekt aktiv femër do të përbënte zbatim të ligjit penal me analogji, gjë që vjen ndesh me parimet e Kodit Penal dhe që do të cënonte jo vetëm shtetin e së drejtës, por edhe sigurinë e individit për liri personale. (Vendimi Nr. 44, datë 10.02.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).

Megjithëse në vitet e fundit është vënë re një tendencë në rritje e kryerjeve të marrëdhënies seksuale përmes kanosjes me zbulimin e një fakti që do të dëmtonte rëndë nderin ose reputacionin e viktimës ose një personi të lidhur me të, ligjvënësi nuk ka marrë asnjë masë për të inkriminuar një veprim të tillë apo për të parashikuar këto veprime si rrethana cilësuese.

Për rrjedhojë, megjithëse kryerja e marrëdhënies seksuale duke e kanosur subjektin pasiv në mënyrën e sipërtreguar paraqet rrezikshmëri më të madhe shoqërore, autori i veprës penale do të dënohet brenda të njëjtit marzh dënimi që parashikon figura e veprave penale të seksionit të krimeve seksuale, nëse asnjë rrethanë cilësuese nuk verifikohet në rastin konkret. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në çështjen Prokuroria pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë kundër A.D., K.P., F.B. dhe R.O., ku megjithëse u vërtetua se marrëdhëniet seksuale me të miturën janë kryer përmes kanosjes së kësaj të fundit me zbulimin e fakteve që do të cënonin nderin dhe reputacionin e saj, të pandehurit u dënuan vetëm për veprën penale të marrëdhënies seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14 – 18 vjeç” të parashikuar nga neni 101 i Kodit Penal (Vendimi Nr. 31, datë 13.01.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë).

Me qëllim dhënien e drejtësisë dhe respektimin e parimeve të legjislacionit tonë penal material dhe atij procedural, si edhe me respektimin e të drejtave të njeriut dhe veçanërisht, të drejtave të

viktimës, është e nevojshme që legjislacioni penal në pjesën që lidhet me krimet seksuale të ndryshohet duke mbajtur në konsideratë nevojat e shoqërisë dhe në përputhje me aktet ndërkombëtare të së drejtës, dhe veçanërisht me Konventën e Lanzaretos dhe Direktivën 2011/93/EU të Parlamentit Europian dhe të Këshillit.

## **5. PËRFUNDIMET**

Kodifikimi i parë që iu bë legjislacionit penal shqiptar zëvendësoi të drejtën penale otomane si dhe ligjet e posaçme penale që ishin burimi kryesor i së drejtës penale në Shqipëri deri më hyrjen në fuqi të Kodit Penal të Mbretërisë.

Në ndryshim nga ligjvënësi penal socialist dhe ai bashkëkohor, ligjvënësi gjatë periudhë së Mbretërisë i kushtonte rëndësi të dorës së parë, mbrojtjes të zakoneve të mira dhe rregullit familjar duke lënë pas dorë individin dhe të drejtën e tij për të disponuar mbi lirinë e tij seksuale. Megjithë problemet në drejtim të respektimit të parimit të barazisë para ligjit, është interesant fakti që në Kodin e parë Penal shqiptar, në Titullin e VIII, ndër të tjera janë inkriminuar edhe vepra penale si: ngacmimi seksual apo shtytja në turpënim ose në luksur.

Në krahasim me të drejtën penale që u aplikua në Shqipërinë e para luftës, e drejta penale socialiste, e cila bazohej në ideologjinë marksiste-leniniste, megjithëse vendosi theksin tek mbrojtja që duhet t'i ofrohej individit nga këto krime, ishte mjaft e cunguar dhe rrethi i subjekteve që do të përfitonin nga mbrojtja juridiko-penale do të ngustoheshin. Kështu, Kodi Penal i vitit 1977 do të ishte aq regresiv në këtë drejtim, saqë do të merrte në mbrojtje juridike viktimën, vetëm në ato raste kur kjo e fundit ishte femër.

Vetëm pas përmbyesjes së regjimit komunist dhe miratimit të Kodit të ri Penal, gama e subjekteve që do të merreshin në mbrojtje nga normat penale do të mund të zgjerohej. Duke mbajtur parasysh se Kodi i ri Penal u miratua para miratimit të Kushtetutës aktuale, lindi nevoja që pas miratimit të kësaj të fundit të bëheshin amendime në Kodin Penal, ndryshime të cilat synonin të ofronin një mbrojtje më të mirë për viktimat e krimeve seksuale.

Megjithë ndryshimet e herëpashershme të kryera në Kodin Penal, ligjvënësi nuk iu është përgjigjur nevojave të shoqërisë në mënyrën më të mirë të mundshme. Përsa më sipër, vlerësohen si të nevojshme

ndërhyrje legislative, të cilat duhet të bëhen në përputhje me aktet ndërkombëtare të së drejtës, dhe që duhet të synojnë në:

- parashikimin në hyrje të seksionit të “krimeve seksuale” të një norme shpjeguese të termave të përdorura në të, me qëllim zbatimin në mënyrë të drejtë të normave juridiko-penale duke shmangur problemet që lidhen me kuptueshmërinë e termave;
- ndryshimin e titujve dhe të përmbajtjes së dispozitave me qëllim shmangien e përdorimit të termave që përmbajnë një konotacion negativ dhe paragjykes;
- parashikimin në përmbajtjen e veprave penale ekzistuese në seksionin e “krimeve seksuale” të rrethanave cilësuese si: kryerja e veprës përmes kanosjes me zbulimin e një fakti që mund të dëmtojë rëndë nderin apo reputacionin e viktimës ose një personi të lidhur ngushtë me të etj.;
- zgjerimin e gamës së subjekteve që merren në mbrojtje nga veprimet e kundërligjshme të kryera me faj që çenojnë integritetin seksual etj.

## **BIBLIOGRAFIA**

Fletore Zyrtare

1. Republika e Shqipërisë, Ministria e P. të Mbrndshsme (1928). Fletorja Zyrtare Nr. 1. Tiranë, f. 1.
2. Qendra e Publikimeve Zyrtare (1995). Fletorja Zyrtare Nr. 2. Tiranë, f. 95-96.
3. Qendra e Publikimeve Zyrtare (2001). Fletorja Zyrtare Nr. 4. Tiranë, f. 103-106.
4. Qendra e Publikimeve Zyrtare (2012). Fletorja Zyrtare Nr. 26. Tiranë, f. 1301.
5. Qendra e Botimeve Zyrtare (2013). Fletorja Zyrtare Nr. 83. Tiranë, f. 3530.
6. Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës (2019). Gazeta Zyrtare Nr. 2. Prishtinë, f. 87.

Doktrinë:

1. Ismet Elezi, Ela Elezi. (2010). Historia e së drejtës penale. SHBLU, Tiranë, f. 120, 140-141, 201, ISBN 978992705
2. Ismet Elezi. (2018). E drejta penale - pjesa e posaçme. Botimet Kumi. Tiranë, f. 105, ISBN 978-9928-247-21-6.
3. Ismet Salihu, Hilmi Zhitija, Fejzullah Hasani. (2014). Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Botimi i I-rë. Prishtinë, f. 607-608.
4. Janet Hyde, John De Lamater, Sandra Byers. (2018). Understanding human sexuality. McGraw-Hill Education. 2018. Canada, f. 396, ISBN 0078035392.

#### Akte ligjore:

1. Mbretnija Shqiptare, Ministrija e Drejtësisë (1929). Kodi Penal Shqiptar. Shtypshkronja Drita. Tiranë, f. 181-197.
2. Ministria e Drejtësisë e R.P.SH (1952). Kodi Penal i R. P. të Shqipërisë. Tiranë, f. 85-86.
3. Këshilli i Ministrave (1982). Kodet e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Tiranë, f. 439-441.
4. Qendra e Botimeve Zyrtare (2021). Ligj Nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar”. Tiranë, f. 26-31.

#### Rekomandime:

1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (2014). Rekomandime për ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar”.
2. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (2017). Rekomandime për projektligjin “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar”.

#### Disertacione:

1. Deniona Katro. (2016). Krimet seksuale. Disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor”. Departamenti i të Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Tiranë, f. 8-10.
2. Engjëll Likmeta. (2014). Mbrojtja juridike penale e pronësisë. Disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor”. Departamenti i të Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Tiranë, f. 150.

#### Revista:

1. Andrea Nathanaili. (1948). Fuqia e dispozitave juridike të vjetra në shtetin e ri. Revista Drejtësia Popullore Nr. 1. Tiranë, f. 47.
2. Andrea Nathanaili. (1952). Krimi dhe elementet e tij përbërëse si pas Kodit Penal të Ri. Revista Drejtësia Popullore Nr. 5. Tiranë, f. 1.
3. Bilbil Klosi. (1952). Fjalimi i Ministrit të Drejtësisë shokut Bilbil Klosi, në Kuvendin Popullor me rastin e paraqitjes për aprovim të projekt Kodit Penal. Revista Drejtësia Popullore Nr. 3. Tiranë, f. 7.
4. Manush Myftiu. (1977). Raport mbi Projektkodin Penal të Republikës Popullore Socialiste. Revista Drejtësia Popullore Nr. 3, f. 3-13.
5. Vasilika Hysi. (2014). Politika penale për veprat penale kundër grave dhe fëmijëve. Revista Studime Juridike Nr. 2. Tiranë, f. 40.

#### Jurisprudencë:

1. Vendimi Nr. 4, datë 12.2.2010, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.
2. Vendimi Nr. 1178, datë 07.05.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
3. Vendimi Nr. 937, datë 04.11.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
4. Vendimi Nr. 31, datë 13.01.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
5. Vendimi Nr. 44, datë 10.02.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Links:

1. INSTAT (2021). Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale, 2020. (online)  
Aksesuar: [http://www.instat.gov.al/media/8271/press-release-krime-2021\\_format.pdf](http://www.instat.gov.al/media/8271/press-release-krime-2021_format.pdf) më 22 prill 2022.
2. Picari M. (2021). Krimet seksuale me të mitur, shqetësim rehabilitimi i viktimave. (online) Aksesuar: <https://www.zeriamerikes.com/a/5975395.html> më 22 prill 2022.

**ROLI I PERCEPTIMEVE NË POLITIKËN E JASHTME:  
RASTI I MARRËDHËNIEVE SHQIPËRI-KINË NË PERIUdhËN E  
LUFTËS SË FTOHTË**

**PHD. JORDAN JORGJI**

Departamenti i Shkencave Sociale  
Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Humane  
Universiteti “Fan.S. Noli” Korçë  
[jordanjorgji@yahoo.com](mailto:jordanjorgji@yahoo.com)

**Abstrakt:** Formulimi dhe zbatimi i politikës së jashtme nuk përbën një proces të thjeshtë dhe automatik. Përkundrazi, nënkupton përpunimin e sinjaleve sistemike brenda njësisë së shtetit, proces ky ku përfshihen faktorë të ndryshëm, shtetërorë, socialë dhe rajonalë. Një prej faktorëve lidhet me personalitetin dhe perceptimet e lidershit, si lente këto me anën e së cilave vëzhgohen, përkthehen dhe përpunohen sinjalet sistemike.

Qëllimi i këtij punimi është përshkrimi i perceptimeve jo të ngjashme që ekzistojnë në tipe të ndryshme lideresh, si dhe rolin e këtyre perceptimeve në politikën e jashtme. Kjo realizohet duke sjellë si rast studimi ekzaminimin e aleancën shqiptaro-kineze gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, dhe konkretisht diferencimi që lideri i dy vendeve kishte në perceptimin e zhvillimeve rajonale dhe ndërkombëtare. Kështu, ideologjia e ngurtë që praktikohet prej liderit shqiptar, për sa i përket vlerësimit të sinjaleve sistemike, në ndryshim nga fleksibiliteti pragmatist dhe racional i udhëheqjes kineze përbëjnë fokusin kryesor të rastit të studimit. Impakti i perceptimeve tek politika e jashtme ilustronet nëpërmjet rrugëve të ndryshme që ndoqën më vonë të dy vendet, gjë që përbën një prej shkaqeve të prishjes së aleancës Shqiptaro-Kineze.

Ky studim cilësor në fushën e shkencës politike dhe analizës së politikës së jashtme bazohet në literaturë parësore të kërkimit dokumentar, të kryer në arkivat e Republikës së Shqipërisë.

**Fjalët çelës:** perceptime, perceptime të gabuara, Luftë e Ftohtë, racionalizëm, ideologji e ngurtë.

**THE ROLE OF PERCEPTIONS IN FOREIGN POLICY: THE CASE  
OF ALBANIA-CHINA RELATIONS DURING THE COLD WAR  
PERIOD**

**Abstract:** The formulation and implementation of foreign policy is not a simple and automatic process. Rather, it is associated with filtering systemic



*signals within the state agent, a process that involves various features and actors, like governmental, social and regional features. One of those is related to the personality and perceptions of leadership, as lenses through which systemic signals are observed, translated and processed.*

*The purpose of this paper is to describe dissimilar perceptions that exist in different types of leadership, as well as the role of perceptions in foreign policy. This is achieved by bringing as a case study the examination of the Albanian-Chinese alliance during the Cold War period, and specifically the differentiation that the leadership of the two countries has had in interpreting regional and international developments. Thus, the rigid ideology practiced by the Albanian leadership, in terms of evaluating systemic signals, in contrast to the pragmatic and rational flexibility of the Chinese leadership constitute the main focus of the present case study. The impact of perceptions on foreign policy is illustrated through the different paths followed by the two countries later, which is one of the reasons for the breakdown of the Albanian-Chinese alliance.*

*The present qualitative study in the field of political science and foreign policy analysis is based on documentary research, conducted at the archives of the Republic of Albania.*

**Key words:** *perceptions, misperceptions, Cold War, rationalism, rigid ideology.*

## **HYRJE**

Kur studiojmë politikën e jashtme të Shqipërisë gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, qoftë nga aspekti historik, por edhe nga ai politik, na bën përshtypje se përse marrëdhëniet që një vend i vogël dhe i varfër si Shqipëria zhvilloi me superfuqi rajonale dhe deri globale u përkeqësuan, kryesisht si pasojë e veprimeve të ndërmarra nga lidërsipit shqiptar. (Biberaj, E. 1986, 117). Pyetja që lind është se përse u prishën marrëdhëniet Shqiptaro-Kineze në vitin 1978, kur Kina kishte asistuar Shqiptarët me ndihma të çmuara në momentet më të vështira ta dhe kur shteti shqiptar e kishte ende nevojë mbështetjen ekonomike dhe politike të Pekinit? Këtij paradoksi vjen ti përgjigjet punimi në fjalë, i cili fokusohet në nivelin e raporteve politike ndërmjet lidërsipit shqiptar dhe atij kinez.

Së dyti, duke qenë se politika e jashtme implementohet dhe vihet në zbatim nga qenie humane, të cilët kanë përvojat e tyre personale dhe botëkuptimin e vet filozofik e moral është e nevojshme të merren parasysh perceptimet e lidërsipit. (Chernobrov, D. 2019, 14). Pra,

pyetja tjetër themelore që lind lidhjet me rolin e perceptimeve të lidërshiptit politik në formulimin dhe ushtrimin e politikës së jashtme. Të dy pyetjet e trajtuara në këtë punim, ndeshen me rezultate të cila konkludojnë se lidërshipti shqiptar aplikonte lente perceptimi të kundërta nga ato të liderëve të Kinës, dhe ky diferencim botëkuptimesh përbënte një shkak të rëndësishëm të ndarjes përfundimtare Shqiptaro-Kineze.

Studimi lidhet me fushën e shkencës politike dhe më specifiku me analizën e politikës së jashtme. Hulimtimi është cilësor dhe bazohet në ekzaminimin e rastit të studimit, me fokus kryesor kontaktet zyrtare që ndërmorën udhëheqësit e Shqipërisë dhe Kinës, në kuadër të takimit të zhvilluar në vitin 1963 në Pekin midis Ministrit Shqiptar të Mbrojtjes Beqir Balluku dhe zyrtarit të lartë të Partisë Komuniste të Kinës Ten Hsiao Pin.

Niveli i analizës është ai i individit. Kjo, sepse siç thekson edhe eksperti i njohur amerikan i shkencës politike, Robert Jervis, përderisa shtetet dhe aparatet e tyre administrative kanë pothuajse të njëjtën përmbajtje, duke reaguar në mënyrë të ngjashme ndaj sfidave të jashtme, anë personaliteti dhe sjellja e udhëheqësve ato që bëjnë ndryshimin detajues. (Jervis, R. 2017, 18).

Përshkrimi i thelluar i rastit të studimit realizohet përmes kërkimit dokumentar në dy arkivat kryesore të shtetit shqiptar: në Arkivin Qendror Shtetëror (AQSH) dhe në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme (AMPJ). Besueshmëria e dokumenteve të konsultuara qëndron në faktin se ato janë zyrtare, të papublikuara dhe i referohen drejtpërsëdrejti takimeve dhe bisedave të nivelit të lartë të politikës shqiptare.

Në pjesën e parë të punimit shpjegohen koncepte kryesore, si: perceptime, lidërshipt, vendimmarrje politike, marrëdhënie ndërkombëtare, politikë e jashtme. Gjithashtu, analizohet rëndësia që ka individi - në këtë rast lidërshipti - në formulimin e politikës së jashtme dhe në garantimin e zbatimit të saj. Pra, për sa i përket metodologjisë së marrëdhënieve Shqiptaro-Kineze analiza fokusohet në nivelin e individit.

Në pjesën e dytë përshkruhen boshtet kryesore të politikës së jashtme të Shqipërisë në periudhën e Luftës së Ftohtë, duke u ndalur në mënyrë të veçantë në analizën e marrëdhënieve Shqiptaro-Kineze në vitet

1957-1978. Analiza e marrëdhënieve dypalëshe realizohet duke marrë parasysh zhvillimet ndërkombëtare dhe rajonale të asaj periudhe.

Rasti i studimit detajohet në pjesën e tretë, ku diskutohet mbi boshtet kryesore të bisedës ndërmjet Ballukut dhe Ten Hsiao Pin në vitin 1963. Vëmendja përqendrohet në mungesën e kovergjencës ndërmjet lidershit shqiptar e atij kinez në lidhje me çështje të veçanta ndërkombëtare dhe rajonale, por edhe për sa i përket vetë marrëdhënieve Shqiptaro-Kineze.

Studimi mund të ndihmojë në pasurimin e mëtejshëm të kontributeve shkencore në fushën e politikës së jashtme, si në literaturën universitare, ashtu dhe në atë të shërbimeve diplomatike.

## **1. PERCEPTIMET DHE ROLI I TYRE NË POLITIKËN E JASHTME**

Perceptimet e lidershit janë procese shoqërore ndërveprimi, që formohen dhe shprehen si rezultat i ndërveprimit të liderit me audiencën, qoftë ky i fundit një lider tjetër bashkëveprues. Ato influencojnë një pjesë të veprimeve politike dhe formohen nga përvojat personale të politikanëve, si dhe nga personifikimi i tyre me përvojat e kolektivitetit ku ata bëjnë pjesë. (Mutz, D. C. 1988, 111). Gjithashtu, perceptimet lidhen me mënyrën e marrjes dhe riprodhimit të informacionit, ku ndërgjegja e lidershit mund të jetë e orientuar drejt ngjarjeve të caktuara apo atyre me një rëndësi të veçantë. (Lord, R. G. & Maher, K. J. 1993, 27, 29). Një kanal i rëndësishëm i influencimit janë Mjetet e Komunikimit Masiv (Mutz, D. C. 1988, 5), ndërkohë që forma më e njohur e marrjes së informacionit është modeli racional, pra akses i palimituar në informacion dhe ndërmarrja e alternativave optimale. (Lord, R. G. & Maher, K. J. 1993, 18).

Perceptimet dhe stereotipet që njerëzit kanë për të tjerët dhe për veten e tyre janë pjesë natyrale e sjelljes së njeriut. Ato i shërbejnë vetëbesimit, por deri në momentin kur mund të përbëjnë ndikim negativ për shëndetin e individit. Sipas Kolakowski, perceptimet dhe vetëperceptimet ruajnë brenda tyre një gjysmë të vërtete dhe konsolidohen si rezultat i kushteve shoqërore ndër vite, duke u ngritur përtej nivelit individual, në atë kombëtar. (Kolakowski, L. 2004, 3-5). Me fjalë të tjera, është e pashmangshme që dikush të jetë imun në riprodhimin e stereotipeve ndaj fqinjëve, në raport me vende dhe popuj të ndryshëm, por edhe për sa i përket popullit dhe kombit ku bën pjesë.

Në këndvështrimin e Chernobrov, gjeneza e perceptimeve ndaj të tjerëve, pozitive apo negative qofshin, është identifikimi i unit me kolektivitetin – përfshirë këtu edhe kombin – dhe marrëdhëniet që identiteti kolektiv zhvillon me identitetet e tjera. Pra, lindja e perceptimeve ndodh atëherë kur procesi i identifikimit dhe krahasimit merr formën e diferencimit apo të konvergencës ndërmjet subjekteve dhe identiteteve të tyre. (Chernobrov, D. 2019, 17 & 22). Në spektrin global dhe rajonal të marrëdhënieve ndërkombëtare identifikimet dinamike pasohen nga identitete fluide, si rrjedhojë e kushteve të përgjithshme që ekzistojnë. Një shembull i tillë lidhet me ndryshimet që pësuan perceptimet e vendeve të Evropës lindore në raport me Perëndimin fill pas periudhës së Luftës së Ftohtë. Kështu, nëse gjatë periudhës në fjalë perceptimet ishin të rezervuara dhe me konotacion negativ, ato u përmirësuan ndjeshëm në dhjetëvjeçarin e parë që pasoi Luftën e Ftohtë, por u përkeqësuan sërish pas vitit 2010. (Chernobrov, D. 2019, 87-88).

Perceptimet mund të ndryshojnë në bazë të faktorëve apo aktorëve të ndryshëm. Një faktor i tillë është ideologjia politike, e cila ndikon në formësimin e perceptimeve që shprehin forcat e majta apo të djathta politike. Alexander Sergunin sjell shembullin e perceptimeve që ekzistojnë në skenën politike të Rusisë në raport me krizën e Ukrainës. Kjo e fundit kulmoi në vitin 2014 me ndërhyrjen ushtarake ruse në Krime dhe u përshkallëzua në vitin 2022 kur ndërhyrja e përsëritur ushtarake u shtri në të gjithë Ukrainën. Linja e ashpër dhe nacionaliste e Rusisë mbështet veprimet e presidentit Vladimir Putin për sa i përket integritimit territorial të Krimesë në Rusi dhe beson se shteti rus duhet të zgjerohet më tej, drejt të gjithë vijës juglindore të Ukrainës. Nga ana tjetër, krahu liberal rus e sheh politikën e Putinit në kundërshtim me paqen dhe normat ndërkombëtare, dhe beson se ashpërsia e linjës së ndjekur justifikon autoritarizmin, nacionalizmin dhe tendencat anti-perëndimore. (Sergunin, A. 2017, 41-42).

Duke vazhduar me Rusinë vëmë re se perceptimet kritike të Perëndimit marrin jehonë gjatë krizave periodike në marrëdhëniet SHBA-Rusi. Kjo ndodhi në vitin 2004, kur vendet perëndimore shfaqën pakënaqësinë e tyre për rizgjedhjen e Putinit në postin e Presidentit. Perceptimet kritike dhe akuzat u thelluan gjatë agresionit ushtarak të Rusisë në Gjeorgji në vitin 2008, pasuar nga njohja e pavarësisë të dy krahinave separatiste atje, Abhazisë dhe Osetisë, dhe kryesisht gjatë

konfliktit në Ukrainë në vitin 2022. Sipas Feklyunina, perceptimet perëndimore ndaj liderishipit autoritarist, agresor dhe deri të rrezikshëm të Rusisë, Moska është kujdesur t'i filtrojë në makinerinë e saj të propagandës dhe ti shfaqë për publikun rus si një retorikë e pastër e Rusofobisë e ardhur nga Perëndimi. (Feklyunina, V. 2013, 100).

Perceptimet politike ndikohen gjithashtu prej historisë kolektive të shtetit dhe të shoqërisë, pra prej peshës të së kaluarës. Robert Jervis ofron shembullin e tensionit që ekziston ndërmjet Iranit dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, tension i cili mes të tjerash lidhet me dallimet mes perceptimeve të liderishipit në të dy vendet. Kështu, në sytë e Iranit SHBA përbën një kundërshtar të drejtëpërdrejtë dhe eminent. Ndiqja e Uashingtonit për regjimin e para vitit 1979, si dhe sanksionet ekonomike amerikane në dëm të Iranit sot janë faktorë thelbësorë që i forcojnë më tepër perceptimet distancuese në Teheran. Nga ana tjetër, në sytë e Amerikanëve Irani perceptohet si një shtet që investon në ruajtjen e terrorizmit, nëpërmjet hegjemonisë rajonale dhe kërcënimeve për prodhimin e armëve nukleare. (Jervis, R. 2014, 15-16).

Perceptimet nacionale janë më të pranishme ndaj një fuqie në rritje, rajonale apo globale, e cila synon forcimin e pozicionit të saj në lidhje me sigurinë, ekonominë dhe politikën e jashtme. Përmendim këtu imazhin për Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe politikën amerikane. Në sontazhin e vitit 2003 u shtrua pyetja mbi rolin ndërkombëtar të Uashingtonit, konkretisht nëse prezenca ushtarake amerikane kishte ndihmuar apo jo në ndërtimin e paqes dhe të stabilitetit në rajonet ku ajo angazhohej? Përkundëjt përgjigjeve konfirmuese që vinin nga SHBA, Kanadaja, Britania e Madhe dhe Australia, e kundërta ndodhte me qytetarët e vendeve myslimane – Jordanisë dhe Indonezisë – së bashku me ata të shteteve që e shihnin me rezerva rolin ushtarak të Amerikës pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, konkretisht Rusisë dhe Francës. (Holsti, O, R. 2008, 17, 27).

Një shembull tjetër i perceptimeve nacionale është Kina, e cila qysh prej viteve '70 të shekullit të kaluar ka shënuar rritje të vazhdueshme në arenën ndërkombëtare. Perceptimet për rolin e Kinës, si një fuqi e re globale, kryesisht në fushën e tregtisë, nuk janë tërësisht polemizuese. Kjo ndodh për shkak të dominancës historike të Pekinit në Azi dhe përvojave të shumta kulturore dhe historike që ka Kina, në

dallim nga vendet perëndimore. (Herrick, C. Gai, Z. Subramaniam, S. 2016, 1).

Perceptimet varen edhe nga kushtet e brendshme të shoqërisë, apo të një rajoni të caktuar. Kështu, nëse sistemi politik dhe ekonomia funksionojnë me eficiencë të kënaqshme, atëherë perceptimet politike do të jenë pozitive. (Rose, J. 2014, 105). Në politikën e jashtme perceptimet pozitive i atribuohen kryesisht kushteve rajonale paqësore dhe bashkëpunuese.

Perceptimet e gabuara ose keqkuptimet ekzistojnë paralelisht me perceptimet. Kështu, tendencat etnocentrike në gjykimin e udhëheqësve të çdo shteti, të kombinuara me mungesën e informacionit dhe dilemat e sigurisë çojnë në ekzistencën e interpretimeve të gabuara dhe në (ri)prodhimin e mungesës së besimit të ndërsjellët. Për Jervis, vendimmarrësit mund të ndikohen nga mënyra se si ata e lexojnë historinë, por dhe në interpretimin e zhvillimeve përtej vendit të tyre, duke u kthyer në subjekte shprehëse të perceptimeve. (Jervis, R. 2017, 228, 334). Në rastin e keqkuptimeve liderët mbivlerësojnë situata apo informacione dhe lënë shteg për përkeqësime potenciale në marrëdhëniet ndërmjet shteteve. (Jervis, R. 2017, 346, 350). Gjithashtu, perceptimet e gabuara mund të lindin si rezultat i moskuptimit të mesazheve përmbajtësore të liderëve të tjerë, me të cilët zhvillohet një bisedë ose negociatë e caktuar, ndryshe nga pritshmëritë fillestare. (Jervis, R. 2017, 359-360).

Chernobrov mendonte se perceptimet janë negative kur “uni” dhe “tjetri” ndajnë më tepër karakteristika të ngjashme mes tyre se sa të kundërta. “Lufta brenda llojit” dhe ngjizja e perceptimeve ndikohen nga faktorë konjunkturalë, rajonalë apo globalë, siç është nacionalizmi, ideologjitë e ndryshme apo lëvizjet e superfuqive. Shpërthimi i urrejtjes për “fqinj” në Jugosllavinë multietnike të periudhës pas shembjes së Bashkimit Sovietik dhe rirforcimit të nacionalizmit përbën një shembull të veçantë ilustrues. (Chernobrov, D. 2019, 97-98).

## **2. POLITIKA E JASHTME SHQIPTARE NË PERIUDHËN E LUFTËS SË FTOHTË DHE PRISHJA E ALEANCAVE**

Përfundimi i Luftës së Dytë Botërore solli ndryshime të konsiderueshme ndërkombëtare dhe nacionale. Dy luftërat e mëdha globale i dhanë fund sistemit multilateral të mbizotërimit të Fuqive të Mëdha evropiane, sistem i cili pati zgjatur pothuajse një shekull, dhe

bota po hynte në organizimin bipolar të shpërndarjes së fuqisë ndërmjet Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Madje antagonizmi nuk u kufizua posaçërisht tek këto dy fuqi, por u shtri edhe në shtete të tjera, të grupuara përreth dy poleve ideologjike-ushtarake të globit. (Dockrill, M, L. & Hopkins, M F. 2006, 32).

Në Shqipëri pushteti politik u rivendikua dhe u mor nga partizanët Shqiptarë, pjesa më e madhe e të cilëve aderonte ose kishte simpati për partinë e sapoformuar komuniste. Kjo klasë e re politike ndërmori masa radikale në politikën e brendshme (Mëhilli, E. 2017, 39), ndërsa në politikën e jashtme Shqipëria u rreshtua me vendet e Lindjes. Bipolariteti global dhe ekzistenca e pasigurisë në rajonin e Ballkanit – për pasojë edhe marrëdhëniet e tensionuara të Shqipërisë me fqinjët – e shtyu udhëheqjen shqiptare drejt lidhjes së aleancave të tipit satelit me shtete më të fuqishme në rajon, por edhe më gjerë. Aleatet e njëpasnjëshme të shtetit shqiptar gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë ishin Jugosllavia, Bashkimi Sovjetik dhe Kina. (Mëhilli, E. 2017, 230). Duke qenë një shtet i vogël dhe i dobët, Shqipëria siguroi nga aleatët mbështetje politike në arenën rajonale dhe më gjerë, me qëllim mbrojtjen e pavarësisë dhe sovranitetit kombëtar. Politika e jashtme shqiptare synoi dhe arriti anëtarësimin e vendit në organizatat ndërkombëtare, si Kombet e Bashkuara, Traktati i Varshavës dhe Këshilli i Ndihmës Ekonomike Reciproke. Gjithashtu, mbështetja e aleatëve për Shqipërinë lidhej me rindërtimin e kësaj të fundit, duke i siguruar shtetit shqiptar kredi të mëdha financiare, furnizime ushtarake, si dhe asistencë të pashembullt ekonomike-kulturore. (Griffith, W, E. 1964, 21).

Megjithatë, nuk munguan problemet në aleancat asimetrrike (Mëhilli, E. 2017, 42, 48) që një vend i vogël si Shqipëria zhvilloi me fuqi më të mëdha se vetja, probleme të cilat ndikuan edhe në prishjen përfundimtare të këtyre aleancave. Së pari, marrëdhëniet strategjike të Tiranës me Beogradin pas Luftës së Dytë Botërore u përkeqësuan – e më tej u ndërpre – si pasojë e konjunkturave më të mëdha, konkretisht konfliktit Jugosllav-Sovjetik. (Schnytzer, A. 1982, 10). Si rezultat, Shqipëria kaloi në sferën e influencës së Bashkimit Sovjetik, duke nisur kështu rrugën e aleancës së re 13-vjeçare Shqiptarosovjetike. Për herë të parë, shteti Shqiptar po zhvillonte kontakte dhe marrëdhënie të

drejtpërdrejta me një fuqi globale, tendencë e cila vazhdoi edhe në vitet e mëvonshme, madje vazhdon edhe në ditët kur po shkruhet ky punim. Së dyti, “aleancat e mëdha” të Shqipërisë u dobësuan për arsye të mungesës së barazisë dhe demokracisë në marrëdhëniet e ngushta ndërshtetërore që ekzistonin në vendet komuniste. Duke qenë se në realitet pushteti politik zotërohej nga një njeri i vetëm, sekretari i parë i partisë ose nga një oligarki partiakësh në disa raste (Hermann, M, G. & Hermann, C, F. 1989, 361-366), marrëdhëniet shtetërore me vendet ideologjikisht simotra shpesh herë influencoheshin nga kontaktet që ekzistonin midis udhëheqësve, si dhe nga perceptimet që ata kishin për njëri-tjetrin, edhe pse kjo nuk zëvendësonte aspak rëndësinë e mosmarrëveshjeve politike të trashëguara. Një shembull konkret i relatave personale të udhëheqësve ishin ato midis liderit Shqiptar Enver Hoxha dhe atij Sovjetik Nikita Hrushov, relata të cilat u udhëhoqën nga tensioni i vazhdueshëm ndër-personal, që më vonë gjeneroi në tension ndërpartiak e ndërshtetëror. (Griffith, W, E. 1964, 54; Crampton, R, J. 2002, 160; Khrushchev, S. 2006, 232). Impakti negativ i perceptimeve të lidërshipt do të përsëritet më vonë tek aleanca Shqiptaro-Kineze.

### **3. IMPAKTI I PERCEPTIMEVE NË MARRËDHËNIET SHQIPTARO-KINEZE**

Aleanca që Tirana zhvilloi me Pekinin pas ndarjes Shqiptaro-Sovjetike ishte rezultat i afrimit të interesave kombëtare dhe bashkërendimit ideologjik komunist. Kina përbën fuqinë që e ka mbështetur Shqipërinë më shumë se kushdo tjetër në periudhën e Luftës së Ftohtë. Rëndësia e ndihmës kineze ishte kryesisht materiale, duke i siguruar vendit të vogël të Ballkanit ndihmë të konsiderueshme financiare, ushtarake dhe teknike. Tregtia Shqiptaro-Kineze u rrit ndjeshëm, nga 3 milion dollarë në vitin 1957 në 115 milion dollarë në vitin 1969. (Intelligence Memorandum 1971, 2-16).

Marrëdhëniet e mira ndërmjet Shqipërisë dhe Kinës zgjatën plot dy dhjetëvjeçarë, nga viti 1956 deri në 1977. Një nga shkaqet kryesore të ndarjes përfundimtare të aleatëve të largët ishin perceptimet e udhëheqësve, veçanërisht impakti përcaktues që kishin mendimet e lidërshiptit shqiptar në vendimmarrjen e politikës së jashtme respektive. Përballë njëri-tjetrit u vunë Enver Hoxha nga njëra anë dhe Çu En Lai me Ten Hsiao Pin-in nga ana tjetër. Këta të fundit – së bashku dhe me Li Hsien Nien – kishin marrëdhënie më të shpeshta me udhëheqjen



shqiptare, ndërsa Mao Ce Dun si lideri suprem i Kinës përqendrohej më tepër tek politika me shtetet e mëdha të arenës globale.

Nëse do të bënim një panoramë karakteresh të personaliteteve të mësipërme, do ti gruponim ata në të paktën dy kategori kryesore. Enver Hoxha dhe Mao Ce Dun si udhëheqës më tepër të ideologjizuar, në dallim nga Çu En Lai dhe Ten Hsia Pin të cilët anonin nga pragmatizmi politik. Gjithashtu, të parët ishin karaktere luftarakë ndërsa të dytët preferonin gjykimet më të ftohta, të matura e diplomatike. (Feng, H. 2007, 44-48 & 57-62). Më konkretisht, lentet me të cilat lidshipi i dy vendeve perceptonte dhe analizonte zhvillimet ndërkombëtare duken më së miri në bisedën zyrtare që ministri i mbrojtjes i Shqipërisë, Beqir Balluku, pati me udhëheqjen kineze në Shtator të vitit 1963 në Pekin. Biseda u zhvillua në kuadrin e tre takimeve periodike që z. Balluku pati me personalitetin e rëndësishëm të Partisë Komuniste të Kinës, Ten Hsiao Pin, më 10, 12 dhe 24 Shtator 1963.

Tematika kryesore e takimit ishte shqetësimi i palës shqiptare mbi afrimin midis Uashingtonit dhe Moskës, që po ndodhte në kuadrin e politikës së ‘bashkekzistencës paqësore’ të anonuar Nikita Hroshov. Në atë kohë, si pala shqiptare dhe ajo kineze kundërshtonin marrëveshjen për ndalimin e provave bërthamore që ishte arritur po atë vit nga SHBA, Bashkimi Sovjetik dhe Mbretëria e Bashkuar. Marrëveshja u interpretua si përpjekje e dy ‘të mëdhenjve’ për t’i ndaluar Pekinit posedimin e armëve bërthamore dhe si pasojë pengimin e fuqizimit të mëtejshëm global të Kinës. Në vazhdim, Moska pati propozuar nënshkrimin e një traktati mossulmimi midis vendeve-anëtare të Traktatit të Varshavës dhe atyre të NATO-s, propozim i cili nxiti pasigurinë e udhëheqjes shqiptare, si dhe vetë takimin midis Ballukut dhe Ten-it.

Në këtë kuadër, ministri shqiptar i propozoi palës kineze nënshkrimin e dy marrëveshjeve të rëndësishme: nënshkrimin e një traktati miqësie, bashkëpunimi dhe ndihme reciproke midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës; nënshkrimin e një pakti ushtarak midis Kinës, Koresë, Vietnamit, Shqipërisë dhe Kubës. Sipas Ballukut, traktati i parë do të kishte kryesisht efekt politik, me qëllim parandalimin e synimeve të mundshme të fqinjëve dhe të dy superfuqive në dëm të sovranitetit territorial shqiptar, ndërsa pakti i dytë do të shërbente si aleancë politiko-ushtarake përkundrejt Traktatit të Varshavës, NATO-s dhe pakteve të tjera rajonale, të tipit SEATO,

ANZUS. Një realizim i mundshëm i dy propozimeve shqiptare nënkuptonte praktikisht daljen e Shqipërisë nga Traktati i Varshavës qysh në vitin 1963.

Pasi dëgjoi dhe analizoi propozimet shqiptare, pala kineze i bëri të ditur ministrit shqiptar mosdakordësinë e Pekinit në lidhje me nënshkrimin e dy aleancave ushtarake. Refuzimi i propozimeve shqiptare bëhej kryesisht për arsye pragmatiste dhe racionale, Ten Hsiao Pin shprehej në mënyrë karakteristike se: “Ne e shikojmë këtë çështje nga pikëpamja e përgjithshme, domethënë sa dobi dhe sa dëm do të ketë”. (AQSH, viti 1963, dosja 7, fq. 80-81). Ten Hsiao Pin, i cili më vonë u bë kryeministër i vendit, u përpoq të qetësonte Ballukun, duke theksuar se probabiliteti i nënshkrimit të një traktati mossulmimi midis vendeve të aleancës ushtarake të Varshavës dhe NATO-s ishte minimal ose pothuajse inekzistent. Kjo, sepse rrezikoheshin interesa kombëtare dhe ndërkombëtare që lidheshin me të gjithë kampin socialist dhe kryesisht me prestigjin e vetë Bashkimit Sovjetik si superfuqi globale.

Sipas Tenit, një afrimitet i tillë juridik midis dy superfuqive do të hidhte praktikisht në diskutim çështje komplekse, siç ishte problemi i Berlinit dhe ai i Gjermanisë në tërësi, por edhe çështja e kufirit të Polonisë me Bashkimin Sovjetik. Në këtë mënyrë, qasja Sovjetikoamerikane nuk mund të shkonte në pafundësi vetëm e vetëm sepse kjo politikë përkrahej nga Hrushovi. Në këndvështrimin e lidhshimit kinez, mbrojtja e interesave kombëtare dhe interesave të kampit socialist në përgjithësi, mbizotëronte ndaj qasjes ideologjike të zhvillimeve ndërkombëtare.

Megjithatë, ky diskutim nuk e bindi përfaqësuesin shqiptar, i cili besonte dhe këmbëngulte se mundësia e nënshkrimit të një traktati mossulmimi ishte reale, për vetë arsyen se Hrushovi dhe udhëheqësit e shteteve të tjera ishin mësuar tashmë të tradhetojnë parimet e socializmit: “*Hrushovi dhe ata që e pasojnë janë duke i bërë lëshime të mëdha e të vazhdueshme imperializmit amerikan. Ata kanë dalë hapur si tregtarë parimesh. Është shumë vështirë të mendosh se ata do të ndalen në rrugën e tyre të afrimit me imperializmin*”. (AQSH, viti 1963, dosja 7, fq. 73-75).

Ngurtësia ideologjike e përfaqësuesit shqiptar shprehte edhe një aspekt tjetër të lenteve me anë të së cilave perceptoheshin zhvillimet ndërkombëtare. Niveli i këndvështrimit dhe analizimit të sinjaleve sistematike nga ana e udhëheqjes shqiptare bazohej kryesisht tek

individit. Kështu, besohej se kërcënimet që mund ti vinin Shqipërisë vareshin ndjeshëm prej vullnetit që tregonte udhëheqësi sovjetik për t'u afruar më shumë me Perëndimin, se sa prej ekuilibrit të forcave në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

Nga ana tjetër, lidhshipi kinez i perceptonte dhe analizonte sinjalet sistemike nga këndvështrimi i lidhur fort me shtetin dhe sistemin ndërkombëtar. Për Kinezët nuk janë liderët ata që vendosin fatin e shteteve të mëdha dhe të vogla, por natyra anarkike e sistemit ndërkombëtar së bashku me shpërndarjen e fuqisë relative. Pikërisht mbi këtë bazë shoqërizohen shtetet-kombe, të cilat veprojnë duke nuhatur dhe marrë parasysh ekuilibrin e forcave. Kështu, Ten Hsiao Pin i përgjigjet Beqir Ballukut: *“Por, tregtia me parimet ka lidhje edhe me disa çështje praktike, ka lidhje me marrëdhëniet midis shteteve. Unë shtrova këto çështje duke marrë parasysh pozitën e Bashkimit Sovjetik si Fuqi e Madhe dhe Valter Ulbrihtin e Vladislav Gomulkën jo si persona, por si dy shtete”*. (AQSH, viti 1963, dosja 7, fq. 73-75).

Në vazhdim, Ten-i përpiqet pa sukses t'i shpjegojë ministrit shqiptar se nënshkrimi i një traktati mossulmimi ndryshon thelbësisht nga traktati tripalësh për ndalimin e provave bërthamore që u arrit në vitin 1963. Ky i fundit erdhi si rezultat i dakordësisë racionale midis dy superfuqive dhe Mbretërisë së Bashkuar si palë e tretë, sepse fuqia bërthamore e Moskës ishte inferiore ndaj fuqisë amerikane. (AQSH, viti 1963, dosja 7, fq. 65-70).

Diferencimi i perceptimeve të Shqiptarëve dhe Kinezëve vërehet gjithashtu në momentin kur në bisedë preket problemi i pasigurisë së Shqipërisë nga fqinjët. Kështu, Beqir Balluku shprehu bindjen e udhëheqjes shqiptare se ekzistonte plotësisht mundësia e një ndërhyrjeje ushtarake në Shqipëri nga ana e fqinjëve, me mbështetjen politike ose ushtarake të dy superfuqive. Jugosllavia dhe Bullgaria do të ndërhynin pas nxitjes së tyre nga ana e Traktatit të Varshavës, ndërsa i njëjti veprim mund të kryej nga NATO me Greqinë dhe Italinë, me qëllim rrëzimin e regjimit komunist ose të paktën përmbysjen e lidhshiptit të Enver Hoxhës. Pasiguria e lartë e shtyu ministrin shqiptar të mbrojtjes të kërkojë me ngut nga pala kineze dërgimin e menjëhershëm të armatimit shtesë për forcimin e mbrojtjes kundër-ajrore, bregdetare dhe tokësore. (AQSH, viti 1963, dosja 7, fq. 23-26). Nga ana e tij, zyrtari kinez u përpoq të bindë Ballukun se në realitet nuk ekzistonte ndonjë rrezik imediat për Shqipërinë nga ana e fqinjëve,

por vetëm kërcënime subversive dhe të përballueshme. Ten Hsiao Pin theksoi nevojën e vlerësimit të situatës ndërkombëtare, përpara se të gjykohej dinamika e fqinjëve kundër Shqipërisë. Kështu, Shqipëria mund të shqetësohej vërtet për ndonjë ndërhyrje ushtarake nga ana e Jugosllavisë, Greqisë, Italisë apo Bullgarisë – ose të gjithë së bashku – vetëm në rast të ndonjë zhvendosjeje sistemike në shpërndarjen e fuqisë relative. E thënë më qartë vetëm nëse do të ndodhte një luftë e gjerë kontinentale ose botërore. Në të kundërt, asnjë fuqi rajonale apo globale nuk kishte interes të drejtpërdrejtë të sulmonte ushtarakisht Shqipërinë. (AQSH, viti 1963, dosja 7, fq. 76-79).

Diferencimi i lenteve perceptuese të lidershit shqiptar dhe atij kinez demonstron edhe kur në diskutim u prekën marrëdhëniet midis Koresë – fjala është për Korenë e Veriut – dhe Bashkimit Sovjetik. Ministri shqiptar i mbrojtjes shfaqti pakënaqësinë e tij në lidhje me politikën e partive komuniste të Koresë dhe Vietnamit, ku këto të fundit nuk kishin denoncuar hapur Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Hrushovin në veçanti si revizionistë. Gjithashtu, Balluku shprehu nevojën që Pekini dhe Tirana të investonin më shumë tek partitë komuniste të Evropës, që këto të dëbonin Hrushovin dhe elementët hrushovianë nga lidershipi i tyre.

Megjithatë, Ten Hsiao Pini e quajti të drejtë qëndrimin që mbanin partitë komuniste të Koresë dhe Vietnamit, të cilat për arsye politike të konfliktit të drejtpërdrejtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës hezitonin të provokonin një izolim të tyre nga Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera të kampit socialist. Gjithashtu, Teni këshilloi zyrtarin shqiptar të mos provokoheshin tensione të mëtejshme ndërshtetërore me Bashkimin Sovjetik dhe vendet e tjera të kampit socialist. Interesant është fakti se në analizën e tij racionale, Ten Hsiao Pin parashikoi ndërhyrjen e forcave të Traktatit të Varshavës në Çekosllovakia, zhvillim i cili do të ndodhte 5 vite më vonë. Kështu ai deklaroi në mënyrë karakteristike se pas ndërhyrjes në Hungari në vitin 1956, pritej që një gjë e tillë të përsëritej edhe në vende të tjera të kampit, për shembull në Çekosllovakia. (AQSH, viti 1963, dosja 7, fq. 47-54, 59-62).

## **PËRFUNDIME**

Personaliteti i liderit si dhe perceptimet që e karakterizojnë atë ndikojnë – drejtpërsëdrejti ose në mënyrë të tërthorë – procesin e përpunimit të

sinjaleve sistemike dhe sub-sistemike, duke lënë gjurmët e tyre në përpilimin e politikës së jashtme. Personaliteti dhe perceptimet që karakterizonin lidërshpin në Tiranë ishin të ndryshme nga ato të Pekinit, pavarësisht se të dy vendet i bashkonte ideologjia marksiste. Këndvështrimi i udhëheqjes kineze bazohej tek analiza racionale që u bëhej sinjaleve sistemike, ndërsa lidërshpi shqiptar ndiqte një rrugë komplekse të perceptimit të zhvillimeve ndërkombëtare dhe rajonale. Më konkretisht, Tirana zyrtare ndërthurte në mënyrë të ngurtë dhe amorfë këndvështrimin neomarksist nga njëra anë, me komplekset psikosociale të shoqërive ballkanike nga ana tjetër. Madje, anatemimi personal shtrihej më pas në nivelin e marrëdhënieve ndërpartiake dhe ndërshtetërore.

Përveç perceptimit të ndryshëm të zhvillimeve ndërkombëtare, diferencimi i lenteve të udhëheqësve politikë ndikoi tek vetë ecuria e marrëdhënieve Shqiptare-Kineze, si dhe në pozicionimin që secili vend pati më vonë në arenën ndërkombëtare. Duke qenë se liderë si Çu En Lai dhe më pas Ten Hsiao Pin aplikonin racionalizëm dhe pragmatizëm në këndvështrimin e tyre mbi zhvillimet ndërkombëtare, Kina filloi të dalë nga guaska e izolimit qysh prej mesit të viteve 1960. Lidhja e marrëdhënieve diplomatike me shumë vende të Perëndimit kulmoi me pranverën Kinezo-Amerikane, e cila u inaugurua në nivelin më të lartë politik, me vizitat në Pekin të Sekretarit Amerikan të Sigurisë Kombëtare Henry Kissinger në vitin 1971 dhe të presidentit Richard Nixon një vit më vonë. Gjithashtu, Kina vazhdoi shtrirjen e influencës së saj në Ballkan dhe në Evropën lindore, duke thelluar bashkëpunimin me shtete si Jugosllavia, Rumania, Çekosllovakia, Greqia, Turqia, etj. Në skenën e brendshme të Kinës, zgjerimi i kontakteve diplomatike u pasua me mbizotërimin e elementëve pragmatistë në hierarkinë e partisë komuniste, përkundrajt lidërshpit ngurtësisht të ideologjizuar. (Pollack, J, D. 1991, 407; Perkins, D, H. 1991, 478).

Nga ana tjetër, totalitarizmi i Partisë së Punës së Shqipërisë, si brenda vendit, ashtu dhe brenda vetë partisë, nuk solli ndonjë përplasje të mundshme midis ekstremistëve dhe pragmatistëve. Enver Hoxha vazhdoi të mbajë nën kontroll politikë-bërjen e Shqipërisë deri në vitin 1985. Si pasojë, Tirana në politikën e saj të jashtme demonstroi një drejtim krejt të ndryshëm nga politika që ndoqi diplomacia kineze. Shqipëria nuk hodhi asnjë hap konkret në përmirësimin e

marrëdhëniet diplomatike, politike apo ekonomike me vendet e Evropës perëndimore ose asaj lindore.

Madje edhe aleanca që ajo kishte zhvilluar me Kinën e largët që prej fundit të viteve 1950 filloi të ‘helmohej’ me ritme të shpejta. Një prej shkaqeve kryesore ishte indinjata e thellë e lidhjes së bashku me afrimitetin midis Pekinit dhe Uashingtonit. Ndikimi tek Enver Hoxha i ideologjisë së ngurtë, nacionalizmit dhe temperamentit emocional, e bënte të vështirë pranimin e fleksibilitetit politik dhe largpamësisë, të cilën demonstroi udhëheqja kineze në lidhje me të ardhmen e vendit të vet. Në sajë të lenteve racionale dhe pragmatiste Kinezët arritën të hedhin gradualisht hapa konkretë në politikën globale të Kinës, politikë e cila lidhej me shtrirjen e marrëdhëniet ekonomike dhe politike të Pekinit tek të gjitha kontinentet.

## **BIBLIOGRAFIA**

**Burime parësore arkivore**

AQSH, viti 1963, dosja 7.

**Burime parësore të tjera**

United States of America, Central Intelligence Agency, Directorate of Intelligence, *Intelligence Memorandum: Communist China: Recent Developments In Trade With Eastern Europe*, Washington: March 1971, (Approved For Released, 25 March 2002): 2-16.

**Burime dytësore**

Biberaj, Elez. (1986). *Albania and China. A study of an Unequal Alliance*. Boulder & London: Westview Press.

Chernobrov, Dmitry. (2019). *Public Perception of International Crises*. London: Rowman & Littlefield.

Crampton, Richard J. (2002). *The Balkans Since the Second World War*. London: Longman.

Dockrill, Michael, L. & Michael F. Hopkins. (2006). *The Cold War, 1945–1991*. Basingstoke & New York: Palgrave Macmillan.

Feng, Huiyun. (2007). *Chinese Strategic Culture and Foreign Policy Decision-Making*. London & New York: Routledge.

Feklyunina, Valentina. (2013). “Constructing Russophobia.” In *Russia’s Identity in International Relations. Images, perceptions, misperceptions*. Edited by Ray Taras, 91-109. London & New York: Routledge.

Griffith, William, E. (1964). *The Sino-Soviet Rift*. Cambridge, Mass: The M.I.T Press.

Herrick, Christopher., Zheya Gai, Surain Subramaniam. (2016). “Introduction.” In *China’s Peaceful Rise: Perceptions, Policy and*

- Misperceptions*. Edited by Christopher Herrick, Zheyu Gai, Surain Subramaniam, pp. 1-8. Manchester, UK: Manchester University Press.
- Hermann, Margaret G. & Charles F. Hermann. "Who Makes Foreign Policy Decisions and How: An Empirical Inquiry." *International Studies Quarterly* vol. 33, no. 4. December, 1989: 361-387.
- Holsti, Ole, R. (2008). *To See Ourselves as Others See Us. How Publics Abroad View the United States after 9/11*. Ann Arbor, Michigan: University of Michigan Press.
- Jervis, Robert. (2014). "The United States and Iran: Perceptions and Policy Traps." In *U.S.-Iran Misperceptions*. Edited by Abbas Maleki & John Tirman, 15-36. London & New York: Bloomsbury Publishing.
- Jervis, Robert. (2017). *Perception and Misperception in International Politics*. New Jersey: Princeton University Press.
- Khrushchev, Sergei. (Ed.) (2006). *Memoirs of Nikita Khrushchev*. Vol. 2. University Park, Pennsylvania: The Pennsylvania State University Press.
- Kořakowski, Leszek. (2004). "National stereotypes." In *Poles and Jews. Perceptions and Misperceptions*. Edited by Włodysław T. Bartoszewski, 3-5. Oxford and Portland, Oregon: The Littman Library of Jewish Civilization.
- Lord, Robert, G. & Karen, J. Maher. (1993). *Leadership and Information Processing: Linking Perceptions and Performance*. London & New York: Routledge.
- Mēhilli, Elidor. (2017). *From Stalin to Mao. Albania and the Socialist World*. Ithaca & London: Cornell University Press.
- Mutz, Diana, C. (1998). *Impersonal Influence. How Perceptions of Mass Collectives Affect Political Attitudes*. Cambridge, UK: Cambridge University Press.
- Perkins, Dwight H. (1991). "China's economic policy and performance." In *The Cambridge History of China*. Vol. 15. Edited by Roderick Macfarquhar & John K. Fairbank, 475-539. Cambridge: Cambridge University Press.
- Pollack, Jonathan D. (1991). "The opening to America." In *The Cambridge History of China*. Vol. 15. Edited by Roderick Macfarquhar & John K. Fairbank, 402-472. Cambridge: Cambridge University Press.
- Rose, Jonathan. (2014). *The Public Understanding of Political Integrity*. Basingstoke, UK: Palgrave Macmillan.
- Schnytzer, Adi. (1982). *Stalinist economic strategy in practice: the case of Albania*. New York: Oxford University Press.
- Sergunin, Alexander. (2017). "Russian perceptions of the Ukrainian crisis." In *Neighbourhood Perceptions of the Ukraine Crisis. From the Soviet Union into Eurasia?* Edited by Gerhard Besier & Katarzyna Stokłosa, 41-68. London & New York: Routledge.

## NDËRMJETËSIMI I KONFLIKTEVE NDËRKOMBËTARE DHE ROLI I SHTETEVE SI PALË TË TRETË

MARSELA SAKO

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale

[marsela\\_sako@yahoo.com](mailto:marsela_sako@yahoo.com)

**Abstrakt:** Ndërhyrja e një pale të tretë, historikisht ka shërbyer për të zgjidhur konfliktet ndërkombëtare. Pavarësisht ndryshimeve që pësoi sistemi ndërkombëtar me përfundimin e Luftës së Ftohtë u evidentua se frekuenca e konflikteve mbeti e lartë, sikundër edhe tendencat ndërmjetësuese. Në këtë mënyrë menaxhimi i situatave konfliktuale nëpërmjet ndërmjetësimit, ka marr një shtrirje gjithmonë e më të madhe veçanërisht pas periudhës së Luftës së Ftohtë. Ndërhyrja e një pale të tretë, për të ndihmuar në zgjidhjen e konflikteve kryesisht atyre me natyrë ndërkombëtare, në shumicën e rasteve ka rezultuar e sukseshme duke e bërë ndërmjetësimin një nga metodat më të preferuara për palët konfliktuale, në funksion të menaxhimit të konflikteve. Nëpërmjet këtij punimi evidentohen se cilat janë karakteristikat dominante që e bëjnë një palë të tretë ndërmjetësuese të sukseshme. Analiza përqëndrohet në mënyrë specifike, te roli i shteteve si aktorë ndërmjetësues në konfliktet ndërkombëtare. Marrja në konsideratë e qasjes teorike që e konsideron ndërmjetësimin “si pjesë të politikës së jashtme”, na krijon bazën e duhur për të analizuar më konkretisht korrelacionin midis ndërmjetësimit si pjesë e politikës dhe sjelljes strategjike të shtetit Turk në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare.

**Fjalë kyçe:** ndërmjetësim, shtete, konflikt ndërkombëtar, interesa, politikë e jashtme

### INTERCESSION OF INTERNATIONAL CONFLICT AND STATE ROLE AS THIRD PARTIES

**Abstract:** The intervention of a third party has historically served to resolve international conflicts. Despite the changes that the international system underwent with the end of the Cold War, it was evident that the frequency of conflicts remained high, as did mediation tendencies. In this way, the management of conflict situations through mediation has taken on an ever greater scope, especially after the Cold War period. The intervention of a third party, to help resolve conflicts, mainly those of an international nature, has in most cases been successful, making mediation one of the most preferred methods for conflicting parties, in terms of conflict management. For this purpose, the paper highlights the dominant characteristics that make a successful third party mediator. The analysis focuses specifically on the role



*of states as mediating actors in international conflicts. Taking into consideration the theoretical approach that considers mediation "as part of foreign policy", creates the right basis for us to analyze more concretely the correlation between mediation as part of politics and the strategic behavior of the Turkish state in solving international conflicts.*

**Keywords:** *mediation, states, international conflict, interests, foreign policy*

## **HYRJE**

Menaxhimi i konflikteve, kryesisht konflikteve të armatosura nëpërmjet ndërmjetësimit ka filluar të evidentohet gjithmonë e më shumë në marrëdhëniet ndërkombëtare në fillim të shekullit të njëzet. Preferencat e palëve konfliktuale për të aplikuar ndërmjetësimin si një mënyrë të zgjidhjes së konflikteve të tyre është e lidhur ngushtësisht edhe me krijimin e strukturave të rëndësishme në sistemin ndërkombëtar të tilla si; Lidhja e Kombeve dhe Kombet e Bashkuara (Wilkenfeld J., etj.al. 2005)

Përgjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, midis viteve 1945-1984 nga 77 situata të konflikteve ndërkombëtare, metoda e ndërmjetësimit është përdorur në 44 prej tyre. Në disa situata ndërmjetësimi është përdorur më shumë se një herë (Bercovitch J. 1986: 155).

Megjithëse pritshmëritë e shumë studiuesve ishin se me përfundimin e Luftës së Ftohtë bota do të ishte më e paqte, lufta e Gjirit në fillimin e viteve 1990 dëshmonte se po niste një epokë e re, me luftra të reja. Ndryshimi i natyrës së sistemit ndërkombëtar ‘nuk ka reduktuar as incidencën e konflikteve ndërkombëtare dhe as tendencën e palëve të treta për të ndërmjetësuar..’ (Zartman I. 2008). Të gjitha këto zhvillime përforcuan qëndrimet e studiuesve në lidhje me faktin se ‘konfliktet i kanë rrënjët në strukturën e sistemit ndërkombëtar’

Me përfundimin e Luftës së Ftohtë studimet mbi mënyrat e zgjidhjes paqësore të konflikteve të armatosura morën një dimension të rëndësishëm. Sfidat e studiuesve mbetej strukturimi i teorive që të mund të shpjegojnë jo vetëm situatat konfliktuale të së shkuarës, por mbi të gjitha të mund të arrijnë të parashikojnë edhe evoluimin e tyre në të ardhmen.

Vëmendja kryesore është përqëndruar te eksplorimi i metodave paqësore të menaxhimit të konflikteve, ku një ndër më kryesoret padyshim mbetet ndërmjetësimi.

Në këtë pikë të trajtesës vlen të nënvizojmë se, edhe në Kapitullin VI (Zgjidhja Paqësore e Mosmarrëveshjeve) / neni 33 / fraksion 1, të Kartës së Kombeve të Bashkuara, theksohet se, “në të gjitha rastet e mosmarrëveshjeve vazhdimësia e të cilave mund të rrezikojë paqen dhe sigurinë ndërkombëtare palët e përfshira duhet të synojnë pikësëpari gjetjen e një zgjidhjeje nëpërmjet metodave paqësore të zgjidhjes së konflikteve të tilla si: negociimit, ndërmjetësimit, arbitrazhi, zgjidhje gjyqësore, etj.

Menaxhimi i suksesshëm i konflikteve, veçanërisht atyre të armatosura, përgjithësisht mund të rezultojë me: ‘(a) një zgjidhje të plotë të çështjeve në konflikt (që reflektohen në ndryshimet në sjellje dhe qëndrime të palëve të përfshira), ose me (b) arritjen e një zgjidhjeje të pranueshme, armëpushimi apo marrëveshjeje të pjesshme’ (Bercovitch J. Regan M. 1999: 4).

Metodologjikisht ky punim bazohet në metodën e kërkimit cilësor. Nëpërmjet analizës së kuadrit teorik të referuar evitohen konceptet kryesore dhe përcaktimet relevante të procesit të ndërmjetësimit në funksion të qëllimit të punimit. Përqëndrimi i analizës në ndërmjetësimin e aktorit shtetëror, përveç dimensionit të trajtimit teorik të fokusuar në një qasje që e konsideron ndërmjetësimin si pjesë të politikës së jashtme, fokusohet edhe në studimin e një rasti specifik sikundër është Turqia. Janë marrë për shqyrtim dokumenta zyrtarë, artikuj gazetash dhe intervista të dhëna nga përfaqësues të lartë në funksion të analizës në thellësi të këtij procesi.

## **VEÇORITË E NDËRMJETËSIMIT TË SUKSESSHËM**

Zgjidhja e një situatë konfliktuale mund të vij nëpërmjet ndryshimit të qëndrimit të njërës palë të përfshirë në konflikt, nëpërmjet përdorimit të forcës së armatosur pra luftës, dhe në mënyrë paqësore. Ndërmjetësimi mbetet një nga format më të preferuara për zgjidhjen paqësore të konflikteve ndërkombëtare. Përgjithësisht palët konfliktuale preferojnë ta zgjidhin konfliktin me ndërmjetësim, kur kanë arritur në përfundimin se kostoja e vazhimit të konfliktit është më e madhe se përfitimet e një marrëveshjeje të mundshme. Tradicionalisht ndërmjetësimi sikundër e përcakton edhe Bercovitch (1992: 7) konsiderohet ‘*një proces i menaxhimit të konfliktit i lidhur por i dallueshëm nga përpjekjet e vetë palëve konfliktuale, ku palët ose përfaqësuesit e tyre kërkojnë asistencën, ose pranojnë një ofertë ndihme, nga një individ, shtet apo organizatë për të ndryshuar, ndikuar*

*ose influencuar perceptimet apo sjelljet e tyre, pa iu drejtuar forcës fizike apo pa përrshirë autoritetin e ligjit’.* Duke pasur parasysh dinamikën komplekse të marrëdhënieve ndërkombëtare, të cilat mbizotërohen nga parimet e ruajtjes së pavarësisë dhe autonomisë së aktorëve, ndërmjetësimi konsiderohet një veprim vullnetar, jo shtrëngues dhe juridikisht jo detyrues (Bercovitch J. 2009). Këto janë disa nga avantazhet kryesore që mbart ky process që e bën edhe më të preferueshëm përkundrejt metodave gjyqësore (gjykatat dhe arbitrazhi). Sipas një tjetër këndvështrimi, *‘ndërmjetësimi konsiderohet një zgjatim i negociatave ku palët e përfshira në mosmarrëveshje kërkojnë ndihmën apo pranojnë një oferte ndihme nga nje palë që nuk është e përfshirë direkt në konflikt për të zgjidhur dallimet pa ndwrhryjen e autoritetit ligjor. Transformimi i marrëdhënies nga dypalëshe (negociatat) në trepalëshe krijon një hapësirë të gjerë për influencimin e marrredhenies midis paleve konfliktuale’* (Kleiboer M. 1996: 360). Në këtë kuptim, ndërhyrja e një pale të tretë në funksion të thyerjes së barrierave që ndajnë palët në konflikt dhe ndihmesës për arritjen në një zgjidhje të pranueshme nga të gjitha palët, ndodh në të gjitha ato raste kur palët e përfshira në një mosmarrëveshje ndërkombëtare e kanë të pamundur zgjidhjen nëpërmjet negociatave.Ndërmjetësimi u mundëson palëve të ruajnë pavarësinë e tyre gjatë gjithë procesit të vendimmarrjes për shkak të nivelit të ulët të ndërhyrjes dhe natyrës ad hoc. Në këto kushte, arsyeja kryesore e preferimit të kësaj metode është se palët konfliktuale e kontrollojnë vetë përfundimin në të cilën arrihet duke mbetur protagonistët kryesorë përgjatë gjithë procesit. Kjo përbën edhe një nga avantazhet kryesore të ndërmjetësimit, që e bën edhe më të preferueshëm përkundrejt metodave gjyqësore (gjykatat dhe arbitrazhi), në të cilin palët konfliktuale nuk e kontrollojnë dot të gjithë procesin dhe vendimi për zgjidhjen. Kjo nënkupton se ndërmjetësi kursesi nuk mund të ketë kompetenca vendimmarrëse në raport me marrëveshjen përfundimtare që mund të arrihet (nëse arrihet) midis palëve të përfshira në konflikt. Roli i tij është të asistoj palët në konflikt të arrijnë një marrëveshje të cilën nuk janë në gjendje ta arrijnë vetë (Touval S. Zartman I W. 2006)). Synimi kryesor është që të arrihet një zgjidhje e shumës jo zero (fito-fito), duke nënkuptuar se të gjitha palët duhet të kenë përfitime. Në këtë mënyrë, sikundër nënvizon studiuesi Zartman (2008), *‘ndërmjetësimi konsiderohet një proces politik që nuk u imponon*

*palëve qëndrime apo sjellje të caktuara. Megjithëse ka ndikim thuajse të pakonsiderueshëm në arritjen e një marrëveshjeje, ndërmjetësuesi nga ana tjerë ushtron një kontroll të lartë mbi mbarëvajtjen e procesit në funksion të arritjes së një marrëveshjeje. Kjo nënkupton se nëse rezultati përfundimtar përcaktohet vetëm nga palët konfliktuale, mbarëvajtja e procesit të ndërmjetësimit është kompetencë e palës së tretë'. Në funksion të përmbushjes së këtij synimi, ndërmjetësuesi ka si angazhim kryesor (Horowitz S. 2007) rritjen e besimit të palëve konfliktuale të njeri-tjetri në funksion të krijimit të një klime bashkëpunimi. Thyerja e barrierrave subjektive që ndan palët në konflikt mbetet një nga sfidat kryesore të ndërmjetësuesit. Në të gjitha situatat konfliktuale të armatosura dhe të gjata në kohë, mosbesimi që palët konfliktuale kanë të njëra tjetra është shumë i lartë, duke e vështirësuar në këtë mënyrë procesin e gjetjes së një zgjidhjeje. Për këtë arsye detyra kryesore e një ndërmjetësuesi mbetet përmirësimi i komunikimit midis palëve konfliktuale dhe ti siguroj ato që të gjitha pretendimet dhe sygjerimet e tyre do të merren në konsideratë. Dhënia prioritet e konfidencialitetit mbetet gjithashtu një nga sfidat kryesore në funksion të arritjes së një marrëveshjeje të pranueshme nga të gjitha palët konfliktuale.*

Sipas studiueses Horowitz (2007), detyra e një ndërmjetësuesi është krijimi i kushteve për zhvillimin e një dialogu të hapur konstruktiv dhe mbi të gjitha të sigurohet se palët e përfshira në konflikt të kenë lirinë e fjalës dhe mbi të gjitha autonomi në vendimmarrje. Duke nënvizuar se ndërmjetësuesi është në rolin e një lehtësuesi, instruktori apo komunikuesi që ndihmon në sqarimin e mosmarrëveshjeve, në identifikimin dhe menaxhimin e emocioneve (dimensioni subjektiv), të gjitha këto në funksion të krijimit të kushteve të favorshme për të mundësuar arritjen e një marrëveshjeje.

Duke e konsideruar 'ndërmjetësimin një proces vullnetar' (Bercovitch J. 1986), kjo evidenton një karakteristikë tjetër shumë të rëndësishme që lidhet me besimin që palët në konflikt kanë të ndërmjetësuesi. Palët konfliktuale dakortësohen për një ose disa ndërmjetësues specifik për shkak edhe të besimit që kanë tek ta. Niveli i lartë i besueshmërisë është i lidhur ngushtësisht edhe me paanshmërinë e ndërmjetësuesit, një karakteristikë shumë e rëndësishme kjo, në mungesë të të cilit nuk mund të flitet për ndërmjetësim. Palët konfliktuale dakortësohen për aktorin ndërmjetësues vetëm nëse kanë bindjen se nuk do të mbajë anën

e palës kundërshtare. Ndërmjetësuesi gjatë gjithë procesit do duhet të tregojë një pozicionim të ekuilibruar duke garantuar mbështetje të njëjtë për palët në konflikt, me qëllim arritjen e një zgjidhjeje të shumës jo zero (fito-fito).

E rëndësishme është që ndërmjetësuesi duke pasur si karakteristika faktin që është i besueshëm, i paanshëm dhe bindës, i lind si detyrë të garantojë një mjedis favorizues për negociatat duke i lejuar aktorët të dëgjojnë dhe kuptojnë veten dhe njëri-tjetrin, të pranojnë dhe vlerësojnë interesat dhe nevojat e tyre duke i renditur sipas rëndësisë dhe të ndërtojnë sëbashku me ndërmjetësuesin – opsionet që ekzistojnë në funksion të arritjes së një marrëveshjeje të realizueshme, të drejtë dhe të qëndrueshme, në mënyrë që të jetë mjaftueshëm fleksibël duke marrë në konsideratë mundësinë e rregullimeve të klauzolave të saj në të ardhmen (Horowitz 2007: 54).

Në mënyrë që ndërmjetësimi të jetë i suksesshëm është domosdoshmëri që aktorët ndërmjetësues të kenë aftësinë dhe gjykimin e nevojshëm për të zbatuar me sukses ndërmjetësimin. Ndonëse është një proces serioz dhe që kërkon kohë, ndërmjetësimi rrallë rezulton të jetë i dëmshëm më shumë sesa i dobishëm, dhe shpesh çon përpara kauzën e zgjidhjes konstruktive të konfliktit dhe sigurisht interesat e vetë ndërmjetësit (Bercovitch , J 1992 )

## **QASJA E SHTETEVE NË NDËRMJETËSIMIN E KONFLIKTEVE**

Shtetet përfaqësojnë aktorin politik më të zakonshëm (më të shpeshtë) të përgatitur për të ndërmjetësuar konflikte ndërkombëtare. Megjithatë, jo të gjitha shtetet ofrojnë shërbimet e tyre si ndërmjetësues, ashtu sikundër jo të gjitha konfliktet asistohen nga ndërmjetës. Theksojmë gjithashtu, se edhe motivet që shtojnë shtetet të bëhen pjesë e proceseve ndërmjetësuese janë të ndryshme nga motivet e aktorëve të tjerw (Mellin M. 2013). Studimet tregojnë se në pjesën më të madhe të rasteve përfshirja e shteteve si palë të treta është e ndikuar nga motive të natyrës humanitare, por në çdo rast përmbushja e interesave të shteteve ndërmjetësuese përbën një tjetër motiv kryesor të ndërhyrjes. Përfshirja në menaxhimin e konflikteve në të gjitha situatat ( kur ftohen nga palët konfliktuale, kur vetëofrohen apo kur ekzistojnë marrëveshje të mëparshme për aktorë të tretë specifikë), mbart një kosto të caktuar. Për këtë arsye vendimi i përfshirjes së shteteve është i bazuar edhe në një analizë kosto-përfitim (Vuković S. 2016). Kjo për faktin se,

sikundër e përcakton edhe Bercovitch, (2009) ndërmjetësimi ‘të konsumon kohë, mbart risqe, pasiguri dhe që shpesh mund të rezultojë edhe me dështim’. Rrallëherë ndërmjetësit nuk tregojnë interes për termat që diskutohen. Pavarësisht nga fakti se interesat e ndërmjetësuesve zakonisht lejojnë një gamë më të madhe rezultatesh të pranueshme sesa interesat e palëve, ata përpiqen të shmangin termat që janë në konflikt me interesat e tyre. Ndërmjetësimi shihet si rezultat i të kuptuarit të sistemit global nga ndërmjetësi, kërkesave të tij të brendshme dhe qëllimeve dhe taktikave të politikës së jashtme. Sipas këtij këndvështrimi, ndërmjetësimi nuk shihet si një veprim i veçantë që ndodh “brenda mjedisit” të politikës ndërkombëtare, por më tepër si një komponent i politikës së brendshme dhe politikës së jashtme. Nga pikëpamja e politikës së jashtme, ndërmjetësimi shihet si një instrument i politikës së jashtme. Për këtë arsye, ai mund të krahasohet me mjete të tjera të politikës, duke përfshirë ato diplomatike, ushtarake dhe ekonomike (Touval S. 2003: 92-95)

Duke i konceptuar shtetet si aktorë racionalë, veprimet e të cilëve bazohen në kalkulime strategjike, me synimin kryesor përmbushjen e interesave vetjak, motivet që influencojnë vendimin e tyre për të ndërmjetësuar, duke përdorur terminologjinë e Zartman (2008: 156-157), ndahen në mbrojtëse dhe sulmuese (*defensive dhe offensive*). Për efekt analize këto trajtohen të veçuara, por në shumicën e situatave ndërmjetësuese këto dy motive dominante ndërthuren me njëra-tjetrën. Kështu, motivet mbrojtëse ilustrohen nga të gjitha ato raste kur konflikti çënon interesat e një ose disa shteteve të tjera. Shtetet interesat e të cilave preken nga vazhdimi i konfliktit shpesh shfaqin interes të ndërmjetësojnë zgjidhjen e tij.

Për shkak se konflikti ka një ndikim në marrëdhëniet e ndërmjetësit me palët konfliktuale, zgjidhja është vendimtare për ndërmjetësuesin. Propabiliteti që konfliktet ndërkombëtare midis dy ose më shumë shteteve të prishin ekuilibrat rajonal dhe ato ndërkombëtar duke u krijuar njëkohësisht hapësira fuqive rivale të rrisin influencën e tyre nga mbështetja që mund t’i ofrojnë njëres prej palëve në konflikt, është gjithmonë i pranishëm. Për këtë arsye, roli i shtetit (apo shteteve) ndërmjetësues merr një rëndësi të veçantë. Shtetet kryesisht ato të fuqishme (superfuqitë apo fuqitë rajonale) janë të prirura të ndërmjetësojnë edhe për të frenuar shtrirjen e influencës së fuqive rivale. Psh. roli i Rusisë si ndërmjetësues në konflikte si ato të:

Nagorno-Karabakut, Armenisë dhe Azerbajxhanit, konfliktet midis Gjeorgjisë dhe rajoneve separatiste të Abkhazisë dhe Osetisë së Jugut etj, është një tregues i demarkacionit nga Moska të zonës së saj të ndikimit. Në të njëjtën perspektivë të politikës së jashtme mund të themi se edhe në situatën e luftës në Bosnje, pasi Komuniteti Evropian dështoi të ndërmjetësonte një zgjidhje paqësore, përfshirja e SHBA-së në menaxhimin e luftës konsiderohet si një mwnyrw për të demonstruar rëndësinë e saj (influcën) në Kontinentin Evropian etj. (Vuković S. 2016: 20). Motivi tjetër sipas Zartman (2008: 157) në funksion të përmbushjes së interesave të shteteve ndërmjetësuese është ai që përcaktohet si sulmues (offensive), që nënkupton se në këtë rast shtetet e përdorin ndërmjetësimin për të zgjeruar influencën apo ndikimin e tyre në rajon dhe më gjerë (në varësi të kontekstit të konfliktit). Procesi i ndërmjetësimit ka për qëllim thjesht të ndihmojë njërën ose të dyja palët (ose më shumë) konfliktuale dhe nuk ka asnjë ndikim të drejtpërdrejtë në aftësinë e ndërmjetësit për të zgjidhur problemin. Për këtë arsye shteti ndërmjetësues do të synonte të fitonte mirënjohjen e palëve konfliktuale, ose të paktën të njëjës prej tyre, duke dhënë kontributin e tij në zgjidhjen e konfliktit. Në këtë kuptim, shtetet në mënyrë individuale apo kolektive mund të ndërhyjnë në një mosmarrëveshje nëse një veprim i tillë do të çonte përpara objektivat e tyre politike, apo e thënë ndryshe do të rriste ndikimin e tyre. Duke e konceptuar ndërmjetësimin në perspektivën e politikës së jashtme, nwnvizojmw se edhe përpjekjet për ndërmjetësim të Turqisë, Katarit dhe Iranit përgjatë *Pranverës Arabe* ishin në përputhje me prioritetet e politikës së tyre të jashtme, me qëllim shtrirjen e influencës në rajon. (Akpınar P. 2015). Rritja e influencës përveç të tjerave konsiderohet e lidhur ngushtësisht edhe me faktin e të vepruarit si garantues të marrëveshjeve të arritura. Mund të përmendim rolin e Shtetet e Bashkuara, Argjentinës, Brazilit dhe Kilit që vepruan si garantues të Protokollit të Rios të vitit 1942 për të kontrolluar krizat midis Ekuadorit dhe Perusë në vitet 1935, 1941, 1981, 1991 dhe 1995 (Jeong Ho W. 2010: 188).

Në këto kushte shtetet që ofrohen të ndërmjetësojnë apo që u bëhet ftesa të ndërmjetësojnë në varësi të karakteristikave të konfliktit synojnë të përmbushin një ose disa qëllime të tyre që mund të jenë: të fitojnë simpatinë e palëve konfliktuale, të rrisin mundësinë e ndikimit dhe marrëdhënieve të mira pas përfundimit të konfliktit me palët e

përfshira në konflikt, të ruajnë zonat e tyre të influencës dhe sigurisht të ofrojnë stabilitet në rajon dhe më gjerë.

Kur flasim për ndërmjetësimin e shteteve duhet të specifikojmë se në të gjitha rastet e ndërhyrjeve shtetet përgjithësisht angazhojnë përfaqësuesit e tyre më të rëndësishëm në vendimmarrje. Mund të veçojmë figura si: Kissinger, Presidenti Carter, Lordi Carrington etj. Aftësia e personave të tillë për të ndërmjetësuar konfliktet ndërkombëtare varet nga (a) pozicioni që ata kanë brenda vendit të tyre, (b) hapësira që u është dhënë në formulimin e politikave dhe (c) burimet, kapacitetet dhe filozofitë e ndryshme politike të shteteve që përfaqësojnë (Bercovitch , J 1992: 12).

## **RASTI I TURQISË**

Gjithmonë e më shumë shtetet po e konceptojnë ndërmjetësimin si ‘pjesë të politikës së jashtme’ (Touval S. 2003: 91). Në këtë pikë të trajtesës vlen të ilustrujmë rastin e Turqisë dhe rolit të saj si ndërmjetësues. Turqia paraqet një nga rastet tipike të shtetit që e sheh të lidhur ngushtësisht ndërmjetësimin me politikën e saj të jashtme, e cila me një synim të qartë për të institucionalizuar këtë aktivitet, ka ndërmarrë hapa për ta konsideruar ndërmjetësimin ndërkombëtar si një "diplomaci të veçantë" (Dieckhoff, M 2014 ; 107). Politika rajonale e Turqisë bazohet në sigurinë për të gjithë, dialogun politik të nivelit të lartë, integrimin ekonomik dhe ndërvarësinë, dhe bashkëjetesën multikulturore. Në funksion të këtij qëllimi ka implementuar principin e ‘zero probleme me fqinjët’ (**Davutoğlu** A. 2010, MFA 2022b).

Turqia është i vetmi vend që shërben si bashkëkryetar i Friends of Mediation Groups në OKB, OSBE, dhe që luan një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e konflikteve dhe ndërmjetësimin, duke përcaktuar orientimin e politikës së jashtme drejt rezultateve dhe një politike realiste (MFA 2022c) Në përcaktimin që i bën Davutoğlu “Turqia përfaqëson një rast unik të një vendi që ka ushqyer partneritete të gjata me perëndimin dhe njëkohësisht ka lidhje të forta qytetërore dhe kulturore me shumë vende të tjera të botës” (Aras B. 2012). Ky pozicionim i jep një status të veçantë. Afërsia me vendet e perëndimit dhe vendeve kryesisht të botës myslimane, përbën një avantazh të rëndësishëm që favorizon përfshirjen e Turqisë si palë ndërmjetësuese. Sipas të dhënave të Ministrisë së Jashtme të Turqisë për zgjidhjen e konflikteve dhe ndërmjetësimin (MFA 2022a), Turqia ka qënë e



pranishme me përpjekjet e saj për ndërmjetësimin e konflikteve në rajone të ndryshme. Këtu përfshihen përpjekjet për të sjellë pajtimin e brendshëm në Irak, Liban dhe Kirgistan; dy procese të veçanta bashkëpunimi trepalësh të nisura me pjesëmarrjen e Serbisë dhe Kroacisë për të arritur paqen dhe stabilitetin e qëndrueshëm në Bosnje-Hercegovinë; një mekanizëm bashkëpunimi trepalësh i nisur me Afganistanin dhe Pakistanin, i cili ka një rol të rëndësishëm në sigurimin e paqes dhe sigurisë në Afganistan, si dhe iniciativën "Zemra e Azisë - Procesi i Stambollit" e krijuar për të promovuar pronësinë rajonale; përpjekjet për zgjidhjen paqësore përmes dialogut të çështjes së programit bërthamor të Iranit; mbështetje për procesin e paqes në Filipinet e Jugut dhe hapat për të lehtësuar dialogun midis Ukrainës dhe Federatës Ruse.

Në të gjitha situatat e përfshira Turqia karakterizohet nga një pozicion neutral lehtësisht të pranueshëm nga palët konfliktuale dhe përgjithësisht ka përdorur strategjinë e lehtësimit të komunikimit. Vlen të theksojmë se neutraliteti është i lidhur ngushtësisht me besimin që palët konfliktuale kanë te shteti ndërmjetësues, në këtë rast Turqisë.

Kur bëhet fjalë për të vepruar si ndërmjetëse në Lindjen e Mesme, Turqia ka shumë burime dhe potencial real. Sigurisht, afërsia në aspektin e kulturës dhe vendndodhjes është vendimtare. Më shumë se çdo komb tjetër, Turqia i njeh dhe i kupton shoqëritë e rajonit, duke përfshirë mentalitetet, mënyrat e të menduarit dhe modelet e sjelljes së tyre. Politikanët kryesorë turq njohin drejtpërdrejt shumë politikanë të Lindjes së Mesme (si nga qeveria ashtu edhe nga opozita); kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e çështjes së ndërmjetësimit dhe ka qenë një përfitim i madh në diskutimet me të dyja palët në konfliktet dhe tensionet që shpërthyen në 2011. (Szymański A. 2011; 80).

Së fundmi janë përpjekjet e saj për të ndërmjetësuar luftën Rusi-Ukrainë.. Turqia është një vend anëtar i Natos që furnizon me armë Ukrainën, por ndërkohë nuk i është bashkuar sanksioneve të perëndimit ndaj Rusisë. Krahas pozicionimit gjeografik, kufijtë detarë që e lidhin si me Ukrainën ashtu edhe me Rusinë, Turqia është partneri më i madh tregtar i Rusisë në rajonin e Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut. Ka konkurruar dhe bashkëpunuar me Rusinë përmes zonave të konfliktit në Siri, Libi dhe Nagorno-Karabakh në vitet e fundit. Ky lloj pozicionimi bashkangjitur me qëllimet e politikës së jashtme turke në

funksion të zgjidhjes së konflikteve ,e bën Turqinë të jetë ndërmjetësuesi ideal në këtë konflikt.

Vlen të nënvizojmë se, ‘ndërmjetësimi funksionon mirë për interesat e Turqisë. Ajo ngre profilin e saj në arenën ndërkombëtare, e bën Turqinë një nga pikat kryesore diplomatike në këtë krizë dhe shtyn të bëjë disa nga zgjedhjet sfiduese që mund t'i duhet të bëjë përfundimisht’ (Dalay G 2022). Ose referuar analizës në the Guardian (2022), ndërmjetësimi i ka shërbyer Turqisë për ‘rritjen e staturës së diplomacisë’. Përcaktimi i ndërmjetësimit si pjesë e politikës së jashtme, në shumë raste karakterizohet nga histori sukse si jo vetëm për shtetin ndërmjetësues, por edhe për paqen dhe stabilitetin e rajonit dhe botës në përgjithësi. Në këtë kontekst theksojmë se, nënshkrimi në Stamboll i marrëveshjes për eksportin e grurit në korrik 2022, e negociuar nga Turqia nën monitorimin e Kombeve të Bashkuara, është marrëveshja e parë e sukseshme që arrin Turqia që nga fillimi i konfliktit Rusi-Ukrainë duke u konsideruar një fitore historike dhe humanitare që padyshim ndikon në forcimin dhe rritjen e besimit te roli ndërmjetësues i Turqisë, që sikurse e përcakton presidenti i Turëisë Erdogan (Global News 2022); “sido që të zhvillohen luftimet ne terren, lufta përfundimisht do të përfundojë në tryezën negociuese”. Një deklaratë e tillë reflekton besimin dhe vendosmërinë e shtetit turk si ndërmjetësues, që në situatën kur lufta ‘po ndryshon në mënyrë thelbësore gjeopolitikën dhe balancën e fuqisë në rajonin e Detit të Zi, Turqia mbetet një fuqi dominante e saj’ (Dalay G. 2022).

## **PËRFUNDIME**

Ndërmjetësimi si një nga metodat politike më të preferuara në zgjidhjen e konflikteve si nga palët konfliktuale, ashtu edhe nga aktorët ndërmjetësues rezulton të jetë një proces kompleks dhe mbi të gjitha delikat. Kjo për faktin se palët e treta do duhet që paralelisht të mund t'i japin fund luftimeve dhe gjithashtu të mund të arrijnë një marrëveshjeje paqeje të cilën palët në konflikt nuk mund ta realizojnë në mungesë të ndërmjetësuesit. Për shkak të karakteristikave që duhet të mbart ky proces të tilla si: mospërdorimi i forcës, liria që palët konfliktuale kanë për të vendosur mbi rrjedhën e bisedimeve me ndërmjetësim, besimi që kanë te ndërmjetësuesi, paanshmëria dhe aftësia bindëse e ndërmjetësuesit janë vendimtare për suksesin e ndërmjetësimit. Kjo marrëdhënie që krijohet sigurisht që mbart kosto,

përfshin strategji të caktuara dhe padyshim edhe interesa. Analizimi në mënyrë specifike i shteteve si ndërmjetësues dhe i qasjes teorike që e konsideron ndërmjetësimin jo thjesht të ndikuar nga politika, por si pjesë integrale të politikës së jashtme evidenton se shtetet si aktorë racionalë i bazojnë veprimet në kalkulime strategjike. Nga analizimi i rastit të Turqisë evidentohet se, pavarësisht rolit tejet aktiv dhe përpjekjeve të saj për t'u përfshirë në zgjidhjen e konflikteve duke i mëshuar strategjisë dhe rolit të ndërmjetësimit në politikën e jashtme, Turqia karakterizohet nga një politikë realiste e bazuar në analizën e kosto – përfitimeve. Konsiderimi i ndërmjetësimit si 'instrument politik, pjesë të politikës së jashtme', ashtu sikundër të gjithë instrumentat e tjerë politik që shtetet kanë në dispozicion, vë në një plan më prioritar përmbushjen e interesave të shteteve, krahas qëllimeve humanitare që karakterizojnë veprimet e tyre në funksion të zgjidhjes së konflikteve.

## **BIBLIOGRAFIA**

- Bercovitch J. (1986) *International Mediation: A Study of the Incidence, Strategies and Conditions of Successful Outcomes. Cooperation and Conflict*, XXI , 1986, 155-168.
- Bercovitch J. (1992) *The Structure and Diversity of Mediation in International Relations* te Bercovitch, J., Rubin, J Z (ed) 1992 "Mediation in International Relations: Multiple Approaches to conflict management", Macmillan,
- Touval S. (1992) *The Superpowers as Mediators* te Bercovitch, J and Rubin JZ (eds). *Mediation in International Relations: Multiple Approaches to Conflict Management*. Macmillan/St. Martin's Press
- Kleiboer M. (1996) *Understanding Success and Failure of international mediation*, *Journal of Conflict Resolution*, Vol 40, No 2, pp 360-389.
- Bercovitch J. Regan Patrick M. 1999 "The structure of international conflict management: an analysis of the effects of intractability and mediation", *International Journal of Peace Studies*, Vol 4, pp 1-19.
- Touval S. (2003) *Mediation and Foreign Policy*, *International Studies Review*, Dec., 2003, Vol. 5, No. 4, *Dissolving Boundaries* pp. 91-95
- Wilkenfeld J. Young Kathleen J. Quinn David M. Victor Asal. (2005) *Mediating International Crises*, Routledge.
- Touval, S. and Zartman I. (2006) *International Mediation in the Post- Cold War Era* te Crocker, C.A., Hampson, F.O. and Aall, P.R. (eds) *Turbulent Peace: The Challenges of Managing International Conflicts*, United States Institute of Peace Press, Washington DC, pp. 427-443.

- Horowitz S. (2007) *Mediation* te Webel C. Galtung, J, ed. “Handbook of peace and conflict studies”, Routledge,
- Zartman I. William. (2008) *Negotiation and Conflict Management: Essays on theory and practice*, Routledge.
- Bercovitch, J. (2009) *Mediation and Conflict Resolution* te Bercovitch, J., Kremenyuk, V. and Zartman, I.W. (eds) *The Sage Handbook of Conflict Resolution*, SAGE, London, pp. 340–357
- Touval S. (2010) *Negotiated Cooperation and its Alternatives*, te Zartman, I.W. and Touval S. (eds) *Cooperation: The Extensions and Limits of International Multilateralism*, Cambridge University Press, New York, pp. 78–91.
- Jeong Ho W. (2010) *Conflict Management and Resolution: An introduction*, Routledge
- Davutoglu** A. (2010) ‘Turkey’s zero-problems foreign policy’, *Foreign Policy*, 20 May 2010 <https://foreignpolicy.com/2010/05/20/turkeys-zero-problems-foreign-policy/>
- Bercovitch J. (2011) *Theory and practice of international mediation: Selected essays*. London; New York: Routledge.
- Szymański A. (2011) Turkey’s role in resolving the Middle East conflicts *International Issues & Slovak Foreign Policy Affairs* , Vol. 20, No. 2, *Unrests in the Arab World* (2011), pp. 71-84
- Aras B. (2012) Turkey’s Mediation and Friends of Mediation Initiative, SAM PAPER, Center for Strategic Research
- Melin M. (2013) *When States Mediate*, *Penn State Journal of Law and International Affairs*, Vol. 2, No. 1, pp. 78–90.
- Dieckhoff M. (2014) *International Mediation*, *ERIS* Vol. 1, Issue 2/2014, pp. 107–123
- Akpınar P. (2015) *Mediation as a Foreign Policy Tool in the Arab Spring: Turkey, Qatar and Iran*, *Journal of Balkan and Near Eastern Studies*, DOI: 10.1080/19448953.2015.1063270
- Vuković S. (2016) *International Multiparty Mediation and Conflict Management, Challenges of cooperation and coordination*, Routledge
- United Nations Charter <https://www.un.org/en/about-us/un-charter>
- 
- Dalay G. (2022) *Why Turkey is in a unik position to mediate* <https://edition.cnn.com/2022/03/29/opinions/turkey-mediator-russia-ukraine-dalay/index.html>
- MFA TURKEY (Ministry of Foreign Affairs). (2022a) *Resolution of Conflicts and Mediation*. <http://www.mfa.gov.tr/resolution-of-conflicts-and-mediation.en.mfa>

MFA TURKEY (Ministry of Foreign Affairs). (2022b) **Policy of Zero Problems with our Neighbors** <https://www.mfa.gov.tr/policy-of-zero-problems-with-our-neighbors.en.mfa>

MFA TURKEY (Ministry of Foreign Affairs) (2022c) **TÜRKİYE'S ENTERPRISING AND HUMANITARIAN FOREIGN POLICY** <https://www.mfa.gov.tr/synopsis-of-the-turkish-foreign-policy.en.mfa>

The Guardian (2022) Turkey leads pack of countries vying to mediate between Ukraine and Russia

<https://www.theguardian.com/world/2022/mar/31/turkey-leads-pack-of-countries-vying-to-mediate-between-ukraine-and-russia>

Global News (2022) Russia, Ukraine reach deal on grain exports with UN, Turkey mediating <https://www.youtube.com/watch?v=NAEGuLpkngk>

## MENDIME TË AUTORËVE BRITANIKË DHE AMERIKANË RRETH QEVERISJES SË MBRETIT ZOG

**DR. BENITA STAVRE**

Departamenti i Gjuhëve të Huaja  
Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë  
Universteti “Fan S. Noli”  
[bstavre@unkorce.edu.al](mailto:bstavre@unkorce.edu.al)

**Përmbledhje:** Në literaturën e botuar nga autorë të ndryshëm nga Britania e Madhe ose Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilët e vizituan apo e studiuuan Shqipërinë në periudhën e viteve 1920-1939, janë të shumtë mendimet që nxitin perceptime të ndryshme rreth personalitetit dhe mënyrës se si Ahmet Zogu ia doli të qëndronte në krye të shtetit shqiptar. Në pjesën më të madhe të rasteve, figura e tij personifikon historinë e kësaj periudhe të Shqipërisë. Duket sikur shkrimet biografike dhe kritikën për qeverisjen e tij, mbizotërojnë faqet e librave, artikujt e gazetave dhe dokumentacionin zyrtar në atë pikë sa figurat e tjera, qoftë dhe jo më pak të shquara se ai, përmenden kalimthi. Fotot e Ahmet Zogut dhe të familjes mbretërore u mbivendosen fotografive të personazheve të tjerë të politikës shqiptare. Artikujt e gazetave të botuara në Amerikë dhe Britani i referohen vendit tonë në atë periudhë si “Shqipëria e Mbretit Zog”. Me një fjalë Ahmet Zogu mori përsipër të bënte një pjesë jo të vogël të historisë shqiptare dhe la gjurmë të çuditshme në të, studimi i të cilave bëhet herë pas here shkak mospajtimesh dhe mendimesh që varen shumë nga njohja apo qëndrimi personal i vetë autorëve. Punimi synon të nxjerrë në pah këto këndvështrime, fokusi i të cilave shpjegon kontekstin e cilësisë së qeverisjes së kësaj figure politike.

**Fjalë kyçe:** studiues, udhëtarë britanikë/amerikanë, qeverisje, mbretëri shqiptare.

### THE OPINION OF BRITISH AND AMERICAN AUTHORS REGARDIN KING ZOG GOVERNANCE

**Abstract:** In the published works of various British and American travelers and historians, who visited or wrote about Albania in the '20s and '30s of the last century, there are various perceptions of the personality and the way Ahmet Zog managed his political career. In most cases, his image personifies the country's history of the period. Biographic writings, royal family photos, and critical reviews on his governing attitude cover book pages, newspaper articles, and official documentation to the point that other significant national characters are left in shadow and the country is referred to as “King Zog's

*Albania". Ahmet Zog, in fact, endeavored to write a significant part of Albanian history. The article tries to outline the study of the outlandish traces he left in it, depending on the attitude of the writers who tried to display his image in the political, social, economic, and international context in which King Zog exercised his power. The paper aims to highlight such perspectives, whose focus defines the contextual quality of the governing skills of this political figure.*

**Key words:** *British/ American travelers, government, Albanian kingdom.*

## **HYRJE**

***“Shumë mbretër, ashtu si dhe malet,  
mund të vlerësohen më mirë nëse  
këqyren nga larg.  
Si miqtë ashtu edhe kundërshtarët e tij  
Mund të japin vlerësime më objektive  
pas një gjysëm shekulli.”  
Edvin Xhaks (1995, 441)***

Në periudhën e viteve 1920 dhe 1930, Shqipëria sapo kishte kapërcyer pragun e të qenit një shprehje gjeografike, me domethënie thujse minimale në qenësinë e saj si një shtet-komb. Edhe pse, në dekadën e dytë të pavarësisë, stabiliteti politik dhe shoqëror ishte ende në hapat e veta të para, diplomacia botërore filloi të dëgjonte zërin e këtij shteti. Britania e madhe dërgoi përfaqësuesin e saj të parë në vitin 1922, i cili u pasua dy muaj me vonë nga përfaqësuesi i diplomacisë shqiptare në selinë e tij në Londër. Departamenti Amerikan i Shtetit, nuk vonoi dhe në dhjetor të po atij viti Ministri i pare Amerikan filloi punë si përfaqësuesi i qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri. Që prej atij viti, Shqipëria krijoi lidhje jo të parëndësishme me të dy shtete.

Duke qenë se shteti shqiptar ishte i dobët në thujse të gjitha aspektet e jetës, ekonomisë, arsimit, dhe shërbimit shëndetësor, atij i nevojitej ndihmesa e një shteti tjetër. Kjo kërkesë iu drejtua më së shumti Britanisë së madhe. Shumë herë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, kjo kërkesë u refuzua, megjithatë kjo mund të quhet një periudhë në të cilën numri i britanikëve apo amerikanëve që e kanë prekur realitetin shqiptar nuk ka qenë i vogël. Madje numri i atyre që kanë dashur të analizojnë aspektet të ndryshme të zhvillimit të saj

politik ka qënë i konsiderueshëm. Marrëdhëniet e para diplomatike dhe konsullore, u ndoqën nga përpjekjet për të reformuar xhandarmërinë shqiptare sipas modelit britanik, nga përpjekje për të krijuar lidhje të qëndrueshme ekonomike me shoqëri koncesionare për nxjerrjen e naftës, si dhe me kontributin e fondacioneve humanitare (kryesisht në fushën e arsimit). Këto sollën jo pak vëmendje të britanikëve dhe amerikanëve në Shqipëri dhe, si rrjedhim, edhe mjaft shkrime për këtë vend të vogël, ndërmarrjet modeste të të cilit për të krijuar një shteg drejt përdimit të rihqin jo pak vëmendje.

Në literaturën e botuar nga autorë të ndryshëm nga Britania e Madhe ose Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilët e vizituan apo e studiuuan Shqipërinë në periudhën e viteve 1920-1939, janë të shumtë mendimet që nxitin perceptime të ndryshme rreth personalitetit dhe mënyrës së Ahmet Zogut ia doli të qëndronte në krye të shtetit shqiptar. Në pjesën më të madhe të rasteve, figura e tij personifikon historinë e kësaj periudhe të Shqipërisë. Duket sikur shkrimet biografike dhe kritikën për qeverisjen e tij, mbizotërojnë faqet e librave, artikujt e gazetave dhe dokumentacionin zyrtar në atë pikë sa figurat e tjera, qoftë dhe jo më pak të shquara se ai, përmenden kalimthi. Fotot e Ahmet Zogut dhe të familjes mbretërore u mbivendosen fotografive të personazheve të tjerë të politikës shqiptare. Artikujt e gazetave të botuara në Amerikë dhe Britani i referohen vendit tonë në atë periudhë si “Shqipëria e Mbretit Zog”. Me një fjalë Ahmet Zogu mori përsipër të bënte një pjesë jo të vogël të historisë shqiptare dhe la gjurmë të çuditshme në të, studimi i të cilave bëhet herë pas here shkak mospajtimesh dhe mendimesh që varen shumë nga njohja apo qëndrimi personal i vetë autorëve.

### ***Cilësime rreth figurës së Ahmet Zogut***

Figura e tij personifikon një konglomerat cilësish ku herë spikatin sqima, nuhatja dhe dinakëria e tij politike dhe, herë të tjera, paaftësia për të dalë nga rrethi i ngushtë i mentaliteteve të vjetra dhe politikave orientale. Në hyrje të librit të tij biografik “Mbret Zog i Shqipërisë: Mbreti musliman i vetëshpallur në Evropë”, Xheizn Toms (Jason Tomes) (2003) shkruan: “Bashkëkohësit nuk mund ta përcaktonin qartë mendimin që kishin për të. Epitetet që përdorën për të janë të shumtë dhe mjaft të ndryshëm: “mbreti i fundit i romancave”, “kusar tiran”, “gangster i urryer”, “monark piktoresk”, “Napoleoni i kohëve të sotme”, “lakeu i Musolinit”, “ndoshta patrioti më i mprehtë nga të



gjithë”, “sundimtar lindor i dobët dhe shtatvogël”, “lexues i Shekspirit dhe një luftëtar i zoti”, (...) “një produkt tipik ballkanik” (...)” (v). Ata që e njohën drejtpërdrejt, qoftë diplomatë, vizitorë apo gazetarë e përshkruajnë të zhytur në një re tymi të vazhdueshme që i shtonte mjegull atmosferës së zyrtë të zyrës së tij. Zyra ishte një ekspozitë mobiljesh dhe tapetesh orientale dhe nëpër muret e saj apo në tryezën e punës ekspozoheshin me krenari pjesë të një arsenali armësh si trofe të një kaluare jo të qetë dhe një ardhmeje po aq të pasigurt të Shqipërisë. Prapa tij qëndron shpesh varur portreti i Nënës Mbretëreshë, prania e së cilës reflektohet jo rrallë në konceptin që Mbreti kishte për aftësitë organizative të një femre tipike shqiptare. Vetë Mbreti shfaqet gjithmonë serioz, me veshje të dizenuara kujdesshëm dhe mjaft të kushtueshme (me përjashtim të rasteve kur uniforma e tij të bardhë i linte shumë për të dëshiruar syrit të një perëndimori). Pavarësisht seriozitetit solemn dhe të qenit “i pashëm, i sjellshëm, i kujdesshëm dhe i paskrupullt”, Ahmet Zogu përshkruhet shpesh si “një duhanxhi të cilit i pëlqenin muzika dhe filmat klasikë perëndimorë” (Caventish, 2008). Një vit para se të shpallej mbret ai dha një intervistë për gazetaren e *The New York Times*-it, An O’Hare Mekormik (Ann O’Hare Macormic). Në shkrimin e saj ndihet ndjeshëm admirimi për figurën dhe aftësitë drejtuese që Ahmet Zogu kishte mundur t’i shpaloste deri atëherë në Shqipëri. Gazetarja shkruan: “Ai është një Shkëlqesi, një djalë i ri, por serioz, që flet me zë të ulët dhe në një mënyrë modeste. Asnjë person që e takon nuk mendon se ai është nga ata luftëtarë që kanë luftuar që në moshën 18-vjeçare; një diktator i hekurt, i rregullt dhe progresist, burrë shteti që “ka tërhequr një kontinent për veshi” dhe që ka zhndërruar vendin e tij pothuaj në qendrën e gravitetit për Evropën” (The New York Times, March 20, 1927).

Nisur nga sa këndvështirmi i gazetares Mekormik, duket qartë se studiuesit e huaj të historisë shqiptare, dhe sidomos biografët e Ahmet Zogut, e kanë kapur figurën e tij në një dimension më të gjerë, në atë të kontekstit të kohës dhe rrethanave në të cilat ai u rrit, dhe në të cilat iu desh të formonte karakterin e tij. Të gjithë bien dakord në faktin që dobësitë në reformat politike ishin pasojë e edukimit të tij të cunguar. Vitet që kaloi në aktivitet të plotë në politikën shqiptare pavarësisht moshës së re nuk e kompesuan dot boshllëkun që krijuan tek ai studimet e lëna përgjysëm në Stamboll. Liceu Perandorak i Galata

Sarajit ishte një nga shkollat shtetërore më prestigjoze në Turqi. Aty kishin ndjekur studimet me pagesë shumë prej politikanëve, diplomatëve, shkrimtarëve të njohur turq. Sipas Toms, ai ia doli shumë mirë në një pjesë të mirë të lëndëve gjatë kohës që studioi aty, sidomos në lëndët që kishin të bënin me karrierën ushtarake. Qëndrimi në Turqi gjatë revolucionit të xhonturqve e pajisi me këndvështrime moderniste në lidhje me botën myslimane, pikëpamje të cilat ai i përdori në hartimin e Kodit Civil shqiptar gjatë mbretërimit të tij. Megjithatë Ahmet Zogu nuk mundi ta rrokë të plotë morinë e kësaj bote njohurish dhe përvojash. Ai vendosi të kthehej në Shqipëri për t'u vënë në krye të revoltës që fiset veriore të Shqipërisë po bënin kundër sundimit turk në vend. Largimi i tij nga bota e qytetëruar e la të cunguar botëkuptimin e tij rreth politikanit modern, botëkuptim i cili nuk shkoi përtej ideve glorifikuese me të cilat ai kishte rrethuar imazhin e Napoleon Bonapardit apo imazhit të Sulltanit në oborrin e Abdul Hamid II.

Ai nuk e njohu në kohën e duhur diplomacinë e politikës evropiane dhe as nuk mundi ta kuptonte tërësinë e interesave që e karakterizonin; kur e bëri këtë ishte tashmë shumë vonë. Zogu e kuptoi që shpëtimi i Shqipërisë, si një vend ballkanik duhej të ishte i lidhur me mbrojtjen e një fuqie evropiane. A nuk i mbështeste Franca interesat jugosllave dhe Anglia ato greke? Fatkeqësisht në rastin e Shqipërisë, shtetet evropiane nuk dëshironin ta përfshinin veten në mënyrë të drejtpërdrejtë, sepse kjo i kompromentonte po aq drejtpërdrejt interesat e tyre me ato të një vendi tjetër ballkanik dhe fuqinë që e mbështeste respektivisht këtë të fundit. Ky ishte një çmim që Shqipëria e kishte paguar shpesh, por që e shndërroi Ahmet Zogun në një drejtues shteti që duhej të kujdesej njëkohësisht që interesat e përtej kufijve të mos ndikonin në interesat, ekonominë dhe qetësinë publike brenda kufijve. Pra, përveç shumë çështjeve problematike që ai i sheshoi -apo mendoi se i sheshoi- midis shtresave shoqërore, përkatësive fetare dhe hapësirave gjeografike, Mbreti duhej të kujdesej që format sado të vogla të pakënaqësive në vend të mos mbështeteshin nga ndonjë ndikim i jashtëm që do t'u jepte atyre përmasa edhe më të mëdha se ç' duhej. Me fjalët e Xhozef Rousek (Joseph Rouseck): "Në këtë realitet të çuditshëm Zogu I kreu detyrën që fati i kishte ngarkuar të bënte, me zell, qytetari dhe qetësi - të kombinuara me dozën e duhur të paskruptullsisë. Cilësitë e tij personale e ndihmuan të qëndronte i papërkulur në një mbretëri ku fiton ai që ka këmbëzën të armës më të shpejtë" (Rouseck, 1939, 96).

Që regjimi i Ahmet Zogut ishte “një përzjerje interesash mes një kryetari fisi, një banditi luftëtar, një pashai otoman dhe një despoti të moderuar” (360) këtë e pranon edhe Xhozef Rothsçaild (Joseph Rothschild). Në librin e tij “Evropa Lindore Qëndrore mes dy Luftrave Botërore”, ai analizon mënyrën e çuditshme të qeverisjes së Ahmet Zogut dhe arrin në përfundimin se vetë personaliteti i ashpër i këtij të fundit e zhndërronte në një autoritarist në politikën e brendshme, por e bënte të kujdesshëm dhe pragmatik në pozitën e lëkundur të interesave ndërkombëtare të kohës. “Në analizë të fundit”, shkruan Rothsçaild, “të kesh arritur në vetëm dhjetë vjet konsolidimin e shtetit të ri shqiptar përballë ndikimeve të regjinalizmit dhe tribalizmit, përballë traditës së rebelimit dhe banditizmit, përballë gërryerjeve të varfërisë dhe analfabetizmit masiv (...) ishte një arritje politike për t’u lavdëruar.” (Rothschild, 2004, 360)

E gjykuar thjesht në një realitet shqiptar, sipas Edvin Xhaks (Edwin Jacques), qeverisja e Mbretit Zog kishte të metat e saj, por këto gjykohen si mjete me të cilat ai menaxhonte një realitet të vështirë shqiptar. Ai e kufizoi mbajtjen e armëve për një pjesë të mirë të fiseve “duke bërë kujdes që nga ky rregull të përjashtoheshin burrat e fisit të tij dhe të disa fiseve nga besnikëria e të cilëve ai varej drejtperdrejt.” Kryetarët e fiseve që bashkëpunuan me të u shpërblyen me ndere dhe para (të cilat studiuesi Bernd Fisher i quajti “paratë e paqes” duke qenë se me to iu desh të mbante shtruar shpirtin e tyre rebel QSA, 2011, 25). Kjo ishte një lëvizje që kufizonte në të njëjtën kohë si gjakmarrjen ashtu edhe kusarinë, dy fenomene të cilat vetë Mbreti i shpalli të jashtëligjshme. Ai ia doli të bindte pjesën më të mirë të shqiptarëve të zakonshëm se nëse nuk kishte lidhje me politikën, vrasja e dikujt do të konsiderohej krim. Kjo e ndihmonte edhe të krijonte bazat e një shteti duke zvogëluar përçarjen fisnore dhe duke rritur ndërgjegjësimin kombëtar. “Pavarësisht nga kritikën e ashpra dhe opozita e hapur, gjakderdhje të mëdha nuk pati kurrë,” përfundon autori. “Ai hodhi themelet e ingranazhit qeveritar, arsimit, shenjat e qytetërimit larg prapambetjes së theksuar, transportin dhe madje përdorimin e avionëve” (Jacques, 1995, 442). Rendi që ai vendosi në vend dhe reformat për çarmatimin e popullsisë ulën nivelin e gjakmarrjes dhe i hapën rrugë përdorimit të ligjit të shtetit edhe në zona të largëta ku përfaqësuesi i shtetit shqiptar e kishte të vështirë t’u bënte të ditur të

gjithëve se ishin shtetas të një kombi dhe i bindeshin rregullit të një qeverie qëndrore.

Në këto vise koncepti i kombësisë nuk i kalonte caqet e fisit dhe të bajrakut dhe ligji i vetëm të cilit i bindeshin ishte Kanuni. Qeveritë e Tiranës, edhe ato më të hershmet, i kishin konsideruar këto vise një ishull malesh ku vigjilonte ashpër gjakmarrja dhe ku çdo përjekje për nënshtrim nga ana e tyre do të zbehej dhe shpejt do të zhdukej nën presionin që ligji i pashkruar ushtronte mbi atë të shkruarin. Mbreti Zog (qoftë edhe gjatë periudhës kur Ahmet Zogu ishte president) u përpoq t'i bënte krerët e palëkundur të malësisë shqiptare t'i jepnin besën atij dhe qeverisë së tij në Tiranë në shumë mënyra. Në të gjitha shkrimet e kohës përmendet fakti që ai kishte përdorur metodën e vjetër të turqve për t'i nënshtruar butësisht bajraktarët e pabindur të veriut. Ata merrnin gjysmën e rrogës së një oficeri në rezervë dhe djemtë apo nipërit e tyre kishin të drejtë të merrnin bursa studimi për jashtë shtetit për përgatitje ushtarake. Në rast se bajraktari vazhdonte të mos joshëj nga këto ofiqe, atëherë Mbreti zgjodhi ose ta dyfishonte rrogën e tij ose t'i ofronte një gradë më të lartë në ushtri. Pasardhësit e tij vërtet mund të shkolloheshin jashtë vendit, por kur ktheheshin në Shqipëri, qeveria kujdesej që ata ta ofronin shërbimin e tyre të kualifikuar nëpër “krahina të humbura, në vende “të sigurta” (Hasluck, 2005, 140). Në këtë mënyrë ata mbaheshin të izoluar nga ndjenjat kryengritëse që i kishin karakterizuar parardhësit e tyre.

Margaret Hesk (Margaret Hasluck), udhëtare që qëndroi në Shqipëri

Kur fiton besimin e shqiptarëve, ti fillon e ndërveprimet që në fakt në Shqipëri ka të paktën tre Mbretër Zog. I pari është Mbreti zyrtar, portreti i të cilit varet edhe në dyqanet më të humbura (...) dhe për të cilin zëdhënësit thonë se është shpëtimtari i kombit dhe se është një monark me të drejta hyjnore. Asnjë shandar nuk mund të emërohet, asnjë mësues nuk mund të pushohet pa dënimin e tij. (...) Pak më vonë mëson se portretet e kudogjendshëm nuk janë provë bindëse e popullaritetit që gëzon Monarkia, sepse tregëtarët që nuk kanë një të tillë gjobiten me 50 franga. Dhe ti fillon e sheh se ky monark i respektuar nga të gjithë thuhet nuk del fare nga Pallati i tij (...) për të marrë mirënjohjen e shtetasve të tij. Pikërisht këtu fillon të njohësh Mbretin e dytë Zog, një udhëheqës të lindur, një gjeni, por që o'ka pasur asnjëherë fat me miqtë që e rrethonin (...) Dikush të përshpërit se Abdurrahman Mati ka mbledhur një dorë të paskrupullit rreth vetes, që ka zënë vendet më kyçe në qeveri dhe e ka izoluar Mbretin nga nënshetasit e tij. Ata janë gati edhe të provokojnë revoltat për ta mbajtur atë brenda dyerve të Pallatit dhe për të mos lëshuar pe në pushtetin e tyre. Në këtë pikë – megjithëse kjo kërkon shumë besim – ty mund të të prezantojnë Mbretin e tretë (...) që nuk kujdeset fare për shtetasit e tij. Një mërgimtar i dëbuar të përshpërit se Mbretin e ushqen ambicia dhe korrupcia. Ai dhe Oborri i tij i kushtojnë Shqipërisë një milion franga ari dhe (...) ai vetë ka një pasuri prej katër milion frangash ari nga "mirësitë" e italyanëve. (...) "A e di se ç'do t'i kishin bërë Zogut kryengritësit e Fierit po të kishin fituar?" më pyeti me zë të mbytur një prej kritikëve të mësipërm (...) "Ja them unë. Ata do t'i kishin kërkuar t'u merret kokën e të lajgjkonte me mentë e tyre."

Ronald Mathison (1937, 188-190)

për trembëdhjetë vjet, vuri re që kishte edhe një mënyrë tjetër disi më dinake me të cilën qeveria e Tiranës përpiqej ta barazpeshonte pushtetin e pakufizuar të disa prej krerëve të fuqishëm në veri. Mbreti zgjodhi t'u ofronte favore të konsiderueshme një numri burrash që në të kaluarën kishin dhënë prova besnikërie ndaj rregjimit të ri dhe "ishin tepër "të fortë" ushtarakisht për të luftuar ndikimin e bajraktarëve kryeneçë" (Po aty, 141). Në këtë mënyrë këta të fundit u përdorën si gur kundërpeshë për të kaluar një pjesë të pushtetit të bajraktarëve te këta funksionarë të qeverisë që ruanin statusin e nënpunësit të saj. Edhe pse këto mjete ironizohen në pjesën më të madhe të studimeve historike apo materialet e biografive, autorët ndajnë mendimin se për sa kohë që kjo i dha mundësinë shtetit të përqëndronte vëmendjen në hartimin e strategjive të zhvillimit të vendit si një i tërë, ky mjet informal qeverisjeje dha rezultatet e duhura. Duhet kuptuar se kjo strategji ishte një ndër arsyet që Ahmet Zogu e përmendte shpesh nëpër intervistat e dhëna, për të justifikuar kalimin e formës qeverisëse në Monarki. Malësorët i kishin dhënë besën atij si një individ dhe jo qeverisë në

konceptin modern të një institucioni që vazhdon të jetë në shërbim të shtetasve të vet, pavarësisht anëtarëve të kabinetit të ministrave dhe përfaqësuesve të administratës. Me një fjalë, sipas tij, nëse Ahmet Zogu largohej nga qeveria, malësorët shkëpusnin çdo lidhje bese me qeverinë e Tiranës dhe përfaqësuesit e saj (Swire, 2005, 409). Në këtë këndvështrim Mbreti Zog vlerësohet për aftësinë që pati në njohjen e thellë të realitetit shqiptar dhe në njehsimin e kombit dhe shtetasve shqiptarë nën një rregull dhe ligj të përbashkët. “Mbreti Zog,” shkruan Toms, “e përdori dhunën, por nuk e ngriti atë në pedestal dhe as nuk e reklamoi politikën e tij mbi bazë dhune. Mbretëria e tij qëndronte veç shumë shteteve autoritariane në Evropën lindore në faktin që ushtria nuk luajti rol të rëndësishëm politik në mbajtjen e shtetit më këmbë, por arsyeja ishte që ushtria ishte më e dobëta e të gjitha organeve të tjera qeverisjeje” (Tomes, 2003, 147). Rezultati më i pritshëm i kësaj strategjie ishte, sipas të njëjtit autor, që Mbreti Zog ia doli ta mbante fronin për një kohë aq të gjatë. Kjo nuk erdhi nga “mbështetja popullore, as edhe nga frika, por kryesisht nga apatia dhe ndjenja e fatalizmit që mbretëronte në popull. Ata pak, që shpresonin se politika do të sillte diçka të mirë, e dëshironin këtë vetëm për veten e tyre dhe menduan se në këtë drejtim do të ishte më mirë të bashkëvepronin me Zogun sesa ta kundërshtonin atë. Të tjerët që ishin shumica dhe që kishin hequr dorë nga shpresat e duronin Mbretin sepse e dinin që kushdo tjetër në vend të tij nuk do të ishte më i mirë se ai” (Po aty, 187).

Në vitin 1935 Sër Eduard Boil (Sir Edward Boyle), shkruante në cilësinë e Kryetarit të Komitetit Ballkanik në Londër: “Nuk mund të shprehem për zhvillimet materiale, për ato të prekshmet; ndryshimet në rrugë, ura, xhandarmëri, toka që u vu në përdorim (...). Qëllimi im është të theksoj unitetin shpirtëror mbi arritjet materiale (...)” (Pearson 2004, 391). Në strategjinë politike që përzgjedhi, Zogu iu kundërvu parimit të parlamentarizmit modern, të cilin Fuqitë e Mëdha e aspironin për Shqipërinë; ky ishte një sistem që nuk i përshtatej gjendjes primitive në të cilën ndodhej politika shqiptare dhe sidomos asaj që ajo ende mbartte të trashëguar ndër bejlerët myslimanë dhe kryeparët e fiseve të veriut (Fischer, 1999). Administrata e Zogut ia doli deri në një farë mase të unifikonte shtetin shqiptar dhe t’i mbante kufijtë shqiptarë larg pikësynimeve gjithpërfshirëse të fqinjëve të saj (Vickers, 2001, 136). Ahmet Zogu aspiroi të mbretëronte në formën e një

monarkie të qytetëruar, perëndimore dhe të pavarur, megjithatë nuk ia doli të largonte dritshkurtësinë dhe egoizmin që karakterizonte politikën shqiptare prej vitesh.

### ***Mendime përmblyëse***

Reformat e karakterit politik, ekonomik, bujqësor, arsimor dhe shoqëror që Mbreti Zog ndërmori ishin mjaft ambicioze, por vënia e tyre në jetë kërkonte një hamonizim më të plotë me mentalitetin e popullit shqiptar. Nevoja për t'i vënë ato shpejt në jetë e detyroi administratën e Mbretit të përdorte modele perëndimore në hartimin e ligjeve dhe programeve të reja. Teorikisht këto do të ishin modele shumë të mira duke qenë se kishin funksionuar për breza të tërë nëpër shtete tashmë të zhvilluara perëndimore. Megjithatë zbatimi i tyre në Shqipëri u përball me një botëkuptim që ende qëndronte i lidhur me ide dhe qëndrime të pandryshuara prej shekujsh. Era e ndryshimeve ishte ende e dobët për t'i lëkundur këto parime të ngulitura thellë (Fischer, 2004, 188). Reformat kërkonin njerëz të aftë dhe këta ishin shumë të paktë në Shqipërinë e viteve 1930. Madje dhe ata që vërtet mund t'i sillnin shtetit shqiptar qoftë edhe një grimë njohurish falë shkollimit dhe aftësive që kishin fituar jashtë shtetit nuk u përshtatën dot me burokracinë që kokëfortësisht ruante pozita të forta në vend. Ahmet Zogu nuk diti sesi t'i jepte shtysë mendimit të ri në Shqipëri dhe shpejt e gjeti veten në krye të një rrethi vicioz drejtuesish të paaftë, pa të cilët e kishte të vështirë të qeveriste. Nëse anëtarët e kabinetit dhe rrjedhimisht punonjësit e administratës do të kishin marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse falë aftësive profesionale (që në fakt në Shqipëri nuk mungonin gjatë gjithë qeverisjes së Mbretit Zog), Zogu ndoshta do të kishte pasur këshilltarët e duhur për të kuptuar drejtimin e përshtatshëm nga duhet të ecnin reformat ekonomike në Shqipëri. Kjo do ta kishte bërë më të prekshëm problemin e fshatarësisë që në atë periudhë mbartte peshën kryesore të zhvillimit të ekonomisë shqiptare. Për më tepër kjo ndoshta do ta kishte zvogëluar edhe sferën e ndikimit ekonomik italian brenda Shqipërisë. Xh. Swire, V. Robinson, N. Hezeltain, Xh. Toms dhe B. Fisher ndajnë të njëjtin mendim se varësia ekonomike ndaj Italisë nuk kishte qenë qëllimi kryesor i politikave të Mbretit Zog. Ajo erdhi si pasojë e pamundësisë që një vend i vogël si Shqipëria me një ekonomi të brendshme të rrënuar prej shekujsh kishte për t'u mbështetur ekonomikisht nga njëra prej fuqive të mëdha. Lidhja

e Kombeve, si institucion, dhe shtetet e tjera evropiane e anashkaluan mbështetjen finaciare të Shqipërisë. Këtë e bënë për të mos shkaktuar turbullira të mëtejshme që, në Ballkan, kishin dhënë prova të forta paqëndrueshmërie. Këtë e arritën duke sakrifikuar zhvillimin e brendshëm ekonomik të saj për hir të interesave më gjithëpërfshirëse në Ballkan dhe në Evropë.

Në mbyllje mund të thuhet se përshkrimet e mësipërme dhe këndvështrimet në të cilat ato u trajtuan e bëjnë edhe më të qartë vështirësinë që kishte në përgjithësi politika shqiptare për të ecur përpara. Të qenit dikush në të varej drejtpërdrejt nga sasia e tokave që trashëgoje, nga vendi ku kishe lindur dhe nga doza e konformizmit me të cilën i shoqëroje veprimet e tua publike. Fatkeqësisht këto u bënë shprehje e qartë e primitivizmit dhe vetkënaqësisë në rang politik. Kjo ishte kritika më e ashpër që administrimi i Mretit i Zog ka marrë nga studiuesit anglezë. Thuajse të gjithë përpiqen apo gjejnë arsye për të justifikuar centralizimin e shtetit dhe përdorimin e një forme të diktaturës së moderuar si një mjet për të ruajtur pozita të qëndrueshme në një vend ku lëkundjet politike kishin shkaktuar tërmete të fuqishme. “Zogu ishte një prej të paktëve politikanë shqiptarë që mendonte sipas modeleve shtetërore moderne”, shkroi Bernd Fisher. Ishte ai që hodhi hapin e madh të kalimit në Monarki si formën më të sigurt për ruajtjen e shtetit të pavarur shqiptar. Momentet në të cilat monarkia e ndiente veten në rrezik, mbartnin në vend edhe ndjenjën e pasigurisë sepse cilado formë tjetër politike e drejtuar nga cilido fraksion politik, nuk do të mund të mbante gjatë të lidhur me njëri-tjetrin fragmentarizimet shqiptare. Këto të fundit kishin dhënë prova edhe më parë se dinin sesi të ngrinin krye kundër njëri –tjetrit; kjo shpejt kishte të ngjarë të përfundonte në një luftë civile. Paqëndrueshmëria e brendshme do të bëhej shkak për ndërhyrjen e jashtme, synimi kryesor i të cilës ishte politika proteksioniste mbi territore të caktuara në vend. Nëse para Ahmet Zogut, ajo që i bashkonte shqiptarët kishte qenë thjesht një “lloj sedre kombëtare” si “e vetmja formë nacionalizmi në vend”, të paktën “ata që erdhën në pushtet pas tij, e gjetën vendin të përgatitur në rang kombëtar” (Fischer, 2004, 321).

## **BIBLIOGRAFIA**

Cavendish R. September 2008. “King Zog I of Albania”. *History Today*, Vol. 58, <http://www.questia.com/library/1G1-185165952/sept-1-1928-king-zog-i>



- [of-albania](#). Jacques, Edwin J. 1995. *Shqiptarët: Historia e Popullit Shqiptar nga Lashtësia deri në Ditët e Sotme*. Tiranë: Kartë e Pendë.
- Fischer, Bernd J. “Albanian Highland Tribal Society and Family Structure in the Process of the Twentieth Century Transformation”, *East European Quarterly*, Vol. 33, 1999. p. 281- 301 <http://www.questia.com/library/1G1-57513390/albanian-highland-tribal-society-and-family-structure> (Shkarkuar tetor 2017)
- Fischer, Bernd J. 2004. *Mbreti Zog dhe Perpjekja për Stabilitet në Shqipëri*. Tiranë: Çabej.
- Hasluck, Margaret. 2005. *Kanuni: Ligji i Pashkruar Shqiptar*. Tiranë: Lisitan.
- Matthews, Ronald. 1937. *Sons of the Eagle; Wanderings in Albania*. London: Methuen & Co.LTD
- Pearson, Owen. 2004. *Albania and King Zog: Independence, Republic and Monarchy 1908-1939*. London: The Center for Albanian Studies.
- Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë. Konferencë Shkencore Ndërkombëtare 1 shtator 2008. *Monarkia Shqiptare: 1928 – 1939; Përmbledhje studimesh*. Tiranë: Botimet Toena 2011.
- Rothschild, Joseph. 2004. *Evropa Lindore Qëndrore midis dy luftave botërore*. Tiranë: Dituria
- Roucek, Joseph S. 1939. *The Politics of the Balkans*, London-New York: Mc.Graw-Hill Book Company.
- Tomes, Jason H. 2003. *King Zog of Albania: Europe’s Self-Made Muslim King*. New York University Press.
- Vickers, Miranda. 2001. *The Albanians: A Modern History*. London-New York: I.B. Tauris Publishers.
- The New York Times, 20 Mars 1927, *Newspaper Archive* - <http://newspaperarchive.com/>, aksesuar dhjetor 2016

## PËRSIATJE HISTORIKE E KULTURORE E POLENËS

**ROMEO TEROLLI**, Universiteti

“Fan S. Noli”, Korçë, [romeo\\_terolli@hotmail.com](mailto:romeo_terolli@hotmail.com)

**ILIRIAN KOROVESHI**

Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, [koroveshiilirian@gmail.com](mailto:koroveshiilirian@gmail.com)

**Abstrakt:** Polena është një nga vendbanimet më të hershme në zonën e Korçës, me gjurmë arkeologjike, tradita dhe zakone të hershme.

Qëllimi i këtij punimi është që të identifikojë elementë të historisë, të kulturës, aspekteve ekonomike, fetare, gjuhës së folur, sjelljes brenda dhe jashtë komunitetit polenak, zakoneve e traditave si dhe elementëve të jetës së përditshme.

Metodologjia e përdorur në këtë punim është kombimin i studimeve të mëparshme dhe të dhënave të shkruara dhe intervistave të terren të realizuara me banorët e zonës. Teknika e intervistimit në këtë studim shërben si mjet për identifikimin e elementëve që janë në qëllim të studimit.

Përmes të dhënave të grumbulluara nga dokumentat paraprake, intervistat e kryera në mënyrë të drejtëpërdrejtë qartësohet se në historinë e Polenës ka një shumësi ngjarjesh për të cilat duhet të shkruhet dhe hulumtohet më tej, duke u nisur nga parimi që Polena paraqet një vendbanim të hershëm e të dëshmuar përmes gjetjeve arkeologjike në të dhe rreth saj. Polena nga ana tjetër paraqet një komunitet me vlera kulturore, vlera të gjuhës, të traditës, të jetës në komunitet për të cilat pak ose aspak është shkruar në punime ose rreferime shkencore. Për të gjitha këto, ky punim kërkimor paraqet edhe një thirrje për institucionet e trashëgimive kulturore, arkeologjike, vendore e qëndrore me qëllim identifikimin dhe dokumentimin e vlerave që mbart komuniteti polenak.

**Fjalë kyçe:** historike, kulturore, përsiatje, Polena, tradita.

## HISTORICAL AND CULTURAL APPROACH OF POLENA VILLAGE

**Abstract:** Polena is one of the earliest settlements in the Korça area, with archeological traces, traditions and early customs.

The purpose of this paper is to identify the elements of history, culture, economic aspects, religion, spoken language, behavior inside and outside the Polena community, customs and traditions as well as elements of daily life.

The methodology used in this paper is a combination of previous studies and written data and field interviews conducted with residents of the area. The

*interviewing technique in this study serves as a tool to identify the elements that are the purpose of the study.*

*Through the data collected through the preliminary documents, the interviews conducted directly clarify that in the history of Polena there are a number of events that need to be written and further researched, starting from the fact that Polena represents an early settlement, established through archaeological finds around it. Polena, on the other hand, represents a community with cultural and linguistic values, tradition, community life, which little or nothing has been written in scientific works or references. For all the above, this research paper is a call for cultural, archaeological, local and central heritage institutions in order to identify and document the values carried by the Polena community.*

**Key words:** *historical, cultural, research, Polena, tradition.*

## **HYRJE**

Në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, f. 2056), Polena përcaktohet si një nga fshatrat e Korçës, pjesë e ish-komunës së Voskop (sot, njësia administrative Voskop, Bashkia Korçë), e cila shtrihet në perëndim të qytetit të Korçës, 860-900m lartësi mbi nivelin e detit. Polena kufizohet në lindje me Dvoranin dhe Qatromin, në perëndim me Lavdarin, në veri me Zaradishtin dhe Voskopin, në jug me Dërsinkun (Papa Kostandin Tollkuçi 1927, f. 2). Theksohet se në Polenë gjenden gjurmët arkeologjike të një vendbanimi ilir të shek. VIII-VII p.e.r. (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, f. 2056). Gjatë sundimit osman Polena u zhvendos dy herë më në perëndim.

Gjatë Luftës ANÇ u dogj nga pushtuesit e vendit dhe përsëri u rindërtua në truallin e mëparshëm. Këshilli NÇ u ngrit në tetor 1942. Celula e Partisë u formua më 30.6.1942. Më 1-3 mars 1943 u mbajt Konferenca e qarkut të PKSH për Korçën. Rreth Polenës janë bërë mjaft përpjekje midis forcave partizane dhe pushtuesve. Polena është qendër e kooperativës së bashkuar. (Fjalorin Enciklopedik Shqiptar 1985).

Tokat e fshtati prodhojnë misër, elb, tërshërë, urov, thekër, fasule, qiqra, thjerrëza dhe rrush të shkëlqyer (ibidem). Veprimtarinë kryesore ekonomike kishin kultivimin e grurit, panxharsheqerit, rritjes së gjedhëve dhe dhenëve. Pranë fshatit gjenden shtresa gëlqerorësh të mermerizuar, me vlerë të veçantë për ndërtime. Mjeshtërit polenakë janë shquar për punimet në gur. Popullsia përllogaritet në 678 banorë në vitin 2005, ndaj 610 banorëve në vitin 1926. Popullsia e fshatit ka

emigruar vazhdimisht brenda e sidomos jashtë vendit (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, f. 2057).

Përmes dokumentave të shkruara (pak të gjendshme), hulumtimit paraprak dhe intervistave të kryera më banorët e Polenës (përmes të cilave janë mbledhur të dhënat parësore) evidentohen materiale të shumta por pak të strukturuar të një vendbanimi të hershëm, me të dhëna të shumta historike e kulturore, të veprimtarisë ekonomike, zakoneve e traditave dhe jetës së përditshme të një prej zonave që ka kontribuar si për zhvillimin e zonës ashtu edhe për zhvillimin e qytetit të Korçës. Nisur nga të dhënat e grumbulluara në vijim të këtij punimi do të evidentohen aspekte të tilla, si:

- Ngjarjet që shënjuan historinë e Polenës.
- Vështrim mbi aspektet kulturore dhe traditës.
- Vështrim mbi aspekte të veçanta, të gjuhës së folur, sjelljes brenda dhe jashtë komunitetit polenak.

Materialet e paraqitura nuk janë shteruese, në kuptimin e plotë, por janë një përpjekje për të strukturuar informacionet e mbledhura përmes dokumentave dhe rrëfimeve të disa dhjetra burimeve përgjatë periudhës janar-prill 2022.

## **QËLLIMI DHE METODA E STUDIMIT**

Kjo përsiatje historike u nis me një referencë shkencore për të treguar disa karakteristika të besueshme e të vërtetueshme për lexuesit. Ky punim ka në bosht të tij fshatin Polenë duke dëshmuar përmes rrëfimeve aspekte historike, tradita, doke e zakone të njërit prej fshatrave më të rëndësishëm në zonën e Korçës. Qëllimi i këtij punimi është përshkrimi i elementëve historike, kulturore, ekonomike, fetare, gjuhës së folur, sjelljes brenda dhe jashtë komunitetit polenak, zakoneve e traditave si dhe elementëve të jetës së përditshme.

Të gjitha sa më sipër, do të realizohen bazuar në dorëshkrimet e mbledhura, të dhënat e shkruara, si dhe në bazë të teknikës së intervistimit (Azemi & Bujari 2013, f. 32) të marra nga banorët e zonës, në terren. Të dhënat parësore në këtë punim do të prezantohen përmes intervistave të kryera në terren me banorë të komunitetit polenak. *“Intervista është një mjet mjaft efikas për mbledhjen e të dhënave në këtë studim. Kërkues të ndryshëm kanë përcaktuar formate të ndryshme duke përfshirë këtu intervista etnografike, intervista të thelluara e kështu me rradhë”* (Le Compte & Preissle, f. 58). Matthews dhe Ross

(2012, f. 219) theksojnë se intervista është një metodë e mbledhjes së të dhënave që zakonisht:

- Lehtëson komunikimin e drejtpërdrejtë midis dy njerëzve, ose ballë për ballë, osë në distancë nëpërmjet telefonit ose internetit.
- I lejon intervistuesit të marrë informacion, ndjenja dhe opinione nga i intervistuari duke përdorur pyetje dhe dialog ndërveprues.

Modeli i intervistës së përzgjedhur është modeli i intervistës gjysmë të strukturuar. Autorët (Ivi, f.220) theksojnë se *“njihen disa struktura të ndryshme të intervistave, të cilat variojnë nga intervistat gjysmë të strukturuar në intervistat e pastrukturuar”*. Në një intervistë gjysmë të strukturuar, kërkuesit zakonisht përgatisin të njëjtin grup pyetjesh për çdo intervistë por i lejojnë vetes dhe pjesëmarrësve mundësinë për të dalë jashtë protokollit” (Lodico et al 2006, f.124). Për këtë arsye, që në krye të herës përmes të dhënave të grumbulluara nga hulumtimi paraprak është hartuar një intervistë me një bosht pyetjesh, por përgjatë intervistave pjesëmarrësve i'u është lejuar mundësia për të diskutuar dhe për çështjeve të tjera. Intervistat e kryera me banorët e zonës së Polenës janë rregjistruar me zë (duke marrë dakortësinë e tyre) me qëllim e vetëm që të mbrohet integriteti i të dhënave. Përzgjedhja e banorëve të intervistuar është bërë bazuar në:

- Klasifikimin bazuar në moshat e ndryshme të individëve të intervistuar.
- Klasifikimin bazuar në njohuritë paraprake mbi zonën e Polenës.
- Klasifikimin bazuar mbi rolin personal e profesional që kanë patur e kanë në fshatin e Polenës.

## **NGJARJET QË SHËNJUAN HISTORINË E POLENËS**

Polena është një krahinë që dëshmon për një vendbanim të hershëm, ashtu si përcaktohet në Fjalorin Enciklopedik të Shqipërisë, dorëshkrimin të Papa Kostandini Tollkuçit (tani e tutje, Papa Sotiri) dhe intervistave të kryera me banorët e zonës (A. K., K. Sh., N. T., P.C, V.V.). Të dhënat historike shkencore mungojnë për disa arsye si: kërkimet e pakta të arkeologëve, studimet e mungura në drejtim të shkrimit të historisë për këtë zonë dhe rrëfimeve të pakta të shkruara,

të cilat më shumë se objekt studimesh janë përpjekje për të mbajtur gjallë historinë e Polenës dhe figurave të shquara polenake.

Në rrëfimet e Papa Sotirit (Historia e fshtatit Polenë 1927 f.4) theksohet se për historinë e hershme të Polenës nuk ka ndonjë dokument të shkruar por rrëfimet e banorëve janë të përafërta dhe përfundimet që dalin përmes tyre ofrojnë të njëjtën qasje mbi historinë e zonës. Këtë qëndrim e gjejmë edhe në intervistat me banorët e zonës si Petro Theodhor (Todi) Cinako<sup>6</sup> i cili shprehet se “*Polena është një vend me histori të shumtë por të pashkruar, informacionet janë trashëguar përmes rrëfimeve të më të vjetërve në brezat e rinj*” (intervistë personale, 10 mars 2022) apo Andrea Koroveshi<sup>7</sup> i cili shprehet se “*Polena është një vendbanim që daton prej shek. VI p.e.r, gjetjet arkeologjike e dëshmojnë këtë, materialet historike të shkruara janë të cunguara*” (intervistë personale 22 mars 2022). Sa i takon gjetjeve arkeologjike banorët (ibidem) shprehen se në zonë janë bërë kërkime të cilat kanë zbuluar heshta, armë dhe stoli të cilat janë zhvendosur në qytetin e Tiranës. Në kujtimet e Petro Ciankos, Vasil Velos<sup>8</sup> dhe Andrea Koroveshit në vitin 1983 janë kryer kërkime të tjera arkeologjike në pjesën e Zaradishtit. Mozaiku i Polenës (Damko 1988, f. 226) është zbuluar përmes gërmimeve në vitin 1986. Autori (Ivi, f.227-232) përshkruan me detaje procesin e identifikimit, sondazheve paraprake, gjetjet arkeologjike, strukturën e mozaikut, si dhe kompozimin e tij. Përfundimet e gjetjeve të mozaikut dëshmojnë për një vendbanim të hershëm. Ky përfundim përforcohet dhe në studimin e autorit për zhvillimin e vendbanimit antik e bazilikës së Zaradishtës (Damko 1993, f. 259-271). Të dhënat arkeologjike të gjetura në zonë dëshmojnë për një vendbanim më një zhvillim të dukshëm që në kohën e antikitetit.

Zhvendosjen më të madhe të popullsisë, thënë ndryshe shpërnguljen më të madhe Polena e ka patur rreth viteve 1400, që lidhet me pushtimin Osman në Shqipëri (A. Koroveshi, intervistë personale, mars 2022). Një pjesë e popullsisë u detyrua të emigrojë drejt Greqisë dhe

---

<sup>6</sup> **Petro Theodhor (Todi) Cinako**, i datëlindjes qeshor 1930, sot 92 vjet, një nga banorët më të vjetër në fshatin Polenë.

<sup>7</sup> **Andrea (Theodhor) Koroveshi**, i datëlindjes 19 korrik 1970, një nga pasardhësit e fisit Koroveshi.

<sup>8</sup> **Vasil (Naum) Velo**, i datëlindjes 9 gusht 1963, pasardhës i fisit Velo, mjeshtër në punimin e gurit e sidomos gurit të kuq të Polenës.

Italisë më pak, ndërsa pjesa më e madhe e popullsisë u zhvendos në pjesën e sipërme të Polenës së sotme, e cila njihet si Polena e Sipërme. Në Polenën e Sipërme rreth viteve 1400-1700 u krijua një strukturë bashkëjetese, ngjashëm me modelin e Voskopojës ku kishte zejtarë, tregëtarë, përpunues të gurit, poçerisë etj. Në aspektin administrativ Polena e Sipërme ishte në varësinë e Voskopojës ndërkohë që kisha ishte e varur nga Kisha e Shën Prodhomit me një status të veçantë (ibidem). Familjet më të njohura të zonës ishin: Zguro, Koroveshi, Tollkuçi, Cianko, Manço, Gogoli, Tanço e Shore (Cianko, intervistë personale, mars 2022).

Një fakt i rëndësishëm historik për Polenën e Sipërme është vrasja e të dërguarit të Ali Pashë Tepelenës. Ngjarja lidhet me fuqizimin, zgjerimit dhe ushtrimin e kontrollit të Ali Pashës Tepelenës gjatë sundimit të tij. Qëllimi i të dërguarit të Ali Pashës, komandant Mersin (Isuf) Arapit ishte së pari, kthimi i popullsisë nga orthodhokse në muslimane dhe së dyti, marrja e sa më shumë burrave dhe djemve të zonës si ustallarë për ndërtimin e kalave të Ali Pashë Tepelenës. Rezistenca e banorëve çoi në vrasjen e komandatit Mersin Arapi, varrosjen e tij në vendin e vrasjes dhe vendosjen e një guri i cili identifikohet edhe sot (intervistat me Petro Cianko, Andrea Koroveshin, Nuçi Tomço<sup>9</sup> dhe Kristaq Shore<sup>10</sup>). Për shkak të këtij konflikti, këshilli i fshatit kërkoi ndihmë për mbrojtje në familjen e Frashërinjve, të cilët si këmbim për shërbimet e tyre do të merrnin një pagesë (ibidem). Në kujtimet e Papa Sotirit theksohet: *“fshati i’u paguante atyre 1500 grosh dhe ushqime për dy vetë, një për Qehajanë dhe një për ndihmësin e tij, si edhe lëndë djegse. Vendbanimi për dy njerëzit e Beut u lëshuan përkohësisht banesat e fshatit, por më vonë u ndërtuan me themeli kulla, në një vend të tillë që nga lart të vrojtoheshin të gjitha shtëpitë dhe rrugët e fshatit”* (Historia e fshatit Polenë 1927 f.4). Me kalimin e kohës të dërguarit e familjes Frashërlliu u zhvendosen totalisht në fshat duke kontrolluar gjithë veprimtarinë e banorëve. Kjo situatë nxiti pakënaqësi tek banorët, të cilët të gjendur përballë mungesës së drejtësisë u larguan drejt Ohrit, Megarovës dhe Krushovës të Manastirit, ndërsa pjesa e popullsisë së mbetur u pajtua

---

<sup>9</sup> *Nuçi (Sotir) Tomço*, i datëlindjes 20 tetor 1942, me profesion inxhinier mekanik, pasardhës i familjes Tomço.

<sup>10</sup> *Kristaq (Stavre) Shore*, i datëlindjes 8 dhjetor 1944, me profesion inxhinier pyjesh, pasardhës i familjes Shore.

- Naussbaum, M (2000). *Women and Human Development*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Rowntree, B.S. (1901). *Poverty: a study of town life*. London: Macmillan.
- Ravallion, M. (1993). *Poverty Alleviation Through Regional Targeting: A Case Study of Indonesia, in The Economics of Rural Organization: Theory, Practice and Policy*. World Bank and Oxford University Press.
- Sen, A. (1981). *Poverty and Famines: An Essay on Entitlement and Deprivation*. Clarendon Press Oxford.
- Sen, A. (1983). *Poor, Relatively Speaking*. Oxford Economic Papers, Vol. 35, pp. 153-169.
- Sen, A. (1999). *Development as Freedom*. Oxford: Oxford University Press.
- Townsend, R. (1979). *Poverty in the United Kingdom: A Survey of Household Resources and Standards of Living*. Harmondsworth: Penguin.
- Townsend, P. (1979). *Poverty in the United Kingdom*, London, Allen Lane and Penguin Books.
- Townsend, R. (1985). *A sociological approach to the measurement of poverty*. A rejoinder to Professor Amartya Sen. Oxford Economic Papers 37: 659-668.
- Townsend, P. (2006). *The Development of Research on Poverty*. Department of Health and Social Security, Journal of Social Science: Vol 2 No 1 Pg 1-8.

**MATJA SASIORE E DINAMIKËS SË NDRYSHIMIT TË DISA  
PARAMETRAVE KIMIKË TEK DISA KULTIVARË MOLLE  
GJATË RUAJTJES NË ZONËN E KORÇËS**

**ILIR NIÇKO<sup>1</sup>, ARBEN GJATA<sup>2</sup>, TEODOR GJATA<sup>3</sup>, KOSTIKA STOJA<sup>4</sup>**

1. Departamenti Agrorshqim, Fakulteti Bujqësisë,  
Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

2. Departamenti Biologji -Kimi, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

3. Departamenti Kimisë, Universiteti Aristotel, Selanik, Greqi

4. Student, Fakulteti Bujqësisë, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë  
ivangjelnicko@gmail.com

**Abstrakt:** *Molla është një nga kulturat kryesore të rajonizuara në zonën e Korçës, e mbështetur gjerësisht edhe në politikat subvencionuse qeveritare. Rritja e konsumit për frymë të këtij produkti është shoqëruar edhe me rritjen e kërkesave konsumatore për cilësi organoleptike dhe ushqimore. Subjekt i këtij studimi janë dinamika e parametrave kimike gjatë ruajtjes të tre kultivarëve të mollës, përkatësisht të Golden delicious, Starking dhe Granny Smith, që zënë dhe peshën kryesore në rajon. Mostrat për këtë qëllim u morën në dy rajone tipike në Pirg dhe në Dvoran. Mostrat u ruajtën në mënyrën natyrale në depo dhe tjetra në frigorifer në temperaturën 2<sup>0</sup>C. Secilës mostër ju matën me metoda standarde lënda e thatë me refraktometër ABBE, pH me pehashmeter, aciditeti i tatueshëm me titrues automatik, numri i formolit, dhe vitamina C me metodën 2,6 diklorindofenol, karbohidratet totale dhe karbohidratet reduktues. Kryerja e analizave u krye menjëherë pas vjeljes dhe më pas çdo muaj për periudhën janar –prill. Rezultatet treguan një reduktim me rreth 5 here të vitaminës C, një zvogëlim të pavërtetuar statistikiisht të lëndës së thatë, rritjen e pH(zvogëlimi i aciditetit), reduktim të aciditetit të titrueshëm dhe një rritje të numrit të formolit për të tre kultivarët Golden Delicious, Starking dhe Granny Smith.*

**Fjale kyçe:** *mollë, lënda thatë, numri formolit, vitamina C, karbohidrate reduktues.*

**QUANTITATIVE MEASUREMENTS OF DYNAMIC VARIATION  
OF SOME CHEMICAL PARAMETERS TO SOME APPLE  
CULTIVARS, DURING THE STORAGE IN REGION OF KORÇA**

**Abstract:** *Apple is one of the main crops in the region of Korca, widely supported by supporting policies of government. Increasing per capita of consumption of this product is accompanied by increasing consumer demands for organoleptic and nutritional qualities. The subject of this study*

were the dynamics of chemical parameters for three apple cultivars, Golden Delicious, Granny Smith and Starking, which occupy the main farming area of the region. For that purpose fresh samples were taken in two typical regions one in Pirc and the second in Dvoran. Samples were preserving by the natural way in the warehouse and the other in the refrigerator at a temperature of 2<sup>0</sup>C. Each sample was measured by standard methods were dry matter was measured by ABBE refractometer, phph-meter, titrable acidity by automatic titration, the number of formol, and vitamin C with 2,6 dichloroindofenol method, total carbohydrates and reducing carbohydrates. The analysis were performed immediately after harvest and then almost each month for the period from January to April. The taken results showed a reduction of about 5 times of the vitamin C, a small decrease of dry matter, increasing of the pH (reduction of acidity), reduction of titrable acidity and a small increase of formol number for the three cultivars Golden Delicious, Starking and Granny Smith taken for this study.

**Key words:** apple, dry matter, formol number, vitamin C, reduced carbohydrates.

## 1. HYRJE

Prodhimi i frutave në Rajonin e Korçës është një sektor potencial shumë i rëndësishëm dhe me perspektive për konsum dhe për degën agro-përpunuese. Vitet e fundit ky sektor po rritet e po fuqizohet me shpejtësi si në prodhimin e frutave tradicionale të qarkut, ashtu dhe në përpunimin e tyre. Molla në veçanti është një nga kulturat kryesore të rajonizuara në zonën e Korçës, e mbështetur gjerësisht edhe në politikat subvencionuse qeveritare. Rritja e konsumit për frymë të këtij produkti është shoqëruar edhe me rritjen e kërkesave konsumatore për cilësi organoleptike dhe ushqimore. Molla në shumicën e rasteve konsumohen si ushqim si dhe për përfitimet shëndetësore që ajo sjell. Shumë studime dietologjike nga më të ndryshmet i japin mollës shumë attribute shëndetësore, si përfitimet që jep në sistemin e tretjes etj. Lëngu i mollës ka një koncentrim të rëndësishëm të fenoleve natyrore me peshë molekulare të ulët që mendohet se mbrojnë organizmin nga sëmundjet që lidhen me moshën për shkak të efekteve antioksiduese. Kërkimet sugjerojnë që lëngu i mollës rrit acetilkolinën në tru, që çon në përmirësimin e memories etj. Disa nga përbërësit kryesore të tillë janë: uji që është një ndër përbërësit më të bollshëm, karbohidratet (fruktozë, glukozë etj), proteina dhe lipide në përmbajtje të limituar që

ndodhen në farë, fibrat dhe acidet organike të cilat ndihmojnë në thithjen e kalciumit të hekurit e të magnezit, pektinat, substancat fitocide që shërbejnë si substanca antibakteriale, pigmente, karotenoide, asteroide, eteret të cilat i japin aromën e saj karakteristike etj, ( Troja R., 2011, Sinha N.K., 2006.)

## **2. MATERIALE DHE METODA**

Subjekt i këtij studimi ishin dinamika e parametrave kimike gjatë ruajtjes të tre kultivarëve të mollës, përkatësisht të *Golden delicious*, *Starking* dhe *Granny Smith*, që zënë dhe peshën kryesore ne rajon. Mollët u grumbulluan ne pjekje teknike. Ato u përzgjodhën në mënyre të tillë që të përfaqësonin gjithë rajonin e Korçës. Konkretisht u morën në sasi të barabarta në dy rajone tipike në Pirg dhe në Dvoran të rajonit të Korçës". Gjithashtu sasia e mollëve për eksperiment u morr në çdo zonë në 5-10 parcela të ndryshme, të gjitha këto të fundit u depozituan për ruajtje ne arka plastike.

Mostra të porsa vjela ne pjekje teknike, u ruajtën në frigoriferët me ajër ne komunën Mollaj në temperaturën 2<sup>0</sup>C. Mostra të tjera u ruajtjen në mënyrën natyrale në depo në temperaturën 7-12<sup>0</sup>C. Mostrat e referencës u ruajtën në frigoriferët me AM në temperaturën 2<sup>0</sup>C dhe 1.5% O<sub>2</sub> në zonës tregtare te Korçës. Studimi i parametrave fiziko-kimike i mollëve të prodhuara në rajonin e Korçës" u krye në Laboratorët e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë. Mostrat e përgatitura në këtë mënyrë u analizuan në intervale kohë të ruajtjes prej 0, 50, 120, dhe 200 ditëshe për përmbajtjen lëndëve të thata, të vitaminës C, Aciditetit total, pH, sheqerna totale, Numri i formolit. Mollët e të tri varieteteve u dërguan në laborator dhe ju nënshtruan proceseve të larjes, grirjes, presimit dhe filtrimit.

### **Metodikat e analizave kimike**

- Përcaktimi i lëndës së thatë u krye me refraktometrin e tavolinës ABBE në temperaturën 20<sup>o</sup> C
- Përcaktimi i aciditetit total te titrueshëm dhe numrit te formolit u krye duke përdorur me përpikëri procedurat e metodës standarde analitike( AOAC Official method.,1980)
- Përcaktimi i acidit askorbik u krye duke përdorur me përpikmëri procedurat e metodës standarde analitike me diklor 2,6 indofenol (FAO, 1991)



- Përcaktimi sheqernave reduktuese (%) u krye duke përdorur me përpikmëri procedurat e metodës standarde analitike *Lane Eynon*, metodë (AOAC, 1984).
- Metoda e përdorur për përcaktimin analitik të karbohidrateve totale ishte metoda me Fenol e Acid sulfurik për karbohidratet totale prej S.S. Nielsen,( Nielsen S.S., 2010) metodë me spektrofotometër për përcaktimin e karbohidrateve totale në spektrofotometer në gjatësinë e valës 490 nm. Fillimisht u përgatit një seri standardesh nga një solucion standard 100mg/L glukozë. Me këtë krijuam një lakore standarde në spektrofotometer nga e cila rezultoi ekuacioni i vartësisë së koncentrimin me A- absorbancën:  $C = 92.0739 \times A + 1.6343$  dhe faktori i regresionit = **0.996248**

### 3. REZULTATE DHE DISKUTIME

Mbas analizimit të mostrave të grumbulluara për treguesit e mësipërm përmendur, rezultatet e mara dhe të përpunuara statistikisht u vendosën në tabelat 1, 2, 3, te cilat japin rezultatet mesatare të përfutuara sipas metodikave të lartpërmendur për disa tregues fiziko-kimikë të domosdoshëm për studimin tonë në vazhdim. Në këtë mënyre ne do të studiojmë dinamikën, ndryshimet, ecurinë, stabilitetin e këtyre treguesve dhe do të cilësojmë metodën më të mirë për ruajtjen e mollës.

**Tabela. 1. Rezultatet mesatare të analizave fiziko-kimike në mollët *Golden delicious*, *Starking* dhe *Granny Smith* gjatë ruajtjes për një periudhë kohe 200 ditore në ambient depoje**

Lloji i mostrës	dite ruajtje	Lënda e thatë Bx	karbohidrate totale	Vit C, mg/100 ml	Ac.Tot. % si ac. malik	pH	numri i formolit/100g
Mollë gold ambient depo	0	13.2	11.65	5.2	0.57	3.6	4
Mollë gold ambient depo	50	13.7	12.19		0.36	3.75	
Mollë gold ambient depo	120	13.2	11.65		0.26	3.91	
Mollë gold ambient depo	200	12	10.36	0.93	0.21	4.03	4.2
Mollë Granny Smith ambient depo	0	13	11.43	4.6	0.74	3.2	5.5
Mollë Granny Smith ambient depo	50	13.1	11.54		0.63	3.38	
Mollë Granny Smith ambient depo	120	13.8	12.29		0.59	3.46	
Mollë Granny Smith ambient depo	200	13.4	11.86	0.5	0.51	3.62	5.75
Mollë Starking ambient depo	0	13	11.43	4.8	0.42	3.68	5.3
Mollë Starking ambient depo	50	13.8	12.07		0.38	3.89	
Mollë Starking ambient depo	120	13.3	11.33		0.34	4.13	
Mollë Starking ambient depo	200	11.2	9.504	0.7	0.166	4.2	6

**Tabela. 2. Rezultatet mesatare të analizave fiziko-kimike në mollët *Golden delicious*, *Starking* dhe *Granny Smith* gjatë ruajtjes për një periudhe kohe 200 ditore në ambient frigoriferik te thjeshte.**

Lloji i mostrës	dite ruajtje	Lënda e thatë Bx	karbohidrate totale	Vit C, mg/100 ml	Ac.Tot. % si ac. Malik	pH	numri i formolit/100g
Mollë Gold frigorifer	0	13.2	11.65	5.2	0.57	3.6	4
Mollë Gold frigorifer	50	13.5	11.97		0.4	3.72	
Mollë Gold frigorifer	120	13.13	11.43		0.31	3.78	
Mollë Gold frigorifer	200	12.8	11.23	0.702	0.296	3.94	5.15
Mollë Granny Smith frigorifer	0	13.13	11.43	4.6	0.74	3.2	5.5
Mollë Granny Smith frigorifer	50	13.1	11.53		0.72	3.3	
Mollë Granny Smith frigorifer	120	13.6	12.07		0.7	3.39	
Mollë Granny Smith frigorifer	200	13.5	11.97	0.78	0.556	3.51	5.5
Mollë Starking frigorifer	0	13.13	11.43	4.8	0.42	3.68	6
Mollë Starking frigorifer	50	13.8	12.08		0.39	3.8	
Mollë Starking frigorifer	120	13.5	11.97		0.36	4.1	
Mollë Starking frigorifer	200	11.2	9.504	0.93	0.208	4.16	6.6

**Tabela. 3. Rezultatet mesatare të analizave fiziko-kimike në mollët *Golden delicious*, *Starking* dhe *Granny Smith* gjatë ruajtjes për një periudhe kohe 200 ditore në ambient frigoriferik AM**

Lloji i mostrës	dite ruajtje	Lënda e thatë Bx	karbohidrate totale	Vit C, mg/100 ml	Ac.Tot. % si ac. malik	pH	numri i formolit/100g
Mollë Gold frigorifer AM	12 0	13. 2	11.6 5	4.1 1	0.5 1	3.6 7	4
Mollë Gold frigorifer AM	20 0	13. 1	11.5 5	4 4	0.5	3.6 9	4
Mollë Granny Smith frigorifer AM	12 0	13	11.4 3	3.7	0.6 9	3.2 3	5. 5
Mollë Granny Smith frigorifer AM	20 0	13. 1	11.5 5	3.6	0.6 7	3.2 6	5. 5
Mollë Starking frigorifer AM	12 0	13. 7	12.1 3	3.8	0.3 8	3.7 2	6. 1
Mollë Starking frigorifer AM	20 0	13. 6	12.0 2	3.6 5	0.3 6	3.7 4	6. 1

### **Karbohidratet totale**

Karbohidratet në mollë ndodhen në formën e monosakarideve, oligosakarideve të tretshme dhe në formën e polisakarideve. Në karbohidratet e tretshme më kryesoret janë glukози, fruktozi, saharozi etj. Nga polisaharidet më të rëndësishme janë amidoni, celuloza. (Troja R., 2011.) Përcaktimi i sasisë së karbohidrateve në mollë ka një rëndësi të madhe. Siç shihet nga Fig. 1. karbohidratet totale kanë ndryshuar në frigoriferët me ajër dhe në mënyrën natyrale në depo që në 50 ditëshin e parë të ruajtjes me një tendencë rritje të lehtë. Mesatarja maksimale e karbohidrateve totale u arrit pas 50 ditësh në mollët *Golden delicious*, *Starking* ndërsa tek *Granny Smith* më vonë. Pas arritjes së sasisë maksimale e karbohidrateve totale vërehet rënia më e shpejtë në

mënyrën natyrale në depo të ruajtjes, më pak në frigoriferët me ajër dhe një stabilitet në ruajtjen me frigoriferët me AM. Karbohidratet reduktues në molle janë pjesa kryesore e karbohidrateve që përmbajnë ato, mbas përcaktimit ato luhateshin 6.64 % në mollët Golden delicious, 5.12 % tek mollët Granny Smith dhe 7.34 % tek mollët Starking:

### **Aciditeti total dhe pH**

Aciditeti në lëngjet e mollës ka një rëndësi të madhe për një sërë arsyesh të lidhura me vetitë organo shqisorë por më e rëndësishmja për studimin tonë është sepse aciditeti reflektohet në vlerat e pH. Rritjet apo uljet e ndjeshme të aciditetit tregojnë që në lëngun e mollës zhvillohen procese biokimike dhe mostra të cilat kanë këto luhajtje të mëdha tregojnë që nuk janë të përshtatshme për tu ruajtur mirë. Gjatë përcaktimeve të bëra në përgjithësi vërehet një ulje e aciditetit të mollës gjatë ruajtjes. Siç shihet nga figura 2, ulja e përmbajtjes së aciditetit ishte më e shpejtë në mënyrën natyrale në depo të ruajtjes, më pak në frigoriferët me ajër dhe e papërfillshme në ruajtjen me frigoriferët me AM.

Për sa i përket vlerave të pH në mollët e ruajtura me të tre metodat janë paraqitur në figura 3., që jep vartësitë e pH nga koha. Aty tregohet se tek mollët vërehet rritja e pH e cila ishte më e lartë në mënyrën e ruajtjes natyrale në depo, më pak në frigoriferët me ajër dhe e papërfillshme në ruajtjen me frigoriferët me AM.

Vlerat e pH janë të lidhura shumë ngushtë me përmbajtjen e aciditetit total, (Fig.3). Edhe një herë në kushtet e ruajtjes me frigoriferët me AM ndryshimet janë qartësisht të papërfillshme nga të dy llojet e tjera të ruajtjes.

Për sa i përket vlerave të pH në mollët e ruajtura gjatë në frigorifer, përveç problemeve organo-shqisorë e të shijes, vërehet që këto vlera janë në caqet kritike për prodhimin e lëngut të mollës e cila kërkon vlera (pH 2.5 - 4). Vlerat e pH shkojnë 4.03 në mollët Golden delicious, 3.62 tek mollët Granny Smith dhe 4.2 tek mollët Starking në mënyrën natyrale në depo të ruajtjes dhe 4.16 tek mollët Starking në frigoriferët me ajër. Modele shumë të ngjashme vihen re edhe në literaturë (Steškova A., etj.2006).




Fig. 1. Ndryshimet e sasisë së karbohidrateve në mollët *Golden delicious*, *Starking* dhe *Granny Smith* gjatë ruajtjes për një periudhe kohe 200.




Fig. 2. Ndryshimet e aciditetit total të titrueshëm në mollët *Golden delicious*, *-Starking* dhe *Granny Smith* gjatë ruajtjes për një periudhe kohe 2





Fig. 3. Ndryshimet e pH në mollët *Golden delicious*, *Starking* dhe *Granny Smith* gjatë ruajtjes për një periudhë kohe 200

### Ndryshimi i vitaminës C

Modeli i përmbajtjes të vitaminës C gjatë ruajtjes ishte shumë i ngjashëm me atë të aciditetit. Në Fig. 4. janë paraqitur sasi të vitaminës C për të tria varietetet e mollëve të rajonit të Korçës. Në të dallohet qartë që sasi të vitaminës C për frutat e freskëta të cilat janë normale, ndërsa nivelet e vitaminës C për mollët e ruajtura për 200 ditë me të tria metodat e përdorura në metodikë pësojnë ulje të sasisë të vitaminës C.

Ulja e përmbajtjes së vitaminës C ishte e shpejtë si në mënyrën natyrale në depot e ruajtjes, po ashtu dhe në frigoriferët me ajër. Sikurse shihet dhe nga figura 4. vihet re një ulje e ndjeshme e koncentrimit të vitaminës C, konkretisht në të tria varietetet e mollëve ulet sasia nga 81% deri 86.5% të sasisë fillestare për 200 ditë ruajtje.

Zvogëlimi i sasisë së vitaminës C gjatë ruajtjes në kushte me AM për 200 ditë ruajtje është në një normë prej 20-24%. Rezultate të njëjta janë gjetur edhe nga studiues të tjerë (Stešková A., etj., 2006) dhe ky degradim i atribuohet kryesisht oksigjenit të ajrit.




**Fig. 4. Histograma. Ndryshimi i sasisë së Acidit askorbik në mollët *Golden delicious*, *Starking* dhe *Granny Smith* gjatë ruajtjes për një periudhë kohe 200**



## Numri i formolit

Numri i formolit është një tregues i lidhur ngushtë me sasinë e aminoacideve që përmbahen në lëngun e frutit. Në Fig. 5. janë paraqitur numrat e formolit, të cilët janë tregues relativisht më të stabilizuar gjatë ruajtjes për një periudhë kohe prej 200 ditësh.



**Fig. 5. Ndryshimi i numri i formolit/100g në mollët *Golden delicious*, *Starking* dhe *Granny Smith* gjatë ruajtjes për një periudhë kohe 200 ditësh.**

## 4. PERFUNDIME

Duke i sintetizuar dinamikën e parametrave fiziko-kimike tek të tre kultivarët e mollës gjatë ruajtjes në mënyrën natyrale në depo, rezultoi se:

- koha maksimale e ruajtjes së frutave me cilësi të pranueshme është 100 ditë në temperaturat e ambientit të zonës së Korçës,
- në frigoriferët me ajër koha maksimale e ruajtjes së frutave me cilësi të pranueshme është 150 ditë,
- në ruajtjen më të gjatë në këto kushte mund të themi, që nuk ruhen cilësi të pranueshme të frutave.

Në mollët e ruajtura për një kohë të gjatë përveç problemeve organo shqisore ndryshonin të gjithë parametrat fiziko-kimike,

- gjatë ruajtjes vihet re rënie e karbohidrateve totale,

- me zgjatjen e kohës së rruajtjes vihet re ulje e ndjeshme e koncentrimit të vitaminës C, kultivari me i ndjeshëm ishte *Golden delicious*, ku vitamina C lëvizi nga 5.2 ne 0.7 mg, krahasuar me *Starking* nga 4.6 ne 0.78 mg dhe *Granny smith* nga 4.8 ne 0.93 mg per 100 ml,
- gjatë rruajtjes vihet re ulje e ndjeshme e aciditetit total, ku ulja më e ndjeshme ishte në *Golden delicious* nga 0.57 ne 0.29, krahasuar me *Starking* nga 0.42 ne 0.20 dhe *Granny smith* nga 0.74 në 0.55,
- gjatë rruajtjes vihet re rritje vlerave të pH, që arrijnë limitet kritike. Kështu në *Golden delicious* nga 3.6 në 3.94, krahasuar me *Starking* nga 3.68 në 4.16 dhe *Granny smith* nga 3.2 në 3.51,
- Në ruajtën e mollëve me frigoriferët me AM qëndrueshmëria e mollëve dhe praktikisht të gjitha parametrat fiziko-kimike të vëzhguara ruajnë pothuaj parametrat e frutit të freskët.
- Për këtë arsye po bëhet domosdoshmëri në zonën e Korçës rritja e kapaciteteve ruajtëse të mollëve me frigoriferët me AM për rritjen cilësisë dhe zgjatjen e kohës në ruajtje të tyre.

## 5. BIBLIOGRAFI

1. AOAC Official method 942.15 Acidity(titratable) of fruit products. B. Glass elektrode method. 1980
2. FAO, (1991) Manuals of Food Quality Control 14 / 8, page 194 / Pearson's Composition and Analysis of Foods 9th edn, , page 264 .
3. Nielsen S.S.2010, Metoda me Fenol-Acid sulfurik për karbohidratet totale prej S.S. Nielsen, *Food Analysis Laboratory Manual*,2010
4. Sinha N.K, Handbook and fruits processing 2006, 16 apples , p. 271,27
5. Stešková A, Morochovičová M, Lešková E. 2006 Vitamin C degradation during storage of fortified foods *Journal of Food and Nutrition Research*. **45**, 55-61
6. Troja R: 2011. Chemistry and Food Technology (Kimia dhe teknologjia e ushqimeve), Tirana 2011.

# VLERËSIMI I NDIKIMIT TË SKEMËS SË MBJELLJES SË SPECIT AUTOKTON CV “GOGOZHARE” NË TREGUESIT BIOMETRIKË DHE TË PRODHIMIT

THOMA NASTO <sup>1</sup>, GJERGJI MERO <sup>2</sup>, YLLI SHAHINLLI <sup>3</sup>  
NEVRUS ZEKA <sup>2</sup>

<sup>1</sup>Departamenti i Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peizazhit UBT,

<sup>2</sup>Departamenti Agronomisë, Universiteti “F. S. Noli” Korçë,

<sup>3</sup>Agjensia Kombëtare Ushqimit Korçë

**Abstrakt:** Ky studim u realizua ne kushtet e zonës së Devollit e cila gjendet në pjesën jug-lindore të vendit. Klima e kësaj zone karakterizohet nga vecoritë e klimës kontinentale – mesdhetare. Rezultatet e marra nga ky studim lidhen me vlerësimin e ndikimit të dendësisë së mbjelljes së bimëve të specit cv “Gogozhare” (i cili është mjaft i përhapur në këtë zonë), në treguesit biomorfologjikë dhe të prodhimit. Ky studim mundëson të dhëna që lidhen me pesë dendësi të mbjelljes së bimëve të specit si më poshtë: 11.1 – 8.3 – 4.8 – 3.7 dhe 2.6 bimë/m<sup>2</sup>. Vlerat e karakteristikave të bimëve, me përjashtim të datës së lulëzimit, zvogëlohen kur hapësira ndërmjet bimëve rritet. Të dhënat e marra evidentojnë faktin se këto dendësi nuk kanë ndonjë ndikim domethënës në peshën mesatare të frutave të specit. Numri dhe mesatarja e frutave për bimë rriten duke filluar nga dendësia më e madhe në drejtim të dendësisë më të vogël, ndërkohë prodhimi për njësi të sipërfaqes shkon duke u zvogëluar. Sasia e prodhimit të destinuar për treg është më e madhe në variantet me dendësi më të vogël të bimëve, ndërsa prodhimi i përgjithshëm për njësi të sipërfaqes rezulton të jetë më i madh në variantet me dendësi më të madhe të bimëve. Për më tepër, sa më e madhe të jetë distanca ndërmjet bimëve të mbjella, aq më e vogël është sasia e frutave skarco. Lartësia e bimëve në variantet e testuara rritet me rritjen e dendësisë së bimëve. Frutat me peshë më të madhe janë marrë në tre vjeljet e para, ndërsa diametri i frutave rezulton të jetë më i madh në frutat e vjeljes së dytë dhe të tretë. Nga të dhënat rezulton se lartësia e bimëve në variantet e testuara rritet me rritjen e dendësisë së bimëve. Masa bimore e mbetur mbas vjeljes së prodhimit, si edhe sasia e lëndës së thatë të bimëve në fund të ciklit të prodhimit, rezulton të jetë më e madhe në variantet me dendësi më të madhe të bimëve, krahasuar me dendësitë e tjera.

**Fjalë kyç:** dendësi e bimëve, tregues, vlerësim, prodhim i përgjithshëm, prodhim për njësi sipërfaqe, fruta për treg, peshë e frutave

## EVALUATION OF PLANTS DENSITY IN BIOMETRIC INDICATORS AND PRODUCTION OF AUTOCHTHONOUS PEPPER “GOGOZHAR”

**Abstract:** *The study was made in the conditions of Devolli's zone, found in the south eastern part of Albania. The climate of this zone is characterized by the properties of that Mediterranean – continental. The results drawn from this study concerning the evaluation of the influence of plants density in the pepper crop (local variety “Gogozhare”), offer important index to make the most appropriate selections in determining the plants density. The values of plants' characteristics, except the date of flowering, regularly decrease when the space for the plants increases.*

*Thus, this study gives evidence that the plants density (five plant density: 11.1 – 8.3 – 4.8 – 3.7 and 2.6 plants/m<sup>2</sup>) does not exert any proved influence on the average weight of the fruits. The number and the average of the fruit per plants is increases beginning from the highest density to the lowest one, whereas the production per surface unit is decreases. The quantity of marketable product higher in variants low plants density, while the total product for unit surface has resulted higher in variants with higher number of plants.*

*In addition, the larger the distance between the planted plants is, the smaller will be the percentage of scarcity fruits. The plant height of the tested variants increased with greater plant density. Fruits with the biggest weight were taken in the first three harvest, while the diameter of the fruits was bigger in the fruits of second and the third harvest. That, the plant height of the variants tested increased with greater plant density. Green mass left after harvesting the product, as well as the quantity of dried matter of the plants in the end of the product cycle, resulted in greater values in the variants with higher density of plants, compared with other densities.*

**Key words:** *plant density, index, evaluation, total yield, production per surface unit, marketable fruits, fruit weight*

### Hyrje

Dendësia optimale e mbjelljes së perimeve të ndryshme nuk mund të konsiderohet si një parametër fiks. Ajo mund të ndikohet nga një numër i madh faktorësh, si aftësia konkurruese e çdo speciejë, kushtet klimatike, tokësore, ujore dhe ushqyese, periudha e kultivimit, destinacioni i prodhimit, etj. Puna kërkimore e shkencore dhe eksperiencia shumë vjeçare kanë bërë të mundur të përcaktohen për çdo specie perimore distancat e duhura të cilat mundësojnë dendësi optimale të mbjelljes (Islam, M., Saha, S., Akand, H. and Rahim, A.

(2011), Agarwal, A., Gupta, S. and Ahmed, Z. (2007). Megjithatë, për speciet perimore, konsiderohet e rëndësishme të eksperimentohet se si specie të ndryshme perimore mund të reagojnë ndaj ndryshimit të dendësisë së mbjelljes, dhe se si një reagim i tillë mund të ndikohet prej praktikave të tjera të kultivimit, sikurse është p.sh. ujitja, plehërimi etj. (Cavero, J., Ortega, R.G. & Gutierrez, M. (2001), Tesi R., 1994, Maniutiu, D., Sima, R., Apahidean, A.S., Apahidean, M. & Ficior, D. (2010).

Ndërkaq, në praktikën e përditëshme vazhdojnë të përdoren akoma disa skema të gatëshme (Alam, M.S., Saha, S.R., Salam, M.A. and Alam, M.K. 2011), të cilat janë në gjendje të sqarojnë funksionet që lidhin parametrat e prodhimit, me dendësinë e mbjelljes, pra të distancave ndërmjet dhe midis rreshtave të mbjellë. Studimi i distancave ndërmjet dhe midis rreshtave, si dhe i orientimit të rreshtave mund të ndihmojë për një zhvillim më të favorshëm të bimëve, për të rritur prodhimtarinë e tyre (Lorenzo, P., and N. Castilla. (1995), Aminifard, M.H., Aroiee, H., Ameri, A. & Fatemi, H. 2012). Në shumë raste, shpërndarja propocionale e bimëve të mbjella, konsiderohet si faktori që përcakton konkurrencën më të vogël të rritjes së bimëve. Nga ana tjetër, rritja e kërkesave për mekanizimin e operacioneve të ndryshme kulture, ka nxitur kryerjen e studimeve për gjetjen e zgjidhjeve më të përshtatshme, të cilat jo gjithmonë koincidojnë me ato optimal (Bianco V.V.; Pinpini F. 1990, Dasgan, H.Y. & Abak, K. (2003) Seifi, S., Nemati, S.H., Shoor, M. & Abedi, B. (2012).

Lidhur me ndikimin e numrit të bimëve për njësi të sipërfaqes në kulturën e specit, të dhënat bibliografike të vendit tonë, sjellin informacione shpesh kontradiktore dhe të pamjaftueshme. Ndërkohë, literatura e huaj evidenton se rezultate të mira mund të merren në rastet kur dendësia e bimëve për njësi të sipërfaqes varion nga 5 – 11 bimë/m<sup>2</sup>. (Srinivas,1982; Evert 1984 etj.). Efektet e dendësisë së mbjelljes, studiohen jo vetëm në raport me prodhimin total për bimë e për m<sup>2</sup>, por edhe në raport me prodhimin e tregëtueshëm. (Nasto Th, Bardhi N., 2004, Tase, Ll, (1986), Idowu, A.O. (2011). Duke u bazuar në rëndësinë e madhe që ka kultura e specit, u mundësua realizimi i këtij studimi për të evidentuar ndikimin që ka dendësia e mbjelljes në treguesit biometrike, sasiorë dhe cilësorë të prodhimit në kulturën e specit, kultivari “Gogozhare”.

Speci “Gogozhare”, konsiderohet si një kultivarët autoktonë lokale më të përhapur dhe më të preferuar jo vetëm nga konsumatori, por edhe nga industria agropërpunuese, kryesisht në kushtet jug – lindore të vendit (Nasto, T.H., Balliu, A. and Zeka, N. (2009).

### **Materiali dhe metoda**

Studimi u realizua në kushtet e zonës së Devollit (Korçe), e cila ndodhet në pjesën juglindore të Shqipërisë. Klima e kësaj zone karakterizohet nga veçoritë e klimës mesdhetare – kontinentale. Stina e verës përgjithësisht është e thatë dhe e nxehtë, ndërsa vjeshta, dimri dhe pranvera karakterizohen nga prania e një lagështie më të madhe dhe temperatura më të ulta. Toka ku u ngrit eksperimenti karakterizohet nga treguesit kimikë dhe fizikë si më poshtë: azoti total 1.25 (%), fosfori i asimilueshëm 34.5 (ppm); potasi i asimilueshëm 125,8 (ppm); aciditeti ujor 6.7; kripëzimi 0.72 ‰; rëra e trashë 25.45 (%); rëra e hollë 20.79 (%); lymi 32.18 (%); argjila 22.58 (%).

Skema e eksperimentit u ngrit në formën e bllokut të randomizuar, me tre përsëritje dhe pesë variante. Mbjellja e fidanëve në fushë u realizua brenda muajit maj, në distancat 70 cm midis rreshtave dhe midis bimëve në rresht sipas varianteve në distancat respektive: 15 cm, 25 cm, 35 cm, 45 cm dhe 55 cm. Në plehërimin bazë u përdorën 150 kg/ha  $P_2O_5$ , 120 kg/ha  $K_2O$  dhe 60 kg/ha azot. Gjatë vegetacioni, plehërat azotike u shpërndanë në dy doza, respektivisht 90 dhe 180 kg/ha, ku e para u përdor 15 ditë mbas mbjelljes në vendin e përhershëm dhe e dyta mbas 40 ditësh. Luftimi i barërave të këqia u realizua me anë të dy prashitjeve dhe një mbushjeje të bimëve. Në vitet e eksperimentit nuk ishte i nevojshme trajtimi i bimëve me anti parazitarë të ndryshëm. Ujitjet u kryen të rregullta, zakonisht çdo 10 – 15 ditë, sipas nevojave të bimëve.

Si kultivar u eksperimentua speci i tipit “Gogozhare”, i cili konsiderohet si një nga kultivarët tradicionalë më të preferuar për këtë zonë, Karakterizohet nga një formë sub-sferike, me ngjyrë të kuqe të errët në pjekje. Mbas çdo vjeljeje, frutat janë numëruar, peshuar dhe ndarë në dy kategori: për konsum të freskët dhe jashtë standardi (fruta të dëmtuara, të kalbëzuara, si dhe ato që nuk kanë formën dhe ngjyrën tipike të kultivarit). U kryen pesë vjelje, ku vjelja e parë u realizua 10 ditë më parë të gushtit, ndërsa e fundit nga mesi i muajit tetor. Në vjeljen e fundit u bë numërimi dhe peshimi edhe i frutave të pa pjekur,

të cilët nuk kishin asnjë vlerë tregëtare, por u llogaritën për të përcaktuar fuqinë prodhuese potenciale të bimëve. Në çdo gjashtë fruta, për secilin variant dhe për çdo vjelje, u bënë matjet e mëposhtëme: lartësia, diametri, trashësia e epikarpit (pjesa mishtore e frutit), lënda e thatë e perikarpit dhe e gjithë frutit, si dhe përqindja e perikarpit në raport me frutin e plotë.

Gjatë periudhës së vegjetacionit janë marrë të dhëna të tjera plotësuese si: fillimi i lulëzimit, lartësia dhe numri ndërnjësive në vjeljen e parë dhe të fundit, nyja ku është shfaqur lulja e parë dhe fruti i parë, si dhe lartësia nga toka e nyjes së parë lulore dhe frutifikuese. Në vjeljen e fundit, bimët u shkulën me gjithë rrënjë, u numëruan dhe u peshuan, nga ku u morr edhe një kampion për përcaktimin e lëndës së thatë. Të dhënat i janë nënshtruar analizës së variancës, ndërsa vlerat mesatare të disa prej treguesve u ballafaquan me testin e Duncanit.

### **Rezultatet dhe diskutimi i tyre**

Të dhënat eksperimentale tregojnë se numri i bimëve për njësi të sipërfaqes, ndikon në karakteristikat prodhuese dhe biometrike të frutave dhe bimëve të specit. Vlerat e karakteristikave të bimëve, me përjashtim të datës së lulëzimit, si rregull zvogëlohen me rritjen e hapësirës në dispozicion të bimëve. Lartësia e bimëve në fazën e lulëzimit ka rezultuar se është më e madhe në variantet me numër bimësh mbi  $8.3 \text{ bimë/m}^2$ , krahasuar me variantet me dendësi më të vogël se  $8.3 \text{ bimë/m}^2$ . Edhe në fund të periudhës së vegjetacionit, bimët me lartësi më të madhe u evidentuan gjithashtu në variantet me dendësi më të madhe të bimëve.

Nga të dhënat përcaktohet se dendësia e bimëve nuk ndikon në numrin e ndërnjësive të lulëzimit, në vendosjen e nyjes së parë prodhuese (zakonisht mbi nyjet 6 –7), si dhe të lartësisë së vendosjes së nyjes së parë prodhues (rreth 15 – 16 cm nga toka), (tabela nr 1.).

**Tabela nr. 1. Ndikimi i dendësisë së bimëve në disa karakteristika biometrike dhe prodhuese të specit “Gogozhar”.**

TREGUESIT MATUR	Dendësia bimë / m <sup>2</sup>				
	Variantet				
	11.1	8.3	4.8	3.7	2.6
E	70x15	70x25	70x35	70x45	70x55
<b>A. Matjet në bimë</b>					
- Lulëzimi (ditë mbas mbjelljes)	56 b	57 ab	57 ab	58 ab	60 a
- Lartësia e bimëve fillim i lulëzimit (cm)	25.1	22.4	18.5	17.6	17.2
- Lartësia e bimëve vjelja e parë (cm)	39.3	34.7	31.8	29.5	28.9
- Lartësia e bim në fund të ciklit (cm)	55.4 a	50.6 a	47.2 b	45.3 b	44.5 b
- Masa e gjelbër në fund të ciklit (kv/ha)	106 a	90 b	59 b	43 b	32 a
- Lënda e thatë (%)	24.2 a	14.1 a	10.2 b	8.5 b	8.3 b
<b>B. Matjet në frutat e të gjitha vjeljeve</b>					
- Pesha mesatare e frutave (gram)	77.2 b	81.1 b	89.9 a	89.0 a	85.3 a
- Diametri i frutave (mm)	71.0 c	74.3 a	77.6 ab	76.5 ab	75.8 b
- Fruta për treg (gram/bimë)	386.0 C	510.9 B	737.2 B	987.9 A	870.1 A
- Fruta për treg (numri/bimë)	5.0 C	6.3 B	8.2 B	11.1 A	10.2 A



- Prodhimi për treg (kv/ha)	428.5 A	388.5 A	362.7 AB	314.2 AB	201.0 B
V0. Shkronjat e vogla, vendosur në krah të disa prej vlerave numerike në tabelë, tregojnë vërtetësinë e të dhënave për nivelin 005P, ndërsa shkronjat e mëdha tregojnë vërtetësinë e të dhënave për nivelin 001P.					

Sasia e prodhimit për treg është më e madhe në variantet me dendësi më të vogël të bimëve, ndërsa prodhimi i përgjithshëm për njësi të sipërfaqes ka rezultuar më i madh në variantet me numër më të madh të bimëve për njësi të sipërfaqes. Prodhimi më i madh është marrë në variantet me numër të bimëve 11.1, 8.3, dhe 4.8 bimë/m<sup>2</sup>, (u morën respektivisht 419,28 kv/ha, 386.62 kv/ha dhe 302.60 kv/ha, krahasuar me variantet me dendësi më të vogël se 4.8 bimë/m<sup>2</sup>, ku respektivisht u morën 277.92 kv/ha dhe 206.40 kv/ha).

Prodhimi i destinuar për konsum për çdo bimë, ka rezultuar më i madh në variantet V4, V5 dhe V3, ku respektivisht janë marrë 849.2, 773,2 dhe 636.3 gram/bimë fruta për treg. Ndërkohë që në variantet me dendësi më të madhe, sasia e prodhimit të tregëtueshëm për bimë është më e vogël. Numri i frutave të tregëtueshëm për bimë ka pothuajse të njëjtën tendencë me prodhimin e frutave për bimë. Në kushtet e një dendësie më të madhe të bimëve, evidentohet një përqindje më e lartë e frutave jashtë standartit me rreth 16 %, krahasuar me dendësitë më të vogla se 4.8 bimë/m<sup>2</sup>, në të cilat përcaktohet dhe vlera më e lartë e diametrit të frutave.

Masa e gjelbër e mbetur mbas marrjes së prodhimit, si dhe sasia e lëndës së thatë të bimëve në fund të ciklit të prodhimit, rezultojnë në vlera më të mëdha në variantet me dendësi më të madhe të bimëve, krahasuar me dendësitë e tjera.

Frutat me peshë më të madhe janë marrë gjithashtu në kushtet e varianteve me dendësi 3.7, 4.8 dhe 8.3 bimë/m<sup>2</sup>, krahasuar me variantet e tjera. Përsa u përket vlerave prodhimit sipas vjeljeve të kryera, rezulton se në dy vjeljet e para merren mesarisht deri 35% të prodhimit total në variantet me dendësi 8.3 dhe 11.1 bimë/m<sup>2</sup>, krahasuar me rreth 25% që merren në variantet me dendësi më të vogël.

Nga të dhënat e studimi rezulton se frutat me peshë më të madhe janë marrë në tre vjeljet e para. Në vjeljen e parë, të dytë dhe të tretë, pesha respektive ka qënë 87.8, 88.0 dhe 85.4 gram, ndërsa frutat e vjeljes së katërt kanë rezultuar me peshë 80.2 gram dhe të vjeljes së fundit 65.4 gram. Diametri i frutave rezulton të jetë më i madh në frutat e vjeljes së dytë dhe të tretë, krahasuar me vjeljen e parë, të katërt dhe të pestë. Raporti lartësi/diametër i frutave është më i madh në vjeljen e pestë dhe më i vogël në të tretën, respektivisht 0.74 dhe 0.58 (tabela nr. 2).

**Tabela nr. 2: Disa karakteristika bio – morfologjike të frutve të specit “Gogozhar”**

Treguesit e matur	Koha e vjeljes				
	08/8	20/8	06/9	20/9	10/10
Pesha mesatare (gram)	87.8 a	88.0 a	85.4 a	80.2 a	65.4 b
Lartësia (cm)	47.6 a	47.9 a	47.0 b	46.5 b	45.0 b
Diametri (mm)	75.2 ab	76.0 a	81.4 ab	68.5 b	60.8 b
Raporti lartësi/diametër	0.63	0.63	0.58	0.68	0.74
Trashësia perikarpit (mm)	5.2	5.3	5.3	5.0	4.8
Pesha perikarpit (% të peshës)	74.8	75.6	75.4	75.0	75.3
Lënda thatë e perikarpit (%)	6.8 A	8.5 A	8.7 B	8.7 B	9.0 C
Lënda e thatë e frutave (%)	8.5 c	9.0 bc	10.4 a	10.8 a	10.8 ab

Lartësia (trashësia) e frutave ka rezultuar më e madhe në vjeljen e dytë, dhe më e vogël në vjeljen e fundit. Trashësia e epikarpit është evidentuar më e madhe në frutat e tri vjeljeve të para, ndërsa përqindja e lëndës së thatë të perikarpit ka qënë më e vogël në frutat e vjeljes së

parë, dhe vjen duke u rritur në frutat e vjeljeve të tjera. E njëjta tendencë evidentohet dhe në përmbajtjen e lëndës së thatë të frutave të plotë.

## **PËRFUNDIME**

- Të dhënat eksperimentale tregojnë se numri i bimëve për njësi të sipërfaqes, ndikon në karakteristikat prodhuese dhe biometrike të frutave dhe bimëve të specit. Parametrat biometrikë dhe fenologjikë, me përjashtim të kohës së lulëzimit, si rregull zvogëlohen me rritjen e hapësirës në dispozicion të bimëve. Lartësia e bimëve, si në fazën e lulëzimit, ashtu dhe në fund të periudhës së vegjetacionit, ka rezultuar më e madhe në variantet me dendësi më të madhe të bimëve.
- Dendësia e bimëve nuk ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në numrin e ndëryjeve të lulëzimit, si dhe në lartësinë e vendosjes së nyjes së parë prodhuese (rreth 15 – 16 cm).
- Sasia e prodhimit për treg, është më e madhe në variantet me dendësi më të vogël të bimëve, ndërsa prodhimi i përgjithshëm për njësi të sipërfaqes ka rezultuar më i madh në variantet me numër më të madh të bimëve.
- Në të gjitha variantet, dendësia e bimëve nuk ka ndikim të vërtetuar në peshën mesatare të frutave të vjela. Numri dhe pesha e frutave të tregtueshëm për bimë, rriten respektivisht me 58 dhe 66%, duke kaluar nga variantet me dendësi 4.8 bimë/m<sup>2</sup> në 3.7 bimë/m<sup>2</sup>, ndërsa prodhimi për njësi të sipërfaqes zvogëlohet me 26%.
- Në variantet me dendësi më të madhe të bimëve, evidentohet përqindje më e lartë e frutave jashtë përdorimit me rreth 16 %, krahasuar me dendësitë më të vogla se 4.8 bimë/m<sup>2</sup>. Po në këto kushte të fundit është evidentuar dhe vlera më e lartë e diametrit të frutave. Me rritjen e distancës midis bimëve, zvogëlohet edhe përqindja e frutave jashtë standardit.
- Masa e gjelbër e mbetur mbas marrjes së prodhimit, si dhe përqindja e lëndës së thatë të bimëve në fund të ciklit të prodhimit, rezultojnë në vlera më të mëdha në variantet

me dendësi më të madhe të bimëve, krahasuar me dendësitë e tjera.

- Përsa u përket niveleve të marrjes së prodhimit sipas vjeljeve të kryera, rezulton se në variantet me dendësi 8.3 dhe 11.1 bimë/m<sup>2</sup>, në dy vjeljet e para mund të merret mesatarisht deri 35% e prodhimit total, krahasuar me rreth 25% që merret në variantet me dendësi më të vogël të bimëve.
- Frutat me peshë më të madhe janë marrë në tri vjeljet e para, ndërsa diametri i frutave ka qenë më i madh në frutat e vjeljes së dytë dhe të tretë.

## BIBLIOGRAFIA

- Agarwal, A., Gupta, S. and Ahmed, Z. (2007). Influence of plant densities on productivity of bell pepper (*Capsicum annuum*) under greenhouse in high altitude cold desert of Ladakh. *Acta Hort.* 756.
- Alam, M.S., Saha, S.R., Salam, M.A. and Alam, M.K. (2011). Effect of sowing time and plant spacing on the yield and yield attributes of sweet pepper (*Capsicum annuum*). *Bangladesh J. Agril. Res.* 36(1).
- Aminifard, M.H., Aroiee, H., Ameri, A. & Fatemi, H. (2012). Effect of plant density and nitrogen fertilizer on growth, yield and fruit quality of sweet pepper (*Capsicum annuum* L.). *African Journal of Agricultural Research*, 7(6).
- Bianco V.V.; Pinpini F. (1990). - *Orticultura*. Bologna.
- Cavero, J., Ortega, R.G. & Gutierrez, M. (2001). Plant density affects yield, yield components, and color of direct seeded paprika. *HortScience*, 36(1). New Mexico
- Dasgan, H.Y. & Abak, K. (2003). Effects of plant density and number of shoots on yield and fruit characteristics of peppers grown in glasshouses. *Turkish Journal of Agriculture & Forestry*, 27.
- Idowu, A.O. (2011). Growth and yield of hot pepper (*Capsicum frutescens*) as influenced by bed width and within row spacing. Unpublished BSc Project, Department of Horticulture, University of Agriculture, Abeokuta.
- Islam, M., Saha, S., Akand, H. and Rahim, A. (2011). Effect of spacing on the growth and yield of sweet pepper (*Capsicum annuum* L.) *Journal of central European agriculture*, 12(2).

- Lorenzo, P., and N. Castilla. (1995). Bell pepper yield response to plant density and radiation in unheated plastic greenhouse. *Acta Horticulturae* 412.
- Maniutiu, D., Sima, R., Apahidean, A.S., Apahidean, M. & Ficior, D. (2010). The influence of plant density and shoot pruning on yield of bell pepper cultivated in plastic tunnel. *Bulletin UASVM Horticulture*, 67(1).
- Nasto, T.H., Balliu, A. and Zeka, N. (2009). The influence of planting density on growth characteristics and fruit yield of pepper (*Capsicum annuum* L.). *J. Acta Hortic.*, 830.
- Nasto, Th., Bardhi N. (2004) - Bazat e perimtarisë dhe prodhimi i perimeve. Tiranë.
- Seifi, S., Nemati, S.H., Shoor, M. & Abedi, B. (2012). The effect of plant density and shoot pruning on growth and yield of two greenhouse bell pepper cultivars. *Journal of Science and Technology of Greenhouse Culture*, 3(11).
- Tase, Ll, (1986) - Studimi i dendësisë së mbjelljes së specit tip "Gjelbëroshi". *B. SH. B. Nr. 4*, 1986, Tiranë.
- Tesi, R. (1994). - *Principi di orticultura e ortaggi di Italia* . Edagricole. Bologna.

ISSN: 2078-7111

Shtëpia botuese:

Tirazhi: 50 kopje

VITI XXVII I BOTIMIT, Nr. 33, 2022

BULETINI SHKENCOR

SCIENCE BULLETIN